



Republika e Shqipërisë
Ministria e Integritimit



Fjalorth për Integrimin European, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit European



Federal Ministry
for Economic Cooperation
and Development

Projekt i financuar nga Bashkimi European
(IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane

gtz

Mbështetje për Ministrinë e Integritimit European - SMEI II



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INTEGRIMIT

Fjalorth për Integrimin European, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit European

TIRANË, PRILL 2010

<i>Botim i:</i>	Ministrisë së Integritit
<i>Kontribuan:</i>	Eglantina Gollaj, Altin Fuga, Sairud Spahija, Ilir Baçi, Blerta Hoxha
<i>Redaktimi Gjuhësor:</i>	Mariana Ymeri, Denata Mesi
<i>Përgatiti për botim:</i>	Blerina Raça, MBA
<i>Ky botim u mundësua me mbështetjen financiare të:</i>	Bashkimit European (IPA 2008) dhe Qe- verisë Gjermane në kuadër të Projektit të GTZ “Mbështetje për Ministrinë e Integritit European - SMEI II”
<i>Përpunimi Grafik:</i>	Erald Lamja, Vignette Marketing Agency

Mospranim i përgjegjesisë:

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të
Bashkimit European

Dy fjalë për FJALORTHIN

Fjalorthi i mëposhtëm përmban 238 terma, në lidhje me integrimin Europian, si dhe me institucionet dhe veprimtaritë e Bashkimit Europian. Ky Fjalorth përditësohet rregullisht dhe përmban të gjitha ndryshimet e sjella nga Traktati i Lisbonës, si dhe nga projektndryshimet më të fundit për traktatet.

Përkufizimet e dhëna në të shpjegojnë se si kanë evoluar terma të veçanta dhe se si, kur është e nevojshme, iu referohen traktateve përkatëse. Informacioni historik, përgjigjet e pyetjeve se si punojnë institucionet, se çfarë procedurash ndiqen, se cilat fusha mbulohen nga politika e Komunitetit, si dhe përgjigje për shumë pyetje të tjera të kësaj natyre, mund të gjenden në këtë Fjalorth.

Përmbajtja

A

Abstenim, ~i konstruktiv (abstenim pozitiv)	15
Acquis e BE-së	15
Agjenci, ~të e Bashkimit European	16
Aksion, ~i i përbashkët (çështjet e drejtësisë dhe të punëve të brendshme)	16
Anëtarësim, ~ i Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin European	18
Arsim, ~i, Formimi profesional, Rinia dhe Sporti	18
Avokat, ~i i Popullit	19

B

Bankë, ~a Europiane e Investimeve	21
Bankë, ~a Qendrore Europiane	22
Bashkëpunim, ~i Gjyqësor në Çështjet Civile	22
Bashkëpunim, ~i më i ngushtë	23
Bashkëpunim, ~i Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale	24
Bashkëpunim, ~i Politik European	25
Bashkim, ~i Doganor	26
Bashkim, ~i Ekonomik dhe Monetar	26
Bashkim, ~i European	27
Bashkim, ~i European Perëndimor	28
Bashkim, ~i i Ndërmarrjeve	29
Bërthamë, ~a e fortë	29
Burime të veta	30
Bisedime, ~t për anëtarësim (aderim)	30
Buxhet, ~i	31

C

COREPER (Komiteti i Përfaqësuesve të Përherëshëm)	32
COREU (Korrespondenca Europiane)	32

D

Debat, ~i mbi të ardhmen e Bashkimit European	33
Deficit, ~i demokratik	34
Deklaratë, ~a (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)	35
Deklaratë, ~a e Lekenit	35
Detyrat e Petersbergut	35
Dialog, ~u social	36

E

E Drejtë, ~a e BE-së	37
E Drejtë, ~a e Nismës Legjislative	37
e-Europë, ~a	38
Ekuilibrë, ~i institucional	38
Energji, ~a	39
Eurojust	40
Europë, ~a “à la carte”	41
Europë, ~a me “gjeometri të ndryshme”	41
Europë, ~a me “ritëm të shpejtë”	41
Europol, ~i (Zyra Europiane e Policisë)	42

F

Fonde strukturore dhe Fondi i Kohezionit	43
Fond, ~i European për Zhvillim	44

G

Galileo	45
Globalizim, ~i i ekonomisë	45

GJ

Gjykatë, ~a Europiane e të Drejtave të Njeriut	46
Gjykatë, ~a Europiane e Llogarive	46
Gjykatë, ~a e Drejtësisë e Bashkimit European	47
Gjykatë, ~a e Përgjithshme	47

H

Harmonizim, ~i i taksave	49
Hierarki, ~a e akteve Komunitare (hierarkia e normave)	49

I

Identitet, ~i European i Mbrojtjes dhe Sigurisë	51
Iniciativë, ~a Qytetare	51
Institucione, ~t Europiane	51
Instrumente, ~t ligjore të Bashkimit European	52
i2010	53

K

Kartë, ~a e të Drejtave Themelore	54
Kartë, ~a Sociale (Karta e të Drejtave Sociale Themelore të Punëtorëve)	55
Kërkim, ~i dhe zhvillim, ~i shkencor	55
Këshill, ~i European	56
Këshill, ~i i Bashkimit European	56
Klasifikim, ~i i shpenzimeve	57
Klauzolë, ~a e mospjesëmarrjes (Opting out)	58
Klauzolë, ~a e pezullimit	58
Kodifikim, ~i i legjislacionit (formal/zyrtar)	58
Kohezion, ~i ekonomik, social dhe territorial	59
Komision, ~i European	60
Komisione, ~t parlamentare	61
Komitete, ~t dhe grupet e punës	61
Komitet, ~i European Ekonomik dhe Social	62
Komitet, ~i i krijuar në përputhje me nenin 36 të Traktatit të Bashkimit European	62
Komitet, ~i i Pajtitimit	63
Komitet, ~i i Punësimit	63
Komitet, ~i i Rajoneve	63
Komitet, ~i Politik dhe i Sigurisë	64
Komitologji, ~a	64
Kompetencë, ~a dytësore	66
Kompetencë, ~a të Bashkimit European	66

Kompetencë, ~a të Jashtme të Bashkimit European	67
Kompromis, ~i i Janinës	68
Kompromis, ~i i Luksemburgut	68
Komunitarizëm, ~i	69
Komunitet, ~i European	69
Konferencë, ~a Ndërqeveritare (KNQ)	70
Konfirmim, ~i i Komisionit European	71
Konkurrencë, ~a	71
Konkurrueshmëri, ~a	72
Konsolidimi i legjisllacionit –joformal/deklarues	73
Kontroll, ~i antitrust	73
Kontroll, ~i paraprak	73
Konventë, ~a Titulli V i TFBE (ish Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European)	74
Konventë, ~a Europiane	74
Konventë, ~a Europiane e Të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)	75
Kritere të konvergencës	76
Kritere, ~t e pranimit (Kritere të Kopenhagenit)	76
Kornizë, ~a Institucionale e Përbashkët	77
Kulturë, ~a	77

L

Lëvizje, ~a e lirë e personave (politika e vizave, azilit, emigracionit dhe të tjera)	79
Libra, ~t e Bardhë	79
Libra, ~t e Gjelbër	80
Luftë, ~a kundër drogës	80
Luftë, ~a kundër krimit të organizuar	81
Luftë, ~a kundër mashtrimit	81
Luftë, ~a kundër racizmit dhe ksenofobisë	82
Luftë, ~a kundër terrorizmit	83

M

Marrëveshje, ~a për Politikën Sociale	84
Masa, ~t për të luftuar pastrimin e parave	84
Mbrojtje, ~a e konsumatorit	85
Mbrojtje, ~a kolektive	85

Metodë, ~a e Hapur e Bashkëndimit	86
Metodë, ~a Komunitare dhe Ndërqeveritare	87
Mirëqenie, ~a e kafshëve	88
Mjedis, ~i	88
Mundësi të barabarta	89

N

NATO-ja (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)	91
NATO-ja “e rinovuar”	91
“Natyra 2000”	92
Ndihmë, ~a e paraanëtarësimi	92
Ndihmë, ~a humanitare	93
Ndihmë-a shtetërore	93
Ndihmë, ~a për zhvillim	94
Ndërmarrje, ~t e Vogla dhe të Mesme	95

O

Organizim, ~i i përbashkët i tregjeve bujqësore	96
Organizma Gjenetikisht të Modifikuar	96
Orientimet e Përgjithshme të Politikës Ekonomike	97

P

Pakt, ~i i Stabilitetit dhe i Zhvillimit	98
Parim, ~i i mosdiferencimit	98
Parim, ~i i proporcionalitetit	99
Parim, ~i parandalues	99
Parlamente, ~t kombëtare	100
Parlament, ~i European	101
Partitë politike Europiane	101
Partnerë, ~t socialë	102
Partneritet, ~i për anëtarësim	103
Patentë, ~a e Bashkimit European	103
Personalitet, ~i juridik i Bashkimit European	104
Perspektivë, ~a financiare	105
Peshim, ~i i votave në Këshill	105

Peticione, ~t	106
Përbërje, ~a e Komisionit European	107
Përfaqësues, ~i i lartë i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë	107
Përgatitje profesionale	108
Përgjegjësi, ~a mjedisore	109
Përgjegjësitë e jashtme të Komunitetit European	109
Politikë, ~a e fqinjësisë	110
Politikë, ~a ekonomike	110
Politikë, ~a e Përbashkët Bujqësore	111
Politikë, ~a e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë	112
Politikë, ~a e Përbashkët e Peshkimit	113
Politikë, ~a e Përbashkët e Transportit	114
Politikë, ~a e Përbashkët Tregtare	114
Politikë, ~a Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes	115
Politikë, ~a Monetare	116
Politikë, ~a për ndër marrjet	116
Politikë, ~a sociale	117
Presidencë, ~a e Këshillit të Bashkimit European	118
President, ~i i Këshillit European	118
President, ~i i Komisionit European	119
Procedurë, ~a e Bashkëpunimit	119
Procedurë, ~a e deficitit të tepërt	120
Procedurë, ~a e Vendimmarrjes së Përbashkët	121
Procedurë, ~a e Këshillimit	121
Procedurë, ~a e Pëlqimit	122
Procedurë, ~a Standarde Zgjedhore e Parlamentit European	123
Proces, ~i i Barcelonës	123
Proces, ~i i Stabilizimit dhe Asocimit	124
Program, ~i i Ndhmës Komunitare për Vende të Evropës Qendrore dhe Lindore (PHARE)	125
Prokurim, ~i publik	125
Pronësi, ~a intelektuale	126
Protokoll, ~i i Kiotos	126
Punësim, ~i	127

Q

Qartësi, ~a e Traktateve (Thjeshtimi i Traktateve)	129
Qeverisje, ~a	129
Qëndrim, ~i i përbashkët (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian)	130
Qëndrim, ~i i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)	130
Qytetari, ~a e Bashkimit Europian	130

R

Rajone, ~t më të largëta	132
REACH (Kudri Rregullator për Kimikatet)	132
Riformulim, ~i i legjislacionit	133
Rini, ~a	133
Rishikim, ~i i Traktateve	134

RR

Rrathë, ~t bashkëqendrorë	135
Rrjete, ~t ndërEuropiane	135
Rrjet, ~i Gjyqësor Europian për Çështjet Penale	136

S

Siguri, ~a ushqimore	137
Statut, ~i për deputetët e Parlamentit Europian	138
Strategji, ~a e Lisbonës	138
Strategji, ~a e paraanëtarësimit	139
Strategji, ~a e përbashkët (Politikë e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)	140
Strategji, ~a Europiane për Punësim	140
Statut, ~i i Shërbimit Publik	141
Subsidiaritet, ~i	142

SH

Shengen (Marrëveshje dhe Konventa)	143
Shëndet, ~i publik	143
Shërbime, ~t audiovizive	144
Shërbim, ~i Europian i Marrëdhënieve me Jashtë	145

Shërbime, ~t me interes ekonomik të përgjithshëm	145
Shërbime, ~t me interes të përgjithshëm	145
Shërbim, ~i publik	146
Shërbim, ~i universal	146
Shoqëri, ~a Europiane	147
Shoqëri, ~a e Informacionit	147
Shpërndarje, ~a e kompetencave	148
Shtylla të Bashkimit European	148
Shumicë, ~a e cilësuar	149
Shumicë, ~a e cilësuar e përforcuar	149
Shumicë, ~a e dyfishtë	150

T

Taksim, ~i	151
Telekomunikacion, ~i ose komunikime elektronike	152
Televizion, ~i pa kufij	152
Të drejta, ~t të njeriut	153
Trajtim, ~i i barabartë i burrave dhe grave	154
Traktatet	154
Traktat, ~i i Amsterdami	155
Traktat, ~i i Lisbonës	156
Traktat, ~i i Nisës	156
Transparencë, ~a (E Drejta për Përdorim të Dokumenteve)	157
Transparencë, ~a e seancave të Këshillit	158
Trojkë, ~a	159

TH

Thellim, ~i	160
Thjeshtim, ~i i legjislacionit	160

U

Unanimitet, ~i	162
“Urë” Komunitare (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European)	162
Urdhër, ~i European i Arrestit	163

V

Vende, ~t candidate	164
Vendim, ~i dhe Vendim, ~i Kuadër (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European)	164
Veprim, ~i i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe Sigurisë)	165
Veprim, ~i i përbashkët (Drejtësia dhe Punët e Brendshme)	165
Vëzhgim, ~i i zbatimit të së drejtës së Bashkimit European	165

Z

Zgjerim, ~i	167
Zonë, ~a Europiane e Kërkimit Shkencor	167
Zonë, ~a e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë	168
Zyrë, ~a Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF)	169
Zyrë, ~a e Shkëmbimit të Informacionit për Ndhimën Teknike (TAIEX)	169

ZH

Zhvillim, ~i i qëndrueshëm	171
Zhvillim, ~i rural	172

SHTOJCË

TERMAT E FJALORIT SIPAS RENDIT ALFABETIK NË ANGLISHT	173
--	-----



Abstenim, -i konstruktiv (abstenim pozitiv) / Abstention, constructive (positive abstention)

Me “abstenim konstruktiv” nënkuptohet mundësia e një Shteti Anëtar për të abstenuar nga votimi në Këshill, në lidhje me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS), pa i penguar Shtetet e tjera Anëtare që të marrin një vendim unanim.

Mundësia për abstenim konstruktiv u vendos nga Traktati i Amsterdimit (ish-neni 23 i Traktatit të Bashkimit Europian, me Traktatin e Lisbonës neni 31 TBE). Në qoftë se abstenimi shoqërohet me një deklaratë zyrtare, Shteti Anëtar, i cili ka abstenuar, nuk është i detyruar të zbatojë vendimin, por duhet të pranojë që vendimi të jetë i detyrueshëm për Bashkimin Europian. Shteti Anëtar nuk duhet të ndërmarrë asnjë veprim që mund të jetë në kundërshtim ose të pengojë Bashkimin Europian të veprojë në përputhje me këtë vendim.

Në përputhje me nenin 31 të Traktatit të Bashkimit Europian (përpara Traktati të Lisbonës, neni 23 të Traktatit të Bashkimit Europian), vendimi nuk mund të miratohet, në qoftë se anëtarët e Këshillit, të cilët i bashkëngjisin abstenimit të tyre një deklaratë të tillë, përbëjnë më shumë se një të tretën e votave të peshuara.

Shiko:

- Politikë e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Traktati i Amsterdimit
- Peshimi i votave në Këshill

Acquis e BE-së / EU Acquis

Acquis e BE-së (përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës e njohur si Acquis Communautaire) është tërësia e të drejtave dhe e detyrimeve të përbashkëta që i bashkon të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian. Acquis e BE-së ndryshon vazhdimisht, nëpërmjet miratimit të akteve të reja, ndryshimit apo shfuqizimit të atyre aktuale. Acquis përfshin:

- përmbajtjen, parimet dhe qëllimet politike të Traktateve;
- legjislacionin e miratuar në zbatim të traktateve dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian;
- deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga Bashkimi Europian;
- masat në lidhje me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë;
- masat në lidhje me drejtësinë dhe punët e brendshme;

marrëveshjet ndërkombëtare të përfunduara nga Komuniteti dhe marrëveshjet e përfunduara nga Shtetet Anëtare ndërmjet njëra-tjetrës në fushën e veprimtarive të Bashkimit Europian. Kështu, Acquis e BE-së përfshin të drejtën e BE-së në kuptim të ngushtë, si dhe objektivat e përbashkëta të parashikuara në Traktate. Bashkimi Europian është angazhuar të ruajë Acquis-në e BE-së e në tërësinë e tij dhe ta zhvillojë atë më tej.

Vendet që aspirojnë të bëhen Anëtare të BE-së, duhet ta pranojnë Acquis-në e BE-së përpara se të bashkohen me Bashkimin Europian. Shmangiet nga Acquis e BE-së Communautaire janë bërë vetëm në rrethana të veçanta dhe janë të kufizuara në qëllim. Shih:

- Traktati i Lisbonës

Anëtarësim, ~i i Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin Europian /

Anëtarësimi i Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin Europian rregullohet në nenin 49 të Traktatit të Bashkimit Europian. Shteti që dëshiron të bëhet anëtar i Bashkimit Europian duhet të plotësojë dy kushte:

- të jetë shtet Europian;
- të respektojë parimet e lirisë, demokracisë, të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe zbatimin e ligjit. (neni 6, paragrafi i parë i Traktatit të Bashkimit Europian).

Këshilli vendos nëse një shtet kandidat do të pranohet si anëtar i Bashkimit Europian. Këshilli, pas konsultimit me Komisionin dhe marrjes së pëlqimit të Parlamentit Europian, e merr vendimin e tij unanimisht.

Kushtet dhe data e pranimit, çdo periudhë kalimtare e mundshme dhe përshtatjet e nevojshme të traktateve mbi të cilat është themeluar Bashkimi Europian, duhet të përcaktohen në formën e një traktati, pranimi mes shtetit kandidat dhe Shteteve Anëtare.

Pranimi në Bashkimin Europian formalizohet përmes ratifikimit të traktatit të pranimit nga të gjitha Shtetet Anëtare dhe vendit kandidat, në përputhje me rregullat e tyre kushtetuese.

Pranimi nuk ndodh në mënyrë automatike, sepse ai varet nga situata në çdo shtet kandidat. Prandaj, zgjatja e periudhës së para-pranimit varet nga koha që i duhet shtetit kandidat që të përshtasë institucionet, standardet dhe infrastrukturën e tij, në mënyrë që të përmbushë detyrimet e tij si Shtet Anëtar në momentin e pranimit.

Traktati i Lisbonës nuk parashikon ndryshime thelbësore përsa i përket procedurave të anëtarësimit. Megjithatë, sipas Traktit të Lisbonës shtetet që aplikojnë për anëtarësim duhet të njoftojnë Parlamentin Europian lidhur me aplikimin e tyre ndonëse vendimi përfundimtar merret nga Këshilli Europian.

Shiko:

- Zgjerim
- Vende candidate

Agjencitë e Bashkimit Europian / European Union agencies

Agjencitë e Bashkimit Europian janë organe publike të krijuara sipas së Drejtës Publike Europiane dhe që gëzojnë personalitet juridik. Ato janë krijuar nga një akt i legjislationit dytësor të Komunitetit për të kryer detyra të veçanta teknike, shkencore ose administrative.

Agjencitë e para u krijuan në vitet '70, por shumica e tyre filluan të funksionojnë në vitin 1994 ose 1995, në vijim të vendimit të Këshillit Europian të Brukselit (tetor 1993), për ngritjen e selive të 7 prej agjencive. Agjencitë e fundit që janë krijuar, janë organe administrative të ngritura për të menaxhuar një ose disa programe të Bashkimit Europian. Këto organe janë krijuar për një periudhë të caktuar dhe janë të vendosura në Bruksel ose Luksemburg.

Tani për tani, 29 organe plotësojnë kushtet e përkufizimit të një agjencie të Bashkimit Europian, megjithëse për t'i përshkruar këto organe përdoren terma të ndryshëm (qendër, institut, agjenci, zyrë, qendër vëzhgimi).

Si organe të pavarura, agjencitë janë një grup heterogjen, por me të njëjtin ndërtim organizativ. Agjencitë mund të ndahen në tri nëngrupe, në përputhje me fushën e aktivitetit të BE-së. Këtyre agjencive u janë shtuar kohët e fundit edhe Agjencitë Administrative.

Agjenci Komunitare:

- OHIM – Zyra për Harmonizimin e Tregut të Brendshëm (Markat Tregtare dhe Skicat), e vendosur në Alikante (Spanjë);
- CPVO – Zyra Komunitare e Varieteteve të Bimëve, Anzhe (Francë);

- ERA – Agjencia Europiane e Rindërtimit, Selanik (Greqi);
- EMEA – Agjencia Europiane e Medikamenteve Mjekësore, Londër (Britani e Madhe);
- EFSA – Autoriteti European i Sigurisë Ushqimore, Parma (Itali);
- EMSA – Agjencia Europiane e Sigurisë së Llundrimit Detar, Lisbonë (Portugali);
- EASA – Agjencia Europiane e Sigurisë në Fluturimin Ajror, Këln (Gjermani);
- ENISA – Agjencia Europiane e Sigurisë së Rrjeteve Informatike dhe Informacionit, Heraklion (Greqi);
- EU-OSHA – Agjencia Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Bilbao (Spanjë);
- ECDC – Qendra Europiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve, Stokholm (Suedi);
- CEDEFOP – Qendra Europiane për Zhvillimin e Përgatitjes Profesionale, Selanik (Greqi);
- EEA – Agjencia Europiane e Mjedisit, Kopenhagën (Danimarkë);
- EUROFOUND – Fondacioni European për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës dhe të Punës, Dublin (Irlandë);
- EMCDDA – Qendra Europiane e Monitorimit të Drogave dhe Abuzimit me Drogat, Lisbonë (Portugali);
- EFRA – Agjencia Europiane e të Drejtave Themelore të Njeriut, Vjenë (Austri);
- ERA – Agjencia Europiane e Transportit Hekurudhor, Valansie dhe Lilë (Francë);
- ETF – Fondacioni European i Përgatitjes Profesionale, Torino (Itali);
- CdT – Qendra e Përkthimit për Organet e Bashkimit European, Luksemburg;
- CFCA – Agjencia Komunitare për Kontrollin e Peshkimit, Vigo (Spanjë);
- FRONTEX – Agjencia Europiane për Administrimin e Bashkëpunimit Operativ të Kufijve të Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit European, Varshavë (Poloni);
- ECHA – Agjencia Europiane e Kimikateve, Helsinki (Finlandë);
- GNSS - Autoriteti Mbikëqyrës i Sistemit European Satelitor, Bruksel (Belgjikë).

Agjencitë në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë:

- EDA – Agjencia Europiane e Mbrojtjes, Bruksel (Belgjikë);
- EUISS – Instituti i Bashkimit European për Studime Sigurie, Paris (Francë);
- EUSC – Qendra Satelitore e Bashkimit European, Madrid (Spanjë).

Agjencitë në fushën e bashkëpunimit policor dhe të drejtësisë në çështjet penale:

- Eurojust – Njësia e Bashkëpunimit Gjyqësor të Bashkimit European, Hagë (Holandë);
- Europol – Zyra e Policisë Europiane, Hagë (Holandë);
- CEPOL – Akademia Europiane e Policisë, Bramshill (Britani e Madhe).

Agjencitë administrative:

- Agjencia Administrative për Shkollimin, Median Audiovizuale dhe Kulturën, Bruksel (Belgjikë);
- Agjencia Administrative për Shëndetin Publik, Luksemburg;
- Agjencia Administrative e Energjisë Inteligjente, Bruksel (Belgjikë).

Shiko:

- Komunitet European
- Shtyllat e Bashkimit European
- Politikë e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Bashkim European

Aksion, ~i i përbashkët (çështje të drejtësisë dhe të punëve të brendshme) / Common action (justice and home affairs)

Aksioni i përbashkët ishte një instrument ligjor i bazuar në ish-kapitullin VI të Traktatit të Bashkimit Europian. Ky instrument u përdor gjatë periudhës 1993-1999. Ai nënkuptonte Aksion të Bashkërenduar nga Shtetet Anëtare në emër të Bashkimit Europian ose brenda kornizës së Bashkimit Europian në rastet në të cilat, për shkak të masës ose pasojave të aksionit të parashikuar, qëllimet e Bashkimit Europian mund të arriheshin në mënyrë më efektive nëpërmjet Aksionit të Përbashkët, sesa nëpërmjet veprimeve vetjake të Shteteve Anëtare. Ky instrument u shfuqizua nga Traktati i Amsterdimit dhe është zëvendësuar nga “vendimet” dhe “vendimet kuadër”.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës vendimet kuadër janë shfuqizuar.

Shiko:

- Vendim dhe Vendim Kuadër (kapitulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian)
- Rrjet Gjyqësor Europian për Çështje Penale (RREGJ)

Arsim, ~i, Formim, ~i profesional, Rinia dhe Sporti / Education, Training, Youth and Sports

Çdo Shtet Anëtar është përgjegjës për organizimin e sistemeve të tij të arsimit dhe përgatitjes profesionale, si dhe përmbajtjen e programeve mësimore. Në përputhje me nenin 165 të Traktatit mbi Funksonimin e Bashkimit Europian (ish neni 149 TKE) dhe nenit 166 TFBE (ish neni 150 TKE) të Traktatit të Komunitetit Europian, roli i Komunitetit është të kontribuojë në zhvillimin e arsimit cilësor, duke nxitur bashkëpunim ndërmjet Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme, duke përkrahur dhe plotësuar veprimin e tyre. Komuniteti synon veçanërisht që të zhvillojë shtrirjen Europiane të arsimit, të mbështesë shkëmbimin e informacionit rreth çështjeve të përbashkëta të sistemeve të arsimit të Shteteve Anëtare.

Sipas Traktatit të Lisbonës, Bashkimi Europian do të kontribuojë në çështjet e sportit europian duke marrë në konsideratë dhe veçoritë e llojeve të sporteve, strukturat e tyre bazuar në aktivitetet vullnetare si dhe funksionin e tij edukues dhe social. Për këtë arsye, qëllimet konkrete të Bashkimit Europian janë:

- zhvillimi i dimensionit europian në edukim, veçanërisht nëpërmjet mesimdhënies dhe përhapjes së gjuhëve të Vendeve Anëtare;
- inkurajimit të lëvizjes së studentëve dhe mësuesve duke inkurajuar ndër të tjera njohjen reciproke të diplomave akademike dhe periudhën e studimit;
- promovimit të bashkëpunimit të strukturave të edukimit;
- zhvillimit të shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencave për çështjet e përbashkëta në sistemin arsimor të vendeve anëtare;
- mbështetjes së zhvillimit të shkëmbimit të të rinjve dhe të shkëmbimit të instruktorëve edukativo-social dhe mbështetjes së pjesëmarrjes së të rinjve në jetën demokratike të Europës;
- mbështetjes së zhvillimit të mësimin në distance;
- zhvillimit të dimensionit europian të sportit duke promovuar ndershmërinë dhe konkurrencën në sport dhe bashkëpunimin e strukturave sportive dhe duke mbrojtur dinjitetin moral dhe fizik të sportistëve dhe veçanërisht sportistëve të rinj;

Bashkimi Europian dhe vendet anëtare duhet të nxisin bashkëpunimin me vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare përgjegjëse në këtë fushë veçanërisht në kuadër të Këshillit të Europës .Ai synon, po ashtu, që të nxisë lëvizshmërinë dhe bashkëpunimin në nivel Europian dhe ndërkombëtar. Bashkimi Europian ka në dispozicion të tij mjete të veçanta,

të cilat synojnë që të forcojnë mirëkuptimin e ndërsjelltë, mësimin e gjuhëve të huaja dhe përdorimin e teknologjive të reja, duke nxitur në të njëjtën kohë njohjen e aftësive dhe kualifikimeve. Këto mjete janë:

- Programi i veprimit në nivelin e Bashkimit Europian i formimit të vazhdueshëm, i cili përmbledh programet sektoriale vijuese: “Comenius” (arsimimi parashkollor dhe shkollor), “Erasmus” (edukimi i lartë, arsimimi dhe përgatitja e lartë profesionale), “Leonardo da Vinci” (arsimimi dhe përgatitja profesionale në nivele të tjera të ndryshme nga ajo e lartë), “Grundtvig” (arsimimi për të rriturit), programi i ndërthurur (fushat që mbeten jashtë katër programeve të përmendura më sipër), dhe programi “Zhan Mone” (integrimi Europian i universiteteve dhe mbështetja për disa institucione dhe shoqata të veçanta, të cilat janë aktive në fushën e arsimit në nivel Europian);
- Programet për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë, të tilla si për shembull, programi “Erasmus Mundus”, i cili zbatohet ndërmjet Bashkimit Europian dhe vendeve të treta dhe synon përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në Evropë dhe ta kthejë atë në një qendër të njohurive të përparuara. Gjithashtu ekzistojnë edhe programet rajonale, “Tempus” (Ballkani perëndimor, Europa Lindore, Azia Qendrore dhe vendet partnere të Mesdheut), “Alfa” (Amerika Latine), dhe “Asia-link” (Azia) që synojnë modernizimin e arsimit të lartë në vendet partnere të Bashkimit Europian.

Arsimimi është pjesë e arritjes së pikësnyimeve të Strategjisë së Lisbonës (“Të bëhemi ekonomia më konkurruese dhe dinamike, e bazuar në zhvillimin e njohurive, në botë”). Në këtë kontekst, Komisioni e ka përforcuar bashkëpunimin politik në fushën e arsimit, veçanërisht përmes metodës së hapur të bashkërendimit.

Shiko:

- eEurope
- i2010
- Rini
- Metodë e hapur e bashkërendimit
- Proces i Stabilizim-Asociimit
- Strategjia e Lisbonës
- Përgatitje profesionale
- Politikë e Fqinjësisë

Avokat, ~i i Popullit / Ombudsman

Institucioni i Avokatit Europian të Popullit u krijua nga Traktati i Bashkimit Europian (Mastriht, 1992) për të siguruar administrimin e mirë dhe transparencën administrative në nivelin e institucioneve të Bashkimit Europian.

Avokati i Popullit emërohet nga Parlamenti Europian, pas zgjedhjes së çdo legjislatore të re, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Tërësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij, aika të drejtë të pranojë ankesa në lidhje me rastet e keqadministrimit në veprimtarinë e institucioneve të Komunitetit apo të organeve të Komunitetit (me përjashtim të Gjykatës Europiane të Drejtësisë), nga çdo qytetar i Bashkimit Europian, apo çdo person fizik ose juridik me banim në një Shtet Anëtar. Ankesat mund të kenë të bëjnë, për shembull, me mungesën ose mohimin e së drejtës për t’u informuar, vonesa administrative të papërligjura, me praktika të padrejta a diskriminuese ose me mungesën e tejkudshmërisë.

Avokati i Popullit mund të fillojë një hetim me nismën e tij ose mbi bazën e një ankese.

Ankesat mund t'i paraqiten Avokatit të Popullit drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet anëtarit të Parlamentit European.

Në rast se Avokati i Popullit vëren se ka të bëjë me një gabim ose pakujdesi, ai ia referon çështjen institucionit përkatës, heton, kërkon një zgjidhje për ndreqjen e problemit dhe, në rast se është e nevojshme, dorëzon projekt-rekomandime për të cilat institucioni duhet të përgjigjet me anë të një raporti të hollësishëm brenda tre muajve. Në qoftë se institucioni në fjalë nuk bie dakord me rekomandimet e propozuara, atëherë Avokati i Popullit nuk ka të drejtë që të urdhërojë zgjidhjen e problemit. Megjithatë, Avokati i Popullit mund të paraqesë një raport të veçantë në lidhje me këtë çështje përpara Parlamentit European, në mënyrë që ai të marrë masat e përshtatshme.

Avokati i Popullit i paraqet raporte vjetore Parlamentit European.

Shiko:

- Qytetari e Bashkimit European
- Gjykata Europiane e Drejtësisë
- Parlament European
- Peticione

B

Bankë, ~a Europiane e Investimeve / European Investment Bank (EIB)

Banka Europiane e Investimeve, e krijuar nga Traktati i Romës, është institucioni financiar i Komunitetit. Detyra e saj është të kontribuojë në kohezionin ekonomik, social dhe territorial përmes zhvillimit të ekuilibruar të territorit të Bashkimit Europian.

27 Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian janë aksionerë të Bankës Europiane të Investimeve. Banka administrohet nga Bordi i Guvernatorëve, i cili përbëhet nga 27 ministrat e financave. Banka Europiane e Investimeve gëzon personalitet juridik dhe është e pavarur nga ana financiare. Ajo siguron financim afatgjatë për projekte praktike për të cilat është provuar leverdia ekonomike, teknike, mjedisore dhe financiare. Banka Europiane e Investimeve jep kredi kryesisht nga mjetet financiare të marra hua në tregjet e kapitaleve, të cilave u shtohet kapitali i aksionarëve. Gjatë periudhës 1994-1999, Banka ishte veçanërisht aktive në sektorë të tillë, si: transporti, telekomunikacioni, energjia, furnizimi me ujë, arsimit dhe përgatitja profesionale.

Sipas nenit 309 TFBE (ish neni 267 TKE), detyra e Bankës Europiane të Investimeve do të jetë që të kontribuojë, nëpërmjet aksesit në tregun e kapitalit dhe duket përdorur burimet e veta, tek zhvillimi i balancuar dhe i qëndrueshëm i tregut të brendshëm të BE-së. Për këtë qëllim ajo do të veprojë si një organizëm jo fitimprurës, do të japi hua, dhe do të japë garanci të cilat do të lehtësojnë financimin e këtyre projekteve në të gjithë sektorët e ekonomisë :

(a) projekte për zhvillimin e rajoneve më pak të zhvilluara;

(b) projekteve për modernizimin ose konvertimin e ndërmarrjeve ose për zhvillimin e aktiviteteve të reja të cilat kërkohen në kuadër të zhvillimit të tregut të brendshëm, kur këto projekte janë të asaj natyre dhe të atyre përmasave që nuk mund të financohen plotësisht nga mjete të ndryshme financiare që kanë shtete anëtare të BE-së;

(c) projekt në interes të përbashkët të disa shteteve anëtare të cilat janë të atyre përmasave dhe asaj natyre që nuk mund të financohen plotësisht nga një shtet anëtar;

Për të kryer këtë funksion, Banka do të lehtësojë financimin e programeve të investimit së bashku me ndihmën nga Fondet Strukturore dhe Instrumentet e tjera financiare të BE-së. Këshilli Europian, në mbledhjen e tij në mars të vitit 2000 në Lisbonë, bëri thirrje për forcimin e përkrahjes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Grupi Banka Europiane e Investimeve (BEI), i cili përfshin Bankën Europiane të Investimeve dhe Fondin Europian të Investimeve (FEI), u krijua për të rritur konkurrueshmërinë ekonomike Europiane. Grupi BEI synon që përmes nismës "Inovacioni 2000" të nxisë aktivitetin sipërmarrës, risitë dhe përdorimin sa më të mirë të burimeve njerëzore, duke u dhënë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme kredi afatmesme, garanci bankare, si dhe duke financuar pjesë të kapitalit në biznese me rrezik të lartë.

Jashtë Bashkimit Europian, Banka Europiane e Investimeve përkrah strategjitë e paraantarësimit të vendeve kandidatë dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor. BEI realizon në mënyrë të ngjashme aspektin financiar të marrëveshjeve të përfunduara si pjesë e politikave Europiane të bashkëpunimit dhe ndihmës për zhvillim. Në lidhje me këtë, Banka i ofron ndihmë vendeve të Mesdheut, si edhe shteteve të Afrikës, Karaibeve dhe Paqësorit (vendeve AKP).

Shiko:

- Kohezion ekonomik, social dhe territorial
- Zgjerim
- Rrjet Trans-Europiane (RRTE)

Bankë, ~a Qendrore Europiane / European Central Bank (ECB)

Banka Qendrore Europiane (BQE), e themeluar në 30 qershor 1998 në Frankfurt të Gjermanisë, është përgjegjëse për politikën monetare në të gjithë vendet e Eurozonës. Që nga 1 janari 1999, detyrat e saj kryesore janë ruajtja e stabilitetit të çmimeve në Eurozonë dhe zbatimi i politikës monetare Europiane, të përcaktuar nga Sistemi Europian i Bankave Qendrore (SEBQ).

Organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Europiane (Bordi ekzekutiv dhe Këshilli drejtues), drejtojnë Sistemin Europian të Bankave Qendrore (SEBQ), që ka për detyrë të menaxhojë qarkullimin e parasë, të kryejë veprimet e shkëmbimit të valutës së huaj, ruajtjen dhe menaxhimin e rezervave shtetërore në valutë të huaj të Shteteve Anëtare, si dhe të sigurojë funksionimin sa më të mirë të sistemit të pagesave.

BQE vepron në mënyrë krejtësisht të pavarur.

Traktati i Nisës, i miratuar në dhjetor 2000, nuk e ndryshoi përbërjen e Këshillit drejtues të Bankës Qendrore Europiane (i përbërë nga anëtarët e bordit ekzekutiv dhe guvernatorët e bankave qendrore kombëtare), por lejoi ndryshime në rregullat e vendimmarrjes (vendimet përgjithësisht miratohen me shumicë të thjeshtë, ku secili shtet ka një votë).

Zgjerimi i mëtejshëm i Eurozonës do të çojë në rritjen e numrit të anëtarëve të Këshillit drejtues. Prandaj Këshilli, me një vendim të marrë në mars të vitit 2003, ndryshoi rregullat e votimit në statutet e BQE dhe SEBQ, me qëllim që të ruhej aftësia e Këshillit drejtues për të marrë vendime në mënyrë efektive në një Eurozonë të zgjeruar, pavarësisht nga numri i Shteteve Anëtare që përdorin Euro-n.

Traktati i Lisbonës për herë të parë konfirmon statusin e Bankës Qendrore Europiane si një institucion i BE-së, çka do të thotë që ajo mund të paditet në Gjykatën e Drejtësisë për veprime apo mosverprime nga ana e saj.

Shiko:

- Kriteria të konvergjencës
- Bashkim Ekonomik dhe Monetar (BEM)

Bashkëpunim, ~i më i ngushtë / Enhanced cooperation

Bashkëpunimi i zgjeruar krijon mundësinë për një bashkëpunim më të ngushtë të ndërsjellë mes Shteteve të Bashkimit Europian që dëshirojnë ta çojnë integrimin Europian edhe më tej, brenda kuadrit institucional të përbashkët të Bashkimit Europian. Në këtë mënyrë, Shtetet Anëtare që dëshirojnë të fillojnë një bashkëpunim të tillë, vendosin vetë se sa shpejt do të ecin përpara dhe/ose se cilat qëllime do të ndjekin. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Bashkëpunimi i zgjeruar lejon zgjerimin e kompetencave të përcaktuara në Traktate. Për më tepër, bashkëpunimi i zgjeruar duhet të ndërmerret vetëm si mënyra e fundit për të zgjeruar bashkëpunimin, pasi Këshilli të ketë arritur në konkluzionin se qëllimet e bashkëpunimit nuk mund të arrihen, brenda një periudhe kohore të arsyeshme, duke përdorur rregullat përkatëse të Traktateve.

Rregullat e përgjithshme për Bashkëpunimin e zgjeruar u përcaktuan nga Traktati i Bashkimit Europian (Titulli III TFBE) dhe vlejnë si për Bashkimin Europian, ashtu edhe për Komunitetin Europian. Në parim, bashkëpunimi i zgjeruar duhet të përfshijë të paktën nëntë Shtete Anëtare, por ai mbetet i hapur për çdo Shtet Anëtar që dëshiron të marrë pjesë në të. Ky bashkëpunim nuk duhet të krijojë diskriminim mes shteteve që marrin pjesë

në të dhe shteteve të tjera. Po ashtu, Bashkëpunimi i zgjeruar duhet që të kontribuojë në realizimin e qëllimeve të Traktatit dhe të respektojë në tërësi legjislacionin komunitar dhe kompetencat e palëve të ndryshme. Ai nuk mund të përdoret në një fushë bashkëpunimi që është brenda kompetencave ekskluzive të Komunitetit.

Përveç rregullave të përgjithshme, Traktatet e veçanta mund të vendosin ose të shtojnë rregulla të veçanta, si në rastin e neneve 326-334 TFBE (ish nenet 11 dhe 11A TKE). Sipas Traktatit të Komunitetit Europian, për shembull, nisma për fillimin e Bashkëpunimit më të ngushtë merrej nga Komisioni Europian, mbi bazën e kërkesës së Shteteve Anëtare që dëshirojnë të marrin pjesë në bashkëpunimin e zgjeruar, ndërsa sipas Traktatit të Bashkimit Europian, ishin Shtetet Anëtare që merrnin nismën për Bashkëpunimin më të ngushtë. Në çdo rast, kërkesa për Bashkëpunim të zgjeruar i paraqitet Këshillit, i cili vendos për të me shumicë të cilësuar. Bashkëpunimi i zgjeruar mund të përdoret, po ashtu, edhe në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS), me përjashtim të çështjeve ushtarake dhe të mbrojtjes.

Traktati i Amsterdimit e përfshiu konceptin e “Bashkëpunimit të zgjeruar” në Traktatin e Bashkimit Europian, në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale dhe në Traktatin themelues të Komunitetit Europian. Traktati i Nisës paraqiti ndryshime të mëdha që synonin ta thjeshtonin mekanizmin e Bashkëpunimit të zgjeruar. Në mënyrë të veçantë, një Shtet Anëtar nuk mund ta kundërshtonte fillimin e një Bashkëpunimi të zgjeruar, gjë e cila në fillim lejohej nga Traktati i Amsterdimit.

Sipas nenit 10 paragrafi 4 të Traktatit të Lisbonës, aktet e miratuara në kuadër të bashkëpunimit më të ngushtë do të jenë të detyrueshme vetëm për shtetet pjesëmarrëse. Ato nuk do të konsiderohen si pjesë e *acquis* që duhet pranuar nga shtetet kandidatë për t'u integruar në Bashkimin Europian.

Shtetet anëtare duhet të marrin një autorizim nga Këshilli përpara se të marrin pjesë në bashkëpunimin më të ngushtë dhe ato duhet të përgjigjen për të gjitha kostot që vijnë nga miratimi i masave në kuadër të bashkëpunimit më të ngushtë.

Traktati i Lisbonës mundëson bashkëpunimin më të ngushtë në lidhje me bashkëpunimin gjyqësor për çështjet penale. Disa nga masat e miratuara në kuadër të bashkëpunimit më të ngushtë për këtë fushë janë subjekt i dispozitave “emergency brake” (freri i emergjencës). Çka do të thotë që, në rast se një Shtet Anëtar pretendon që një ligj i miratuar në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë mund të prekë aspekte themelore të sistemit të tij të drejtësisë penale, ky ligj i dërgohet Këshillit Europian dhe procedura legjislative e zakonshme pezullohet. Megjithatë, nëse të paktën nëntë shtete vendosin të vazhdojnë me miratimin e kësaj mase, ato duhet të njoftojnë Parlamentin Europian, Komisionin dhe Këshillin dhe në këtë rast autorizimi për bashkëpunimin më të ngushtë quhet i dhënë.

Shiko:

- Europa “à la carte”
- Bërthamë e fortë
- Europa “me shumë shpejtësi”
- Shengen (Marrëveshja dhe Konventa)
- Kornizë institucionale e përbashkët
- Traktati i Nisës
- Europa me “gjeometri të ndryshme”

Bashkëpunim, -i Gjyqësor në Çështjet Civile / Judicial cooperation in civil matters

Në Zonën Europiane të Drejtësisë, individët dhe bizneset duhet të jenë të lirë t'i ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre. Pikësynimi kryesor i Bashkëpunimit Gjyqësor në Çështjet Civile është që të përmirësojë bashkëpunimin mes Autoriteteve të Shteteve Anëtare, me qëllim që

të mënjanohen të gjitha pengesat që rrjedhin nga mospërputhja mes sistemeve të ndryshme gjyqësore dhe administrative (njohja dhe zbatimi i ndërsjellë i vendimeve gjyqësore, mundësia për t'iu drejtuar gjykatave dhe harmonizimi i legjislacioneve kombëtare).

Traktati i Mastrihtit e përfshiu që në vitin 1993 Bashkëpunimin Gjyqësor në Çështjet civile në kapitullin VI të tij. Traktati i Amsterdimit e zhvendosi Bashkëpunimin Gjyqësor në Çështjet Civile në kapitullin IV të Traktatit të Komunitetit Europian (artikulli 65). Në këtë mënyrë, Traktati i Amsterdimit e bëri Bashkëpunimin Gjyqësor në Çështjet Civile pjesë të Legjislacionit Komunitar, duke e përfshirë atë në Zonën e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë (ZLSD). Megjithatë, marrja përsipër nga Komuniteti i kësaj fushe bashkëpunimi, u realizua gradualisht gjatë një periudhe 5-vjeçare (neni 67 i Traktatit të Komunitetit Europian). Meqenëse Komisioni ndante të drejtën e iniciativës ligjore me Shtetet Anëtare, Parlamenti Europian thjesht konsultohet dhe Këshilli i merrte vendimet me unanimitet.

Deri në hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështjet Civile kryhej përmes konventave. Falë përfshirjes së kësaj fushe në legjislacionin Komunitar, shumica e konventave janë kthyer në rregullore, duke i dhënë kështu Gjykatës Europiane të Drejtësisë kompetencën për t'i interpretuar.

Këshilli Europian i mbledhur në Tampere (tetor 1999) e vendosi parimin e njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore si gurin themeltar kryesor të Bashkëpunimit Gjyqësor si në Çështjet Penale, ashtu edhe ato Civile brenda Bashkimit Europian.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Nisës në shkurt 2003, procedura e vendimmarrjes e përcaktuar në nenin 67, u zëvendësua nga votimi me shumicë të cilësuar dhe procedura e bashkëvendimmarrjes në lidhje me Bashkëpunimin Gjyqësor në Çështjet Civile, me përjashtim të çështjeve të së drejtës familjare.

Aspektet thelbësore të nenit të ri 81 TFBE (ish neni 65 TKE) ndahen në dy pjesë: neni 81 parashikon kompetencat e përgjithshme në çështjet civile duke parashikuar se Bashkimi Europian do të zhvillojë bashkëpunimin gjyqësor në fushën civile të cilat kanë ndikime ndërkuftare bazuar në parimin e njohjes reciproke të vendimeve gjyqësore dhe të vendimeve jashtëgjyqësore. Në mënyrë të qartë parashikohet miratimi i masave harmonizuese.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë
- Procedurë e Bashkëvendimmarrjes
- Komunitarizëm
- “Urë” Komunitare
- Konventë (kapitulli VI i Traktatit të BE)
- Lëvizje e lirë e personave (viza, azil, imigrim dhe politika të tjera)
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale

Bashkëpunim, ~i Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale / Police and judicial cooperation in criminal matters

Brenda Zonës së Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë, qëllimi i Bashkëpunimit Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale, është të sigurojë një nivel të lartë sigurie për qytetarët e Bashkimit Europian, duke nxitur dhe forcuar bashkëpunimin e shpejtë dhe të efektshëm ndërmjet autoriteteve policore dhe gjyqësore, nenet 82-89 TFBE. Me Traktatin e Lisbonës, Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor është vendosur në Titullin V të TFBE, Zona e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë dhe qëllimi i tij është që të parandalojë dhe luftojë racizmin dhe ksenofobinë, si dhe krimin e organizuar, dhe në veçanti terrorizmin, trafikimin e qenieve njerëzore, krimet kundër fëmijëve, trafikimin e lëndëve narkotike, trafikimin e armëve, korrupsionin dhe mashtrimin.

Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale zhvillohet në këto forma:

- Bashkëpunimi mes forcave policore kombëtare;
- Bashkëpunimi mes shërbimeve doganore kombëtare;
- Bashkëpunimi mes autoriteteve gjyqësore kombëtare.

Ky Bashkëpunim realizohet kryesisht përmes agjencive të ngritura nga Bashkimi European (Eurojust, Europol dhe Rrjeti Gjyqësor European).

Bashkëpunimi i përcaktuar në Titulli V përfshin, po ashtu, edhe përafrimin e legjislacionit në çështjet penale të Shteteve Anëtare dhe zhvillimin e mekanizmave për njohjen e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore në çështjet penale.

Përveç kësaj, ky Bashkëpunim kryhet edhe përmes marrëveshjeve ndërqeveritare, në të cilat janë të kufizuara kompetencat e Komisionit European, të Parlamentit European dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit European dhe është Këshilli i Bashkimit European dhe Shtetet Anëtare që vendosin.

Në fillim, kapitulli VI i Traktatit të Bashkimit European, i paraqitur nga Traktati i Mاستrihtit, përmbante rregullat që krijuan bashkëpunimin në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme. Megjithatë, Traktati i Amsterdimit e uli numrin e çështjeve që përfshiheshin në kapitullin VI, duke zhvendosur një pjesë të tyre tek Traktati Themelues i Komunitetit European (Shtylla e parë), veçanërisht në kapitullin IV, "Vizat, azili, imigracioni dhe politika të tjera në lidhje me lëvizjen e lirë të individëve". Rregullat mbi Bashkëpunimin Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale mbetën në kapitullin VI të Traktatit të Bashkimit European. Prandaj, kapitulli IV i Traktatit të Komunitetit European dhe kapitulli VI i Traktatit të Bashkimit European formonin bazën ligjore, në të cilën mbështetej Zona e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës pjesë nga shtylla e parë që mbulonin çështjet e vizave, emigracionit, kontrollit kufitar dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe çështjet e shtyllës së tretë janë bashkuar në një Titull të ri të Traktatit, Zona e Lirisë Sigurisë dhe Drejtësisë dhe (Titulli V i TFBE).

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë
- Lëndë narkotike
- Eurojust
- Urdhër European i Arrestit
- Rrjeti Gjyqësor European për Çështje Penale (RRGJE)
- Europol (Zyra Europiane e Policisë)
- Mashtrim
- Pastrim i parave
- Krim i organizuar
- Shtylla të Bashkimit European
- Racizëm dhe ksenofobizëm
- Terrorizëm

Bashkëpunim, ~i Politik European / European political cooperation (EPC)

Bashkëpunimi Politik European (BPE) u prezantua jozyrtarisht në vitin 1970 (pas raportit Davinjon) dhe u zyrtarizua me Aktin Unik European, në vitin 1987. Qëllimi i Bashkëpunimit Politik European është këshillimi ndërmjet Shteteve Anëtare në çështjet e politikës së jashtme. Shtetet anëtare marrin parasysh pikëpamjet e Parlamentit European dhe, kur është e mundur, mbajnë qëndrime të përbashkëta në organizatat ndërkombëtare ku bëjnë pjesë. BPE u zëvendësua nga Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)

Bashkim, -i Doganor / Customs Union

Bashkimi Doganor është elementi thelbësor i tregut të përbashkët. Krijimi i Bashkimit Doganor ishte objektivi parësor pas nënshkrimit të Traktatit të Romës dhe ky proces vazhdoi deri në vitin 1968. Masat më të rëndësishme për krijimin e Bashkimit Doganor përfshinin:

- eliminimin e të gjitha detyrimeve doganore dhe kufizimeve sasiore midis Shteteve Anëtare;
- krijimin e një Tarife të Përbashkët Doganore (CCT), e cila zbatohet në të gjithë Komunitetin Europian për mallrat nga vendet e treta (të ardhurat e fituara nga këto tarifa doganore përbëjnë një pjesë të të ardhurave të vetë Komunitetit);
- Politikën Tregtare të Përbashkët si një shtrirje të jashtëm të Bashkimit Doganor (Komuniteti flet me një zë në nivel ndërkombëtar).

Procedura dhe rregulla të përbashkëta u hartuan së bashku me Dokumentin Unik Administrativ (DUA), i cili zëvendësoi dokumentet e ndryshme të përdorura më parë. Në vitin 1993, me hyrjen në fuqi të tregut të vetëm, u hoqën jo vetëm të gjitha kontrollet rutinë në kufijtë e brendshëm, por edhe formalitetet doganore. Në këtë mënyrë, shërbimet doganore të Shteteve Anëtare e humbën rolin e tyre si mbledhës të akcizave, TVSH-së dhe të të dhënave statistikore.

Komuniteti ka nënshkruar disa marrëveshje, si për të lehtësuar tregtinë, për shembull Marrëveshja për Zonën Ekonomike Europiane (ZEE), ashtu edhe për të nxitur zhvillimin, duke siguruar hyrje preferenciale në tregjet Europiane të mallrave, për shembull, Konventa e Lomës e nënshkruar me vendet e Afrikës, të Karaibeve dhe Paqësorit (AKP).

Sfidat e së ardhmes përfshijnë nxitjen e bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet administratave kombëtare dhe luftën kundër mashtrimit, përmes programeve të njëpasnjëshme "Dogana 2002" dhe "Dogana 2007". Një nga përparësitë e programit "Dogana 2007" është mbështetja për Shtetet e reja Anëtare që t'i përshtatin sistemet e tyre doganore me kushtet e tregut të hapur dhe të zbatojnë kontrollet doganore në kufijtë e jashtëm të Bashkimit Europian.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Bashkimi Europian ka kompetencë ekskluzive në bashkimin doganor (neni 3 TFBE). Shiko:

- Politika e Përbashkët Tregtare
- Burime të veta

Bashkim, -i Ekonomik dhe Monetar / Economic and Monetary Union (EMU)

Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM) është procesi i harmonizimit të politikave ekonomike dhe monetare të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian me synimin e fundit të krijimit të një monedhe të vetme, Euros. Bashkimi Ekonomik dhe Monetar ishte tema e një Konference Ndërqeveritare (KNQ), e cila i përfundoi diskutimet e saj në Mاستriht në dhjetor 1991.

BEM u realizua në tre faza:

- Faza e parë (1 korrik 1990 - 31 dhjetor 1993): U hoqën të gjitha pengesat ndaj lëvizjes së lirë të kapitalit ndërmjet Shteteve Anëtare, u forcua bashkërendimi i politikave ekonomike dhe u intensifikua bashkëpunimi ndërmjet bankave qendrore.
- Faza e dytë (1 janar 1994 - 31 dhjetor 1998): U vendos konvergjenca e politikave ekonomike dhe monetare të Shteteve Anëtare (për të siguruar stabilitetin e çmimeve dhe financa të qëndrueshme publike), u krijua Instituti Monetar Europian (IME) dhe u krijua në vitin 1998, Banka Qendrore Europiane (BQE).

- Faza e tretë (nga 1 janari 1999): U përcaktua në mënyrë të pandryshueshme kursi i këmbimit valutor dhe u paraqit monedha e përbashkët në tregjet e valutave të huaja dhe si para elektronike. Euro u paraqit si një mjet i ligjshëm pagese.

Kur filloi faza e tretë, 11 Shtete Anëtare vendosën që të marrin në përdorim euron si monedhë të përbashkët. Greqia iu bashkua këtyre shteteve 2 vjet më vonë. Sllovenia hyri në Eurozonë, më 1 janar 2007.

Tri Shtete Anëtare kanë vendosur të mos e përdorin monedhën e vetme: Britania e Madhe dhe Danimarka, të cilat përfituan nga një klauzolë e mospjesëmarrjes, si dhe Suedia, si pasojë e referendumit të mbajtur në shtator të vitit 2003. Shtetet, të cilat u bënë pjesë e Bashkimit Europian, më 1 maj 2004 dhe 1 janar 2007, do të mund të përdorin euron menjëherë pasi të përmbushin kriteret e konvergencës. Këtyre shteteve nuk iu dha mundësia, gjatë bisedimeve të pranimit, që të përfitojnë nga një klauzolë mospjesëmarrjeje.

Suksesi afatgjatë i BEM kërkon që Shtetet Anëtare të konsolidojnë edhe më tej buxhetet e tyre, si dhe të bashkërendojnë në një shkallë më të madhe politikat e tyre ekonomike.

Traktati i Lisbonës njohu formalisht ekzistencën e Eurogrup çka do të thotë që njohu mbledhjen e Ministrave të Financës të shteteve të eurozonës të cilët mbledheshin zakonisht në mënyrë informale përpara takimeve të ECOFIN. Shiko:

- Orientime të Përgjithshme të Politikës Ekonomike (OPPE)
- Kriteret e konvergencës
- Banka Qendrore Europiane (BQE)
- Konferenca Ndërqeveritare (KNQ)
- Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit

Bashkim, -i European / European Union

Bashkimi Europian (BE) u themelua nga Traktati i Bashkimit Europian (Mastriht, 1992). Ideja e krijimit të Bashkimit Europian është e vjetër. Ajo u hodh për herë të parë në mbledhjen e Udhëheqësve Europianë në vitin 1972. Bashkimi është në të njëjtën kohë një projekt politik dhe një organizatë.

Bashkimi është një projekt politik, në të cilin shtetet anëtare kanë deleguar kompetencat e tyre për të arritur qëllime të përbashkëta (neni 1 i TBE). Sipas Traktatit të Lisbonës, Bashkimi Europian do të themelohet në bazë të Traktatit të Lisbonës dhe të Traktatit të Funkcionimit të Bashkimit Europian. Bashkimi zëvendësoi dhe pasoi Komunitetin Europian.

Për të arritur këtë qëllim, Bashkimi ka këto pikësnyime:

- Të nxisë përparimin ekonomik dhe shoqëror, zhvillimin e qëndrueshëm, të nxisë krijimin e një zone pa kufij të brendshëm dhe Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Këto pikësnyime përputhen me qëllimet e ndjekura nga politikat sektoriale të Bashkimit Europian.
- Të forcojë identitetin e tij në arenën ndërkombëtare. Ky qëllim lidhet me zbatimin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.
- Të forcojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përmes prezantimit të qytetarisë së Bashkimit Europian. Qytetaria e Bashkimit Europian, e cila u krijua nga Traktati i Mastrihtit, vendos një lidhje të veçantë mes Bashkimit Europian dhe qytetarëve të Shteteve Anëtare.
- Të krijojë një Zonë të Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë. Siç tregon edhe emërtimi, kjo zonë synon të krijojë kushtet për më shumë liri, siguri, dhe drejtësi për qytetarët Europianë.
- Të krijojë Acquis-në e BE-së, korpusin e rregullave ligjore të përcaktuara nga Bashkimi Europian dhe brenda kornizës së tij.

Bashkimi European bazohet mbi vlera të tilla si: respekti për dinjitetin njerëzor, lirinë, demokracinë, barazinë, respektin për ligjin dhe të drejtat e njeriut. BE ka simbolet e tij: flamurin (dymbëdhjetë yje në një sfond blu), himnin e tij (“Oda e Gëzimit” e Ludvig van Bethovenit), moton e tij (“Të bashkuar në larmi”), monedhën e tij (euron) dhe Ditën e Europës (9 Maj).

Bashkimi European ka një kornizë institucionale e cila përbëhet në thelb nga Këshilli European, Parlamenti European, Këshilli i Bashkimit European dhe Komisioni European. Kjo kornizë institucionale siguron bashkërendimin dhe vazhdimësinë e veprimeve të Bashkimit. Traktati i Lisbonës i jep Bashkimit European personalitet juridik, duke i dhënë kështu të drejtën të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare, mundësinë të padisë dhe të paditet në çështjet ndërkombëtare. Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Komuniteti European
- Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM)
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale
- Traktatet
- Traktati i Amsterdimit
- Traktati i Nisës
- Traktati i Lisbonës

Bashkim, -i European Perëndimor / Western European Union (WEU)

I krijuar në vitin 1948 nga Traktati i Brukselit, Bashkimi European Perëndimor (BEP) është një organizatë Europiane që ka për qëllim bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Ai përbëhet nga 28 vende me katër statuse të ndryshme: Shtetet Anëtare, anëtarë të shoqëruar, vëzhgues, dhe partnerë të shoqëruar. Dhjetë nga shtetet anëtare të Bashkimit European janë anëtarë (Belgjika, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Spanja, Mbretëria e Bashkuar), pesë të tjerë kanë status vëzhguesi (Austria, Danimarka, Finlanda, Irlanda dhe Suedia). Gjashtë anëtarët e shoqëruar janë Republika Çeke, Hungaria, Islanda, Norvegjia, Polonia dhe Turqia, ndërsa partnerët e shoqëruar janë shtatë: Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia.

Në Traktatin e Amsterdimit ishte përcaktuar se Bashkimi European Perëndimor është pjesë integrale e zhvillimit të Bashkimit, sepse BEP i jep Bashkimit European aftësi vepruese në fushën e mbrojtjes. Megjithatë, ky paragraf u fshi nga Traktati i Nisës. Ky Bashkim luajti një rol të madh në realizimin e detyrave të para të Petersbergut, si për shembull, vendosja e njësisë policore në Mostar, apo bashkëpunimi me policinë në Shqipëri. Ndërkohë, sot duket se BEP nuk e ka më të njëjtën rëndësi dhe se Bashkimi European po zhvillon strukturat dhe aftësitë e veta brenda kuadrit të Politikës Europiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (PESM). Një dëshmi e këtij zhvillimi është transferimi i aftësive operacionale nga BEP tek Bashkimi European. Organet në varësi të Bashkimit European Perëndimor, Instituti i Studimeve të Mbrojtjes dhe Qendra Satelitore, u shndërruan në agjenci të Bashkimit European, më datë 1 janar 2002. Traktati i Nisës fshiu nga Traktati mbi Bashkimin European një numër dispozitash që rregullonin marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit European Perëndimor dhe Bashkimit European.

Mbrojtja kolektive, e cila ishte pjesë e fushës së kompetencave të BEP, është tani pjesë e kompetencave të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO).

Shiko:

- Mbrojtje kolektive
- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Identitet European i sigurisë dhe i mbrojtjes
- Politika Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes (PESM)

- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
- NATO e rinovuar
- Detyra të Petersberg-ut

Bashkim, ~i i Ndërmarrjeve / Mergers

Bashkimi i Ndërmarrjeve është kombinimi i dy ose më shumë ndërmarrjeve përmes bashkimit ose blerjes së tyre. Megjithëse bashkimet e ndërmarrjeve mund të kenë ndikim pozitiv në treg, ato mund të sjellin si pasojë edhe një kufizim të ndjeshëm të konkurrencës, duke krijuar apo forcuar mbizotërimin e një aktori në treg.

Komisioni Europian, me qëllim që të parandalojë rrezikun e kufizimit të konkurrencës, kontrollon projektet e përqendrimit, të cilat kanë rëndësi, të përmasave komunitare, (domethënë kur bashkimi i ndërmarrjeve i shtrin efektet e tij jashtë kufijve të një prej shteteve anëtare dhe kur xhiroja e qarkullimit të vlerave materiale dhe monetare e kalon një kufi të caktuar në nivel botëror dhe komunitar), i lejon këto bashkime duke u vënë kushte të caktuara ose edhe e ndalon kryerjen e bashkimit.

Gjatë përcaktimit nëse përqendrimi është në përputhje me pikësynimet e tregut të përbashkët, Komisioni vlerëson shumë faktorët në lidhje me rrethanat konkrete të çështjes, dhe bazohet, ndërmjet të tjerave, në konceptet e “dimensionit evropian”, “pozitës dominuese”, “konkurrencës efektive”, dhe “tregut përkatës”. Kriteri themelor mbi bazën e të cilit analizohen përqendrimit, është parimi i “pozitës dominuese”. Sipas këtij parimi, një ose më shumë ndërmarrje konsiderohen se kanë një pozitë dominuese, në qoftë se ato kanë forcë ekonomike për të ndikuar mbi parametrat e konkurrencës dhe veçanërisht mbi çmimet, prodhimin, cilësinë e prodhimit, shpërndarjen dhe risitë, si dhe të kufizojnë konkurrencën në mënyrë të ndjeshme.

Rregullorja (KE) nr. 139/2004, e cila hyri në fuqi, më 1 maj 2004, i ndryshoi krejtësisht rregullat e Komunitetit Europian për kontrollin e përqendrimeve.

Shiko:

- Konkurrencë
- Politikë për ndërmarrjet

Bërthamë, ~a e forte / Hard core

Koncepti “Bërthamë e fortë” përdoret për një grup të kufizuar shtetesh, që kanë mundësi dhe dëshirojnë ta zgjerojnë më tej bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë.

Ky koncept u realizua në praktikë gjatë krijimit të Zonës Shengen, që bëri të mundur që një grup shtetesh anëtare të kufizonin hap pas hapi kontrollet kufitare dhe të realizonin lëvizjen e lirë të individëve. Kjo Bërthamë e fortë u organizua fillimisht jashtë kornizës institucionale të Bashkimit Europian, por u integrua më pas në traktate nëpërmjet përfshirjes në Traktatin e Amsterdimit.

Traktati i Amsterdimit e formalizoi përdorimin e këtij koncepti përmes paraqitjes së mekanizmit të “bashkëpunimit më të ngushtë”. “Bashkëpunimi më i ngushtë” i jep mundësi një numri shtetesh Anëtare ta thellojnë edhe më tej bashkëpunimin Europian, brenda kornizës institucionale të Bashkimit Europian.

Shiko:

- Bashkëpunimi më i ngushtë
- Shengen (Marrëveshja dhe Konventa)
- Europa me ritëm të shpejtë
- Europa “à la carte”
- Europa me gjeometri të ndryshme

Bisedime, ~t për anëtarësim (aderim) / Accession negotiations

Bisedimet për anëtarësim janë jetike për t'i vëzhguar dhe ndihmuar vendet candidate për t'u përgatitur për anëtarësimin, si edhe për të vlerësuar sa gati janë ato për një gjë të tillë. Secili vend vlerësohet më vete, nga këndvështrimi i përmbushjes së kriterëve të anëtarësimit. Bisedimet i ndihmojnë vendet candidate të përgatiten për të përmbushur detyrimet e anëtarësimit në Bashkimin Europian. Ato i japin mundësi edhe Bashkimit Europian të përgatitet për zgjerimin, për sa i takon kapacitetit thithës të tij.

Bisedimet kanë të bëjnë me përqafimin dhe vënien në zbatim të acquis të BE-së, gjë e cila vëzhgohet nga Komuniteti. Acquis ndahet në kapituj dhe numri i kapitujve përputhet me numrin e fushave në të cilat duhet të ketë progres. Këto fusha identifikohen përmes kontrollit rutinë të acquis. Programi për Asistencë Teknike dhe Shkëmbim Informacioni (TAIEX) luan një rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Secili kapitull dikutohet më vete dhe përcaktohen kriteret e matshme bazë për hapjen dhe mbylljen e secilit kapitull.

Bisedimet zhvillohen në konferenca dypalëshe ndërqeveritare, midis Shteteve Anëtare dhe vendit kandidat. Për secilin prej kapitujve përcaktohen qëndrime të përbashkëta diskutuese, në lidhje me çështjet ku ka kompetencë Komuniteti.

Rezultatet e bisedimeve (që dalin nga dialogu politik dhe ekonomik) futen në një projekt-traktat-anëtarësimi, pas mbylljes së diskutimeve për të gjithë kapitujt. Sipas rastit, sistemi i masave kalimtare u jep mundësi diskutimeve të mbyllen edhe nëse nuk është realizuar tërësisht transponimi i acquis.

Shiko:

- Partneritet për anëtarësim
- Vende candidate
- Acquis i BE-së
- Zgjerim
- PHARE (Program i Komunitetit për vende të Evropës Qendrore dhe Lindore)
- Ndihmë për paraanëtarësim
- Strategji për paraanëtarësim
- Kontroll rutinë
- TAIEX (Asistenca teknike dhe shkëmbimi i informacionit)

Burime të veta / Own resources

Fillimisht buxheti i Komunitetit varej nga kontributet financiare të Shteteve Anëtare. Por, sipas një vendimi të miratuar, më 21 prill 1970, kontributet e Shteteve Anëtare u zëvendësuan nga burimet e veta. Këto janë mjete financiare të cilat transferohen nga Shtetet Anëtare në buxhetin e Komunitetit për të mbuluar shpenzimet e Bashkimit Europian. Në saje të financimit të buxhetit të Bashkimit Europian përmes të ardhurave të veta, Bashkimi Europian ka mundur të arrijë pavarësinë ekonomike.

Tani për tani, shumat e të ardhurave të veta nuk mund të kalojnë 1,24% të të Ardhurave Kombëtare Bruto (AKB) të përgjithshme të Shteteve Anëtare. Të ardhurat e vetë Bashkimit përfshijnë këto katër forma të ardhurash:

- Taksat mbi produktet bujqësore dhe sheqerin: këto përfshijnë kryesisht detyrimet doganore mbi importet nga shtetet jo-anëtare të produkteve bujqësore, të cilat i nënshtrohen rregullave të tregut të përbashkët, taksat mbi sheqerin, isoglukozën dhe shurupin e inulinës.
- Taksa doganore: këto krijohen nga zbatimet e tarifës së përbashkët doganore dhe vendosen mbi importet nga vendet e treta në kufijtë e jashtëm të Bashkimit Europian.

Këto dy burime përbëjnë "burimet e veta tradicionale".

- Të ardhurat nga TVSH-ja: këto të ardhura vijnë si pasojë e zbatimit të një tarife të njësuar mbi bazën e TVSH-së të çdo Shteti Anëtar. Kjo tarifë u ul me 50% në vitin 2004. Kjo tarifë zbatohet mbi një bazë TVSH-je të zvogëluar, e cila nuk mund të kalojë 50% të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PPB) të Shtetit Anëtar.
- Burimi i katërt bazohet mbi të ardhurat kombëtare bruto: ky burim u prezantua në vitin 1988 dhe është një burim “shtesë”, sepse ai vendoset në përputhje me të ardhurat nga tre burimet e tjera të veta të buxhetit. Burimi i të ardhurave llogaritet gjatë procedurës së miratimit të buxhetit, mbi bazën e një tarife të njësuar që vendoset mbi AKB-në e përgjithshme të të gjitha Shteteve Anëtare.

Shiko:

- Buxhet
- Bashkim Doganor
- Perspektivë financiare

Buxhet, ~I / Budget

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkimit European përfshihen në buxhetin e Komunitetit European, mbi bazën e parashikimeve vjetore. Buxheti i Komunitetit European bazohet në disa parime, të cilat përfshijnë:

- parimin e unitetit (të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet mbledhen në një dokument të vetëm);
- parimin e përvitshmërisë (veprimet buxhetore grupohen në një vit të caktuar buxhetor);
- parimin e ekuilibrit (shpenzimet nuk duhet të tejkalojnë të ardhurat).

Komisioni European është përgjegjës për të paraqitur projekt-buxhetin vjetor paraprak përpara Këshillit European, i cili i ndan kompetencat buxhetore me Parlamentin European. Përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, natyra e shpenzimeve përcaktonte se cili nga këto dy institucione e kishte fjalën i fundit. Nëse shpenzimi ishte i detyrueshëm, atëherë vendoste Këshilli European, por nëse shpenzimi nuk ishte i detyrueshëm, atëherë ishte Parlamenti European që merrte vendimin përfundimtar. Traktati i Lisbonës ka eliminuar konceptin e shpenzimeve të detyrueshme në nenin 314 të TFBE. Për pasojë, Parlamenti European do të ketë një rol më të madh në procesin e përcaktimit të buxhetit vjetor pasi nuk do të përjashtohet nga shqyrtimi i buxhetit të fushave që më parë ishin pjesë e shpenzimeve të detyrueshme (bujqësia). Dispozitat e reja për buxhetin do të rrisin rolin e Parlamentit European lidhur me shpenzimet e bujqësisë. Sipas Traktatit të Lisbonës Parlamenti European dhe Këshilli duhet të arrijnë një marrëveshje të përbashkët për të gjithë buxhetin përfshirë dhe shpenzimet për bujqësinë (neni 314 i TFBE).

Heqja e dallimit midis shpenzimeve të detyrueshme (bujqësia) dhe shpenzimeve jo të detyrueshme së bashku me zbatimin e procedurës së zakonshme ligjvënëse (vendimmarrje e përbashkët) për politikën bujqësore, përbëjnë hapa të rëndësishme. Ndryshimet do ta bëjnë procesin e përcaktimit të buxhetit për bujqësinë më shumë transparent të hapur dhe të balancuar.

Me qëllim që të stabilizohen buxhetet vjetore, që nga viti 1988, buxheti është bërë objekt i marrëveshjeve shumëvjeçare ndër-institucionale mbi disiplinën buxhetore mes Parlamentit European, Këshillit dhe Komisionit European. Këto “perspektiva financiare” shumëvjeçare drejtojnë shpërndarjen e shpenzimeve dhe synojnë që të sigurojnë një nivel të kënaqshëm të të ardhurave, me qëllim që të mbështeten përparësitë e Bashkimit European.

Shiko:

- Klasifikim i shpenzimeve
- Gjykata Europiane e Llogarive
- Perspektivë financiare
- Burime të veta



COREPER (Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm) / Coreper

Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm ose “Coreper” (neni 2007 i Traktatit themelues të Komunitetit Europian) është përgjegjës për përgatitjen e punës së Këshillit të Bashkimit Europian. Ai përbëhet nga ambasadorët e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian (“Përfaqësuesit e përhershëm”) dhe kryesohet nga Shteti Anëtar që mban Presidencën e Këshillit.

COREPER-i zë një pozicion kyç në sistemin e vendimmarrjes të Komunitetit Europian, duke qenë në të njëjtën kohë një forum për dialog (mes përfaqësuesve të përhershëm dhe ndërmjet tyre dhe qeverive përkatëse të tyre), si edhe një organ kontrolli politik (udhëheq dhe mbikëqyr punën e grupeve të ekspertëve).

Ai kryen shqyrtimin paraprak të dosjeve që janë në rendin e ditës të Këshillit Europian (propozime dhe projekte për aktet e hartuara nga Komisioni Europian) dhe përipiqet që të arrihet konsensus për çdo çështje. Në qoftë se kjo nuk mund të bëhet, atëherë ai mund t'i sugjerojë Këshillit Europian orientime, alternativa ose zgjidhje të mundshme.

Rendi i ditës i Këshillit Europian pasqyron përparimin e bërë në Coreper. Rendi i ditës i Këshillit përbëhet nga çështje A, të cilat miratohen pa debat, mbi bazën e marrëveshjes së arritur në Coreper, dhe çështje B të cilat duhet të diskutohen në Këshill.

COREPER-i është i ndarë në dy komitete:

- COREPER-i I, përbëhet nga zëvendës, përfaqësuesit e përhershëm, dhe trajton çështje të karakterit teknik.
- COREPER-i II, përbëhet nga vetë përfaqësuesit e përhershëm dhe trajton çështje të karakterit politik, tregtar, ekonomik ose institucional.

Veprimtaria e Coreper-it përfshin të gjitha fushat e punës së Këshillit Europian, me përjashtim të çështjeve të bujqësisë, dosjet e të cilave përgatiten nga Komiteti Special i Bujqësisë (KSB). Komitetet speciale të ngritura nga Këshilli Europian, si për shembull, Komiteti Politik dhe i Sigurisë (KPS) për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, ose Komiteti i Punësimit për fushën e punësimit, duhet të veprojnë duke pasur parasysh të Drejtat e Coreperit.

Shiko:

- Komitete dhe grupe pune
- Këshill i Bashkimit Europian
- Komision Europian
- Presidencë e Këshillit të Bashkimit Europian

COREU (Korrespondencë Europiane) / COREU (CORespondance EUropéenne)

COREU është një rrjet komunikimi i Bashkimit Europian, që lehtëson bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komisionit Europian në fushën e politikës së jashtme. COREU lehtëson marrjen e shpejtë të vendimeve në rastet e krizave.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)

D

Diskutim, ~i mbi të ardhmen e Bashkimit European / Debate on the future of the European Union

Pasi i kishte ndezur dritën jeshile zgjerimit, Konferenca Ndërqeveritare 2000 (KNQ 2000) bëri thirrje për një debat më të gjerë dhe më të thellë rreth së ardhmes të Bashkimit European. Për këtë qëllim, Deklarata e Nisës, shtojcë e Traktatit të Nisës, kërkoi fillimin e një debati të gjerë, me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara, pra të përfaqësuesve të parlamenteve kombëtare, ashtu edhe mendimin publik, domethënë organizatave politike, ekonomike dhe akademike dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në Shtetet Anëtare, po ashtu edhe në vendet candidate.

Ky debat mbi të ardhmen e Bashkimit European vazhdoi deri në mesin e vitit 2003 përmes diskutimeve edhe në Internet, për të mbledhur sa më shumë mendime të mundshme për çështjet kyçe që lidhen me të ardhmen e Evropës. Ky debat u mbështet nga Komisioni European, i cili synonte që debati të zhvillohej si në nivel European, me kontribute dhe forume diskutimi me pjesëmarrjen e personaliteteve nga Komuniteti European, ashtu edhe në nivel kombëtar, me debate kombëtare mbi të ardhmen e Bashkimit European, me pjesëmarrjen e një numri sa më të madh qytetarësh. Shkëmbimi i mendimeve që u krye si pjesë e këtij debati, u zhvillua paralelisht me punën e Konventës parapërgatitëse për KNQ 2004.

Më 18 qershor 2004, kryetarët e shteteve dhe qeverive të mbledhur në KNQ ranë në një mendje, pas disa kompromiseve, për Projekt Kushtetutën Europiane, të përgatitur nga Konventa.

Kushtetuta u nënshkrua në një ceremoni në Romë në 29 tetor 2004 pas marrëveshjes së 25 krerëve të shteteve anëtare të BE-së. Më pas, për të hyrë në fuqi, Kushtetuta iu nënshtrua procesit të ratifikimit nga Shtetet Anëtare. Procesi i ratifikimit iu nënshtrua formave të ndryshme në cdo vend anëtar në varësi të traditës, dispozitave kushtetuese dhe proceseve politike. Në vitin 2005, refendumi që u mbajt në Francë dhe në Holandë rrëzoi projektin e Kushtetutës Europiane. Megjithëse pjesa më e madhe e shteteve e kishin ratifikuar Kushtetutën Europiane nëpërmjet procedurave parlamentare, përsëri ajo nuk hyri dot në fuqi pasi ndryshimi i i traktateve kushtetuese kërkon unanimitet. Si pasojë, u bë e qartë që ajo nuk mund të hynte në fuqi. Kjo çoi në një periudhë reflektimi dhe fundin politik të Kushtetutës Europiane.

Në Këshillin European të 22-23 qershorit 2007, u arrit një marrëveshje për mbajtjen e një Konference ndërkombëtare, e cila parashikonte heqjen e termit ,kushtetutë' dhe të shumë simboleve nga teksti i Kushtetutës Europiane. Gjithashtu, u parashikua se do të ndryshoheshin disa nga dispozitat e saj (për shembull ato që kishin të bënin me votimin për çështje të politikës së jashtme, apo shtimin e një protokollit për Kartën e të Drejtave Themelore si pasojë e presionit të bërë nga Britania e Madhe dhe Polonia. Midis ndryshimeve të tjera ishin dhe hapësirat e mëdha për të dalë nga ato fusha të legjisllacionit dhe sistemi i ri i votimit i parashikuar në Kushtetutën Europiane nuk do të zbatohet përpara vitit 2014.

Në takimin e qershorit u përdor dhe termi Traktati Reformues duke bërë të qartë tashmë se ideja e kushtetutës nuk ekzistonte më. Teknikisht, u ra dakord që Traktati Reformues mund të ndryshonte Traktatin e Bashkimit European dhe Traktatin Themelues të Komunitetit European, duke përfshirë shumë nga dispozitat e Kushtetutës Europiane. U ra dakord që Traktati i Themelimit të Komunitetit European që përmbante pjesën më të madhe të dispozitave thelbësore të së drejtës europiane të quhej Traktati i Funkcionimit të Bashkimit European. Për më tepër u ra dakord që, ndryshe nga Kushtetuta europiane ku Karta ishte pjesë e tekstit, traktati thjeshtë t'i referohej asaj për ta bërë të detyrueshme. Traktati Reformues u nënshkrua në Lisbonë në tetor 2007 dhe për këtë arsye, për të ruajtur dhe traditën, u quajt Traktati i Lisbonës. Traktati i Lisbonës ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2009.

Shiko:

- Konventë Europiane
- Konferenca Ndërqeveritare (KNQ)
- Deklarata e Lekenit
- Traktati i Nisës
- Traktati i Lisbonës

Deficit, ~i demokratik / Democratic deficit

Deficiti demokratik është një koncept i cili bazohet, kryesisht, mbi argumentin se Bashkimi Europian dhe institucionet e tij vuajnë nga mungesa e demokracisë dhe duken të paarritshme nga qytetari i thjeshtë, pasi metoda e funksionimit të tyre është shumë e ndërlikuar. Kjo pikëpamje pasqyron perceptimin sipas të cilit sistemi institucional i Komunitetit Europian mbizotërohet nga një institucion që ndërthur kompetencat legjislative dhe ekzekutive (Këshilli i Bashkimit Europian) dhe një institucion të cilit i mungon legjitimiteti demokratik (Komisioni Europian).

Në çdo hap të ri të procesit të integritimit Europian, çështja e legjitimitetit demokratik është bërë gjithnjë e më shumë e ndjeshme. Traktatet e Mاستrihtit, Amsterdimit dhe Nisës hodhën hapat e parë drejt përfshirjes së parimit të legjitimitetit demokratik në sistemin institucional, duke zgjeruar kompetencat e Parlamentit në lidhje me emërimin dhe kontrollin e Komisionit dhe duke e zgjeruar gradualisht fushën e përdorimit të procedurës së vendimmarrjes së përbashkët.

Me nismën e Këshillit Europian të Nisës (dhjetor 2000) filloi një debat i gjerë publik rreth të ardhmes së Bashkimit Europian, në të cilin mund të merrnin pjesë qytetarët dhe u thirr mbledhja e një Konvente Europiane, të cilës iu kërkua që të shqyrtonte mënyra të ndryshme për të përmirësuar legjitimitetin demokratik.

Një nga qëllimet e qarta të Traktatit të Lisbonës, i shprehur që në parathënien e tij, është rritja e “legjitimitetit demokratik të Bashkimit”. Kjo ka qenë motoja e procesit që coi në miratimin e traktatit duke filluar që nga Deklarata e Laeken e vitit 2001. Traktati parashikon një seksion të ri në Titullin II “dispozita mbi parimet demokratike”. Aty parashikohen dispozita për qytetarët europianë (shih Kapitullin 2) dhe dispozita të reja që synojnë të përmirësojnë lidhjen midis institucioneve europiane dhe shoqërisë në pëgjithësi. Neni i ri 11 i TBE parashikon një detyrim të përgjithshëm për dialogun me shoqërinë civile. Traktati gjithashtu parashikon të drejtën e qytetarëve për të vendosur një çështje në agendën ligjvënëse të Komisionit kur këtë e kërkojnë rreth një milion qytetarë (neni 24 TFBE). Duke zgjeruar përdorimin e vendimmarrjes së përbashkët dhe duke përfshirë për pasojë më shumë Parlamentin Europian në procesin ligjvënës, Traktati i Lisbonës ka kontribuar pjesërisht në reduktimin e deficitit demokratik. Për më të tepër, sipas Traktatit të Lisbonës, mbledhjet e Këshillit të Ministrave do të bëhen në public, çka do të thorrë rritje e transparencës dhe zbutje e distancave me qytetarin.

Shiko:

- Debat mbi të ardhmen e Bashkimit Europian
- Konventë Europiane
- Parlamenti Europian
- Qeverisje
- Parlamente kombëtare
- Qartësi e traktateve (Thjeshtim i traktateve)
- Thjeshtim i legjislationit
- Subsidiaritet (Vartësia)
- Transparencë (E drejtë për t’u njohur me dokumentet)
- Iniciativë Qytetare

Deklaratë, ~a (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë) / Declaration (Common Foreign Security Policy)

Deklarata është një instrument i cili nuk parashikohet në dispozitat e Kapitullit V të Traktatit të Bashkimit Europian, por është tipar i Bashkëpunimit Politik Europian (BPE). Deklarata është një shprehje e përgjithshme e vijës politike, por nuk është ligjërisht e detyrueshme për t'u zbatuar. Ajo përdoret më shpesh në lidhje me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS). Deklaratat lëshohen nga Presidenca e Këshillit në emër të Bashkimit Europian dhe, në ato raste në të cilat është e nevojshme, në emër të Presidencës.

Traktati i Lisbonës parashikon një numër deklaratash të cilat, pavarësisht statusit të tyre si akte politike, janë gjithashtu të nevojshme për interpretimin e dispozitave të Traktatit. Si shembull, mund të përmendet deklarata për Kartën e të Drejtave Themelore, Deklaratën e përbërjes së parlamentit e kështu me radhë.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Bashkëpunim Politik Europian (BPE)
- Presidencë e Këshillit të Bashkimit Europian

Deklaratë, ~a e Lekenit / Laeken Declaration

Një vit pas Traktatit të Nisës dhe Deklaratës së Nisës, në të cilat përcaktohet se reformat institucionale duhet të vazhdojnë edhe mbas arritjes së rezultateve të Konferencës ndërqeveritare 2000 (KNQ 2000), Këshilli Europian në Leken, më 15 dhjetor 2001, miratoi "një deklaratë rreth të ardhmes së Bashkimit Europian" e njohur edhe si "Deklarata e Lekenit", duke e angazhuar Bashkimin Europian për t'u bërë më demokratik, më transparent dhe më efektiv.

Në deklaratë janë formuluar 60 pyetje në lidhje me të ardhmen e Bashkimit Europian, të grupuara në katër tema: ndarja dhe përcaktimi i kompetencave, thjeshtimi i traktateve, ndërtimi institucional dhe rruga drejt një kushtetute për qytetarët Europianë. Në përpjekje për t'u dhënë përgjigje këtyre pyetjeve themelore, deklarata thirri mbledhjen e një Konvente me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të interesuara. Konventa kishte për detyrë që të shqyrtonte çështjet më të rëndësishme të ngritura nga zhvillimi i ardhshëm i Bashkimit Europian, me qëllim që të siguronte një përgatitje sa më të gjerë dhe transparente që ishte e mundur për KNQ 2004.

Konventa i mbylli punimet e saj, më 19 korrik 2003, pasi ra dakord mbi projektin e Traktatit kushtetues. Më 18 qershor 2004, Kryetarët e shteteve dhe qeverive, mbas disa kompromisesh, ranë dakord mbi Projektin e Kushtetutës Europiane, të përgatitur nga Konventa. Në vitin 2005, referendumet e mbajtura në Holandë dhe Francë hodhën poshtë projektin për Kushtetutën Europiane. Si pasojë e këtij refuzimi, u hoq dorë nga ideja e kushtetutës dhe përpjekjet u përqëndruan për hartimin e Traktatit Reformues, përpjekje të cilat kulminuan me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës.

Shiko:

- Debat mbi të ardhmen e Bashkimit Europian
- Konventë Europiane
- Konferenca Ndërqeveritare (KNQ)
- Traktati i Nisës

Detyra të Petersberg-ut / Petersberg tasks

Detyrat e Petersberg-ut janë pjesë e integruar e Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM). Ato përmenden shprehimisht në Traktatin e Bashkimit Europian (neni 17) dhe mbulojnë:

- detyrat humanitare dhe shpëtimi;
- detyrat paqeruajtëse;
- detyrat e forcave të luftimit në menaxhimin e krizave, përfshirë edhe vendosjen e paqes.

Këto detyra u përcaktuan në Deklaratën e Petersberg-ut, të miratuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Europian Perëndimor (BEP) në qershor 1992.

Në këtë mbledhje Shtetet Anëtare të BEP deklaruan gatishmërinë e tyre për t'i dhënë BEP-it, por po ashtu, edhe NATO-s dhe BE-së, njësi ushtarake nga të gjitha forcat e tyre të armatosura konvencionale.

Shiko:

- Mbrojtje kolektive
- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
- NATO e rinovuar
- Bashkimi Europian Perëndimor (BEP)

Dialog, ~u social / Social dialogue

Dialogu social është termi i përdorur për përshkrimin e procedurës së konsultimit, që përfshin palët në tregun Europian të punës: Bashkimi i Konfederatave të Industrisë dhe Punëmarrësve në Evropë (BUSINESSEUROPE), Qendrën Europiane të Ndërmarrjeve me Kapital Publik (QENKP) dhe Konfederatën Europiane të Sindikatave (KES).

Dialogu social përfshin diskutime, veprime të përbashkëta dhe, ndonjëherë, në marrëveshje ndërmjet palëve në tregun Europian të punës, si dhe diskutime ndërmjet palëve në tregun Europian të punës nga njëra anë dhe institucioneve të Bashkimit Europian, në anën tjetër.

Dialogu social në nivel Europian u fillua nga Komisioni Europian në vitin 1985. Neni 138 i Traktatit të Bashkimit Europian (siç u ndryshua nga Akti Unik Europian), e ngarkon Komisionin me përgjegjësinë ligjore për zhvillimin e këtij debati.

Deri më sot, ky debat ka sjellë pesëmbëdhjetë mendime të përbashkëta mbi rritjen ekonomike, futjen e teknologjisë së re, arsimin, formimin profesional dhe fusha të tjera. Dialogu social mund të çojë gjithashtu në marrëdhënie kontraktuale, duke përfshirë edhe marrëveshje të cilat zbatohen nga Këshilli, ose nga vetë palët e tregut Europian të punës, mbi bazën e një propozimi nga Komisioni. Deri më sot janë miratuar pesë marrëveshje, kuadër ndërsektoriale të këtij lloji, në lidhje me lejen e paslindjes, punës me orar jo të plotë, kontratat me kohë të kufizuar, punën nëpërmjet telefonit dhe stresin në punë.

Me qëllim që t'i jepet një shtysë e re dialogut social, në mars të vitit 2003, u ngrit Samiti Social Trepalësh për rritjen ekonomike dhe zhvillimin. Në Samit marrin pjesë zyrtarë të lartë të Presidencës së Këshillit dhe Komisionit, si dhe përfaqësues të palëve të tregut Europian të punës. Samiti zhvillohet një herë në vit, pak përpara zhvillimit të Këshillit Europian (sesioni i pranverës), i cili debaton rreth situatës ekonomike dhe sociale në Bashkimin Europian.

Traktati i Lisbonës vë theksin tek dialogu social. Neni 152 TFBE parashikon konceptin e partnerëve socialë, të dialogut dhe të mbledhjes së tre partnerëve socialë.

Shiko:

- Komiteti Europian Ekonomik dhe Social (KESE)
- Kartë Sociale (Kartë e të Drejtave Themelore Sociale të Punëtorëve)
- Partnerë të tregut të punës
- Politikë sociale
- Marrëveshje për Politikën Sociale



E Drejtë, ~a e Nismës Legjislative / Right of legal initiative

Në mënyrë që komisioni të ruajë rolin e tij si mbrojtësi i interesave të përgjithshëm, atij i është dhënë e Drejta e Iniciativës Legjislative, e cila i jep mandatin dhe detyrimin që të paraqesë propozime brenda fushave të përcaktuara nga Traktati, ose sepse kështu parashikohet shprehimisht në Traktat, ose sepse Komisioni e konsideron këtë të nevojshme.

Kompetenca e iniciativës legjislative është ekskluzive për sa u takon çështjeve të Komunitetit, mbi bazën e parimit se Këshilli merr vendime vetëm “me propozim të Komisionit”, në mënyrë që të ruhet bashkërendimi i të gjithë. iniciativës.

Brenda Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, Komisioni mund të bëjë propozime, ashtu si edhe Shtetet Anëtare. Nga ana tjetër, ai nuk gëzon të njëjtën të drejtë për çështje të caktuara të lidhura me drejtësinë dhe punët e brendshme.

Gjithashtu Këshilli dhe Parlamenti European mund t'i kërkojnë Komisionit, të paraqesë propozime, në rast se ato e konsiderojnë të nevojshme.

E Drejta e Iniciativës Legjislative konsiderohet si një element me rëndësi themelore për ekuilibrin institucional mes institucioneve të ndryshme të Bashkimit European.

Traktati i Amsterdimit e shtriu të Drejtën e Iniciativës Legjislative të Komisionit edhe mbi politikën e reja (shëndeti dhe punësimi), mbi çështjet që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të personave, si dhe me Shtyllën e Tretë. Pas shkrirjes së shtyllës së parë me të tretën nga Traktati i Lisbonës, Komisioni gëzon të drejtën e nismës legjislative edhe në fusha që më parë i përkisnin shtyllës së tretë. Gjithashtu, me Traktatin e Lisbonës, e drejta e nismës legjislative mund të ushtrohet edhe nga qytetarët e Bashkimit. Sipas nenit 24 të TFBE, një milion qytetarë nga një numër domethënës Shtetesh Anëtare mund të kërkojnë vendosjen e një çështjeje në agjendën e Komisionit.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Komisioni European
- Ekuilibër institucional
- Shtylla të Bashkimit European
- Iniciativë Qytetare

E Drejtë, ~a e BE-së / EU Law

E Drejta e BE-së (përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës e quajtur e Drejta Komunitare) përbëhet nga traktatet themeluese (legjislacioni parësor) dhe dispozitat e akteve të miratuara nga institucionet komunitare në lidhje me zbatimin e këtyre traktateve, d.m.th. rregullore, direktiva etj. (legjislacioni dytësor)

Në një kuptim më të gjerë, e Drejta e BE-së përfshin të gjitha rregullat e rendit ligjor komunitar, duke përfshirë parimet e përgjithshme të së drejtës, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit European, të drejtën që rrjedh nga marrëdhëniet e jashtme të Bashkimit dhe e drejta shtesë që përfshihet në konventa dhe marrëveshje të ngjashme, të lidhura ndërmjet Shteteve Anëtare dhe që kanë për qëllim zbatimin e dispozitave të traktateve.

Të gjitha këto rregulla të së drejtës përbëjnë një pjesë të asaj që njihet si Acquis e BE-së (përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës njohur si Acquis Communautaire).

Shiko:

- Acquis e BE- së
- Kartë e të Drejtave Themelore
- Instrumente ligjore komunitare
- Hierarki e akteve ligjore komunitare (hierarkia e normave)
- Vëzhgim i zbatimit të së drejtës komunitare

e-Europe / eEurope

Nisma “e-Europe” filloi nga Komisioni Europian në dhjetor 1999 dhe u miratua nga Këshilli Europian i Lisbonës në mars 2000. Komunikata që u miratua me titullin “e-Europe - Një shoqëri informacioni për të gjithë”, është pjesë e të ashtuquajturës Strategji e Lisbonës, në të cilën përcaktohet se Bashkimi Europian duhet të bëhet ekonomia më konkurruese dhe dinamike, e bazuar në njohuritë në botë, brenda vitit 2010. Pikësynimet kryesore të nismës janë:

- Të bëjë të mundur që çdo qytetar, shtëpi dhe shkollë, çdo biznes dhe administrata, të bëhen pjesë e epokës dixhitale dhe të lidhen me internetin;
- Të krijojë një Evropë të aftë të përdorë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, të karakterizuar nga shpirti i nismës për biznes dhe përkrahja e çdo risie në teknologjinë e informacionit;
- Të sigurojë që shoqëria e informacionit të ushtrojë një rol gjithëpërfshirës.

Për të arritur këtë qëllim, në maj të vitit 2000, Komisioni miratoi plan-veprimin “e-Europe 2002”. Masat kryesore të këtij Plani synonin të nxisnin një lidhje më të shpejtë interneti, me kosto më të lirë dhe të sigurtë, të nxisnin investimet financiare dhe rritjen e kapaciteteve njerëzore, si dhe nxitjen e përdorimit të internetit.

Plani i veprimit “e-Europe 2005” pasoi planin e veprimit “e-Europe 2002”. “e-Europe 2005” u përqendrua kryesisht në zhvillimin e lidhjeve me brez të gjerë me çmime sa më konkurruese, në sigurinë e rrjeteve informatike dhe në përdorimin më të mirë të teknologjive të informacionit nga autoritetet publike (“eAdministrata”).

Nisma “i2010”, e paraqitur në qershor 2005, është kuadri i ri strategjik i Komisionit në fushën e shoqërisë së informacionit dhe medias. “i2010” është nisma e parë e Komisionit, e miratuar në kuadrin e Strategjisë së rishikuar të Lisbonës dhe partneritetit për rritje ekonomike dhe punësim.

Shiko:

- i2010
- Shoqëri e informacionit
- Strategji e Lisbonës
- Telekomunikacioni
- Rrjetet NdërEuropiane (RRTE)

Ekuilibrë, -i institucional / Institutional balance

Parimi i Ekuilibrit Institucional të Bashkimit Europian do të thotë se, çdo institucion duhet të veprojë në përputhje me kompetencat që i janë dhënë nga Traktatet Europiane, në përputhje me ndarjen e kompetencave. Vetë ky parim nuk përcaktohet me shumë fjalë në Traktate, por rrjedh nga një vendim i Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Europiane (çështja Meroni e vitit 1958). Parimi i Ekuilibrit Institucional të Bashkimit Europian ndalon

në këtë mënyrë çdo shkelje të kompetencave të një institucioni nga një institucion tjetër. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian është përgjegjëse që ky parim të respektohet.

Marrëdhënia ndërmjet Komisionit Europian, Këshillit të Bashkimit Europian dhe Parlamentit Europian, udhëhiqet nga ideja e “trekëndëshit institucional”. Marrëdhëniet mes tyre dhe kompetencat e tyre, që përcaktohen nga Traktatet, kanë ndryshuar rrënjësisht gjatë viteve, veçanërisht, në rastin e Parlamentit, ndikimi i të cilit është rritur mjaft. Pavarësisht nga progresi që është bërë nga Traktati i Bashkimit Europian dhe nga Traktati i Amsterdimit, ekziston akoma një mungesë ekuilibri ndërmjet kompetencave legjislative të Këshillit Europian dhe atyre të Parlamentit Europian, duke qenë se kompetencat legjislative janë ndarë në mënyrë të barabartë mes këtyre dy institucioneve vetëm në fushat në të cilat përdoret procedura e vendimmarrjes së përbashkët. Zgjerimi i përdorimit të vendimmarrjes së përbashkët dhe rritja e kontrollit ndaj Komisionit nga ana e Parlamentit Europian të përfshira në Traktatin e Lisbonës kanë ndikuar në një ekuilibrim të kompetencave midis Parlamentit Europian, Këshillit të Ministrave dhe Komisionit.

Shiko:

- Procedurë e vendimmarrjes së përbashkët
- Këshilli i Bashkimit Europian
- Komisioni Europian
- Institucione Europiane
- Parlamenti Europian
- Qeverisje
- Kornizë Institucionale e Përbashkët

Energji, ~a / Energy

Pikësynimi i politikës Europiane për energjinë është që të zhvillojë një ekonomi, të bazuar në përdorimin efikas të energjisë, më të sigurtë, me zhvillim të qëndrueshëm dhe sa më konkurrues. Për të arritur këto pikësynime, Bashkimi Europian (BE) duhet të përballet me një numër problemesh të vështira:

- të luftojë ndryshimet e klimës;
- të garantojë furnizimin e sigurtë me energji;
- të investojë në kërkimin shkencor dhe zhvillimin e teknologjive të reja në fushën e përdorimit efektiv të energjisë, në energjitë e rinovueshme dhe teknologjitë e reja, veçanërisht teknologjitë me emetim të ulët të dioksidit të karbonit; të krijojë një treg të brendshëm për energjinë dhe të garantojë mirëfunksionimin e tij.

Bashkimi Europian është i vetëdijshëm për rëndësinë e zgjerimit të burimeve të tij të energjisë dhe po vlerëson me shumë kujdes të gjitha burimet e energjisë, pavarësisht nëse ato janë lëndët djegëse fosile (qymyr, gaz dhe naftë), bërthamore ose të rinovueshme (energji diellore, nga era, biomasa, gjeotermale, hidrike, e baticë/zbaticës).

Në janar 2007 Bashkimi Europian paraqiti Politikën e Përbashkët për Energjinë, e cila e vendos energjinë në qendër të përpjekjeve të përbashkëta: Traktatet Themeluese të Komunitetit Europian të qymyrit dhe Çelikut (Traktati i KEQÇ) dhe Traktati i Komunitetit Europian të Energjisë Atomike (EURATOM) të nënshkruara në vitin 1951 dhe 1957 hodhën themelet e integritit të mëtejshëm Europian.

Traktati themelues i Komunitetit Europian nuk krijoi ndonjë bazë juridike të veçantë për zhvillimin e politikës së përbashkët për energjinë. Politika e përbashkët për energjinë bazohet akoma në Traktatin e Euratom-it dhe në një numër dispozitash të shpërndara në kapitujt e tregut të brendshëm dhe mjedisit.

Programi i ri “Energji inteligjente në Europë”, i cili është pjesë e programit kuadër për inovacionin teknologjik dhe aftësinë konkurruese (2007-2013), parashikon dhënien e

mbështetjes financiare nga Bashkimi European për të arritur pikësynimet në fushën e energjisë së qëndrueshme.

Traktati i Lisbonës i jep Bashkimit një kompetencë më të qartë në politikat e energjisë. Neni 4 i TFBE parashikon se energjia është pjesë e kompetencave që ndahen midis BE-së dhe shteteve anëtare. Traktati i Lisbonës parashikon futjen e energjisë edhe në pjesën e tregut të brendshëm dhe tek mbrojtja e mjedisit. Vendimmarrja në këtë fushë bëhet pjesë e procedurës së zakonshme legislative.

Shiko:

- Mjedis
- Zhvillim i qëndrueshëm
- Rrjete NdërEuropiane (RRTE)

Eurojust / Eurojust

Eurojust-i u krijua me një vendim të Këshillit European, i miratuar në vitin 2002. Eurojust është institucioni të cilit i është besuar forcimi i luftës kundër krimeve të rënda përmes bashkëpunimit më të ngushtë brenda Bashkimit European në fushën e zbatimit të ligjit.

Eurojust-i është një institucion që bashkërendon aktivitetin e prokurorive kombëtare të shteteve anëtare dhe përbëhet nga 27 përfaqësues kombëtarë: gjyqtarë, prokurorë, dhe oficerë policie, të dërguar nga shtetet anëtare. Ky institucion i përmbush detyrat e tij me ndihmën e një ose disa prej anëtarëve kombëtarë, ose duke vepruar në mënyrë kolegjiale. Për më tepër, çdo Shtet Anëtar mund të emërojë një ose më shumë korrespondentë kombëtarë, të cilët po ashtu, mund të shërbejnë si pika kontakti për Rrjetin European gjyqësor.

Eurojust-i ka kompetencë që të hetojë dhe të procedojë në krimet e rënda, veçanërisht krimin e organizuar ose krimin ndërkufitar. Qëllimi i Eurojust-it është që të nxisë bashkëpunimin mes autoriteteve kompetente në shtetet anëtare, por edhe të lehtësojë ndihmën ligjore të ndërsjellë ndërkombëtare, si dhe t'u përgjigjet kërkesave për ekstradim ose urdhrave Europeanë të arrestit.

Eurojust-i kontribuon po ashtu, në hetimin e veprave penale edhe nëpërmjet analizave të kryera nga Europol. Ka njëfarë mbivendosjeje në kompetencat e këtyre dy institucioneve në lidhje me krimet nëpërmjet kompjuterëve, mashtrimin dhe korrupsionin, pastrimin e produkteve të krimit, krimin ndaj mjedisit, si dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale.

Neni 85 TFBE (ish neni 31 TBE) parashikon se misioni i EUROJUST është që të mbështesë dhe të forcojë koordinimin dhe bashkëpunimin midis strukturave kombëtare, pjesë të hetimit dhe procedimit penal në lidhje me krimet e rënda që prekin dy ose më shumë shtete anëtare ose që kërkojnë procedimin e përbashkët në bazë të operacioneve të përbashkëta dhe informacioneve që japin strukturat e shteteve dhe Europolit.

Parlamenti European dhe Këshilli kanë të drejtë të miratojnë rregullore dhe të përcaktojnë strukturën e Eurojust-it si dhe fushën e veprimit dhe detyrat. Detyrat mund të përfshijnë:

- nisjen e një hetimi penal si edhe propozimin për fillimin e procedimit penal ;
- koordinimin e hetimeve dhe procedimeve ;
- forcimin e bashkëpunimit gjyqësor, duke përfshirë zgjidhjen e konflikteve juridiksionale dhe të bashkëpunimit më të ngushtë në Europë.

Kufizimet e kompetencave të Eurojust-it janë përfshirë në nenin 85(2) TBE: aktet formale të bashkëpunimit gjyqësor do të realizohen nga autoritet kombëtare kompetente.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë

- Urdhër European i Arrestit
- Rrjet Gjyqësor European për Çështjet Penale (RREÇP)
- Europol (Zyra Europiane e Policisë)
- Mashtrim
- Pastrim i parave
- Krim i organizuar
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor për Çështjet penale
- Terrorizëm

Europë, ~a “à la carte” / Europe “a la carte

Europa “à la carte” nënkupton një model integrimi me nivele të ndryshme, në të cilin shtetet e veçanta anëtare zgjedhin si nga një meny “à la carte” politikat në të cilat ata duan të marrin pjesë dhe të përfshihen plotësisht, duke ruajtur megjithatë një numër minimal objektivash të përbashkëta.

Shiko:

- Rrathë bashkëqendrorë
- Bashkëpunim i zgjeruar
- Bërthamë e fortë
- Europë me “ritëm të shpejtë”
- Kornizë Institucionale e Përbashkët
- Europë me “gjeometri të ndryshme”

Europë, ~a me “gjeometri të ndryshme” / “Multi speed” Europe

Europa me “gjeometri të ndryshueshme” është termi i përdorur për të përshkruar idenë e një metode integrimi të diferencuar, e cila pranon se ka ndryshime të papajtueshme brenda strukturës së integritit dhe, rrjedhimisht, lejon një ndarje të përhershme ndërmjet një grupi të shteteve anëtare dhe një numri njësisht integrimi më pak të zhvilluara.

Shembuj të gjeometrive të ndryshme brenda integritit të BE-së përfshijnë pikërisht bashkëpunimin më të ngushtë, klauzolat e pjesëmarrjes dhe mospjesëmarrjes. Këto instrumenta parashikohen edhe në Traktatin e Lisbonës (për shembull klauzola e rezervës së Britanisë dhe të Polonisë për Kartën e të Drejtave Themelore).

Shiko:

- Rrathë bashkëqendrorë
- Bashkëpunim i zgjeruar
- Evropë “à la carte”
- Bërthamë e fortë
- Kornizë Institucionale e Përbashkët
- Evropë me “gjeometri të ndryshme”

Europë, ~a me “ritëm të shpejtë” / “Variable-geometry” Europe

Europa me “ritëm të shpejtë” është termi i përdorur për të përshkruar idenë e një metode integrimi të diferencuar, ku objektiva të përbashkëta ndiqen nga një grup shtetesh anëtare të afta dhe me dëshirën për të ecur përpara, duke lënë të nënkuptohet që shtetet e tjera anëtare do t'i ndjekin nga pas.

Shiko:

- Rrathë bashkëqendrorë
- Bashkëpunim i zgjeruar
- Europë “à la carte”
- Bërthamë e fortë
- Kornizë Institucionale e Përbashkët
- Europë me “gjeometri të ndryshme”

Europol (Zyra Europiane e Policisë) / Europol (European Police Office)

Europoli është përgjegjës për përmirësimin e bashkëpunimit mes autoriteteve policore dhe doganore të Shteteve Anëtare.

Ideja për krijimin e një Zyre Europiane të Policisë u hodh fillimisht në Këshillin Europian të Luksemburgut (qershor 1991). Europoli u krijua nga Traktati i Mastrihtit dhe e filloi veprimtarinë e tij në janar 1994 si Njësia e Drogës Europol. Konventa për krijimin e Europolit, u nënshkrua në korrik 1995 dhe hyri në fuqi, më 1 tetor 1998.

Europoli ka për detyrë që të luftojë kriminalitetin dhe terrorizmin, por nuk është në vetvete një forcë policore Europiane. Europoli është një instrument në shërbim të Shteteve Anëtare, i krijuar për t’i ndihmuar këto shtete që të përballen me krimin. Konkretisht, Europoli duhet të lehtësojë shkëmbimin e informacioneve ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe të përgatitë analiza mbi zhvillimin e kriminalitetit për këto shtete. Europoli merr pjesë në grupet hetimore të përbashkëta, që përbëhen nga përfaqësues të autoriteteve të shteteve të ndryshme anëtare dhe u jep atyre menjëherë informacionin që u nevojitet.

Traktati i Lisbonës konfirmon ekzistencën e Europol-it si një agjenci dhe parashikon një kontroll më të madh të Parlamentit Europian mbi të.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë
- Konventë (kapitulli VI i Traktatit të BE)
- Lëndë narkotike
- Pastrim i parave
- Krim i organizuar
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale

F

Fonde strukturore dhe Fond i Kohezionit / Structural Funds and Cohesion Fund

Fondet strukturore dhe Fondi i Kohezionit janë instrumentet financiare të politikës rajonale të Bashkimit European (BE), qëllimi i së cilës është që të ngushtojë diferencat në zhvillim ndërmjet rajoneve dhe shteteve anëtare. Për këtë arsye, fondet kontribuojnë në arritjen e qëllimit të kohezionit ekonomik dhe social.

Për periudhën 2007-2013, buxheti i akorduar për politikën rajonale është rreth 348 miliard euro, ku përfshihen 278 miliard euro për Fondet strukturore dhe 70 miliard euro për Fondin e Kohezionit. Kjo shumë përbën 35% të buxhetit të Komunitetit dhe është zëri i dytë më i lartë i buxhetit.

Ekzistojnë katër Fonde strukturore:

- Fondi European për Zhvillim Rural (ERDF), i cili është më i madhi. Që në 1975 ai ka dhënë mbështetje për infrastrukturën dhe investimet që krijojnë vende pune, kryesisht për bizneset;
- Fondi Social European (ESF) i krijuar në 1958, kontribuon në integrimin në punë të kategorive të papuna dhe të pafavorizuara, kryesisht duke financuar masa trajnimi. Fondi European Udhëzues dhe i Garancisë për Bujqësinë, Seksioni i Udhëzimit. Ky seksion ndihmon si në zhvillimin ashtu edhe në përshtatjen strukturore të zhvillimit të zonave rurale më në nevojë, nëpërmjet përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit të strukturave të tyre për prodhimin, përpunimin dhe marketimin e produkteve bujqësore dhe pyjore;
- Instrumenti Financiar për Udhëzimet e Peshkimit (IFUP) mbështet ristrukturimin në sektorin e peshkimit.

Për të përshpejtuar konvergjencën ekonomike, sociale dhe territoriale, në vitin 1994, Bashkimi European krijoi Fondin e Kohezionit. Ky fond shkon për vendet me të ardhura për frymë kundrejt PBB nën 90% të mesatares komunitare. Synimi i Fondit të kohezionit është të japë financim për projektet e infrastrukturës së mjedisit dhe transportit. Megjithatë, ndihma në kuadrin e këtij fondi varet nga disa kushte. Nëse deficiti publik i një Shteti Anëtar përfitues tejkalon 3% të PBB-së (UME: Kriteret e konvergjencës), atëherë nuk miratohet asnjë projekt i ri, derisa deficiti të vihet nën kontroll.

Këto fonde do të përdoren për financimin e politikës rajonale nga viti 2007 deri në 2013, në kuadrin e tre objektivave të rinj, konkretisht:

- objektivi i “konvergjencës”, për të përshpejtuar konvergjencën e Shteteve Anëtare dhe të rajoneve më pak të zhvilluara të BE-së, duke përmirësuar shtimin e punësimit dhe kushtet e tij. Ky objektivi financohet nga ERDF dhe ESF, si dhe nga Fondi i Kohezionit dhe përmban 81.5% të të gjithë burimeve të akorduara. Tavani i bashkëfinancimit për shpenzime publike shkon në 75% për ERDF dhe ESF dhe 85% për Fondin e Kohezionit;
- objektivi i “konkurrueshmërisë dhe punësimit rajonal”, për t’i paraprirë ndryshimeve ekonomike e sociale, për të promovuar risinë, sipërmarrjen, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e tregjeve të punës, të cilat përfshijnë rajone të pambuluara nga objektivi i konvergjencës. Financohet nga ERDF dhe ESF dhe përbën 16% të të gjithë burimeve të akorduara. Masat e këtij objektivi mund të përfitojnë bashkëfinancim deri në 50% të shpenzimeve publike;

- objektivi i “bashkëpunimit territorial European”, për të forcuar bashkëpunimin në nivelet ndërkufitare, transkombëtare dhe ndër-rajonale në fushat e zhvillimit urban, rural dhe bregdetar, si dhe për të nxitur zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe formimin e rrjeteve ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME). Ky objektivi financohet nga ERDF dhe përbën 2% të të gjitha burimeve të akorduara. Masat e objektivit Bashkëpunimi Territorial mund të përfitojnë bashkëfinansim deri në 75% të shpenzimeve publike.

Mbështetja e dhënë nga Fondi strukturor dhe Fondi i Kohezionit për të tre objektivat, përfshi gjithmonë bashkëfinansimin. Normat e bashkëfinansimit mund të ulen në varësi të parimit “ndotësi paguan”, ose kur një projekt gjeneron të ardhura. Të gjitha projektet duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së, veçanërisht për sa i përket konkurrencës, mjedisit dhe prokurimit publik.

Traktati i Lisbonës rrit në mënyrë të konsiderueshme pushtetin e Parlamentit European – veçanërisht nëpërmjet përdorimit më të gjerë të vendimmarrjes së përbashkët në një numër të madh fushash duke përfshirë dhe fondet strukturore.

Shiko:

- Kohezion ekonomik, social dhe territorial
- Strategji Europiane për Punësimin (EES)

Fond, ~i European për Zhvillim / European Development Fund

I krijuar nga Traktati i Romës në 1957, Fondi European për Zhvillim (EDF), është instrumenti kryesor që jep ndihmën komunitare për bashkëpunimin në zhvillimin e shteteve të Afrikës, Karaibeve, Paqësorit dhe Vendeve dhe Territoreve të përtej Detit (OCT).

EDF-ja financon projektet apo programet që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendeve në fjalë. Ai përbëhet nga disa instrumente, përfshi grante, kapitale risku dhe hua për sektorin privat.

EDF-ja financohet nga Shtetet Anëtare dhe ende nuk është përfshirë në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit. Megjithatë, ndihma e dhënë vendeve dhe territoreve të përtej detit, përfshihet në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit European që nga 1 janari 2008, ndërkohë që ndihma që u jepet vendeve të Afrikës, Karaibeve dhe Paqësorit, do të vazhdojë të financohet nga EDF, të paktën për periudhën 2008-2013.

Secila EDF, të cilat përgjithësisht ndjekin ciklin e marrëveshjeve të partneritetit, planifikohet për një periudhë prej rreth pesë vitesh. Për EDF-në e nëntë (2000-2007) janë dhënë 13.5 miliard euro, përveç 9.9 miliard euro që tepruan nga EDF-të e mëparshme. Kontributi i Bankës Europiane të Investimeve nga burimet e saj, shton edhe 1.7 miliard euro gjatë periudhës që mbulon EDF e nëntë.

Shiko:

- Ndihmë për zhvillim



Galileo / Galileo

“Galileo” është emri i sistemit European të drejtimit satelitor, që është zhvilluar nga Bashkimi European dhe Agjencia Hapësinore Europiane (ESA) që në 2002. Funkcional është bërë që në 2008. “Galileo” synon të garantojë rrjedhshmëri, efektshmëri dhe siguri të transportit në Evropë. Nisur nga zbatimet e shumta, mund të jetë i dobishëm edhe për fusha të tjerë.

“Galileo” forcon identitetin shkencor të Evropës dhe zhvillon pavarësinë e BE-së në fushën strategjike të pozicionimit satelitor. Pra, është një alternativë e qenësishme ndaj monopolit de facto të sistemit amerikan GPS. Sidoqoftë, “Galileo” është në pajtim me sistemin GPS, si dhe me sistemin rus të radio-navigimit, “Glonass”.

“Galileo” u mundëson përdoruesve me një marrës që të përcaktojnë pozicionin e tyre me përpikëri të lartë në kohë reale. Programi përfshin 30 satelitë në orbitë nga 2006 e tutje dhe stacione tokësore që të përçojnë sinjalet te përdoruesit.

Disa nga sektorët që mund të përfitojnë nga zbatimet e programit “Galileo” janë: shërbimet sociale (asistencë për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit), drejtësia dhe doganat (kontrollat kufitare), shërbimet e kërkim-shpëtimit (drejtimit në det dhe në terren malor) dhe bujqësia (menaxhim preciz i zonave të mëdha bujqësore).

Shiko:

- Zonë Europiane e Kërkimit Shkencor (ZEKSh)
- Kërkimi shkencor dhe zhvillimi
- Rrjete NdërEuropiane (RRTE)

Globalizim, ~i i ekonomisë / Globalisation of the economy

Globalizimi i referohet fenomenit të hapjes së ekonomive dhe kufijve, çka çon në rritjen e tregtisë dhe të lëvizjes së kapitalit, lëvizjes së njerëzve dhe ideve, përhapjes së informacionit, njohurive dhe teknologjisë, nga një proces për-rregullimi. Ky proces, si gjeografik ashtu edhe sektorial, nuk ka filluar kohët e fundit, por është përshpejtuar në këtë periudhë.

Ndërkohë që globalizimi është burim i shumë mundësive, mbetet një nga sfidat më të mëdha për Bashkimin European sot. Në mënyrë që të shfrytëzohet plotësisht potenciali i rritjes që ofron kjo dukuri dhe për të garantuar ndarje të drejtë të përfitimeve, BE po punon për ngritjen, nëpërmjet një qeverisjeje shumëpalëshe, e një modeli për zhvillimin e qëndrueshëm, që synon të gjejë pikën e pajtimit midis rritjes ekonomike, kohezionit social dhe mbrojtjes së mjedisit..

Shiko:

- Politikë e Përbashkët Tregtare
- Konkurrueshmëri
- Zhvillim i qëndrueshëm



Gjykatë, ~a Europiane e të Drejtave të Njeriut / European Court of Human Rights

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut është një gjykatë ndërkombëtare e krijuar më 1959 në kuadër të Këshillit të Europës. Ajo vendos për paditë e ngritura nga shtetet ose individët që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave politike dhe civile të parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Që nga viti 1998, ajo funksion si një gjykatë me kohë të plotë dhe individët mund t'i drejtohen asaj në mënyrë të drejtpërdrejtë. Përgjatë 50 viteve, Gjykata ka dhënë mbi 10,000 vendime. Vendimet janë të detyrueshme për shtetet të cilave ato i drejtohen dhe ato i kanë detyruar qeveritë që të ndryshojnë legjislacionin e tyre dhe praktikën e tyre administrative për një numër të madh fushash. Jurisprudenca e Gjykatës e ka kthyer Konventën për të Drejtat e Njeriut në një instrument me fuqi të madhe zbatuese për përballimin e sfidave të reja dhe për konsolidimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Europë. Gjykata ka qendrën në Strasburg në ndërtesën e të drejtave të njeriut, projektuar nga arkitekti britanik Richard Rogers më 1994 – një ndërtesë imazhi i së cilës është bërë i njohur në mbarë botën. Nga kjo ndërtesë gjykata monitoron respektimin e të drejtave të njeriut të 800 milion evropianëve në 47 vende anëtare të Këshillit të Europës të cilët e kanë ratifikuar Konventën.

Sipas deklaratës mbi nenin 6 (2) të Traktatit të Lisbonës, Bashkimi Europian do të aderojë në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të njeriut dhe ky proces do të bëhet nëpërmjet një dialogu të vazhdueshëm midis Gjykatës së Strasburgut dhe Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

Gjykatë, ~a Europiane e Llogarive / European Court of Auditors

Gjykata Europiane e Llogarive me bazë në Strasburg, përbëhet nga një shtetas i secilit Shtet Anëtar. Anëtarët e saj zgjidhen për gjashtë vjet (e rinovueshme) me shumicë të cilësuar të Këshillit të Bashkimit Europian, pasi ky i fundit këshillohet me Parlamentin Europian. Gjykata Europiane e Llogarive vepron me pavarësi të plotë.

Kjo gjykatë kontrollon të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkimit Europian (dhe të çdo organi të ngritur nga Komuniteti) nga ana ligjore dhe e rregullsisë, si dhe siguron që menaxhimi financiar të jetë i efektshëm. Gjithashtu, i përcjell Parlamentit Europian dhe Këshillit një Deklaratë garancie në lidhje me besueshmërinë e raporteve financiare dhe të ligjshmërisë e rregullsisë së transaksioneve që përmbajnë raportet. Gjykata harton një raport vjetor që botohet në Gazetën Zyrtare në fund të çdo viti buxhetor.

Sipas Traktatit të Amsterdimit (të miratuar në qershor 1997), Gjykata e Llogarive ka kompetenca t'i raportojë Parlamentit Europian dhe Këshillit Europian parregullsitë dhe përgjegjësitë kontrolluese, që janë shtrirë në fondet Komunitare që menaxhohen nga organet e jashtme dhe nga Banka Europiane e Investimeve. Në bazë të Traktatit të Nisës, Gjykata mund të ngrejë dhoma të brendshme, ku të miratojë kategori të caktuara raportesh apo pikëpamjesh.

Gjykata Europiane e Llogarive u krijua në 1975 dhe ka qenë institucion Europian që nga Traktati i Bashkimit Europian në 1992. Gjykata vepron në bazë të neneve 246 dhe 248 të Traktatit të KE-së.

Shiko:

- Buxhet
- Institucione Europiane
- Banka Europiane e Investimeve (EIB)

Gjykatë, ~a e Përgjithshme / General Court

Ashtu si Gjykata Europiane e Drejtësisë, edhe Gjykata e Përgjithshme - GJP (përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës e njohur si Gjykata e Shkallës së Parë e Komuniteteve Europiane - GJSHPKE) garanton zbatimin e ligjit nga ana e institucioneve komunitare dhe Shteteve Anëtare, në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve themeluese. GJP (ish GJSHPKE) u ngrit në 1989, duke krijuar një autoritet gjyqësor me dy shkallë, për të forcuar mbrojtjen e interesave të palëve, duke pakësuar kështu barrën e punës të Gjykatës Europiane të Drejtësisë dhe duke bërë që çështjet të marrin drejtim më shpejt.

GJP përbëhet nga të paktën një gjyqtar nga secili Shtet Anëtar (neni 254 TFBE, ish neni 224 i Traktatit themelues të Komunitetit Europian). Statuti i Gjykatës së Drejtësisë përcakton se duhet të jenë 27 gjyqtarë. Ata emërohen me miratimin e qeverive të Shteteve Anëtare me mandat të rinovueshëm 6-vjeçar. Gjyqtarët emërojnë kryetarin nga radhët e tyre për një mandat të rinovueshëm 3-vjeçar. Nuk ka avokatë këshillues (advocate-general), por këtë rol e luajnë gjyqtarët e GJP. GJP është e organizuar në dhoma prej pesë apo tre gjyqtarësh, ose, në disa raste, prej një gjyqtari të vetëm.

Për të lehtësuar barrën e punës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, GJP është përgjegjëse për të gjitha paditë e bëra nga personat dhe Shtetet Anëtare (apele kundër një vendimi, mosveprimi, dëmeve etj.), me përjashtim të atyre që i ngarkohen një paneli gjyqësor dhe atyre të rezervuara vetëm për Gjykatën e Drejtësisë (neni 256 TFBE ish neni 225 i Traktatit të KE-së). Mbi bazën e të drejtës së nismës që gëzojnë si Gjykata e Drejtësisë ashtu edhe Komisioni, panelet gjyqësore mund të krijohen për të shqyrtuar në shkallë të parë procedime të caktuara në fusha të veçanta. Kjo alternativë u përdor për të krijuar Gjykatën Europiane të Shërbimit Civil, që funksionon që në shkurt 2005. Gjithashtu, për disa fusha të veçanta të përcaktuara në statutin e Gjykatës së Drejtësisë, GJSHPKE ka fuqi ligjore të japë vendime paraprake. Vendimet e saj janë objekt apelimi në Gjykatën e Drejtësisë, por vetëm në bazë të interpretimit të parimeve ligjore madhore.

Shiko:

- Gjykatë e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane
- Institucione Europiane

Gjykatë, ~a e Drejtësisë e Bashkimit European

Traktati i Lisbonës i emërton Gjykatat Europiane në mënyrë kolektive Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit European (GJDBE). Ajo permbledh tre entitete: Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Përgjithshme, aktualisht e quajtur Gjykata e Shkallës së Parë dhe gjykatat e specializuara (panelet gjyqësore), (neni 9 F TFBE).

Gjykata e Drejtësisë garanton respektimin e ligjit në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Traktateve Themeluese. Përbëhet nga po aq gjyqtarë sa numri i Shteteve Anëtare (neni 251 TFBE, ish neni 221 TKE). Që nga 1 janari 2007, Gjykata ka 27 gjyqtarë. Zëvendësimi i pjesshëm realizohet çdo tre vjet. Gjyqtarët zgjedhin midis tyre një kryetar të Gjykatës, me mandat të rinovueshëm 3-vjeçar. Gjyqtarët ndihmohen nga tetë avokatë të përgjithshëm, të cilët emërohen për gjashtë vjet, me miratim mes Shteteve Anëtare. Gjykata mund të mbledhet në seksione (3-5 gjyqtarë), në seksione të mëdha (13 gjyqtarë), ose në seksione plenare.

Gjykata Europiane e Drejtësisë u krijua nga Traktati themelues i Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut më 1952. Ajo ka dy funksione kryesore:

- të verifikojë nëse instrumentet e institucioneve dhe qeverive Europiane janë në pajtim me Traktatet (procedime për shkelje, procedime për mosveprim, veprime për anulim);
- të japë vendime, me kërkesë të gjykatave vendase, për interpretimin apo vlefshmërinë e dispozitave që përmban e drejta komunitare (referuar vendimit paraparak).

Mbingarkesa e Gjykatës së Drejtësisë dhe zgjatja e kohës për përfundimin e çështjeve, çoi në krijimin e Gjykatës së Shkallës së Parë GJSHPKE në 1989 (me Traktatin e Lisbonës e quajtur Gjykata e Përgjithshme). GJSHPKE përfaqëson shkallën e dytë të autoritetit gjyqësor dhe e ka lehtësuar Gjykatën e Drejtësisë nga një pjesë e barrës së punës. Në të njëjtën linjë, Traktati i Nisës mundësoi ngritjen e paneleve gjyqësore të specializuara, siç është Gjykata Europiane për Shërbimin Civil.

Për të thjeshtuar dhe racionalizuar punën e Gjykatës, Statuti i saj tashmë mund të ndryshohet nga Këshilli, duke vepruar unanimisht me kërkesë të Gjykatës apo Komisionit Europian. Po kështu, Këshilli Europian miraton rregulloren e brendshme të Gjykatës, me shumicë të cilësuar.

Traktati zgjeron rolin e GJED vecanërisht përsa i përket juridiksionit mbi zonën e drejtësië dhe punëve të brendshme si rezultat i shkrirjes së shtyllave, shtyllës së parë dhe asaj të tretë.

Traktati parashikon se paditë për mosveprime do të ngrihen jo vetëm kundër Parlamentit Europian, këshillit të Ministrave dhe Komisionit por kundër Këshillit Europian, Bankës Qendrore Europiane ose kundër cdo agjencie të Bashkimit. Traktati parashikon gjithashtu rritjen e mundësisë së qytetarëve për të ngritur padi kundër akteve ligjore të BE-së në GJED.

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS) mbetet jashtë juridiksionit të GJED. Megjithatë GJED do të ketë juridiksion për të monitoruar nëse veprimet në kuadër të PPJS nuk do të prekin zbatimin e procedurave dhe shtrirjen e kompetencave të institucioneve të parashikuara në Traktate për ushtrimin e kompetencave të bashkimit.

Shiko:

- Gjykatë e Shkallës së Parë e Komuniteteve Europiane
- Institucione Europiane

H

Harmonizim, ~i i taksave / Tax harmonisation

Harmonizimi i taksave qëndron në bashkërendimin e sistemeve tatimore të vendeve Europiane, për të shmangur ndryshimet e pabashkërenduara në politikat fiskale kombëtare, të cilat do të kishin efekt pengues në tregun e brendshëm.

Harmonizimi i plotë tatimor i shtrirë në 27 vende është një sfidë e vështirë, meqë kjo fushë mbetet thelbësisht në kompetencën e shteteve anëtare. Megjithatë, është arritur një shkallë minimale harmonizimi, për shembull, me bandat e përbashkëta të taksës mbi vlerën e shtuar, që kërkojnë një normë minimale TVSH-je prej 15% për të gjitha produktet (përveç përjashtimeve dhe autorizimeve të veçanta).

Zgjerimi i fundit i thelloi pabarazitë tatimore brenda Bashkimit Europian. Në të njëjtën kohë, miratimi i së njëjtës monedhë në 12 shtete Europiane, e ka bërë të nevojshme vendosjen e normave të përbashkëta për TVSH-në dhe rregullave të përbashkëta për tatimin e bizneseve në Bashkimin Europian. Që në 1997, shtetet anëtare janë përfshirë në një debat të larmishëm mbi fushën e veprimit që duhet të kenë ndërhyrjet e bashkërenduara që synojnë të kontrollojnë efektet negative të konkurrencës tatimore. Ky debat është përqendruar në tri fusha: (i) tatimi i shoqërive tregtare, (ii) tatimi i kursimeve/të ardhurave dhe (iii) tatimi i pagesave të qerasë midis shoqërive tregtare.

Në kuadër të “paketës fiskale” për të luftuar konkurrencën e dëmshme tatimore, Këshilli miratoi:

- një kod sjelljeje për tatimin e bizneseve (dhjetor 1997);
- një instrument për uljen e shtrebbërimeve në tatimin mbi kursimet në formën e pagimit të interesave (Direktiva 2003/48/KE);
- një instrument për mënjanimin e taksave ndaj interesave ndërkufitarë dhe pagesave të qerasë ndërmjet kompanive (Direktiva 2003/49/KE).

Shiko:

- Bashkim Doganor
- Bashkim Ekonomik dhe Monetar (BEM)
- Tatime

Hierarki, ~a e akteve Komunitare (hierarki e normave) / Hierarchy of Community acts (hierarchy of norms)

Një deklaratë e shtuar në Traktatin e Bashkimit Europian pohon se është i mundshëm rishikimi i klasifikimit të akteve Komunitare, duke synuar krijimin e një hierarkie të përshtatshme ndërmjet kategorive të ndryshme të akteve.

Qëllimi kryesor i kësaj hierarkie është që t'i japë mundësi autoritetit legjislativ të përqendrohet më shumë në aspektet politike të çështjeve sesa në çështje të hollësishme. Kjo hierarki do të diktojë formën e procesit vendimmarrës të Bashkimit, duke siguruar që instrumentet me status kushtetues t'i nënshtrohen një procedure më të detyrueshme (si miratimi i votimit unanim, shumicë e cilësuar dhe pëlqim) përkundrejt akteve ligjore, të cilat (këto të fundit) u nënshtrohen procedurave më pak fleksible (p.sh., procedura e vendimmarrjes së përbashkët) sesa aktet zbatuese (p.sh., delegimi i institucionalizuar i kompetencave të Komisionit).

Kjo çështje që u bë objekt diskutimi në kontekstet e debateve të fillimit në vitin 1999, u përqendrua në mundësinë e përfshirjes së procedurës së vendimmarrjes së përbashkët në Traktat. Ideja ishte shmangia e një procedure tepër të rreptë që zbatohet për disa akte të një rëndësie dytësore dhe, në këtë mënyrë, parandalon bllokimin e procesit legjislativ. Në 1991, gjatë bisedimeve për Traktatin e Amsterdimit, Komisioni kishte propozuar futjen e një hierarkie normash dhe të një sistemi të ri për klasifikimin e dokumenteve të Komunitetit European (traktate, ligje, akte dytësore dhe zbatuese), por Komisioni European nuk arriti të kapërcejë problemet e ngritura nga tradita të ndryshme kombëtare ligjore.

Shiko:

- E Drejtë Komunitare
- Instrumente ligjore Komunitare

I

Identitet, ~i European i Mbrojtjes dhe Sigurisë / European security and defence identity

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Bosnjë, nxori në pah pabarazinë në lidhje me rrezikun, pasi forcat Europiane vepronin në tokë, ndërsa forcat amerikane ndërhynin nga ajri, pra ishin më pak të rrezikuara.

Administrata e Klintonit e pranoi që në Evropë mund të ketë kriza, ku Shtetet e Bashkuara nuk do të dëshironin të ndërhyjnë. Kjo administratë ka përkrahur idenë për të krijuar një lloj shtylle Europiane brenda NATO-s, ose, e thënë ndryshe, një Identitet Europian të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Në këtë kontekst, Këshilli i NATO-s, i mbledhur në Bruksel në janar 1994, njohu rëndësinë e përcaktimit të një identiteti Europian të veçantë në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen. Hapat e parë u hodhën në Këshillin e NATO-s në Berlin, më 3 qershor 1996.

Që atëherë Bashkimi Europian ka krijuar strukturat e veta të përhershme politike dhe ushtarake për kontrollin politik dhe menaxhimin strategjik të krizave. Në dhjetor 2002, brenda kuadrit të marrëveshjeve të përhershme për bashkëpunim dhe këshillim Bashkimi Europian-NATO, të njohura si “Berlin Plus”, u nënshkrua një Marrëveshje Strategjike Partneriteti për Menaxhimin e Krizave. Falë kësaj marrëveshjeje, Bashkimi Europian do të ketë të drejtën, me efekt të drejtpërdrejtë, për të përdorur burimet logjistike dhe planifikuese të NATO-s, përfshirë informacionin ushtarak.

Shiko:

- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
- NATO e rinovuar
- Mbrojtje Kolektive
- Politikë e Përbashkët e Mbrojtjes dhe Sigurisë

Iniciativë, ~a Qytetare / Citizen's Initiative

Traktati i Lisbonës parashikon nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në politikë-bërjen në nivelet europiane. Sipas nenit 24 TFBE, qytetarët europianë mund t'i kërkojnë Komisionit një projektligj në rast se mblidhen mbi një milion firma nga një numër domethënës Shtetesh Anëtare.

Institucione Europiane / European institutions

Institucionet Europiane janë organet politike të ngritura nga Traktati i Romës për ndërtimin e një Evrope të bashkuar. Neni 9 TFBEU, përmend shtatë institucione Europiane stricto sensu:

- Këshilli Europian
- Parlament-i Europian
- Këshilli i Bashkimit Europian
- Komisioni Europian
- Banka Qendrore Europiane
- Gjykata e Drejtësisë
- Gjykata e Llogarive

Çdo institucion vepron në bazë të kompetencave të përcaktuara në traktate dhe në përputhje me procedurat, kushtet dhe objektivat e parashikuara në traktate. Në bazë të nenit 9 TFBE, struktura institucionale e BE-së ka për qëllim që të promovojë vlerat e tij, avancojë objektivat e tij, t'i shërbejë interesave të qytetarëve dhe të shteteve anëtare dhe të sigurojë koherencë, efektivitet dhe vazhdimësi të politikave dhe veprimeve.

Institucionet janë protagoniste në procesin vendimmarrës . Ato ndërveprojnë me aktorë të tjerë si Komiteti European Ekonomik dhe Social, Komiteti i Rajoneve, Banka Europiane e Investimeve, Avokati i Popullit dhe Agjencitë Komunitare, duke përbërë kështu sistemin institucional European.

Shiko:

- Këshilli European
- Këshilli i Bashkimit European
- Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane (GJED)
- Komisioni European
- Gjykata Europiane e Llogarive
- Parlamenti European
- Banka Qendrore Europiane

Instrumente ligjore të Bashkimit / EU Legal Instruments

Termi “instrumente ligjore të Bashkimit” ka të bëjë me instrumentet që kanë në dispozicion institucionet e Bashkimit European, për të kryer misionet e tyre sipas Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit European, duke pasur parasysh parimin e subsidiaritetit. Ato janë:

- Rregullorja - është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare;
- Direktiva – është e detyrueshme për Shtetin Anëtar që i drejtohet vetëm për rezultatin që duhet arritur. Ajo duhet të përfshihet në kuadrin ligjor kombëtar, por duke i lënë Shtetit Anëtar zgjedhjen e teknikës për formën dhe mjetet e zbatimit;
- Vendimi - është i detyrueshëm në të gjithë elementet e tij për të gjithë;
- Këshillimi dhe mendimi: nuk janë të detyrueshme, dhe kanë thjesht karakter deklarues.

Përveç këtyre instrumenteve të përmendura në nenin 249 të TFBE, praktika ka çuar në zhvillimin e një sërë aktesh atipike (sui generis): marrëveshje ndër-institucionale, rezoluta, përfundime, komunikata, libra të gjelbër dhe libra të bardhë.

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës instrumentat ligjorë të përdorur më parë për shtyllën e tretë si vendimet kuadër, veprimet e përbashkëta, qëndrimet përbashkëta u shfuqizuan.

Shiko:

- Qëndrim i Përbashkët
- Strategjia e Jashtme e Përbashkët
- Libra të Gjelbër
- Hierarki e akteve komunitare (hierarki e normave)
- Aksion i Përbashkët
- Thjeshtim i legjisllacionit
- Libra të Bardhë

i2010 / i2010

Pas paraqitjes në qershor 2005, i2010 – Shoqëria Europiane e Informacionit për 2010 – është Kuadri i ri Strategjik i Komisionit Europian për Shoqërinë e Informacionit dhe Medias.

i2010 është përqendruar në tre prioritete:

- realizimin e një hapësire të vetme Europiane të informacionit që nxit tregun e brendshëm të hapur dhe konkurrues për shoqërinë e informacionit dhe medias;
- promovimin e novacionit dhe investimeve në kërkimin shkencor në lidhje me teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (TIK);
- krijimin e një shoqërie Europiane të informacionit, e bazuar në përfshirje, që i jep përparësi përmirësimit të shërbimeve publike dhe cilësisë së jetës.

i2010 është nisma e parë e Komisionit, e miratuar në kuadrin e Partneritetit të Rinovuar të Lisbonës për rritjen dhe punësimin. Kjo strategji vjen pas dy planeve të veprimit, “eEvrope 2002” dhe “eEvrope 2005”, të cilat përcaktonin aksionet që duheshin realizuar për promovimin e TIK-ut në Evropë.

Shiko:

- Shërbime audiovizive
- eEvrope
- Shoqëri e Informacionit
- Strategji e Lisbonës

K

Kartë, ~a e të Drejtave Themelore / Charter of Fundamental Rights

Në vijim të përvjetorit të 50-të të Deklaratës Universale të së Drejtave të Njeriut, të festuar në dhjetor 1998, Këshilli European i Këlnit (3-4 qershor 1999) filloi punën për hartimin e Kartës së ë Drejtave Themelore. Qëllimi i kësaj karte ishte që Të Drejtat Themelore në nivel të Bashkimit European, të bashkohen në një dokument të vetëm, për të ndërgjegjësuar më shumë mendim publik.

Karta e të Drejtave Themelore e BE-së u shpall solemnisht nga Këshilli European në Nisë, më 7 dhjetor 2000. Karta bazohet në Traktatet Komunitare, konventat ndërkombëtare, si Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (1950) dhe Karta Sociale Europiane (1989), traditat kushtetuese të përbashkëta të Shteteve Anëtare, si edhe deklarata të ndryshme të Parlamentit European.

Puna për hartimin e projektit të Kartës së të Drejtave Themelore iu besua një asambleje të veçantë, Konventës, që përbëhej nga 62 anëtarë, përfshirë përfaqësuesit e institucioneve Europiane dhe të qeverive të Shteteve Anëtare. Në 7 kapituj të ndarë në 54 nene, karta përcakton të drejtat themelore në lidhje me dinjitetin, lirinë, barazinë, solidaritetin, shtetësinë dhe drejtësinë.

Karta sanksionon të drejta që nuk janë të garantuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNj) e cila mjaftohet me mbrojtjen e të drejtave civile dhe politike. Kjo kartë shkon më tej duke mbuluar të drejtat sociale të punëtorëve, mbrojtjen e të dhënave, bioetikën dhe të drejtën për administrim të mirë.

Neni 6(1) të TBE parashikon se Karta do të ketë të njejtën vlerë juridike si Traktatet. Polonia dhe Britania e Madhe kanë bërë rezerva nëpërmjet një protokolli të vecantë bashkëngjitur Traktatit të Lisbonës.

Karta në vetvete nuk parashikon të drejta përveç atyre të parashikuara në instrumentat kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe dokumente nga të cilat burojnë dhe dispozitat e saj.

Shiko:

- Qytetari e Bashkimit European
- Mundësi të barabarta
- Trajtim i barabartë i burrave dhe grave
- Konventë Europiane
- Konventë Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNj)
- Të drejta të njeriut
- Deklaratë e Lekenit
- Kartë Sociale (Karta e të Drejtave Sociale Themelore të Punëtorëve)
- Traktati i Nisës
- Traktati i Lisbonës

Kartë, ~a Sociale (Kartë e të Drejtave Sociale Themelore të Punëtorëve) / Social Charter (Charter of the Fundamental Social Rights of Workers)

Karta e të Drejtave Sociale Themelore të Punëtorëve, e njohur si Karta Sociale, u miratua më 1989 në formën e deklaratës nga të gjitha Shtetet Anëtare, me përjashtim të Britania e Madhe, e cila e miratoi, më 1998. Karta konsiderohet si instrument politik që përmban “detyrime morale”, me qëllim garantimin e respektimit në Shtetet Anëtare të këtyre të drejtave sociale, të cilat lidhen kryesisht me tregun e punës, formimin profesional, mbrojtjen sociale, mundësitë e barabarta dhe shëndetin e sigurinë në punë. Në të i kërkohet shprehimisht Komisionit që të propozojë nisma që synojnë përkthimin në akte legjislative të përmbajtjes së Kartës Sociale. Kjo e fundit është pasuar nga dy programe veprimi dhe propozime konkrete legjislative.

Karta e të Drejtave Themelore, e shpallur në Nisë, më 7 dhjetor 2000, përfshin mes të tjerave të drejtat e shpallura në Kartën Sociale.

Shiko:

- Kartë e të Drejtave Themelore
- Dialog Social
- Politika Sociale
- Marrëveshje për Politikën Sociale (Marrëveshje sociale)

Kërkim, ~i shkencor dhe zhvillim / Research and development

Në thelb të Strategjisë së Lisbonës, e cila synon përmirësimin e rritjes dhe punësimit në Evropë, Politika e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit është një nga përparësitë e Bashkimit Europian. Kërkimi shkencor, bashkë me arsimin dhe risinë, përbën “treëndëshin e dijes” që duhet t’i lejojë Evropës të ruajë dinamizmin ekonomik dhe modelin e vet social. Programi i shtatë Kuadër për Kërkimin Shkencor (2007–2013) ka si objektiv Bashkimin e Hapësirës Europiane të Kërkimit Shkencor (HEKSh), si dhe nxitjen e investimeve kombëtare të nevojshme për arritjen e objektivit 3% të PBB-së.

Për më tepër, krijimi i një Instituti Europian të Teknologjisë më 2009, duhet t’i lejojë ekselencës Europiane të marrë shtrirjen e vet të plotë.

Bashkërendimi i nismave në lidhje me kërkimin shkencor dhe zhvillimin brenda Komunitetit, bazohet në instrumente të ndryshme:

- programet kuadër të kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik. Të krijuar, më 1994, këto programe shumëvjeçare përfshijnë programe specifike për sektorë të ndryshëm, si: teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, mjedisin, bioteknologjinë, energjinë (përfshi energjinë bërthamore), transportin dhe lëvizjen e kërkuesve shkencorë. Programi i shtatë kuadër (2007–2013) gëzon buxhetin më të madh të kërkimit shkencor, që nga krijimi i Evropës. Ai u përgjigjet nevojave të industrisë dhe politikave Europiane dhe synon të verë dijet në shërbim të dinamizmit ekonomik dhe të progresit mjedisor dhe social.
- Qendra e Përbashkët e Kërkimit Shkencor (QPKSH), organ kërkimor që mbështet aksionin e Bashkimit Europian, përbëhet nga tetë qendra kërkimore të shpërndara në Komunitetin Europian, të cilat plotësojnë nevojat specifike të politikave të ndryshme të Komunitetit Europian. Ajo është në ballë të kërkimeve për energjinë bërthamore (veçanërisht sigurinë) dhe është shumëfishuar në sektorë si: materialet, mjedisi, rreziqet industriale dhe satelitët. Qendra financohet nëpërmjet programeve kuadër të BE-së për kërkimin shkencor dhe nga të ardhurat e veta nga kontratat tregtare.

Politika Europiane për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillim bazohet në dispozitat e tre Traktateve Themeluese (ECSC, Euratom dhe Titulli XIX i TFBE). Akti i vetëm Europian futi konceptin e teknologjisë në të drejtën Komunitare dhe Traktati i Bashkimit Europian formuloi më tej objektivat e Komunitetit në këtë fushë.

Shiko:

- Zonë Europiane e Kërkimit Shkencor (ZEKSH)

Këshilli, ~i European / European Council

Këshilli European është termi i përdorur për të përshkruar takimet e rregullta të kryetarëve të shteteve ose qeverive të Shteteve Anëtare të Bashkimit European. Roli i tij është t'i japë Bashkimit European shtysën e duhur për t'u zhvilluar dhe të përcaktojë orientimet e politikave të përgjithshme (neni 4 i Traktatit të Bashkimit European). Këshilli European nuk miraton legjislacionin.

Këshilli European mbledhet të paktën 4 herë në vit (praktikisht dy herë për çdo presidencë) dhe Presidenti (Kryetari) i Komisionit European merr pjesë si anëtar me të drejta të plota. Traktati i Lisbonës e zyrtarizoi këtë praktikë. Një mbledhje e jashtëzakonshme mund të mbahet kurdo që është e nevojshme. Kryesohet nga Shtetit Anëtar që mban presidencën 6-mujore të Bashkimit European dhe nga Presidenti i Këshillit European. Vendimet merren me konsensus, pas bisedimeve ndërmjet Shteteve Anëtare, të cilat fillojnë para samitit. Rezultati i diskutimeve të Këshillit European regjistrohet në përfundimet e botuara në fund të mbledhjes.

Këshilli European u krijua nga Komunikata e lëshuar në mbylljen e Samitit të Parisit në dhjetor 1974 dhe u mbledh për herë të parë, më 1975. Përpara kësaj kohe, nga 1961 deri më 1974, ka ekzistuar praktika e konferencave Europiane të nivelit të lartë. Akti i vetëm European (1986) krijoi bazën ligjore për ekzistencën e Këshillit European dhe Traktati i Bashkimit European (Traktati i Mastroihti, 1992) përcaktoi funksionet e tij.

Në përputhje me një deklaratë bashkëngjitur Aktit Final të Konferencës Ndërqeveritare, që shërbeu si paraprijëse e Traktatit të Nisës, të gjitha mbledhjet e Këshillit European janë mbajtur në Bruksel, që kur Bashkimi numëronte 15 Anëtarë.

Traktati i Lisbonës u dha Bankës Qendrore Europiane dhe Këshillit European statusin e institucionit.

Sipas Traktatit të Lisbonës, Këshilli European do të ketë të njejtën përbërje, me pjesmarrjen e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit dhe një Presidenti me kohë të plotë. Qëllimi i tij është që t'i japë Bashkimit një ritëm të ri për zhvillimin e tij dhe të përcaktojë udhëzimet e përgjithme politike. Këshilli European vazhdon të mos ushtrojë rol ligjvënës.

Shiko:

- Këshilli i Bashkimit European
- Konferenca Ndërqeveritare (KNQ)
- Presidenti i Këshillit European

Këshilli, ~i i Bashkimit European / Council of the European Bashkim

Këshilli i Bashkimit European ("Këshilli i Ministrave" ose "Këshilli") është institucioni kryesor vendimmarrës i Bashkimit European. Në mbledhjet e tij marrin pjesë ministra të Shteteve Anëtare dhe, rrjedhimisht, është institucioni që përfaqëson Shtetet Anëtare. Selia e Këshillit është në Bruksel, por disa mbledhje mbahen në Luksemburg. Sesionet e Këshillit thërriten nga Presidenca, e cila vendos edhe programin.

Këshilli mbledhet në trajta të ndryshme (nëntë gjithsej) dhe mbledh ministrat përkatës të Shteteve Anëtare që mbulojnë: çështjet e përgjithshme dhe marrëdhëniet me jashtë; çështjet ekonomike dhe financiare, punësimin, politikat sociale, shëndetin dhe çështjet e konsumatorit, konkurrueshmërinë, bashkëpunimin në fushat e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme, transportin, telekomunikacionet dhe energjinë; bujqësinë dhe peshkimin; mjedisin; arsimin, rininë dhe kulturën.

Çdo shtet i Bashkimit European kryeson Këshillin European për gjashtë muaj, me rotacion. Që në janar 2007, është në fuqi një sistem i ri për mbajtjen e Presidencës së Këshillit European. Për çdo periudhë 18-mujore, tri presidencat që kanë qenë në detyrë, përgatisin një projekt program të përbashkët. Vendimet përgatiten nga Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm (Coreper) të Shteteve Anëtare, i ndihmuar nga grupet e punës të funksionarëve të administratave kombëtare.

Këshilli European, bashkë me Parlamentin European, ushtron funksione legjislative dhe buxhetore. Ai është gjithashtu institucioni drejtues për vendimmarrjen për çështjet e politikës së jashtme, për sigurinë e përbashkët dhe për bashkërendimin e politikave ekonomike (qasja ndërqeveritare), si dhe për mbajtjen e kompetencës ekzekutive, të cilën zakonisht ia delegon Komisionit.

Në më të shumtën e rasteve, vendimet e Këshillit European, bazuar në propozimet e Komisionit, merren bashkërisht me Parlamentin European me procedurën e bashkë-vendimmarrjes. Në varësi të çështjes, Këshilli European merr vendime me shumicë të thjeshtë, shumicë të cilësuar ose me unanimitet. Megjithatë, shumica e cilësuar përdoret më shpesh (në bujqësi, tregun unik, mjedis, transport, punësim, shëndetësi etj.).

Me Traktatin e Lisbonës, votimi me shumicë të cilësuar në Këshillin e Ministrave bëhet metoda e zakonshme e votimit (neni 16 TBE). Gjithashtu, Traktati parashikon edhe një klauzolë transparence (neni 16 (8) TBE) sipas të cilës mbledhjet e Këshillit do të jenë publike kur votohet ose vendoset për hartimin e një akti legjislativ. Në fakt, çdo mbledhje e Këshillit të Ministrave ndahet në dy pjesë, që kanë të bëjnë me aktivitetet e akteve legjislative dhe jo-legjislative, ku vetëm gjysma e parë do të jetë publike.

Shiko:

- Komitete dhe grupe pune
- Coreper
- Këshilli European
- Presidencë e Bashkimit
- Shumicë e cilësuar
- Unanimitet

Klasifikim, ~i i shpenzimeve / Classification of expenditure

Ka të bëjë me dallimin që bëhet ndërmjet shpenzimeve të Bashkimit European, për të cilat parimi bazë dhe shuma përcaktohen ligjërisht nga marrëveshjet, legjislacioni dytësor, konventat, traktatet ndërkombëtare apo kontratat private (shpenzime “të detyrueshme”) dhe shpenzimeve për të cilat autoriteti buxhetor është i lirë të vendosë shumën si t’i duket e arsyeshme (shpenzime “jo të detyrueshme”). Çështja nëse shpenzimi duhet të konsiderohet apo jo i detyrueshëm, shkakton mosmarrëveshje ndërmjet dy anëve të autoritetit buxhetor, Këshillit dhe Parlamentit European, pasi Parlamenti ka fjalën e fundit në përcaktimin e shumës së shpenzimeve vetëm kur këto nuk janë të detyrueshme. Traktati i Lisbonës ka eliminuar konceptin e shpenzimeve të detyrueshme (neni 314 TFBE) . Për pasojë, Parlamenti European ka një rol më të madh në procesin e buxhetimit vjetor pasi ai nuk do të përjashtohet më nga vlerësimi i atyre fushave të buxhetit që përfshiheshin tek shpenzimet e detyrueshme (të bujqësisë).

Heqja e dallimeve midis shpenzimeve të detyrueshme dhe jo të detyrueshme dhe përdorimi i procedurës së zakonshme legjislative për buqësinë është një hap i rëndësishëm për këtë fushë.

Shiko:

- Buxhet
- Politikë e Përbashkët Bujqësore (PPB)
- Procedurë e Këshillit
- Këshilli i Bashkimit European
- Parlamenti European

Klauzolë, ~a e mospjesëmarrjes / Opting out

Mospjesëmarrja është një përjashtim që i ofrohet një vendi që nuk dëshiron t'u bashkohet shteteve të tjera anëtare në një fushë të caktuar bashkëpunimi, si një mënyrë për të shmangur një bllokim të përgjithshëm. Për shembull, Britania e Madhe kërkoi të mos merrte pjesë në fazën e tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (BEM). I njëjti trajtim iu lejua Danimarkës për sa i takon BEM, mbrojtjes dhe qytetarisë Europiane.

Në të njëjtën mënyrë, Acquis e Shengenit ka qenë objekt i një përshtatje të pjesshëm, pasi Irlanda, Britania e Madhe dhe Danimarka mund të vendosin rast pas rasti nëse duan të marrin pjesë plotësisht apo pjesërisht në masat e planifikuara.

Shiko:

- Bashkëpunim i zgjeruar
- Këshilli European
- Shengen (Marrëveshje dhe Konventa)
- Bashkim Ekonomik dhe Monetar (BEM)

Klauzolë, ~a e pezullimit / Suspension clause

Traktati i Amsterdimit i shtoi Traktatit të Bashkimit European klauzolën e pezullimit (neni 7). Sipas kësaj klauzole, disa nga të drejtat e një shteti anëtar (p.sh. të drejtat e votimit në Këshill) mund të pezullohen, në qoftë se ky shtet ka shkelur në mënyrë të rëndë dhe të vazhdueshme parimet mbi të cilat është themeluar Bashkimi European (liria, demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, si dhe respektimi i ligjit). Megjithatë, detyrimet e tij do të jenë sërish në fuqi.

Traktati i Nisës i shtoi një mekanizëm parandalues kësaj procedure. Mbi bazën e propozimit të një të tretës të shteteve anëtare, të propozimit të Komisionit ose të Parlamentit European, Këshilli, me shumicë prej katër të pestat e anëtarëve të tij, pas marrjes së pëlqimit prej Parlamentit European, mund të përcaktojë nëse ekziston një rrezik i dukshëm i shkeljeve të rënda të këtyre parimeve themelore nga ana e një shteti anëtar dhe jep rekomandimet e duhura për të.

Shiko:

- Kartë e të Drejtave Themelore
- Të drejta të njeriut

Kodifikim, ~i i legjisllacionit (formal/zyrtar) / Consolidation of legislation- formal/ oficial

Kodifikimi i legjisllacionit (formal/zyrtar) ka të bëjë me miratimin e një akti të ri ligjor, botuar në Gazetën Zyrtare (seria L), i cili përfshin dhe shfuqizon aktet e kodifikuara (akti bazë + akt i ndryshuar), pa e ndryshuar përmbajtjen e tyre. Kodifikimi mund të jetë:

- vertikal - akti i ri përfshin aktin bazë dhe aktet që e ndryshojnë në një akt të vetëm;

- horizontal- akti i ri përfshin disa akte bazë paralele dhe ndryshimet e tyre, në lidhje me të njëjtën çështje në një akt të vetëm.

Shiko:

- Bashkim i legjislacionit – joformal/deklarues
- Riformulim i legjislacionit
- Thjeshtim i legjislacionit

Kohezioni, ~i ekonomik, social dhe territorial / Economic, social and territorial cohesion

Kohezioni ekonomik dhe social është shprehje e solidaritetit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe rajoneve të Bashkimit Europian. Qëllimi i këtij kohezioni është zhvillimi i ekuilibruar në Bashkimin Europian, duke pakësuar ndryshimet strukturore ndërmjet rajoneve dhe duke nxitur mundësi të barabarta për të gjithë individët. Në terma praktikë, kjo arrihet me një larmi veprimesh financiare, fillimisht përmes Fondeve strukturore dhe Fondit të Kohezionit. Çdo tre vjet, Komisioni Europian paraqet një raport në lidhje me progresin e bërë në arritjen e kohezionit ekonomik dhe social, si edhe vlerëson se sa kanë kontribuar në këtë drejtim politikat e Komunitetit.

Në nivel Europian, origjina e Politikës së Kohezionit Ekonomik dhe Social gjendet në Traktatin e Romës (1957), në parathënien e të cilit bëhet një referencë për të zvogëluar ndryshimet rajonale. Në vitet '70 u ndërmor veprimi i Komunitetit për të bashkënduar instrumentet rajonale dhe për të siguruar burimet shtesë financiare. Me kalimin e kohës, këto masa rezultuan të papërshtatshme për situatën në Komunitet, ku, ndryshe nga parashikimet, krijimi i tregut të brendshëm dështoi në pakësimin e diferencave mes rajoneve.

Me miratimin e Aktit Unik Europian në 1986, kohezioni ekonomik dhe social u bë qëllim, së bashku me përfundimin e tregut të vetëm. Më në fund, Traktati i Mاستrihtit (1992) e përfshiu këtë politikë në vetë Traktatin e Komunitetit Europian (neni 158 deri 162).

Kohezioni ekonomik dhe social, në thelb, zbatohet nëpërmjet politikës rajonale të Bashkimit Europian. Përveç reformës së politikës së përbashkët bujqësore dhe zgjerimit me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, në vitin 2004 politika rajonale ishte një nga çështjet kryesore të diskutuara në Axhendën 2000, e cila mbulon periudhën 2000 - 2006, kryesisht për shkak të ndërlikimeve financiare.

Politika rajonale është zëri buxhetor më i madh i Komunitetit Europian, me një shumë prej 348 miliard eurosh (me çmimet e 2006-ës) për periudhën 2007- 2013. Zgjerimi në 27 Shtete Anëtare në janar 2007 kërkoi një rend plotësisht të ri. Sipërfaqja e Bashkimit Europian është rritur me rreth 25%, popullsia me mbi 20% dhe pasuria vetëm me afërsisht 5%. PBB mesatar për frymë në Bashkimin Europian ka zbritur me mbi 10% dhe diferencat mes rajoneve janë dyfishuar. Meqë 60% e rajoneve me zhvillim të mangët gjenden në 12 Shtetet Anëtare që iu bashkuan BE-së në vitin 2004, qendra e gravitetit të politikës rajonale po zhvendoset drejt Lindjes.

Për periudhën 2007-2013, kohezioni ekonomik dhe social përqendrohet më tepër në zhvillimet kyçe në fushën e rritjes ekonomike dhe punësimit, duke vazhduar të mbështesë rajonet që nuk e kanë përfunduar procesin e konvergencës në terma realë. Ndiha strukturore gjithashtu vazhdon të jetë e nevojshme në zonat gjeografike që përballen me probleme strukturore të veçanta (zonat ku po ndodhin ristrukturime industriale, zona urbane, zona rurale, zona me varësi nga peshkimi dhe zonat që vuajnë nga pengesa natyrore apo demografike). Në fund, thjeshtimi dhe decentralizimi i menaxhimit të instrumenteve financiare të politikës rajonale (Fondet strukturore dhe Fondi i Kohezionit), do të jenë kryefjala e reformës së politikës rajonale për periudhën 2007-2013.

Me Traktatin e Lisbonës, Kohezioni Ekonomik, Social dhe Territorial përbën Titullin XVIII të TFBE.

Shiko:

- Komitet i Rajoneve (KR)
- Zgjerim
- Banka Europiane e Investimeve (BEI)
- Fonde strukturore dhe Fond i Kohezionit
- Subsidiaritet
- Zhvillim i qëndrueshëm
- Rrjete NdërEuropiane (RRTE)

Komision, ~i European / European Commission

Komisioni European është një institucion kolegjal, politikisht i pavarur, që mishëron dhe mbrohet interesat e përgjithshëm të Bashkimit European. E drejta thuhet ekskluzive për të marrë nisma në fushën e legjislativës, e bën atë motorin e integritit European. Komisioni European përgatit dhe pastaj zbaton instrumentet legjislative të miratuara nga Këshilli dhe Parlamenti European, në lidhje me politikën e Komunitetit.

Komisioni European gjithashtu ka kompetenca zbatimi, menaxhimi dhe kontrolli. Ai është përgjegjës për planifikimin dhe zbatimin e politikave të përbashkëta, ekzekutimin e buxhetit dhe menaxhimin e programeve komunitare. Gjithashtu, si “gardian i traktateve”, ai garanton zbatimin e të drejtës Europiane.

Komisioni emërohet me mandat 5-vjeçar nga Këshilli, që vepron me shumicë të cilësuar, në mirëkuptim me shtetet anëtare. Komisioni i nënshtrohet një vote emërimi nga Parlamenti European, të cilit i jep llogari. Komisionerët ndihmohen nga administrata, e përbërë nga drejtoritë e përgjithshme dhe departamente të specializuara, stafi i të cilave është i ndarë kryesisht ndërmjet Brukselit dhe Luksemburgut..

Që nga konceptimi fillestar, Komisioni European gjithmonë është përbërë nga dy shtetas të secilit Shtet Anëtar me popullsi të madhe dhe nga një shtetas i secilit shtet tjetër. Sidoqoftë, Traktati i Nisës e kufizoi numrin e anëtarëve të Komisionit me nga një për çdo Shtet Anëtar. Traktati i Lisbonës sanksionon që pas vitit 2014, në Komisionin European do të përfaqësohen vetëm 2/3 e Shteteve Anëtare. Më pas, anëtarët do të përzgjidhen sipas sistemit të rotacionit, bazuar në parimin e barazisë. Ky sistem i ri është një shenjë progresi pasi zvogëlimi i Komisionit do të eliminojë çdo nacionalizëm të kolegjit të Brukselit të ngarkuar me përfaqësimin e interesave të përgjithshme të Bashkimit.

Me Traktatin e Lisbonës, Komisioni ka një rol më të qartë në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme si pasojë e shkrirjes së shtyllës së parë dhe të tretë.

Ndërkohë që zgjedhjet për Parlamentin European do të kenë një ndikim të drejtëpërdrejtë në përzgjedhjen e Presidentit të Komisionit. Traktati parashikon se Këshilli European duhet të marrë në konsideratë zgjedhjet në Parlamentin European kur do të propozojë kandidaturën për postin e Presidentit të Komisionit tek Parlamenti European. Gjithashtu, për herë të parë Traktati pohon shprehimisht që kolegji i Komisionerëve përgjigjet para Parlamentit European (neni 17 i TBE).

Shiko:

- Përbërje e Komisionit European
- Konfirmim i Komisionit European
- Institucione Europiane
- Vëzhgim i zbatimit të së Drejtës Komunitare
- President i Komisionit European
- E drejtë e iniciativës

Komisione parlamentare / Parliamentary committees

Ashtu si në parlamentet e shteteve, brenda Parlamentit European janë ngritur komisione të ndryshme, për të përgatitur procedimet në seanca plenare. Puna më kryesore legislative e Parlamentit European kryhet në këto komisione. Anëtarët e çdo komisioni zgjidhen në fillim ose në mes të çdo mandati parlamentar, sipas përkatësisë së tyre politike dhe përvojës së tyre.

Sipas Rregullores së brendshme të Parlamentit European, anëtarët e Parlamentit European caktojnë numrin e komisioneve dhe përcaktojnë kompetencat e tyre. Për mandatin e gjashtë parlamentar (2004-2009) u vendos të rritet në 20 numri i komisioneve të përhershme të specializuara, kundrejt 17 që ishin më parë. Këto ndahen sipas sektorëve (tregu i brendshëm, bujqësia, punësimi, industria, kultura, çështjet kushtetuese dhe ligjore etj.).

Parlamenti European mund të krijojë edhe nënkomisione, komisione të përkohshme dhe komisione hetimore, nëse shihet e nevojshme. Komisionet hetimore shqyrtojnë për shkelje të mundshme të së Drejtës Komunitare, apo rastet e keqadministrimit në zbatimin e saj. Për shembull, një komision hetimor u ngrit në 1997 për të hetuar vonesën e reagimit European ndaj krizës së “lopës së çmendur”. Komisione të përkohshme ngrihen për një periudhë 12-mujore, por mund t’iu ripërtërihet mandati pafundësisht. Kompetencat e tyre nuk kufizohen vetëm në zbatimin e Të Drejtës Komunitare.

Detyra kryesore e komisioneve të përhershme është të debatojnë rreth propozimeve për legjislacionin e ri, të parashtuar nga Komisioni European dhe të hartojnë raporte me nismën e vet. Një Relator emërohet për çdo propozim për legjislacionin apo iniciativë tjetër, sipas një marrëveshjeje ndërmjet grupeve politike që përbëjnë Parlamentin. Raporti i relatorit diskutohet, ndryshohet dhe votohet brenda komisionit parlamentar, pastaj i përcillet kuvendit plenar që mbledhet një herë në muaj në Strasburg, i cili diskuton e voton në bazë të këtij raporti.

Gjatë procesit të përgatitjes së votës të miratimit të Parlamentit për Komisionin European, Komisionet Parlamentare dëgjojnë anëtarët e propozuar të Komisionit, sipas fushave të tyre të kompetencës.

Shiko:

- Konfirmim i Komisionit European
- Parlamenti European

Komitete dhe grupe pune / Committees and working parties

Komitetet që kanë për detyrë të ndihmojnë institucionet e Bashkimit European, përfshihen në të gjitha fazat e procesit legjislativ. Komisioni, nga ana e vet, këshillohet rregullisht me ekspertët përpara se të hartojë një propozim të ri për legjislacionin. Këto Komitete Europiane, të cilat përbëhen nga përfaqësues të grupeve të interesuara, ekspertë nga sektori privat ose qeveria, sigurojnë që Komisioni të jetë i hapur ndaj shqetësimeve të atyre që do të preken nga legjislacioni. Gjithsej janë rreth 60 Komitete Këshillimi, që mbulojnë të gjithë sektorët. Megjithatë, gjysma e tyre merret me çështje bujqësore.

Në Parlamentin European, komitete të ndryshme të përhershme, organizojnë punën e deputetëve të Parlamentit European.

Edhe Këshilli European ndihmohet nga komitetet dhe nga grupet e punës, të cilat përgatisin vendimet e tij. Ekzistenca e disa komiteteve parashikohet në traktate (p.sh. “Komiteti për Drejtësi dhe Punë të Brendshme”, i krijuar mbi bazën e nenit 36), kurse të tjerë, janë komitete ad hoc, si p.sh., Komiteti i Çështjeve Kulturore që vlerëson propozimet për bashkëpunim kulturor, përgatit diskutimet e Këshillit European dhe ndjek masat e ndërmarra. Këto komitete përbëhen nga përfaqësues të Shteteve Anëtare, plus një anëtar i Komisionit. Paralelisht, grupe pune të ndryshme bëjnë punën përgatitore për Coreper. Ndërsa disa prej tyre janë krijuar përkohësisht për t’u marrë me një çështje të veçantë, rreth 100 grupe mbulojnë një sektor të caktuar dhe takohen rregullisht.

Pasi miratohet një tekst legjislativ, duhen respektuar disa parime të përgjithshme, për zbatimin e të cilave mund të jenë të nevojshme masa më të sakta. Në këtë rast, teksti parashikon që një komitet të ngrihet brenda Komisionit, me qëllim që të merret vendimi i duhur. Këto komitete përbëhen nga ekspertë të emëruar nga Shtetet Anëtare, drejtohen nga Komisioni Europian dhe, përgjithësisht, qeverisen nga rregulla të përcaktuara me vendimin e Këshillit Europian datë 28 qershor 1999 që njihet si “Vendimi për Komitologjinë”. Ka rreth 300 komitete të tilla që veprojnë në fushat e industrisë, çështjeve të brendshme, bujqësisë, mjedisit, tregut të brendshëm, studimit dhe zhvillimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe sigurisë ushqimore.

Shiko:

- Komitet i krijuar në përputhje me nenin 36 të Traktatit të Bashkimit Europian
- Coreper
- Komitet i Punësimit
- Komitete parlamentare
- Komitet Politik dhe i Sigurisë (KPS)

Komitet, ~i Europian Ekonomik dhe Social / European Economic and Social Committee (EESC)

Komiteti Europian Ekonomik dhe Social u krijua, më 1957, si një organ këshillimor nga Traktati Themelues i Komunitetit Ekonomik Europian, për të përfaqësuar interesat e grupeve të ndryshme ekonomike dhe sociale. Përbëhet nga 344 anëtarë që iu përkasin tri kategorive: nëpunësve, punëtorëve dhe përfaqësuesve të llojeve të veprimtarive të veçanta (si: fermerëve, artizanëve, bizneseve dhe industrive të vogla, profesioneve të lira, përfaqësuesve të konsumatorëve, shkencëtarëve dhe mësuesve, kooperativave, familjeve, lëvizjeve për mbrojtjen e mjedisit). Anëtarët emërohen me vendim të cilësuar të Këshillit me një mandat 4-vjeçar të ripërsëritshëm.

Komitetit Europian Ekonomik dhe Social i kërkohen këshilla përpara se të miratohen shumë instrumente që kanë të bëjnë me tregun e brendshëm, arsimin, mbrojtjen e konsumatorit, mjedisin, zhvillimin rajonal dhe çështjet sociale. Komiteti Europian Ekonomik dhe Social mund të japë dhe mendime me nismën e vet. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (maj 1999), Komitetit Europian Ekonomik dhe Social duhet t’i merren këshilla për një gamë më të gjerë çështjesh (politikën e re të punësimit, legjisacionin e ri për punët sociale, shëndetin publik, mundësi të barabarta) dhe po ashtu, këshillimi i Komitetit Europian Ekonomik dhe Social mund të kërkohet nga vetë Parlamenti Europian.

Traktati i Nisës i miratuar në dhjetor 2000, nuk e ndryshoi numrin dhe shpërndarjen e vendeve të Shteteve Anëtare në Komitetin Europian. Megjithatë, e drejta për anëtarësi u qartësua: KEES përbëhet nga “përfaqësues të kategorive të ndryshme të veprimtarive ekonomike dhe shoqërore”.

Shiko:

- Dialog social
- Partnerë socialë

Komitet, ~i i krijuar në përputhje me nenin 36 të Traktatit të Bashkimit Europian / Article 36 Committee of the EU Treaty

Komiteti i përcaktuar në nenin 36 të Traktatit të Bashkimit Europian, i njohur gjithashtu si CATS, është një grup pune i Këshillit Europian.

Komiteti përbëhet nga zyrtarë të lartë dhe ka si rol bashkërendimin e grupeve të punës përkatëse në fushën e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor (Shtylla e Tretë). Misioni i tij është

gjithashtu të përgatisë punën e rëndësishme të Komitetit të përfaqësuesve të përhershëm. Organi homolog për çështjet e azilit dhe emigracionit është SCIFA (Komiteti Strategjik për Emigracionin, Kufijtë dhe Azilin), i cili ndryshe nga CATS, është grup pune i Shtyllës së Parë.

Shiko:

- Coreper

Komitet, ~i i Pajtitimit / Conciliation Committee

Neni 294 TFBE, paragrafi 10 (ish 251, paragrafi i Traktatit të Bashkimit European) parashikon krijimin e një Komiteti Pajtimi, si pjesë e procedurës së vendimmarrjes së përbashkët ndërmjet Këshillit dhe Parlamentit European. Ky komitet përfshin anëtarët e Këshillit European ose përfaqësuesit e tyre dhe një numër të njëjtë përfaqësuesish nga Parlamenti European dhe bashkëkryesohet nga Presidenti i Parlamentit dhe Presidenti i Këshillit European. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet këtyre dy institucioneve pas leximit të dytë të një propozimi, i paraqitet komitetit. Qëllimi është që të arrihet mirëkuptimi për një tekst nga të dy palët. Komisioni gjithashtu luan rol në Komitetin e Pajtitimit për të ndihmuar Parlamentin dhe Këshillin European që të zgjidhin mosmarrëveshjet.

Projekti i çdo teksti të përbashkët duhet të miratohet brenda gjashtë javësh (që mund të shtyhet me dy javë) me shumicë absolute të votave të hedhura në Parlamentin European dhe me shumicë të cilësuar në Këshillin European. Nëse njëri nga institucionet e refuzon propozimin, ky projekt nuk miratohet.

Shiko:

- Procedurë e Vendimmarrjes së Përbashkët
- Këshilli i Bashkimit European
- Parlamenti European

Komitet, ~i i Punësimit / Employment Committee

Komiteti i Punësimit, ashtu siç përcaktohet nga Traktati i Amsterdimit dhe nga vendimi i Këshillit European i janarit të vitit 2000, ka zëvendësuar zyrtarisht Komitetin e Punësimit dhe Tregut të Punës (KOTP), të ngritur në vitin 1996. Komiteti i Punësimit merr përsipër detyrat e realizuara më parë nga KOTP për promovimin e bashkërendimit të politikave kombëtare të punësimit dhe të tregut të punës.

Detyra kryesore e Komitetit të Punës është të asistojë Këshillin European në punën e vet për Strategjinë Europiane për Punësimin dhe instrumentet e saj (Udhëzimet për punësimin, këshillimet për zbatimin e politikave kombëtare të punësimit, etj.) Komiteti gjithashtu formulon mendime me kërkesë qoftë të Këshillit apo të Komisionit European, ose me iniciativë të vet. Komiteti përbëhet nga dy përfaqësues nga secili Shtet Anëtar dhe nga dy përfaqësues nga Komisioni European. Komiteti këshillohet me partnerët sociale në nivel European, me qëllim që të realizojë me sukses detyrat e veta..

Shiko:

- Punësim
- Strategji Europiane për Punësimin

Komitet, ~i i Rajoneve (KR) / Committee of the Regions (CoR)

I krijuar në 1992 nga Traktati i Mاستrihit dhe i ngritur në 1994, Komiteti i Rajoneve është një organ këshillimor që u mundëson autoriteteve vendore dhe rajonale t'u dëgjohet zëri në procesin vendimmarrës të Bashkimit European. Ai përbëhet nga 344 përfaqësues nga autoritetet vendore dhe rajonale, të emëruar nga Këshilli për katër vjet.

Komiteti i Rajoneve këshillohet nga Këshilli, Parlamenti dhe Komisioni në fushat me ndikim në interesat vendore dhe rajonale. Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Amsterdami në maj 1999, Komiteti i Rajoneve duhet të marrë ndihmesë konsultimi për një gamë të gjerë fushash: kohezioni ekonomik dhe social, punësimi, politika sociale, rrjetet e transportit ndër-European, energjia dhe telekomunikacionet, arsimit dhe rinia, formimi profesional, kultura, mjedisi, shëndeti publik dhe transporti. Komiteti i rajoneve mund të japë mendime edhe me iniciativën e vet.

Traktati i Nisës, i miratuar në dhjetor 2000, nuk e ndryshoi as numrin dhe as shpërndarjen e vendeve të Shteteve Anëtare në Komitetin e Rajonit. Duke pasur parasysh zgjerimin, Traktati parashikon që në të ardhmen numri i anëtarëve të mos kalojë numrin 350. Për sa i takon të drejtës për t'u zgjedhur për anëtarësi, Traktati parashikon qartë që Anëtarët duhet të kenë mandat zgjedhor të autoritetit lokal apo rajonal, ose të jenë politikisht të zgjedhur për një asamble të zgjedhurish.

Komiteti i Rajoneve, ashtu si Banka Qendrore dhe Gjykata e Llogarive, gëzon të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës me qëllim mbrojtjen e detyrimeve/interesave të tyre (neni 263 i TFBE).

Shiko:

- Institucione Europiane
- Subsidiariteti

Komitet, ~i Politik dhe i Sigurisë / Political and Security Committee (PSC)

Komiteti Politik dhe i Sigurisë (KPS) është një organ i përhershëm në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, të përmendur në nenin 38 TBE (ish nenin 25 të Traktatit të Bashkimit Europian). Ai përbëhet nga drejtuesit politikë të ministrive të jashtme të Shteteve Anëtare. Fusha e veprimit e tij është:

- Të vëzhgojë situatën ndërkombëtare në fushat që mbulohen nga Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS);
- të kontribuojë në përcaktimin e politikave;
- të vëzhgojë zbatimin e vendimeve të Këshillit Europian.

Nën përgjegjësinë e Këshillit Europian dhe të Përfaqësuesit të Lartë të për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, komiteti ushtron kontroll politik dhe drejtim strategjik të operacioneve të menaxhimit të krizave. Kështu, ai mund të autorizohet nga Këshilli Europian që të marrë vendime rreth menaxhimit praktik të një krize. Ai ndihmohet nga një grupi politik-ushtarak, Komiteti për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave dhe nga Komiteti Ushtarak dhe stafi ushtarak.

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdami, ngritja e komitetit u vendos parimisht nga Këshilli Europian në Helsinki, në dhjetor 1999. Komiteti ishte fillimisht i përkohshëm, por u bë organ i përhershëm nga Këshilli Europian në Nisë, në dhjetor 2000.

Shiko:

- Përfaqësuesi i Lartë i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë
- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Politika Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes (PESM)

Komitologji, ~a / Comitology

Sipas nenit 202 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian, Komisioni Europian ka për detyrë zbatimin e legjislativonin në nivel Komunitar. Praktikisht, secili akt legjislativ përcakton fushën e kompetencave zbatuese që i janë dhënë Komisionit nga Këshilli i

Bashkimit European. Në këtë kontekst, traktati parashikon që Komisioni European duhet të ndihmohet nga një komitet, sipas procedurës së njohur si “komitologji”.

Komitetet janë forume diskutimi dhe përbëhen nga përfaqësues të Shteteve Anëtare dhe kryesohen nga Komisioni European. Ato i japin mundësi Komisionit European që të hyjë në dialog me administratat kombëtare, përpara miratimit të masave zbatuese. Komisioni European siguron që masat në fjalë të pasqyrojnë sa më mirë që është e mundur situatën në secilin nga vendet e interesuara.

Marrëdhëniet ndërmjet Komisionit dhe Komiteteve European bazohet në modele të përcaktuara në një Vendim të Këshillit (“Vendimi për Komitologjinë”), i cili i jep Parlamentit European të drejtën të vëzhgojë zbatimin e instrumenteve legjislativë, të miratuara me procedurën e vendimmarrjes së përbashkët. Parlamenti European mund të kundërshtojë masat e propozuara nga Komisioni ose, sipas rastit, nga Këshilli, nëse i konsideron se ato kanë tejkaluar kompetencat ekzekutive të dhëna nga legjislati.

Kategoritë e komiteteve në vijim mund të dallohen sipas mënyrës se si funksionojnë:

- Komitetet e këshillimit: japin mendime të cilat Komisioni European duhet t'i marrë në konsideratë.
- Komitetet e menaxhimit: nëse masat e miratuara nga Komisioni European nuk përputhen me mendimin e komitetit, Komisioni European duhet t'ia komunikojë ato Këshillit European i cili, brenda një periudhe të përcaktuar nga akti themelor, mund të miratojë një vendim ndryshe me shumicë të cilësuar.
- Komitetet rregullatore: nëse masat e parashikuara nga Komisioni European nuk janë në pajtim me mendimin e komitetit, Komisioni European mund t'ia paraqesë ato Këshillit European dhe, për informacion, Parlamentit European. Këshilli European mund të japë pëlqimin ose të bëjë një ndryshim brenda periudhës, jo më të gjatë, se tre muaj. Nëse Këshilli European nuk merr një vendim, Komisioni European harton masat zbatuese, në rast se Këshilli European nuk e kundërshton këtë. Në rastin e dytë, Komisioni European mund të paraqesë një propozim të ndryshuar, ose një propozim të ri, ose të paraqesë sërish të njëjtin propozim.
- Komitetet rregullatore me kontroll: këto duhet t'i mundësojnë Këshillit dhe Parlamentit European të kryejnë një kontroll para miratimit të masave me shtrirje të përgjithshme, të cilat kanë për objekt ndryshimin e elementëve jothelbësore të një akti të miratuar me vendimmarrje të përbashkët. Në rastin në të cilin një nga dy institucionet shpreh mospëlqimin e vet, Komisioni nuk mund të miratojë masën e propozuar. Megjithatë, në këtë pikë mund të paraqesë një propozim të ndryshuar ose të ri.

Vendimi i Këshillit i 28 qershorit 1999 zëvendësoi vendimin e 13 korrikut 1987, duke thjeshtuar sistemin dhe duke mbajtur parasysh procedurën e re të vendimmarrjes së përbashkët (që i njeh Parlamentit të drejtën për të ndërhyrë). Ajo gjithashtu e përmirësoi transparencën e sistemit të komiteteve në favor të Parlamentit European dhe publikut të gjerë. Dokumentet e komiteteve janë më lehtësisht të arritshme nga qytetarët dhe regjistrohen në një regjistër publik. Parlamenti, në këtë mënyrë, është mjaft i informuar për punën e komiteteve.

Vendimi i vitit 1999 u zëvendësua nga një vendim i ri i miratuar në korrik 2006, që fut një procedurë të re për ushtrimin e kompetencave ekzekutive: procedurën rregullatore me kontroll. Ideja e kësaj procedure të re është të vendosë dy degët e pushtetit legjislativ në një nivel barazie, të paktën për çështjet që i nënshtrohet vendimmarrjes së përbashkët, në lidhje me vëzhgimin e ushtrimit nga Komisioni i kompetencave ekzekutive që i janë dhënë.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, komitologjia është shfuqizuar dhe Traktati tashmë bën dallimin midis akteve të deleguara dhe akteve zbatuese.

Shiko:

- Procedurë e Vendimmarrjes së Përbashkët
- Komitete dhe grupe pune
- Këshilli i Bashkimit European
- Komisioni European

Kompetenca dytësore / Subsidiary powers

Neni 352 TFBE (ish neni 308 i Traktatit themelues të Komunitetit European) siguron një masë përshtatshmërie në lidhje me fushat e kompetencës së Bashkimit. Pra, mundëson që kompetencat e Bashkimit të përshtaten sipas objektivave të përcaktuara nga Traktati, kur ky i fundit nuk ka dhënë kompetencat e duhura për veprim për arritjen e këtyre objektivave.

Neni 352 TFBE (ish neni 308 i Traktatit të KE-së) mund të përdoret si bazë juridike, vetëm kur përmbushen kushtet e mëposhtme:

- kur aksioni i parashikuar “është i nevojshëm për të arritur, në funksionimin e tregut të përbashkët, brenda kuadrit të politikave të përcaktuara në Traktate, një nga objektivat e Bashkimit”;
- kur nuk ekziston asnjë dispozitë në Traktat që të parashikojë arritjen e këtij objekti.

Për më tepër, mundësia për t’iu referuar këtij neni i takon Këshillit të Bashkimit European, që vepron me unanimitet pas propozimit të Komisionit dhe këshillimit me Parlamentin European.

Neni 352 pasqyron idenë e hartuesve të Traktatit të Romës sipas së cilës, fuqitë e dhëna në formën etributeve të veçanta (kompetenca funksionale), mund të rezultojnë të pamjaftueshme për arritjen e objektivave të vendosur shprehimisht nga vetë Traktatet (kompetenca materiale). Kjo në asnjë rast nuk mund të shërbejë si bazë për të zgjeruar fushat e kompetencës së Bashkimit. Dispozitat e parashikuara në nenin 352 TFBE nuk aplikohen në PPJS.

Shiko:

- Kompetenca të Komunitetit
- Shpërndarje e kompetencave
- Balancë Institucionale
- Subsidiariteti

Kompetencë, ~a të Bashkimit / EU Powers

Kompetencat e Komunitetit janë kompetencat që i janë dhënë Bashkimit European (BE) në disa fusha të veçanta nga Shtetet Anëtare. Ka tri lloje Kompetencash të cilat varen nga mënyra e atribuimit:

- Kompetenca të qarta: janë përcaktuar qartë në traktate;
- Kompetenca të nënkuptuara: kur Komuniteti European ka kompetenca të qarta në një fushë të veçantë (p.sh. transporti) si edhe kompetenca në të njëjtën fushë në lidhje me marrëdhëniet e jashtme (p.sh. bisedime për marrëveshje ndërkombëtare);
- Kompetenca dytësore: kur Komuniteti European nuk ka kompetenca të qarta ose të nënkuptuara për të arritur një qëllim të përcaktuar nga Traktati në lidhje me tregun e përbashkët, neni 308 i Traktatit themelues të Komunitetit European lejon që Këshilli të marrë me unanimitet masat që i konsideron të nevojshme.

Shiko:

- Shpërndarje e kompetencave
- Përgjegjësi të jashtme të Komunitetit Europian
- Subsidiariteti
- Kompetencë për Subsidiaritetin

Kompetencat e jashtme të Bashkimit Europian / External responsibilities of the European Community

Përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, kompetencat e jashtme të Bashkimit Europian përcaktoheshin në përputhje me faktin, nëse ato binin mbi Bashkimin Europian apo mbi Shtetet Anëtare. Kompetenca përshkruhet si “ekskluzive”, nëse ushtrohet vetëm nga Bashkimi (p.sh. Politika e Përbashkët Bujqësore) dhe “të përziera”, nëse ndahen me Shtetet Anëtare (p.sh. Politika e Transportit).

Dallimi është përcaktuar në praktikat gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, bazuar në parimin e përgjegjësisë së nënkuptuar, ku përgjegjësia e jashtme rrjedh nga ekzistenca e përgjegjësisë së brendshme. Traktati i Komunitetit Europian ngarkon me përgjegjësi të jashtme eksplicite vetëm në dy raste: në politikën tregtare (neni 207 TFBE ish neni 133) dhe në marrëveshjet e asocimit (neni 217 TFBE ish neni 310).

Duhet të theksohet që Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë ndodhet nën kapitullin e marrëdhënieve të jashtme të Bashkimit Europian, që drejtohen përmes procedurave ndërqeveritare (Shtylla e dytë) dhe jo nga përgjegjësitë e jashtme të Komunitetit Europian. Me qëllim që Komuniteti Europian të përshtatet me ndryshimet rrënjësore në strukturat e ekonomisë botërore dhe që të pasqyrojë përgjegjësitë që i janë dhënë OBT-së, Traktati i Amsterdimit ka ndryshuar nenin 133 të Traktatit të Komunitetit Europian (me Traktatin e Lisbonës, neni 207 TFBE), kështu që Këshilli Europian vendos me unanimitet për të shtrirë qëllimin e politikës së përbashkët tregtare deri në negociatat ndërkombëtare dhe marrëveshjet për shërbimet dhe pronësinë intelektuale.

Traktati i Nisës ka mundësuar futjen e marrjes së vendimeve përmes shumicës kualifikuese në këto fusha. Kompetencën e përbashkët për marrëveshjet për harmonizimin e shërbimeve kulturore, audiovizive, arsimore, shoqërore dhe shëndetësore do të vazhdojnë ta kenë Shtetet Anëtare. Rrjedhimisht, këto marrëveshje i nënshtrohen unanimitetit.

Traktati i Lisbonës bën një ndarje racionale midis kompetencave të jashtme të cilat më parë ishin të shtyllës komunitare dhe shtyllës së politikës së jashtme. Me ndryshimet që solli Traktati, dispozitat që i japin kompetencë të jashtme BE-së përveç dispozitave të PPJS janë përfshirë në pjesën e 5 të TFBE:

- Dispozitat e përgjithshme marrëdhëniet me jashtë të BE
- Politika e përbashkët tregtare
- Bashkëpunimi me vendet e treta në ndihmën humanitare
- Bashkëpunimi për zhvillim
- Bashkëpunimi ekonomik, teknik dhe financiar me vendet e treta
- Ndihma humanitare
- Masat shtrenguese
- Marrëveshjet ndërkombëtare
- Marrëdhëniet e BE-së me organizatat ndërkombëtare dhe vendet e treta dhe përfaqësitë e Bashkimit.

Shiko:

- Politika e Përbashkët Tregtare
- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Kompetenca të Komunitetit
- Shpërndarje e kompetencave
- Shtylla të Bashkimit Europian
- Kompetenca për subsidiaritetin

Kompromis, ~i i Janinës / Ioannina compromise

Kompromisi i Janinës e merr emrin nga një takim jozyrtar i Ministrave të Jashtëm në qytetin grek të Janinës në 29 mars 1994. Midis vendimeve të marra, në takim u mor edhe një vendim i Këshillit në lidhje me çështjen e veçantë të votimit me shumicë të cilësuar në një Komunitet me 16 anëtarë. Më vonë vendimi u ndryshua pas vendimit të Norvegjisë për të mos iu bashkuar Komunitetit. Kompromisi përfundimtar parashikon që, nëse anëtarët e Këshillit që përfaqësojnë 23 vota (kufiri i minoritetit të vjetër bllokues) dhe 26 vota (kufiri i ri) shprehin qëllimin e tyre për të kundërshtuar vendimmarrjen nga Këshilli Europian me shumicë të cilësuar, Këshilli Europian, brenda kompetencave të tij dhe brenda një kohe të arsyeshme do të gjejë një zgjidhje të kënaqshme që mund të miratohet me 68 nga 87 vota.

Në vijim të ripeshimit të votave në Këshill të Ministrave, Traktati i Nisës i jep fund Kompromisit të Janinës.

Shiko:

- Këshilli i Bashkimit Europian
- Shumicë e cilësuar
- Traktati i Nisës
- Peshim i votave në Këshill

Kompromis, ~i i Luksemburgut / Luxembourg compromise

Kompromisi i Luksemburgut, i nënshkruar më 30 janar 1966, parashikon se “Kur, në rastet e vendimeve që mund të jenë miratuar me shumicë pas një propozimi të Komisionit Europian, varen interesa shumë të rëndësishëm të një apo më shumë shteteve të Komunitetit, anëtarët e Këshillit Europian duhet të angazhohen për të arritur brenda një kohe të arsyeshme zgjidhjet që mund të miratohen nga të gjithë anëtarët e Këshillit, duke respektuar interesat e tyre të ndërsjella dhe ato të Komunitetit”.

Kjo i dha fund krizës që vinte përballë Francën me pesë partnerë Europianë dhe Komisionin Europian për shkak të kalimit progresiv nga votimi me unanimitet, tek votimi me shumicë të cilësuar, e parashikuar kjo nga Traktati i Romës që në 1966. Qeveria franceze, e cila privilegjon qasjen ndërqeveritare, shprehu kundërshtinë duke praktikuar politikën e “karriges bosh”. Me fjalë të tjera, nuk mori pjesë në seancat e Këshillit të Ministrave që nga 30 qershori 1965 për shtatë muaj.

Megjithatë, Kompromisi që është një deklaratë politike e Ministrave të Punëve të Jashtme dhe që nuk mund ta ndryshojë Traktatin, nuk i ndaloi Këshillit të merrte vendimet e veta në bazë të Traktatit themelues të Bashkimit Europian, që parashikonte në disa raste votimin me shumicë të cilësuar. Për më tepër votimi me shumicë të cilësuar është shtrirë gradualisht në shumë fusha dhe tashmë është bërë procedurë e konsideruar si rregull dhe unanimiteti është bërë përjashtim. Kompromisi i Luksemburgut edhe pse qëndron në fuqi, thjesht mund të evokohet dhe nuk mund të blloktojë procesin vendimmarrës.

Shiko:

- Këshilli i Bashkimit European
- Shumicë e cilësuar
- Unanimitet

Komunitarizëm / Communitisation

Ky term tregon sistemin sipas të cilit një çështje e caktuar që, në Kornizën Institucionale të Bashkimit European trajtohet sipas metodës ndërqeveritare (Shtylla e dytë dhe e tretë) transferohet tek metoda komunitare (Shtylla e parë).

Metoda Komunitare mbështetet tek ideja që interesi i përgjithshëm i qytetarëve të Bashkimit European mbrohet më mirë kur institucionet e Komunitetit luajnë rol të plotë në procesin e vendimmarrjes së përbashkët, duke pasur parasysh parimin e subsidiaritetit.

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdami (maj 1999), çështja që lidhet me lëvizjen e lirë të njerëzve, e cila më parë trajtohej nën bashkëpunimin për drejtësi dhe punë të brendshme (Shtylla e tretë), është “komunitarizuar”. Prandaj, ajo do të trajtohet sipas metodës komunitare, pas një faze tranzitore 5-vjeçare.

Shiko:

- Politikë e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- “Urë” Komunitare (Titulli VI i Traktatit të BE-së)
- Metodë Komunitare dhe Ndërqeveritare
- Shtylla të Bashkimit European

Komunitet, ~i European / European Community

Komuniteti European (KE) është element themelues i procesit integruar European. Ai u themelua (si Komuniteti Ekonomik European) nga Traktati i Romës, më 1957, me objektiv kryesor krijimin e tregut të bashkuar pa kufij të brendshëm. Ngritja e Bashkimit European (BE) në 1992 nuk shkaktoi zhdukjen e Komunitetit Ekonomik European. Ai mbetet pjesë e BE-së nën emërtimin “Komuniteti European”.

Neni 2 i Traktatit Themelues të KE-së, përcaktonte se ka për detyrë të mbështesë në mbarë Komunitetin:

- zhvillim harmonik të barazpeshuar dhe të qëndrueshëm të aktiviteteve ekonomike;
- nivel të lartë punësimi dhe mbrojtje sociale, si dhe barazi mes meshkujve dhe femrave;
- rritje e qëndrueshme jo inflacioniste;
- nivel të lartë konkurrueshmërie dhe konvergjencë të performancës ekonomike;
- nivel të lartë mbrojtjeje dhe përmirësim të cilësisë së mjedisit, rritjen e standardit të jetesës dhe cilësinë e jetës, kohezionin ekonomik dhe social, si dhe solidaritetin ndërmjet shteteve anëtare.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, KE ka hartuar një paketë politikash sektoriale, duke u fokusuar në fushat e transportit, konkurrencës, bujqësisë dhe peshkimit, azilit dhe migrimit, energjisë dhe mjedisit.

Këto politika zbatohen në bazë të procedurës vendimmarrëse të përcaktuar nga Traktati themelues i KE-së, duke i kushtuar theks të veçantë kohezionit. Mekanizmi vendimmarrës që sundon këto politika, bazohet në një model specifik të njohur si “metoda komunitare”.

Sipas Traktatit të Lisbonës, termi ‘Komunitet’ do të zëvendësohet me fjalën ‘Bashkim’, çka do të thotë që Bashkimi merr përsipër objektivat dhe veprimet e Komunitetit.

Shiko:

- Metodë Komunitare dhe Ndërqeveritare
- Bashkimi Europian
- Shumicë e cilësuar
- Traktate
- Traktati i Amsterdamit
- Traktati i Nisës

Konferencë, ~a Ndërqeveritare (KNQ) / Intergovernmental Conference (IGC)

Ky term përdoret për të përshkruar bisedimet ndërmjet qeverive të Shteteve Anëtare, me synim ndryshimin e Traktateve. KNQ-të luajnë një rol të rëndësishëm në integrimin Europian, pasi ndryshimet institucionale duhet të jenë gjithmonë rezultat i bisedimeve të tilla.

Këto konferenca mbledhen me nismën e Shteteve Anëtare ose të Komisionit, nga Këshilli i Ministrave me shumicë të thjeshtë (pas këshillimit me Parlamentin Europian dhe nëse duhet, edhe këshillimit me Komisionin).

Puna përgatitore i besohet një grupi të përbërë nga përfaqësues të secilës qeveri të Shteteve Anëtare dhe, si forcë zakoni, nga një përfaqësues i Komisionit Europian. Parlamenti Europian e ndjek nga afër të gjithë punën e grupit me anë të vëzhguesve dhe diskutimeve me Presidentin e Parlamentit Europian. Ky grup raporton rregullisht tek Këshilli i çështjeve të përgjithshme. Vendimet përfundimtare merren nga Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive në Këshillin Europian. Duhet të theksohet se puna përgatitore për KNQ 2004 mori një kurs të pazakontë, pasi iu besua një Konvente dhe u shoqërua me debat të gjërë publik.

KNQ-të më të rëndësishme të viteve të fundit kanë përfunduar në traktatet e mëposhtme:

- Akti i Bashkuar Europian (1986): paraqiti ndryshimet e nevojshme për të përfunduar tregun e brendshëm në 1 janar 1993.
- Traktati i Mاستrihtit (1992): Traktati i Bashkimit Europian u bisedua në dy KNQ të veçanta, një për Bashkimin Ekonomik dhe Monetar (BEM) dhe tjetra për bashkimin politik që përbën Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS) dhe bashkëpunimin për Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme (DÇB).
- Traktati i Amsterdamit (1997): është rezultat i KNQ që filloi në Këshillin Europian në Torino në Mars 1996. Detyra e Konferencës ishte rishikimi i dispozitave të Traktatit të Mاستrihtit, i cili ngriti probleme të zbatimit dhe përgatitjes për zgjerim në të ardhmen.
- Traktati i Nisës (2001): KNQ para këtij Traktati u shpall në shkurt 2000 që të adresonte çështjet e pazgjidhura nga Traktati i Amsterdamit, konkretisht: përmasat dhe përbërja e Komisionit Europian, peshimi i votave në Këshillin e Ministrave, zgjerimi i mundshëm i votimit të cilësuar në Këshill dhe bashkëpunimi më i ngushtë – të përfshira nga Këshilli Europian në Santa Maria de Feira European në qershor 2000.
- Traktati Reformues, Traktati i Lisbonës (2007): Këshilli Evropian i 21-22 qershorit i 2007 i dha mandat presidencës Portugese që të thërriste një Konferencë Ndërqeveritare. Qëllimi i Konferencës ishte që të hartonte në një traktat ndryshimet e Traktateve ekzistuese me qëllim rritjen e efikasitetit dhe legjitimitetit demokratik të BE-së së zgjeruar si edhe për të siguruar bashkërendimin e veprimeve të jashtme të Bashkimit. Mandati parashikonte bazën dhe kuadrin e punës si edhe afatet për të realizuar atë. KNQ e përfundoi punën e saj më 18 tetor 2007 duke prezantuar Traktatin Reformues.

Shiko:

- Konventë Europiane
- Rishikim i Traktateve
- Traktate

- Traktati i Amsterdamit
- Traktati i Nisës
- Traktati i Lisbonës

Konfirmim, ~i i Komisionit Europian / Confirmation of the European Commission

Procedura e konfirmimit konsiston në dy faza:

- emërimi i Presidentit të Komisionit Europian;
- përcaktimi i listës së anëtarëve të Komisionit dhe mandatimi i Komisionit Europian si i tërë.

Që nga Traktati i Nisës, përgjegjësia për emërimin e Presidentit i takon Këshillit Europian, i cili përbëhet nga Kryetarët Shtetesh dhe Qeverish dhe vepron me shumicë të cilësuar. Ky emërim duhet të miratohet nga Parlamenti Europian.

Këshilli Europian, duke vepruar me shumicë të cilësuar dhe me marrëveshje me Kandidatin për President, miraton listën e personave që synon të emërojë si Anëtarë të Komisionit, e përpiluar në pajtim me propozimet e bëra nga secili Shtet Anëtar.

Përfundimisht, Presidenti dhe Anëtarët e Komisionit Europian emërohen nga Këshilli Europian, duke vepruar me shumicë të cilësuar, pasi e gjithë trupa është miratuar nga Parlamenti Europian.

Komisioni Europian aktual që e mori mandatin në nëntor 2004, u miratua me këtë procedurë.

Sipas nenit 17 të TBE, Këshilli, në marrëveshje me të zgjedhurin për President miraton listën e personave që ai propozon për Komisionerë. Këta persona do të zgjidhen në bazë të propozimeve që bëjnë shtetet anëtare. Trupa e Komisionerëve do të jetë subjekt i votës së pëlqimit/miratimit nga Parlamenti Europian. Në bazë të këtij miratimi, Komisioni emërohet nga Këshilli Europian i cili voton me shumicë të cilësuar.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, zgjedhjet për Parlamentin Europian do të kenë ndikim në zgjedhjen e Presidentit të Komisionit dhe Traktati parashikon që Këshilli Europian duhet të marrë në konsideratë zgjedhjet parlamentare kur do të propozojë kandidatin për President të Komisionit.

Shiko:

- Përbërje e Komisionit Europian
- Komisioni Europian
- Parlamenti Europian
- Presidenti i Komisionit Europian
- Traktati i Lisbonës
- Traktati i Nisës

Konkurrencë, ~a / Competition

Tregu me konkurrencë të lirë është tregu në të cilin sipërmarrjet, të pavarura nga njëra-tjetra, ushtrojnë të njëjtin aktivitet dhe përpiqen të tërheqin konsumatorë. Me fjalë të tjera, çdo sipërmarrje i nënshtrohet presionit konkurrues të të tjerëve. Konkurrenca efikase u ofron sipërmarrjeve një fushë loje të barabartë, dhe konsumatorëve shumë përfitime (çmime më të ulëta, cilësi më të mirë, mundësi më të shumta zgjedhjeje etj.)

Politika Europiane për Konkurrencën synon të garantojë konkurrencë të lirë dhe të ndershme në Bashkimin Europian. Politika e Komunitetit Europian për Konkurrencën (nenet 101-109 TFBE ish neni 81-89 i Traktatit të Komunitetit Europian) bazohet në pesë parime kryesore:

- ndalimi i marrëveshjeve dhe praktikave tregtare antikonkurruese dhe e abuzimeve me pozicionin dominues, të cilat janë të tilla që mund të cenojnë konkurrencën brenda tregut të përbashkët (rregullat anti-trust);
- mbikëqyrja parandaluese e operacioneve të përqendrimit, me përmasa Europiane, në mënyrë që të përcaktohet nëse ato kufizojnë konkurrencën;
- mbikëqyrja e ndihmës së dhënë në çdo lloj forme nga Shtetet Anëtare ose nëpërmjet burimeve shtetërore të tilla që shtrembërojnë, apo kërcënojnë konkurrencën me anë të favorizimit të disa ndërmarrjeve ose të disa prodhimeve;
- liberalizimi i disa sektorëve ku ndërmarrjet shtetërore apo private janë zhvilluar në formë monopoli, si telekomunikacioni, transporti, ose energjia;
- bashkëpunimi me autoritetet e konkurrencës jashtë Bashkimit Europian.

Komisioni Europian dhe Autoritetet Kombëtare të Konkurrencës vënë në zbatim Rregullat e Bashkimit për Konkurrencën. Bashkëpunimi ndërmjet tyre, brenda Rrjetit Europian për Konkurrencën (RrKE), garanton zbatim efikas dhe të qëndrueshëm të rregullave.

Shiko:

- Kontroll antitrust
- Politikë për ndërmarrjet
- Shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik
- Ndihmë Shtetërore

Konkurrueshmëri, ~a / Competitiveness

Ekonomia e qëndrueshme është një ekonomi me nivel të lartë dhe të qëndrueshëm të rritjes së prodhueshmërisë.

Që nga Strategjia e Lisbonës, e cila përcaktoi angazhimin që Europa të bëhej ekonomia më konkurruese dhe dinamike në botë, konkurrueshmëria është bërë një nga përparësitë politike të Bashkimit. Industria Europiane duhet të jetë konkurruese që Komuniteti të arrijë qëllimet ekonomike, sociale dhe mjedisore dhe kështu të garantojë përmirësim të cilësisë së jetës për qytetarët e Evropës. Në përpjekjet për mbështetjen e konkurrueshmërisë, Bashkimi Europian gjithashtu përpiqet të përshtatë ekonominë Europiane me ndryshimin struktural, rialokimin e aktivitetit industrial në ekonominë e reja, rishpërndarjen e vendeve të punës dhe burimeve drejt sektorëve industrialë të rinj dhe riskun e një procesi të de-industrializimit.

Konkurrueshmëria e Bashkimit Europian përcaktohet nga rritja e prodhueshmërisë dhe, rrjedhimisht, varet nga performanca dhe e ardhmja e industrisë Europiane, veçanërisht nga aftësia e Bashkimit Europian për rregullimet strukturore. Për të qenë konkurrues, Bashkimi Europian duhet të performojë në shkallën më të lartë për sa i përket kërkimit shkencor dhe rrisë, teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, sipërmarrjes, konkurrencës, arsimit dhe formimit profesional.

Janë të nevojshme analiza gjithëpërfshirëse ekonomike dhe analiza të detajuara të të gjithë sektorëve, me qëllim që të mbështetet ndërhyrja e Bashkimit Europian për rritjen e konkurrueshmërisë.

Shiko:

- Punësim
- Politikë për ndërmarrjet
- Globalizim
- Strategjia e Lisbonës
- Kërkim shkencor dhe zhvillim
- Zhvillim i qëndrueshëm

Fuqizim, ~i i legjislacionit–joformal/deklarues

Ekziston një procedurë e veçantë për fuqizimin jozyrtar dhe krejt deklarues të legjislacionit dhe thjeshtimit të akteve ligjore. Përfshirja e ndryshimeve ligjore pasuese në trupin e një akti themelor, nuk nënkupton miratimin e një instrumenti të ri. Në këtë rast bëhet fjalë thjesht për një sqarim nga Komisioni. Teksti përfundimtar që nuk ka fuqi ligjore, mund të botohet kur është e nevojshme në Gazetë Zyrtare (Seria C) pa citime.

Kontroll, ~i antitrust / Antitrust control

Termi “antitrust” u referohet rregullave të konkurrencës për marrëveshjet dhe praktikat e biznesit, të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe shpërdorimin me pozitën mbizotëruese.

Marrëveshjet dhe praktikat përqendruese që mund të kufizojnë konkurrencën, ndalohen nga dispozitat antitrust të nenit 81 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian (Traktati i KE-së). Ndalimi përfshin kartelet (referuar gjithashtu si “marrëveshjet”) dhe situatat në të cilat bizneset konkurruese bëjnë marrëveshje të fshehta për të kufizuar konkurrencën duke fiksuar çmimet, duke kufizuar prodhimin apo duke ndarë tregjet mes tyre. Gjithsesi, marrëveshjet kufizuese mund të lejohen nëse ato gjenerojnë efekte më tepër pozitive sesa negative (marrëveshjet që përmirësojnë prodhimin, shpërndarjen e prodhimit, duke kontribuar në progresin teknik, etj.).

Rregullat Antitrust të Bashkimit gjithashtu ndalojnë shpërdorimin me pozitën mbizotëruese brenda një tregu (neni 82 i Traktatit të KE-së). Një sipërmarrje është në një pozitë mbizotëruese, kur zotëron një përqindje të konsiderueshme të tregut dhe mund t'i shmangët konkurrencës normale në këtë treg. Në këtë rast, i ndalohet të shpërdorjë këtë mbizotërim, p.sh., duke vendosur artificialisht çmime tejet të larta apo shumë të ulëta, apo duke ushtruar diferencim ndërmjet partnerëve tregtarë.

Komisioni mund t'iu vërë gjoba të mëdha sipërmarrjeve që përfshihen në praktika të paligjshme biznesi.

Që më 1 maj 2004, rregullat e përditësuara antitrust të Komunitetit, u kanë lejuar Autoriteteve Kombëtare të Konkurrencës të vënë në zbatim rregullat Komunitare për marrëveshjet dhe shpërdorimin e mbizotërimit në të njëjtën mënyrë si Komisioni.

Shiko:

- Konkurrencë

Kontroll, ~i paraprak / Screening

Kontrolli paraprak (screening), ose ekzaminimi analitik i acquis, është faza përgatitore për bisedimet e anëtarësimit. Ky proces është jetik, sepse përbën bazën e marrëdhënies dypalëshe ndërmjet Bashkimit Europian dhe vendeve kandidate të ndryshme.

Procesi i kontrollit paraprak kryhet bashkërisht nga Komisioni dhe secili vend kandidat, duke i lejuar këtij të fundit të familjarizohet me Acquis dhe të tregojë se i ka kapacitetet për ta vënë në zbatim.

Një tjetër qëllim i kontrollit paraprak është vënia në dukje e fushave të acquis në të cilat nevojitet progres, me qëllim që legjislacioni i vendit kandidat të jetë në përputhshmëri me rregullat komunitare. Këto fusha janë të grupuara në kapituj, të cilët diskutohen një për një.

Një ushtrim kontrolli paraprak mund të kryhet gjatë bisedimeve të anëtarësimit, nëse acquis duhet të përditësohet.

Shiko:

- Bisedime për anëtarësim
- Vende kandidate

- Zgjerim
- Acquis e BE-së

Konventë, ~a Titulli V i TFBE (ish Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European) / Convention (Title V of TFEU)

Konventa është një instrument që i përket Shtyllës së tretë të Bashkimit European (Drejtësia dhe Çështjet e Brendshme). Ky instrument u fut nga Traktati i Mاستrihtit, bashkë me qëndrimin e përbashkët dhe aksionin e përbashkët. Për shembull, Europoli bazohet në Konventën e miratuar në 1995.

Ky instrument u miratua nga Traktati i Amsterdimit. Ai renditet bashkë me vendimin dhe vendimin kuadër në nenin 34 të Traktatit të Bashkimit European. Që nga hyrja në fuqi e Traktatit të Amsterdimit (maj 1999), Konventat mund të përdoren vetëm për Bashkëpunimin Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale.

Konventa miratohet nga Këshilli, i cili vepron unanimisht pas këshillimit me Parlamentin European dhe hyn në fuqi pas miratimit nga të paktën gjysma e Shteteve Anëtare.

Me ndryshimet e bëra nga Traktati i Lisbonës, kuadri ligjor për çështjet e kësaj fushe do të përfshijë direktivat dhe rregulloret. Shiko:

- Aksion i Përbashkët (Çështjet e Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme)
- Qëndrim i Përbashkët (Titulli VI i Traktatit të BE-së)
- Vendim dhe Vendim Kuadër (Titulli VI i Traktatit të BE-së)
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në çështjet Penale

Konventë, ~a Europiane / European Convention

Procesi për krijimin e Konventës Europiane filloi në dhjetor 2000, me Deklaratën bashkëngjitur Traktatit të Nisës, "Deklaratën për të ardhmen e Bashkimit European". Kjo Deklaratë propozonte vazhdimin e reformës institucionale përtej asaj çfarë ishte arritur në KNQ-në 2000, pas një procedure me tri faza: shpalljen e debatit mbi të ardhmen e Bashkimit European, një Konventë për Reformën Institucionale që të ngrihej siç u vendos nga Këshilli European në Leken në dhjetor 2001 dhe në KNQ-në e mbledhur në 2004.

Sipas Deklaratës së Lekenit, e cila e krijoi, qëllimi i konventës ishte të shqyrtonet katër çështjet kyçe rreth të ardhmes së Bashkimit European: ndarja e pushteteve, thjeshtimi i traktateve, roli i parlamenteve kombëtare dhe statusi i Kartës së Të Drejtave Themelore. Fazat e parashikuara ishin tre: faza e dëgjimit, faza e deliberimit dhe faza e hartimit. Faza e tretë do të përmbylej me një tekst të vetëm kushtetues. Ky dokument shërben si pikënisje për negociatat e KNQ-së, të mbajtura nga Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive përgjegjëse për një vendim apo ndryshime të traktateve.

Mbledhja përruese e Konventës u mbajt, më 28 shkurt 2002 dhe i mbylli punimet, më 10 korrik 2003, pas arritjes së marrëveshjes në lidhje me propozimin për një Kushtetutë Europiane.

Konventa është një risi në historinë e Bashkimit European, pasi KNQ-të e mëparshme nuk ishin paraprirë nga një fazë debati e hapur për të gjithë aktorët dhe grupet e interesit.

Më 18 qershor 2004, KNQ u mblodh në nivel kërresh shteti apo qeverie dhe ra dakord për projekt Kushtetutën Europiane, të përgatitur nga Komisioni. Pas refuzimit me referendum nga Franca dhe Holanda, u hoq dorë nga ideja për Kushtetutën Europiane. Traktati Reformues është pasues i kësaj iniciative.

Shiko:

- Debat mbi të ardhmen e Bashkimit European
- Konferenca Ndërqeveritare (KNQ)
- Deklarata e Lekenit
- Rezultat i Konventës Europiane
- Traktati i Lisbonës
- Traktati i Nisës

Konventë, ~a Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) / European Convention on Human Rights (ECHR)

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e nënshkruar në Romë nën drejtimin e Këshillit të Evropës në 4 nëntor 1950, vendosi një sistem të paprecedent të mbrojtjes ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke u ofruar individëve mundësinë që t'u drejtohen gjykatave për përforcimin e të drejtave të tyre. Konventa, që është miratuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit European, krijoi disa organe mbikëqyrjeje në Strasburg. Ato janë:

- Komisioni European, përgjegjës për shqyrtim të përparuar të çështjeve të paraqitura nga shtetet ose nga individët;
- Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, tek e cila dërgoheshin çështje nga Komisioni European ose nga Shtetet Anëtare, në vijim të një raporti nga Komisioni European (në rastin e një vendimi gjyqësor);
- Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, i cili funksionon si ruajtës i KEDNJ, të cilit i kërkohet të sigurojë një zgjidhje politike të një mosmarrëveshjeje, në rastet kur çështja nuk dërgohet për shqyrtim përpara gjykatës.

Numri gjithnjë e në rritje i çështjeve e bëri të nevojshme reformën e rregullave mbikqyrëse të vendosura nga Konventa. Prandaj, organet mbikëqyrëse u zëvendësuan, më 1 nëntor 1998, nga një Gjykatë Europiane e të Drejtave të Njeriut. Struktura e thjeshtuar e shkurtoi kohëzgjatjen e procedurave dhe rriti karakterin gjyqësor të sistemit.

Shpesh është hedhur ideja që Bashkimi European të përfshihet në KEDNJ. Megjithatë, në një mendim dhënë, më 28 mars 1996, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European përcaktoi se Komunitetet Europiane nuk mund të përfshihen në konventë, sepse Traktati i Komunitetit European nuk parashikon kompetenca për të parashtruar rregulla ose për të përfunduar marrëveshje ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut. Përveç dhënies së personalitetit juridik BE-së, duke i lejuar kësaj të fundit të drejtën për të qenë anëtare e organizateve ndërkombëtare, Traktati i Lisbonës parashikon në mënyrë të qartë që Bashkimi European të aderojë në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (neni 6(2) TBE). Ky proces do të bazohet në një dialog të vazhdueshëm midis dy gjykatave, Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Aderimi do të bëhet në mënyrë të atillë që nuk prek natyrën specifike të së drejtës europiane dhe kompetencat e Bashkimit të përcaktuara në Traktate.

Megjithatë, Traktati i Amsterdimit kërkon respektimin e të Drejtave themelore të garantuara nga Konventa, duke formalizuar vendimet e Gjykatës së Drejtësisë për këtë çështje. Përsa u përket marrëdhënieve ndërmjet dy gjykatave, praktika e zhvilluar nga Gjykata e Drejtësisë për të përfshirë parimet e Konventës në Të Drejtën e Bashkimit European, ka bërë të mundur ruajtjen e pavarësisë dhe bashkërendimit të punës së tyre.

Shiko:

- Të drejta të njeriut
- Kartë e Të Drejtave Themelore

Kritere, ~t të Konvergencës / Convergence criteria

Traktati thekson Katër Kriteret të Konvergencës, të cilat duhet të plotësohen nga secili Shtet Anëtar, për të siguruar konvergencë të qëndrueshme për arritjen e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (BEM) përpara pjesëmarrjes në fazën e tretë të BEM dhe para se të miratonte euron. Komisioni dhe Banka Qendrore Europiane hartojnë raporte për të kontrolluar nëse plotësohen kriteret. Këto kritere janë:

Raporti i deficitit qeveritar ndaj prodhimit të brendshëm bruto nuk duhet të kalojë 3% dhe raporti i borxhit qeveritar ndaj prodhimit të brendshëm bruto, nuk duhet të tejkalohet 60%;

Duhet të ekzistojë një nivel i qëndrueshëm i çmimeve të tregut, si edhe një normë mesatare e inflacionit, një vit përpara shqyrtimit, normë e cila nuk duhet të kalojë me më shumë se 1.5 pikë përqindje normën e tri shteteve anëtare që kanë ecurinë më të mirë të stabilitetit të çmimeve

Duhet të ekzistojë një normë afatgjatë interesi që nuk e kalon me më shumë se 2 pikë përqindje normën e shteteve anëtare që kanë ecurinë më të mirë të stabilitetit të çmimeve

Kufijtë normalë të luhatjes të parashikuara nga mekanizmi i kursit valutor në sistemin monetar European, duhet të respektohen pa tensione të ashpra, të paktën për dy vitet e para përpara shqyrtimit.

Kriteret e konvergencës synojnë të sigurojnë që zhvillimi ekonomik brenda BEM të jetë i ekuilibruar dhe të mos krijojë tensioneve ndërmjet shteteve anëtare. Duhet pasur parasysh edhe që kriteret në lidhje me deficitin dhe borxhin e qeverisë, duhet të plotësohen pas fillimit të fazës së tretë të BEM (1 janar 1999). Për këtë qëllim, u miratua një Pakt Stabiliteti nga Këshilli European në Amsterdam në qershor 1997 dhe që u mundëson anëtarëve të Eurozonës të bashkërendojnë Politikat Buxhetore Qeveritare Kombëtare dhe të shmangin deficitet buxhetore qeveritare të tejkaluara.

Shiko:

- Bashkim Ekonomik dhe Monetar (BEM)
- Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit

Kritere të pranimit (Kritere të Kopenhagenit) / Accession criteria (Criteria of Copenhagen)

Çdo vend që aspiron anëtarësimin në Bashkimin European, duhet të përmbushë kushtet e përcaktuara në nenin 49 dhe parimet e përcaktuara në nenin 6, paragrafin 1 të Traktatit të Bashkimit European. Kritere të përshtatshme u vendosën nga Këshilli European në Kopenhagen në 1993 dhe u përforcuan nga Këshilli European në Madrid në 1995.

Për të hyrë në BE, një Shtet Anëtar i ri duhet të plotësojë tre kritere:

kriterin politik: stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve;

kriterin ekonomik: ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale dhe aftësia për të përballuar presionet e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda BE-së;

pranimin e Acquis-së së BE-së : aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, përfshi pranimin e qëllimeve të bashkimit politik, ekonomik dhe monetar.

Këshilli European vendos të hapë bisedimet pasi përmbushet kriteri politik.

Çdo vend që dëshiron të bashkohet me Bashkimin, duhet të përmbushë Kriteret e anëtarësimit. Strategjia e paraanëtarësimit dhe bisedimet e anëtarësimit sigurojnë kuadrin dhe instrumentet e nevojshëm.

Traktati i rishikuar i BE-së parashikon se Këshilli European përcakton kriteret për anëtarësimin e një vendi për tu bërë anëtar i BE-së. Kjo kodifikon praktikën aktuale sipas të cilës u

pranuan Kriteret e Kopenhagenit. Traktati shton dhe një dispozitë në të cilën parashikohet e drejta e shteteve anëtare për të dalë nga Bashkimi si dhe parashikon procedurat sesi mund të negociohet dalja nga Bashkimi.

Shiko:

- Bisedime për anëtarësim
- Partneritet i anëtarësimit
- Vende kandidatë
- Zgjerim
- Strategji e paraanëtarësimit

Kornizë, ~a Institucionale e Përbashkët / Single institutional framework

Korniza Institucionale (neni 9 TFBE) është shprehja praktike e parimit se ekziston vetëm një grup institucionesh. Ai nënkupton se janë të njëjtat institucione që i shërbejnë Bashkimit Europian. Këto institucione marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve për shtylla të ndryshme.

Ekzistenca e një grupi të vetëm institucionesh është një nga mënyrat e përdorura nga autorët e Traktateve për të garantuar bashkërendimin mes aktivitetit të Bashkimit Europian dhe aktivitetit të Komunitetit.

Shiko:

- Komunitete Europiane
- Institucione Europiane
- Bashkimi Europian
- Barazpeshë institucionale
- Shtylla të Bashkimit Europian

Kulturë, ~a / Culture

Edhe pse dëshira për të zhvilluar veprimtari kulturore në nivel Europian ishte e dukshme në fillim të viteve '70, kulturës iu dha vend zyrtarisht në integrimin Europian vetëm në vitin 1991 me anë të nenit 151 të Traktatit të Mاستrihtit ku thuhet se: "Komuniteti do të kontribuojë në zhvillimin e plotë të kulturave të Shteteve Anëtare, duke respektuar karakteristikat e tyre kombëtare dhe rajonale dhe në të njëjtën kohë duke vënë në dukje trashëgiminë e përbashkët kulturore".

Për të krijuar një fushë kulturore Europiane, Bashkimi Europian është thirrur për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme, për të përkrahur dhe për të harmonizuar veprimtaritë e tyre në fushat e mëposhtme:

- Përhapja e kulturës dhe historisë së popujve Europianë
- Konservimi i trashëgimisë kulturore me rëndësi Europiane
- Shkëmbime kulturore jo tregtare
- Krijimtari artistike, letrare dhe shërbime audiovizive
- Bashkëpunimi me vendet e treta dhe organizatat përgjegjëse ndërkombëtare.

Komisioni Europian, për dhjetë vjet, përkrahu bashkëpunimin kulturor përmes tri programeve eksperimentale në këtë sektor, duke mbuluar artet pamore, plastike dhe skenike, trashëgiminë dhe librat (Kaléidoscope, Ariane and Raphaël). Komuniteti Europian ka përkrahur edhe nismën e Shteteve Anëtare për të zgjedhur çdo vit "Qytetin Europian të Kulturës" që nga viti 1985.

Në vitin 2000, Komisioni Europian miratoi programin kuadër “Kultura 2000”, një orientim i ri për veprimtari kulturore. Qëllimi i këtij programi është krijimi i një hapësire të përbashkët kulturore, duke nxitur dialogun kulturor, krijimin dhe përhapjen e kulturës dhe lëvizjen e artistëve dhe veprave të tyre, trashëgiminë kulturore Europiane, format e reja të shprehjes kulturore dhe rolin social-ekonomik të kulturës. Në 2007, programi “Kultura” pasoi programin kuadër “Kultura 2000”. Programi i ri mbulon periudhën 2007-2013. Ai përvetëson objektivat e programit kuadër “Kultura 2000”, por gjithashtu përfshin grumbullimin dhe shpërndarjen e informacionit në fushën e bashkëpunimit kulturor.

Përveç programit “Kultura”, bashkëpunimi kulturor në Evropë promovohet gjithashtu nga aktivitete të veçanta, të financuara nga programe Europiane të tjera. Kjo vlen kryesisht për aktivitetet në kontekstin e politikave të zhvillimit ekonomik, kërkimor, arsimor, formimi profesional dhe rajonal, të cilat gjithashtu promovojnë bashkëpunimin kulturor. Ky bashkëpunim është ndërtuar mbi një bazë të gjerë, pasi shumica e programeve janë të hapura për Shtetet Anëtare të Zonës Ekonomike Europiane dhe vendeve candidate, por janë përfshirë edhe vende të treta dhe organizata ndërkombëtare.

Traktati i Lisbonës (neni 167(5) TFBE) parashikon se Këshilli merr vendime me shumicë të cilësuar dhe jo me unanimitet, çka do të thotë që po hiqet dore nga vetoja e shteteve.

Shiko:

- Shërbime audiovizive
- Arsim
- Subsidiaritet

L

Lëvizje, ~a e lirë e personave (politika e vizave, azilit, emigracionit dhe të tjera) / European security and defence identity

Titulli V i Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit European përcakton Politikën e Bashkimit European për “vizat, azilin, emigracionin dhe politika të tjera që lidhen me lëvizjen e lirë të personave”. Këto fusha të ndërhyrjes Komunitare janë të lidhura me krijimin gradual të një zone të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë dhe mbulojnë si vijon:

- lëvizjen e lirë të individëve
- kontrollet në kufijtë e jashtëm
- azilin, emigracionin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të vendeve të treta
- bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale.

Pas një periudhe ndërmjetëse 5-vjeçare pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (maj 1999), Komisioni ka të drejtën ekskluzive të nismës dhe zbatohet procedura e vendimmarrjes së përbashkët, përveç disa fushave të caktuara si, bashkëpunimi gjyqësor në çështje ligjore familjare, për të cilat Këshilli ende vepron me vendim unanim dhe Parlamenti European vetëm këshillohet.

Fuqitë e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European janë më të kufizuara se zakonisht. Për shembull, Gjykata nuk mund të vendosë për masa që lidhen me ruajtjen e rendit publik dhe sigurinë kombëtare.

Para se të përfshiheshin në Traktatin e KE-së nga Traktati i Amsterdimit, këto fusha binin kryesisht nën titullin VI të Traktatit të Bashkimit European (Shtylla e tretë). Traktati i Amsterdimit i ka “komunitarizuar”, duke i futur brenda kuadrit ligjor të Shtyllës së parë.

Traktati i Lisbonës përfshiu çështjet e azilit, vizave, migracionit, në Titullin V të TFBE, Zona e Lirisë Drejtësisë dhe Sigurisë.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë, dhe Drejtësisë
- Komunitarizëm
- “Urë” komunitare (Titulli VI i Traktatit të KE-së)
- Bashkëpunim Gjyqësor në Çështjet Civile
- Shtylla të Bashkimit European

Libra të Bardhë / White Paper

Librat e Bardhë të Komisionit janë dokumente që përmbajnë propozime për veprim të Bashkimit në një fushë të veçantë. Në disa raste, ata janë vijim i Librave të Gjelbër, të publikuar për fillimin e një procesi këshillimi në nivel European. Në rast se Librat e Bardhë pranohen nga Këshilli European, ata mund të kthehen në program veprimi për Bashkimin në fushën përkatëse.

Si shembull mund të përmendim Librin e Bardhë për përfundimin e tregut të brendshëm (1985), për rritjen ekonomike, konkurrueshmërinë, punësimin (1993) dhe për qeverisjen European (2001). Më vonë, Libri i Bardhë për shërbimet e interesit të përgjithshëm (2004)

dhe ai për politikën Europiane të komunikimit (2006), kanë mbajtur zhvillimin e politikave Komunitare.

Shiko:

- Komision-i Europian
- Instrumente ligjore Komunitare
- Qeveri-a
- Libra të Gjelbër

Libra të Gjelbër / Green Paper

Librat e Gjelbër janë dokumente të botuara nga Komisioni Europian për të nxitur e mbështetur diskutimet në nivel Europian për tema të caktuara. Ato ftojnë palët përkatëse (organe apo individë) të marrin pjesë në një proces këshillimi dhe debati në bazë të propozimeve që paraqesin. Librat e Gjelbër mund të nxisin zhvillime legjislative që janë të parashtruara në Librat e Bardhë.

Librat e Gjelbër për Rimarrjen në Evropë (2003), për Ndryshimet demografike dhe solidaritetin e ri ndërmjet brezave (2005) ose, së fundmi për Strategjinë Europiane për energji të qëndrueshme, konkurruese dhe të sigurt (2006), janë shembuj temash që diskutohen.

Shiko:

- Instrumente Ligjore Komunitare
- Komision-i Europian
- Libra të Bardhë

Luftë-a kundër drogës / Fight against drugs

Lufta kundër drogës përfshin një fushë të gjerë veprimtarish, të cilat synojnë kryesisht që të parandalojnë shpërdorimin me lëndët narkotike dhe të luftojnë trafikun e paligjshëm të lëndëve narkotike. Baza specifike ligjore e aktivitetit të Bashkimit Europian në këtë fushë varet nga masat e ndërmarra.

Lufta kundër trafikut të drogave është evidentuar qartë nga Traktati i Amsterdimit si një objektiv në kuadrin e Titullit VI të Traktatit të Bashkimit Europian dhe kështu bie në fushën e veprimit të Bashkëpunimit Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale.

Për sa i përket parandalimit të varësisë nga droga, ky aspekt mbulohet nga neni 152 i Traktatit themelues të Komunitetin Europian, i cili shprehet se “Komuniteti plotëson aksionin e Shteteve Anëtare në pakësimin e dëmeve që droga i shkakton shëndetit, përfshi informimin dhe parandalimin”.

Në dritën e përfundimeve të mbledhjeve të Këshillit Europian, të mbajtura në Kardif (qershor 1998) dhe në Vjenë (dhjetor 1998), Këshillit, Komisionit dhe Parlamentit Europian iu kërkua të hartonte një strategji gjithëpërfshirëse kundër drogës, si vazhdimësi e planit të veprimit 1995-1999. Kësaj kërkesë Komisioni iu përgjigj duke paraqitur:

- një strategji për drogën (2000-2004);
- një plan veprimi (2003-2008).

Në dhjetor 2004 Këshilli Europian miratoi një Strategji Europiane për Drogën për periudhën 2005-2012, që përfshinte dy plane veprimi për periudhat 2005-2008 dhe 2008-2012.

Lufta kundër trafikut të drogës kryesohet nga Njësia “Drugs” e Europolit, një njësi inteligjente, e cila lehtëson Bashkëpunimin Policor dhe Doganor ndërmjet Shteteve Anëtare.

Qendra Europiane Vëzhguese për Drogën dhe Varësinë ndaj Drogës, me bazë në Lisbonë, është përgjegjëse për t'i siguruar Komunitetit dhe Shteteve të tij Anëtare informacione objektive, të besueshme dhe të krahasueshme, që përmbajnë një panoramë të fenomenit të drogës dhe varësisë ndaj drogës si dhe të pasojave.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë, dhe Drejtësisë
- Agjenci të Bashkimit European
- Europol (Zonë Policore Europiane)
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale
- Shëndet publik

Luftë, ~a kundër krimit të organizuar / Fight against organised crime

Lufta kundër krimit të organizuar, e cila është pjesë e Bashkëpunimit Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale (TFBE, Kapitulli 4, Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështjet Penale) synon t'i japë publikut nivel më të lartë sigurie brenda Zonës së Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë.

Politika e BE-së synon të parandalojë dhe të luftojë krimin e organizuar. Ajo informohet dhe plotëson punën e organizatave ndërkombëtare.

Zbatimi bazohet kryesisht në përafrimin e të drejtës penale të brendshme në këtë fushë në punën e Europolit dhe, në njëfarë mase të Eurojustit.

Përprjekjet për luftën kundër krimit të organizuar mishërohen në programin pesëvjeçar të miratuar në 2004 në Hagë, që vazhdon në gjurmët e programit "Tampere 1999". Kryefjala është zhvillimi i një koncepti strategjik të parashikuar nga programi i Hagës dhe të paraqitur nga Komisioni në 2005.

Neni i ri 83(1) TFBE përmban një listë të detajuar të krimeve të rënda me natyrë ndërkufitare dhe ky nen i jep Bashkimit të drejtën për të miratuar rregullat minimale të përbashkëta për sa i përket përkufizimit të tyre dhe sanksioneve. Krimi i organizuar është një nga llojet e veprave kriminale të parashikuara në nenin 83 TFBE.

Shiko:

- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale
- Eurojust
- Europol (Zona Policore Europiane)
- Pastrim parash
- Shtylla të Bashkimit European

Luftë, ~a kundër mashtrimit / Fight against fraud

Lufta kundër mashtrimit dhe korrupsionit është pjesë e përpjekjeve të përgjithshme për të luftuar krimin e organizuar, por gjithashtu lidhet edhe me një çështje më specifike që është lufta kundër të gjitha aktiviteteve të paligjshme që dëmtojnë interesat financiarë të Komunitetit. Lufta kundër mashtrimit mishërohet në dy baza ligjore:

- Neni 29 i Traktatit të Bashkimit European kërkon bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet forcave policore, autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente në Shtetet Anëtare, si drejtpërdrejt, ashtu edhe përmes Europolit në këtë fushë.
- Neni 280 i Traktatit themelues të Komunitetit European ka të bëjë me veprimtaritë që prekin interesat financiare të Komunitetit dhe i kërkon Këshillit dhe Parlamentit European që të miratojnë masa sipas procedurës së vendimmarrjes së përbashkët, pas këshillimit me Gjykatën e Llogarive.

Që në qershor 1999, autoriteti i ngarkuar me luftën kundër mashtrimit ka qenë Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF) e cila zëvendësoi Task-forcën e Parandalimit të Mashtrimit (UCLAF) e ngritur në 1988.

Në KNQ-në e Nisës (shkurt 2000), me qëllim që të forconte aksionin Komunitar në këtë fushë, Komisioni propozoi përfshirjen në traktate, të një baze ligjore për ngritjen e një sistemi me rregulla për procedimet e së drejtës penale për mashtrimin ndërkombëtar, si dhe për emërimin e një prokurori publik Europian për bashkërendimin e hetimeve dhe ndjekjen penale për shkeljet që cenojnë interesat financiare të Bashkimit Evropian. Ky propozim u ndoq nga një Libër i Gjellbër (dhjetor 2001) për mbrojtjen e së Drejtës Penale të Interesave Financiare Komunitare, duke sugjeruar emërimin e një prokurori Europian.

Shiko:

- Eurojust
- OLAF (Zyra Europiane Kundër Mashtrimit)
- Shtylla të Bashkimit Europian
- Bashkëpunim-i Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale

Luftë, ~a kundër racizmit dhe ksenofobisë / Fight against racism and xenophobia

Masa e parë kyçe në luftën kundër racizmit ishte rezoluta e miratuar nga Këshilli dhe përfaqësuesit e Shteteve Anëtare në korrik 1996, që deklaronte vitin 1997 si "Vitin Europian kundër racizmit".

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, neni 13 i tij parashikoi një bazë për të luftuar të gjitha format e diferencimit në bazë të seksit, racës, origjinës etnike, fesë apo besimit, handikapit, moshës apo orientimit seksual. Në bazë të këtij neni, Këshilli, në qershor 2000, miratoi një Direktivë të rëndësishme në zbatim të parimit të trajtimit të njëjtë të njerëzve, pavarësisht nga origjina raciale apo etnike.

Në të njëjtin vit, Këshilli miratoi një program veprimi Komunitar për luftën kundër diferencimit (2001-2006), i ideuar që të mbështeste skema për parandalimin dhe luftën ndaj dallimit në bazë të racës apo përkatësisë etnike.

Përveçse merr përsipër të zbatojë nenin 19 TFBE (ish neni 13 TKE), Bashkimi Europian ka ndjekur përpjekjet për të integruar luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë në të gjitha politikat e veta: veçanërisht në punësim, Fondin Strukturor Europian, arsim, formim profesional dhe rini. Për më tepër, neni 67 TFBE (ish neni 29 i Traktatit të Bashkimit Europian, i futur nga Traktati i Amsterdimit), përbën bazën ligjore për luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë në fushat e Bashkëpunimit Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale.

Hyrja në fuqi e Traktatit të Nisës (1 shkurt 2003) plotësoi mekanizmin penalizues që ofronte Traktati i Amsterdimit me një mekanizëm parandalues apo paralajmërues, i fokusuar veçanërisht në shpërdorimet me të drejtat e njeriut, siç është racizmi, ksenofobia dhe antisemitizmi.

Shiko:

- Mundësi të barabarta
- Agjenci të Bashkimit Europian
- Të drejta të njeriut
- Parim i mosdiskriminimit
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale
- Politikë Sociale

Luftë, ~a kundër terrorizmit / Fight against terrorism

Neni 67 TFBE (ish neni 29 i Traktatit të Bashkimit Europian) i referohet në mënyrë specifike terrorizmit si krim i rëndë. Me ndryshimet e bëra nga Traktati i Lisbonës, përpjekjet e Bashkimit Europian për luftën kundër terrorizmit bien në Titullin V TFBE, Hapësira e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë. Krimet terroriste përcaktohen si akte të qëllimshme si: rrëmbimi i personit apo pengmarrja; çlirimi i substancave të rrezikshme; shkaktimi i zjarreve, përmblyetje apo shpërthimeve efekti i të cilave është rrezikimi i jetës njerëzore; vrasjet dhe aktet që mund të dëmtojnë rëndë një vend apo një organizatë ndërkombëtare, që janë kryer me qëllimin për të frikësuar rëndë një popullatë, duke shtrënguar autoritet publike, apo duke destabilizuar rëndë apo shkatërruar strukturat themelore publike (vendimi kuadër i 13 qershorit 2002).

Në betejën kundër terrorizmit, Bashkimi Europian ka një numër mjeteve specifike që ua lehtëson punën Agjencive të Rendit të Bashkimit Europian, për sigurimin e asistencës së ndërsjellë:

- Europol-i;
- Eurojust-i;
- Urdhër-Arresti Europian;
- Ekipe të përbashkëta hetimore, ku përfshihen nivelet drejtuese të autoriteteve të zbatimit të ligjit në Shtetet Anëtare dhe, nëse duhet, të personelit të Europol-it.

Mjetet e tjera kanë të bëjnë më drejtpërdrejt me organizatat terroriste, anëtarët dhe operacionet e tyre. Ato përfshijnë një listë të përbashkët personash të cilëve duhet t'iu konfiskohen asetet terroriste që zotërojnë.

Që nga sulmet e 11 shtatorit në SHBA në 2001, fazat kryesore në zhvillimin e Politikës Antiterrorizëm të Bashkimit Europian janë shënjuar nga ngjarje të ndryshme:

- një plan veprimi për Bashkëpunim më të ngushtë Policor dhe Gjyqësor për Kundërterrorizmin u miratua nga Këshilli Europian në një seancë të jashtëzakonshme, më 21 shtator 2001, pas sulmeve të 11 shtatorit;
- një deklaratë, se të gjitha Shtetet Anëtare do të veprojnë bashkërisht në frymë solidariteti, nëse një prej tyre është viktimë e një sulmi terrorist, duke mobilizuar të gjithë instrumentet që kanë në dispozicion, përfshi burimet ushtarake, u përmbyll në takimin e Këshillit Europian në mars 2004, pas sulmeve të Madridit, më 11 mars 2004;
- një Strategji Kundërterrorizmi u miratua në dhjetor 2005, pas bombave në Londër; kjo u përqendrua në qasjet "parandalim", "mbrojtje", "përçarje", "reagim".

Përpjekjet për të luftuar terrorizmin më tani bazohen në një program pesëvjeçarë të miratuar në 2004 në Hagë. Programi përcakton përparësitë e ndërhyrjeve për periudhën 2005-2010.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë
- Eurojust
- Urdhër-Arresti Europian
- Rrjet Gjyqësor Europian për Çështjet Penale (RrGjE)
- Europol (Zyra Policore Europiane)
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale

M

Marrëveshje, ~a për Politikën Sociale / Social Policy Agreement

Marrëveshja për Politikën Sociale u nënshkrua nga njëmbëdhjetë Shtete Anëtare në dhjetor 1991. Britania e Madhe nuk pranoi të merrte pjesë në Marrëveshje. Kjo marrëveshje paraqet objektivat e politikës sociale të cilave u hapi rrugën Karta Sociale e vitit 1989: nxitja e punësimit, përmirësimi i kushteve të jetesës dhe të punës, lufta kundër përjashtimit social, zhvillimi i burimeve njerëzore etj. Ajo përcakton gjithashtu edhe procedurën për miratimin e masave të politikës sociale dhe njeh rolin thelbësor që luan në këtë fushë menaxhimi dhe organizatat punëtore.

Kur u nënshkrua, Marrëveshja për Politikën Sociale iu shtua Protokollit mbi politikën sociale, një mekanizëm ky me anë të të cilit Britania e Madhe i lejoi Shtetet e tjera Anëtare të ecnin përpara në fushën e politikës sociale pa pjesëmarrjen e saj.

Në vijim të zgjedhjeve parlamentare të vitit 1997, Britania e Madhe lajmëroi se kishte ndërmend të hiqte dorë nga klauzola e mospjesëmarrjes. Marrëveshja për Politikën Sociale u përfshi atëherë në Kreun Social të Traktatit të Komunitetit European me anë të Traktatit të Amsterdimit. Gjithashtu, ajo përfshinte edhe shfuqizimin zyrtar të Protokollit mbi Politikën Sociale.

Shiko:

- Kartë Sociale (Karta e të Drejtave Sociale Themelore të Punonjësve)
- Dialog Social
- Politikë Sociale

Masë, ~a për të luftuar pastrimin e parave / Measures to combat money laundering

Pastrimi i parave është procesi përmes të cilit personat e ngarkuar në veprimtari kriminale, fshehin origjinën e paligjshme të pronave apo të ardhurave të fituara përmes kësaj veprimtarie.

Bashkëpunimi më i mirë mes Shteteve Anëtare dhe, në veçanti, i autoriteteve doganore të tyre, përbën njërin prej synimeve që punës për parandalimin e pastrimit të parave. Këto përpjekje brenda Bashkimit European janë dy llojesh:

- Në kuadër të Traktatit mbi Funksonimin e Bashkimit European, lëvizja e lirë e kapitalit rregullohet në mënyrë të tillë që flukset të mund të vëzhgohen. Këto rregulla kanë lidhje si me operatorët financiarë, ashtu edhe me institucionet e kreditit, organizatat e tjera financiare, si dhe me mjetet e realizimit të transaksioneve financiare, sidomos të operacioneve ndërkombëtare. Ato kanë në objektiv edhe përdorimin e sistemit financiar për qëllimet e pastrimit të parave.
- Në kuadër të titullit IV të Traktatit mbi Funksonimin e Bashkimit European (Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale), lufta kundër pastrimit të parave shikohet, kryesisht, si pjesë e betejës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Fokusi është te përkufizimi i veprave penale dhe te fuqizimi i ndihmesës së ndërsjellë (Konventa për Ndhimesën e Ndërsjellë për Çështjet Penale, datë 29 maj 2000, miratuar nga Këshilli i Bashkimit European në tetor 2001).

Ndërkohë që është punuar më parë gjatë viteve "90, në kuadër të Shtyllës së parë, është përdorur Shtylla e tretë për ta fuqizuar Politikën e Bashkimit Europian. Mbi këtë bazë, lufta kundër pastrimit të parave mbështetet në programet e punës, deri më tani një program pesëvjeçar i miratuar në vitin 2004 në Hagë, i cili vijon punën e bërë në kuadër të Programit të Tamperës të vitit 1999.

Të gjitha dispozitat e zonës së Drejtësisë Lirisë dhe Sigurisë që i përkisnin shtyllës së parë dhe dispozitat e shtyllës së tretë janë tashmë të shkrira në Titullin V të TFBE. Këto ndryshime do t'i mundësojnë Bashkimit të zhvillojë veprimet e politikave e veta të cilat përputhen me pritshmëritë e qytetarëve për sa i përket zonës së drejtësisë dhe sigurisë.

Neni 83 i Traktatit të Lisbonës parashikon që BE, më anë të procedurës së zakonshme miraton rregulla minimum për sa i përket përkufizimeve dhe sanksioneve për krimet e ndryshme, duke përfshirë si krimin e organizuar, ashtu dhe pastimin e parave. Këto vepra janë parashikuar në një listë të pasur të nenit 83. Parlamenti dhe Këshilli i miraton këto rregulla me shumicë të cilësuar.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë, dhe Drejtësisë
- Eurojust
- Krim i organizuar
- Shtylla të Bashkimit Europian
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale
- Terrorizëm

Mbrojtje, ~ a e konsumatorit / Consumer protection

Mbrojtja e konsumatorit trajtohet në nenin 169 TFBE (ish neni 153 i Traktatit të Komunitetit Europian) i cili u shtua me Traktatin e Matrihtit. Mbrojtja e konsumatorit ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, sigurisë, interesave ligjore dhe ekonomike dhe të drejtën e tyre për t'u informuar.

Neni 169 TFBE, i referohet qartë një baze ligjore tjetër për arritjen e objektivave, përkatësisht nenit 114 TFBE (ish neni 95 TKE), ku kërkohet procedura e vendimmarrjes së përbashkët për të gjitha masat që përfshijnë përafimin e legjislacioneve të Shteteve Anëtare për arritjen e një tregu të vetëm të brendshëm, kur bëhet fjalë për mbrojtjen e konsumatorit. Në të njëjtën kohë, ky nen përcakton që të miratohen masa të veçanta, të cilat përkrahin dhe i shtohen politikës së ndjekur nga Shtetet Anëtare, sipas procedurës së vendimmarrjes së përbashkët pas këshillimit me Komitetin Ekonomik dhe Social.

Një Shtet Anëtar mund të ruajë ose paraqesë masa më të rrepta për mbrojtjen e konsumatorit, sesa ato të parashtruara nga Komuniteti, për sa kohë që ato përputhen me Traktatin dhe Komisioni njoftohet rreth tyre.

Shiko:

- Procedura të vendimmarrjes së përbashkët
- Siguri ushqimore
- Organizma të Ndryshuar Gjenetike (GMO)
- Parim i paralajmërimit

Mbrojtje, ~a kolektive / Collective defence

Mbrojtja kolektive ka të bëjë me pjesëmarrjen në mbrojtjen e Evropës sipas Traktateve të Brukselit (neni V) dhe të Uashingtonit (neni 5), që përcaktojnë se në rast sulmi, vendet nënshkruese duhet të sigurojnë ndihmë për vendosjen e sigurisë:

- Traktati i Brukselit është nënshkruar në vitin 1948 nga Franca, Britania e Madhe, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu. Është ndryshuar në vitin 1954 nga Marrëveshjet e Parisit, përmes të cilave është themeluar Bashkimi Europian Perëndimor (BEP). Neni V i këtij Traktati përcakton parimin e ndihmës së ndërsjelltë, në rast të ndonjë sulmi të armatosur kundër njërit prej Palëve të Larta Kontraktuese, në bazë të nenit 51 të Kartës OKB-së (e drejta e vetëmbrojtjes).
- Traktati i Atlantikut Verior është nënshkruar në Uashington në vitin 1949 nga dhjetë vende të Europës Perëndimore dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadaja. Neni 5, për solidaritetin midis anëtarëve në rast të një sulmi të armatosur, përbën pikën vendimtare të Traktatit. Nëse ndodh një sulm i tillë i armatosur, secila prej palëve duhet të ndihmojë palën e sulmuar gjatë ushtrimit të së drejtës së vetëmbrojtjes individuale ose kolektive, duke marrë ato masa që konsiderohen të nevojshme për të rivendosur dhe mbajtur sigurinë, përfshirë edhe përdorimin e forcës së armatosur. Këto masa ndërpriten atëherë kur Këshilli i Sigurimit të ketë marrë masat e nevojshme për rivendosjen dhe ruajtjen e paqes dhe të sigurisë.

Që në vitin 1949, NATO ka qenë garantuesi kryesor i sigurisë në Evropën Perëndimore, ndërsa Bashkimi Europian Perëndimor thjesht ka numëruar në vend për pothuajse 30 vjet. Megjithatë, BEP është e vetmja organizatë Europiane që ka vendosur detyrimin automatik për mbrojtje kolektive. Ky zhvillim i Identitetit Europian të Sigurisë dhe Mbrojtjes (IESM) nuk e prek në asnjë mënyrë parimin që NATO vijon të përbëjë bazën për mbrojtjen kolektive të Evropës.

NATO do të vazhdojë të luajë një rol kryesor në politikën e mbrojtjes së Bashkimit. Sipas Traktatit të Lisbonës, të gjitha vendet anëtare dhe ato që nuk janë pjesë të NATO-s duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin në rast sulmi në territorin e tyre. Megjithatë, ky mbetet një detyrim për shtetet individuale dhe jo për institucionet e Bashkimit.

Traktati përmban një dispozitë të re e cila institucionalizon bashkëpunimin midis shteteve anëtare, e quajtur Bashkëpunimi i Strukturuar i Përhershëm. Qëllimi i tij është që të forcojë bashkëpunimin. Ashtu sic parashikohet dhe në nenin 2 të Protokollit, Bashkëpunimi i Strukturuar i Përhershëm mbulon një numër të madh fushash siç janë investimet në pajisjet e mbrojtjes. Agjencia Europiane e Mbrojtjes do të ketë një rol në vlerësimin e përhershëm të pjesëmarrjes së shteteve në këtë bashkëpunim.

Traktati i Lisbonës futi gjithashtu një klauzolë solidariteti, sipas të cilit shtetet anëtare dhe Bashkimi do t'i ofrojnë ndihmën e tyre çdo shteti anëtar nëse bëhet viktimë e një sulmi terrorist ose një fatkeqësie natyrore apo humanitare, me kërkesën e autoriteteve politike të tij. Kjo dispozitë ka disa implikime për mbrojtjen, në mënyrë të veçantë për sa i përket mbrojtjes civile.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM)
- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
- Pamja e re e NATO-s
- Bashkimi Europian Perëndimor (BEP)

Metodë, ~a e Hapur e Bashkërendimit / Open method of coordination

Metoda e Hapur e Bashkërendimit (MHB), e krijuar si pjesë e politikës së punësimit dhe procesit të Luksemburgut, është përkufizuar si një instrument i Strategjisë së Lisbonës (2000).

MHB ofron një kuadër të ri për bashkëpunimin midis Shteteve Anëtare, politikat kombëtare të të cilëve mund të orientohen kështu, në drejtim të objektivave të përbashkëta. Sipas kësaj Metode Ndërqeveritare, Shtetet Anëtare vlerësohen nga njëri - tjetri (oponenca), ku roli i

Komisionit kufizohet vetëm me mbikëqyrje. Parlamenti European dhe Gjykata Europiane nuk luajnë gati asnjë rol në procesin e Metodës së Hapur të Bashkërendimit.

Metoda e Hapur e Bashkërendimit zhvillohet në fusha që janë kompetencë e Shteteve Anëtare, siç janë punësimi, mbrojtja sociale, përfshirja sociale, arsimiti, rinia dhe trajnimi.

Parimisht, mbështetet në:

- identifikimin dhe përcaktimin bashkërisht të objektivave që duhen arritur (miratuar nga Këshilli);
- instrumentet matëse të përcaktuar bashkërisht (statistika, tregues, udhëzues);
- vlerësimi krahasues, domethënë krahasim i ecurisë së Shteteve Anëtare dhe shkëmbimi i praktikave më të mira (vëzhguar nga Komisioni).

Në varësi të fushave në fjalë, Metoda e Hapur e Bashkërendimit përfshin të ashtuquajturat masa “të legjislacionit soft”, të cilat janë të detyrueshme për Shtetet Anëtare në shkallë të ndryshme, por të cilat nuk marrin asnjëherë formën e direktivave, rregulloreve apo vendimeve. Kështu, në kuadër të strategjisë së Lisbonës, Metoda e Hapur e Bashkërendimit u kërkon Shteteve Anëtare të përpilojnë plane të reformave kombëtare dhe t’ia përcjellin këto plane Komisionit. Megjithatë, Politika për Rininë nuk kërkon vendosjen e objektivave dhe Shtetet Anëtare e kanë vetë në dorë të vendosin për objektivat, pa pasur nevojë për bashkërendim në nivel European të planeve kombëtare të veprimit.

Shiko :

- Arsimim
- Punësim
- Strategjia e Lisbonës
- Politikë Sociale
- Përgatitje profesionale
- Rini

Metodë, ~a Komunitare dhe Ndërqeveritare / Community and intergovernmental methods

Metoda Komunitare është shprehje e përdorur për mënyrën institucionale të veprimit në Shtyllën e parë të Bashkimit European. Kjo Metodë vijon nga një logjikë integrimi, duke pasur parasysh parimin e subsidiaritetit dhe ka tiparet dalluese të mëposhtme:

- monopoli i Komisionit me të drejtën e nismëtarit
- përdorimi i gjerë të votimit me shumicë të cilësuar në Këshill
- roli aktiv i Parlamentit European
- interpretimi standard i së Drejtës Komunitare nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European

Kjo metodë është në kundërshtim me Metodën Ndërqeveritare të veprimit që përdoret në Shtyllën e dytë dhe të tretë, e cila shkon sipas një logjike ndërqeveritare. Ajo ka këto tipare dalluese:

- E Drejta e Iniciativës e Komisionit ndahet me Shtetet Anëtare, ose kufizohet për disa fusha të veçanta të veprimtarisë;
- Këshilli European përgjithësisht vepron me unanimitet;
- Parlamenti European ka një rol krejt këshillimor;
- Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European nuk luan rol të rëndësishëm.

Me ndryshimet e parashikuara në Traktatin e Lisbonës, metoda ndërqeveritare zbatohet vetëm për Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, të ashtuquajturën shtyllën e dytë. Traktati i Lisbonës sjell ndryshime të rëndësishme lidhur me përdorimin e shumicës së cilësuar dhe rritjen e rolit të Parlamentit në procedurat e vendimmarrjes së përbashkët.

Shiko:

- Komunitarizë m
- Shtylla të Bashkimit Europian
- Shumicë e cilësuar
- E Drejtë e Iniciativës Legjislative
- Unanimitet

Mirëqenie, ~a e kafshëve / Animal welfare

Problemi i mirëqenies së kafshëve është trajtuar për herë të parë me legjislacion në vitin 1974. Kërkesat ligjore në këtë fushë janë njohur, veçanërisht, në një protokoll shtesë që i është bashkëlidhur Traktatit të Amsterdimit (1997). Ky “Protokoll për Mbrojtjen dhe Mirëqenien e Kafshëve” vendos rregullat për punën e BE-së në këtë fushë. Zyrtarisht, protokollin njihet që kafshët janë qenie me ndjenja dhe i detyron institucionet Europiane t’i marrin plotësisht në konsideratë kërkesat ligjore për mirëqenien e kafshëve gjatë hartimit dhe vënies në zbatim të politikave të përbashkëta.

Legjislacioni Europian në fushën e mirëqenies së kafshëve synon t’i shpëtojë kafshët nga çdo vuajtje e panevojshme në tre fusha kryesore: blegtori, transport dhe thertore. Është thelbësore marrja e masave në këto fusha, jo vetëm për arsye etike dhe morale, por edhe për shëndetin e kafshëve dhe cilësinë e produkteve ushqimore. Në kuadër të një strategjie të plotë për sigurinë ushqimore, edhe politikave të tjera të Komunitetit (bujqësia, transporti, tregu i brendshëm dhe puna kërkimore-shkencore) u kërkohet të marrin në konsideratë këtë nevojë.

Në fillim të vitit 2006 Komisioni Europian miratoi një plan veprimi pesëvjeçar për të përforcuar standardet ekzistuese, për të zgjeruar punën kërkimore, për të vendosur masa vlerësimi dhe pjesëmarrjeje dhe për të promovuar mirëqenien e kafshëve në nivel ndërkombëtar.

Në bashkëpunim me autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare, Zyra e Çështjeve Ushqimore dhe Veterinare (ZCUV) ealizon kontrole në terren për të siguruar përmbushjen e kërkesave të legjislacionit të Komunitetit. Roli i kësaj zyre është rritur qysh prej zgjerimit të BE-së, kur numri i shteteve anëtare arriti 27.

Neni 13 TFBE sjell në tekstin e Traktatit të Lisbonës fjalët e Protokollit ekzistues (Nr. 33) mbi Mbrojtjen e Mirëqënies së Kafshëve, i bashkëngjitur Traktatit. Në tekstin e këtij neni përfshihet edhe referimi ndaj kafshëve si qenie të ndjeshme. Gjuha e Protokollit balancon nevojën për të siguruar mirëqënien e kafshëve përkundrejt nevojës për të respektuar legjislacionin dhe dispozitat administrative dhe doganat e shteteve anëtare të lidhura veçanërisht me ritet fetare kulturore dhe tradicionale dhe trashigiminë rajonale.

Shiko:

- Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB)
- Mjedisi
- Siguri ushqimore

Mjedisi, ~i / Environment

Politika e Mjedisit e Bashkimit Europian, mbështetur në nenin 191 TFBE (ish neni 174 TKE) të Traktatit themelues të Komunitetit Europian, synon të ruajë, mbrojë dhe përmirësojë cilësinë e mjedisit dhe të mbrojë shëndetin e njeriut. Kjo politikë përqendrohet gjithashtu, te përdorimi i kujdesshëm dhe racional i burimeve natyrore dhe ndihmon në promovimin, në nivel ndërkombëtar, të masave që synojnë të luftojnë problemet mjedisore rajonale ose globale. Ajo mbështetet në parimet e parandalimit, ndreqjes së problemit në burim dhe parimit “ndotësi të paguajë”.

Programi i gjashtë i punës për mjedisin, i miratuar në vitin 2002, përcakton përparësitë dhe objektivat e politikës mjedisore Europiane deri në vitin 2010, duke u përqendruar në katër fusha prioritare: ndryshimi i klimës; natyra dhe biollojshmëria, mjedisi, shëndeti dhe cilësia e jetës; burimet natyrore dhe mbetjet. Ajo plotësohet nga shtatë strategji tematike në fushat e mëposhtme: ndotja atmosferike, mbetjet, mjedisi detar, dherat, pesticidet, burimet natyrore dhe mjedisi qytetës.

Gjatë tridhjetë vjetëve të fundit puna mjedisore ne hapësirën Europiane është zhvilluar nga zgjidhja e disa problemeve konkrete të caktuara, në një qasje më horizontale, parandaluese dhe të integruar. Ideja e “zhvillimit të qëndrueshëm” është mishëruar si njëri prej objektivave të Bashkimit, në Traktatin e Amsterdimit, ndërsa integrimi i çështjes së mbrojtjes së mjedisit është përforcuar në politikat e tjera të Komunitetit Europian, sidomos në ato politika që lidhen me tregun e brendshëm, transportin dhe energjinë.

Tani është më e lehtë për një Shtet Anëtar të zbatojë standarde më të rrepta se standardet e harmonizuara, me kusht që ato të jenë të krahasueshme me Traktatin dhe t’i njoftohen Komisionit.

Shumica e veprimeve të Bashkimit në këtë fushë, janë miratuar sipas procedurës së vendimmarrjes së përbashkët, me përjashtim të fushave të caktuara, siç janë dispozitat fiskale, rregullimi i territorit apo fusha që prekin ndjeshëm vendimet e shteteve anëtare në lidhje me energjinë.

Traktati i Lisbonës konfirmon situatën aktuale për sa i përket ndarjes së kompetencave midis Shteteve Anëtare dhe BE-së në lidhje me politikat e mjedisit. Për herë të parë, në Traktat përmenden në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndryshimet klimaterike. Politikat e mjedisit duhet të kontribuojnë për arritjen e disa objektivave, një prej të cilave është nxitja e masave në nivel ndërkombëtar për të luftuar ndryshimet klimaterike. I lidhur ngushtë me ndryshimet klimaterike, është dhe neni për energjinë i cili parashikon ndërmarrjen e veprimeve për nxitjen e energjive eficiente, ruajtjen e energjisë dhe zhvillimin e energjive alternative. Një klauzolë solidariteti është parashikuar në nenin 222 TFBE i cili parashikon se Bashkimi dhe Vendet Anëtare duhet të veprojnë së bashku në rast shkatërrimi në masë. Traktati parashikon edhe disa ndryshimeve në procedurën vendimmarrëse për masat në fushën e mjedisit me ndjeshmëri të lartë kombëtare si planifikimi i territoreve, menaxhimi i ujërave, përdorimi i tokës, me përjashtim të menaxhimit të mbeturinave dhe çdo shtet mund të zgjedhë midis burimeve të ndryshme të energjisë.

Shiko:

- Përgjegjësi mjedisore
- Siguri ushqimore
- Organizma të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ)
- Protokoli i Kiotos
- Naturë 2000
- Parim i kujdesit
- REACH (Kuadri Rregullues për Kimikatet)
- Zhvillim rural
- Zhvillim i qëndrueshëm

Mundësi të barabarta / Equal opportunities

Parimi i përgjithshëm i mundësive të barabarta përmban dy elemente kyçe: njëri është ndalimi i diskriminimit mbi baza kombësie, ndërsa tjetri është barazia midis burrave dhe grave. Synohet të zbatohet për të gjitha fushat, sidomos në jetën ekonomike, shoqërore, kulturore dhe familjare.

Traktati i Amsterdamit i shtoi një dispozitë të re që përforcon parimin e mosdiskriminimit të lidhur ngushtë me mundësitë e barabarta. Sipas kësaj dispozite, Këshilli gëzon të drejtën të marrë masat e duhura për të luftuar diskriminimin mbi bazë seksuale, raciale apo origjinë etnike, feje apo besimi, handikapi, moshe apo orientimi seksual. Për më tepër, falë programit të tij për luftën kundër diskriminimit (2001-2006), Bashkimi Europian ka nxitur dhe plotësuar veprimtaritë e shteteve anëtare në luftën kundër të gjitha formave të diskriminimit.

E miratuar në dhjetor 2000, Karta e të Drejtave themelore e Bashkimit Europian përfshiu kapitullin "Barazia", që përcakton parimet e mosdiskriminimit, barazi ndërmjet burrit dhe gruas, larmisë kulturore, fetare dhe gjuhësore. Ajo mbulon edhe të drejtat e fëmijëve, të personave të moshuar dhe të personave me aftësi të kufizuara.

Shiko:

- Karta e të Drejtave Themelore
- Trajtim i barabartë i burrave dhe grave
- Parim i mosdiskriminimit



NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior) / (North Atlantic Treaty Organisation)

Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO ose Aleanca e Atlantikut) u krijua nga Traktati i Atlantikut Verior, i njohur edhe si Traktati i Uashingtonit, i nënshkruar më 4 prill 1949 dhe e ka selinë në Bruksel. Ajo aktualisht përbëhet nga 28 anëtarë pas këtyre zgjerimeve:

- 1949 (12 shtetet themeluese): Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Franca, Islanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia, Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- Shkurt 1952: Greqia dhe Turqia;
- Maj 1955: Republika Federale e Gjermanisë;
- Maj 1982: Spanja;
- Mars 1999: Republika Çeke, Hungaria dhe Polonia;
- Mars 2004: Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia;
- Prill 2009: Shqipëria dhe Kroacia.

Politika e BE-së i respekton detyrimet e Shteteve Anëtare në kuadër të NATO-s dhe Politika e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen përcaktohen brenda këtij kuadri.

Roli i Kryesor i NATO-s në politikën e mbrojtjes së BE-së njihet edhe nga Traktati i Lisbonës. Shiko:

- Mbrojtje-a kolektive
- Politikë-a e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Politikë-a Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM)
- Pamje-a e re e NATO-s
- Bashkim-i European Perëndimor (BEP)

NATO “e rinovuar” / “New-look” NATO

NATO “e rinovuar” ka të bëjë me procesin e ripërcaktimit të rolit dhe mënyrës së veprimit të organizatës. Aspektet kyçe që përfshihen janë Njohja e Identitetit European të Mbrojtjes, Forcimi i Komponentit European të Sistemit Ndëratlantik të Sigurisë, Roli i ri i Bashkimit European Perëndimor dhe Perspektiva e Zgjerimit Lindor të NATO-s.

Kjo do të shoqërohet me një thellim të marrëdhënieve të NATO-s me vendet e treta me anë të partneriteteve për paqe dhe Këshillit për bashkëpunim të Atlantikut Verior. Një sfidë e madhe në lidhje me këtë është krijimi i një partneriteti të shëndoshë dhe të qëndrueshëm me Rusinë dhe Ukrainën.

Shiko:

- Mbrojtje-a kolektive
- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM)
- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
- Bashkimi European Perëndimor (BEP)

Natyr 2000 / Natura 2000

“Natyr 2000” është një grup zonash në Shtetet Anëtare, në të cilat duhet të mbrohen flora dhe fauna dhe habitati i tyre. Kuadri organizativ për mbrojtjen jepet në “Direktivën për shpendët” (1979) dhe “Direktivën për habitatet” (1992).

Legjislacioni i Bashkimit përcakton speciet e florës dhe faunës dhe habitatet që janë me interes, për shkak të faktit që janë të rrallë ose të cenueshëm dhe sidomos speciet dhe habitatet që janë në rrezik zhdukjeje. Pas propozimeve nga Shtetet Anëtare, Komisioni cakton zonat e mbrojtura të këtyre specieve dhe habitateve, të klasifikuar sipas shtatë rajoneve biogeografike të BE-së (Alpine, Atlantike, Boreale, Kontinentale, Makaroneziane, Mesdhetare dhe Panoniane).

Rrjeti përbëhet nga: Zonat e Mbrojtjes së Posaçme (ZMP) për ruajtjen e mbi 180 specieve të shpendëve; Zonat e Ruajtjes së Posaçme (ZRP) për ruajtjen e specieve dhe nënspecieve të shpendëve; Zonat e Posaçme të Ruajtjes (ZPR) për ruajtjen e mbi 250 llojeve të habitateve, 200 specieve shtazore dhe mbi 430 specieve bimore. Sot, “Natyr 2000” mbulon mbi 20% të terrenit të BE-së.

Shtetet Anëtare janë përgjegjëse për administrimin e këtyre zonave dhe duhet të kujdesen për ruajtjen e specieve dhe të habitateve të përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit. Edhe pse veprimtaritë njerëzore, siç janë bujqësia dhe blegtoria, vazhdojnë të jenë të lejuara brenda këtyre zonave, ato duhet të jenë në përputhje me synimin e ruajtjes.

Shiko:

- Mjedis
- Zhvillim rural
- Zhvillim i qëndrueshëm

Ndihmë, ~a paraanëtarësimi (aderimit) / Pre-accession assistance

Ndihma përpara anëtarësimi u jepet vendeve që janë kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Europian, për të përmbushur kushtet (kriteret e Kopenhagenit). Janë të nevojshme investime të konsiderueshme, nëse vendet kandidatë duan t'i harmonizojnë institucionet dhe standardet e tyre me legjislacionin e Bashkimit dhe nëse duan të jenë në gjendje t'i përmbushin detyrimet e tyre si Shtete Anëtare.

Ndihma paraanëtarësimi, që u jepet vendeve kandidatë, është një faktor kyç në strategjinë e paraanëtarësimi dhe përcaktohet nga partneritetet për anëtarësim.

Për periudhën 2007-2013, Instrumenti i Asistencës Paraanëtarësimi (IPA) do të jetë i vetmi mjet për dhënien e fondeve, duke zëvendësuar instrumentet e para-anëtarësimi të periudhës 2000-2006 (PHARE, SAPARD për masat strukturore në bujqësi, ISPA për zhvillimin e infrastrukturës në fushat e mjedisit dhe të transportit, instrumenti i posaçëm i paraanëtarësimi për Turqinë), si edhe programin CARDS për vendet e Ballkanit Perëndimor.

IPA përbëhet nga pesë komponentë: mbështetja për tranzicionin dhe ngritjen e institucioneve, bashkëpunimi ndërkuftar, zhvillimi rajonal, zhvillimi i burimeve njerëzore dhe zhvillimi rural. Tre komponentët e parë kanë të bëjnë me vendet kandidatë dhe vendet e mundshme për kandidatë. Ndërsa tre komponentët e fundit kanë të bëjnë vetëm me vendet kandidatë, me synimin për t'i përgatitur ato për miratimin dhe zbatimin e politikës së kohezionit dhe administrimin e Fondeve strukturore.

Edhe Banka Europiane për Investime (BEI) dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN) japin bashkëfinancim për vendet kandidatë.

Pas anëtarësimi në Bashkimin Europian, Shtetet e reja Anëtare, të cilat nuk kanë më të drejtë të përfitojnë ndihmë paraanëtarësimi, përfitojnë asistencë financiare të përkohshme, e quajtur Linja Kalimtare, e parashikuar nga Traktati i Anëtarësimi.

Shiko:

- Bisedime për anëtarësimin
- Partneritet për anëtarësim
- Vende kërkuese
- Acquis i BE-së
- Zgjerim
- Banka Europiane për Investime (BEI)
- Strategji për paraanëtarësimin
- Programi i Ndhmës së Komunitetit për Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (PHARE) Strategji për paraanëtarësimin
- Fonde strukturore dhe Fond i Kohezionit
- TAIEX (Asistencë Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit)

Ndihmë, ~a humanitare / Humanitarian aid

Bashkimi European si i tërë (Komisioni dhe Shtetet Anëtare) është një nga donatorët më të mëdhenj të ndihmës humanitare në botë.

Dimensioni i ndihmës humanitare të veprimit të jashtëm të Bashkimit European është bërë më i rëndësishëm vitet e fundit, për shkak të rritjes së numrit të krizave në mbarë botën dhe vullnetit të Bashkimit European për të marrë rolin udhëheqës në përpjekjet ndërkombëtare humanitare.

Prandaj, më 1992 u krijua Zyra e Ndhmës Humanitare të Komisionit European (ZHKE). Detyra e kësaj zyre është të sigurojë ndihmë urgjente për viktimat (në formën e të mirave dhe shërbimeve) e katastrofave natyrore apo artificiale, ose për konflikte jashtë Bashkimit European. Kjo ndihmë bazohet në parimet e mosdiskriminimit, barazisë dhe humanizmit. Ndhima humanitare shpërndahet nga partnerë të Zyrës së Ndhmës Humanitare të Komisionit European, kryesisht OJQ-të, agjencitë humanitare të OKB-së dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Traktati i Lisbonës parashikon një dispozitë të vecantë për fondin european për ndihmën humanitare. Neni 214 TFBE parashikon përdorimin e shumicës së cilësuar për fushën e ndihmës humanitare. Për më tepër, ai bën të qartë se operacionet e ndihmes humanitare duhet të bëhen në përputhje me parimet ndërkombëtare të ndihmës humanitare sic janë paanshmëria, neutraliteti, dhe mosdiskriminimi. Traktati i Lisbonës parashikon krijimin e Korpusit Evropian të ndihmës humanitare (neni 214 TFBE), me qëllim ngritjen e kuadrit për kontributin e përbashkët të evropianëve të rinj në operacionet europiane të ndihmës humanitare. Paramenti Evropian dhe Këshilli përcaktojnë rregulat dhe procedurat për funksionimin e Korpusit me anë të një rregulloreje të miratuar me procedurën e zakonshme ligjvënëse.

Shiko:

- Ndihmë për zhvillim

Ndihmë, ~a shtetërore / State aid

Ndhima shtetërore do të thotë masë e marrë nga një autoritet publik (qendror, rajonal ose vendor), duke përdorur burimet publike, për të favorizuar sipërmarrje të caktuara apo prodhimin e mallrave të caktuara. Biznesi që përfiton nga ndihma shtetërore, gëzon, kështu, përparësi kundrejt konkurrentëve të vet. Rrjedhimisht, mbajtja nën kontroll e ndihmës shtetërore pasqyron nevojën për të ruajtur konkurrencën e lirë dhe të ndershme brenda Bashkimit European.

Për rrjedhim, është e ndaluar ndihma që jepet në mënyrë selektive nga Shtetet Anëtare ose përmes burimeve shtetërore dhe që mund të prekë tregtinë midis Shteteve Anëtare apo mund të shtrembërojë konkurrencën nën 107 TFBE (ish nën 87 i Traktatit themelues të Komunitetit Europian). Megjithatë, ndihma shtetërore mund të lejohet, nëse përlligjet nga objektiva me interes të përgjithshëm: ndihmë për të nxitur zhvillimin e zonave në pozita të pafavorshme ose për shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për punën kërkimore-zhvillimore, për mbrojtjen e mjedisit, për trajnim, për punësim dhe për kulturën.

Komisioni Europian ka detyrë të mbajë nën shqyrtim ndihmën shtetërore që japin Shtetet Anëtare, qoftë kjo e parashikuar apo që ka filluar të jepet tashmë, për tuu kujdesur që kjo ndihmë të mos shtrembërojë konkurrencën.

Komisioni dhe Gjykata Europiane i kanë bërë një interpretim shumë të gjerë konceptit të "ndihmës" lidhur kjo me organin që e jep atë (vetë shteti, një autoritet rajonal apo vendor, një organ mbi të cilin shteti ushtron një ndikim mbizotërues, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një shoqëri private apo shoqëri me pronësi publike që ushtron veprimtari në bazë të së drejtës private etj.), formës (ndihmë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, siç është çlirimi i firmës nga barra financiare e saj) dhe qëllimit të saj.

Aktualisht është duke u kryer një reformë e normave dhe procedurave që kanë të bëjnë me ndihmën shtetërore. Kjo reformë propozon që ndihma shtetërore duhet të jepet më rrallë dhe të përcaktohen më mirë përfituesit e saj, në mënyrë që ajo të japë një ndihmesë më të madhe për rritjen e aftësisë konkurruese të industrisë Europiane dhe prej saj të lindin vende pune afatgjata.

Shiko:

- Konkurrencë
- Kohezion-i ekonomik, social dhe territorial
- Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm

Ndihmë, ~a për zhvillim / Development aid

Fillimet e politikës së zhvillimit të Komunitetit Europian nisën me nënshkrimin e Traktatit të Romës në vitin 1957. Vendet dhe territoret jo Europiane të Shteteve Anëtare ishin përfituesit e parë. Megjithatë, vetëm me hyrjen në fuqi të Traktatit të Bashkimit Europian (Traktati i Mastrihtit, 1993) kjo politikë gëzon bazë të veçantë ligjore nën 208 deri 212 TFBE (ish nën 177 deri 181 te Traktatit të Komunitetit Europian). Me zgjerimin e Bashkimit Europian, bashkëpunimi është shtrirë gradualisht në vende të tjera, si: vendet e Afrikës, të Karaibeve dhe të Paqësorit (AKP), të cilat kanë një marrëdhënie të ngushtë dhe të gjatë me disa Shtete Anëtare. Marrëveshja Cotonou, e firmosur në qershor 2000 dhe e rishikuar në vitin 2005, ka forcuar këtë partneritet që bazohet në Konventat Lomé, e para ndër të cilat u nënshkrua në vitin 1975.

Përveç këtyre marrëveshjeve fillestare, vende të tjera si vendet e Amerikës Latine dhe Azia, përfitojnë gjithashtu nga politika e zhvillimit komunitar.

Qëllimi kryesor i politikës së zhvillimit të Bashkimit Europian është zbutja e varfërisë. Kjo politikë zbatohet jo vetëm përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe rajonale, por edhe përmes programeve specifike në disa sektorë, si shëndetësia dhe arsimimi. Politika e zhvillimit përfshin bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen e Bashkimit Europian dhe të Shteteve Anëtare në nismat e zbatuara në nivel botëror, si nisma për vendet e varfra të mbytura në borxhe.

Sot, Bashkimi Europian është partneri kryesor tregtar i vendeve në zhvillim dhe kontribuesi kryesor i ndihmës për zhvillim. Bashkimi Europian dhe Shtetet Anëtare sigurojnë se bashku 55% të ndihmës për zhvillim ndërkombëtar.

Traktati i Lisbonës përcakton qartë se një nga objektivat parësorë të BE-së në politikat e zhvillimit është të reduktojë dhe eliminojë varfërinë .

Shiko:

- Fondi European për Zhvillim
- Ndihmë humanitare

Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme / Small and medium-sized enterprises

Në nivel të Bashkimit, Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) përkufizohen përmes një pakete kriteresh që kanë të bëjnë me krahun e punës, xhiron afariste dhe pavarësinë e aktivitetit tregtar. Në bazë të kriterit të krahut të punës, një mikro-ndërmarrje ka më pak se 10 punëmarrës, një ndërmarrje e vogël më pak se 50 dhe një ndërmarrje e mesme më pak se 250. Bashkimi European i ka përkufizuar në mënyrë specifike NVM-të, në mënyrë që përfitimet e dhëna për mbështetjen e tyre t'u rezervohen vetëm atyre bizneseve që i kanë me të vërtetë tiparet e firmave të tilla.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme përbëjnë më shumë se 90% të të gjitha ndërmarrjeve Europiane dhe janë epiqendra e ekonomisë Europiane. Sipas parullës, "Gjërat lindin të vogla", nga Karta Europiane e Ndërmarrjeve të Vogla (2000), Bashkimi European po krijon një sërë masash në mbështetje të NVM-ve (mundësi përfitimi të fondeve, tatime, punë kërkimore, teknologjia e informacionit dhe komunikimit etj.). BE-ja ka vendosur edhe një kuadër të vetëm dhe koherent të politikave për këto masa të ndryshme, me synim realizimin e potencialit të pashfrytëzuar të NVM-ve për t'u rritur dhe me qëllim krijimin e vendeve të punës brenda BE-së.

Për t'u kujdesur që interesat dhe nevojat konkrete të NVM-ve janë marrë tërësisht parasysh në kontekstin e politikave Europiane, një përfaqësues i NVM-ve funksionon si hallkë midis tyre dhe Komisionit European.

Edhe pse Bashkimi European nxit përdorimin e përkufizimit të Komunitetit për t'u përdorur për NVM-të, ky përkufizim është i detyrueshëm vetëm për disa çështje të caktuara, siç janë; ndihma shtetërore, vënia në zbatim e fondeve strukturore apo programet e Komunitetit.

Shiko:

- Konkurrueshmëri
- Politikë për Ndërmarrjet



Organizim, ~i i përbashkët i tregjeve bujqësore / Common organisation of the agricultural markets (COM)

Organizatat e Tregut të Përbashkët (OTB) përbëjnë Shtyllën e parë të Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB). Ato janë instrumenti themelor i rregullimit të tregut për prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore në të gjithë Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian, përmes:

- Shmangies së pengesave ndaj tregimit të produkteve bujqësore brenda për brenda Bashkimit;
- Mbajtjes së një pengese të përbashkët doganore, në lidhje me vendet e treta.

Qysh prej reformës së PPB në vitin 2003, shumica e OTB-ve i janë nënshtruar një sistemi të ri me një pagesë të vetme për fermat. Shtetet Anëtare që kanë hyrë në BE, më 1 maj 2004, marrin pjesë drejtpërdrejt në sistemin e ri. Ndryshime u janë bërë edhe masave për administrimin e krizave dhe klasifikimin mjedisor të fermave.

Shiko:

- Politikë-a e Përbashkët Bujqësore (CAP)

Organizma Gjenetiksht të Modifikuara (OMGJ) / Genetically modified organisms (GMOs)

OMGJ-të janë organizma me material gjenetik (ADN) të ndryshuar jo nga riprodhimi dhe/ose rikombinimi natyror, por nga prezantimi i një gjeni të modifikuar ose një gjeni nga një varietet ose lloj tjetër.

Legjislacioni Komunitar Europian për OMGJ-të ka ekzistuar që në 1990. Veprimi i Bashkimit Europian është përcaktuar për të mbrojtur shëndetin dhe mjedisin në vazhdimësi të rregullave të një tregu të vetëm. Bashkimi Europian ka përcaktuar me ligj përdorimin, shpërndarjen, tregtinë dhe prejardhjen e OMGJ-ve. Ka miratuar gjithashtu masa për zbatimin e dispozitave për transportin ndërkufitar të OMGJ-ve, të parashikuara në Protokollin e Kartagjenës për sigurinë biologjike.

Në vitin 2004, pas pesë vjetësh pa asnjë leje të re marketingu, Komisioni Europian dha lejen për hedhjen në treg të disa ushqimeve të caktuara OMGJ, ose të ushqimeve që përmbajnë OMGJ dhe për marketingun dhe kultivimin e farave OMGJ.

Përpara hedhjes në treg, OMGJ-të duhet t'i nënshtrohen në fillim, një procesi vlerësimi shumë të rreptë. Pastaj ato etiketohen në përputhje me kërkesat ligjore të etiketimit dhe gjurmimit të produkteve.

Laboratori i referencës për vlerësimin e OMGJ-ve është Qendra Kërkimore e Përbashkët (QKP) e Komisionit Europian. Kjo qendër bashkërendon rrjetin Europian të laboratorëve të referencës për OMGJ-të dhe punon për zbulimin, identifikimin dhe shprehjen në terma sasiorë të pranisë së OMGJ-ve në ushqime. Edhe Autoriteti Europian për sigurinë ushqimore jep mendime shkencore për OMGJ-të.

Shiko:

- Agjenci të Bashkimit Europian

- Zhvillim i qëndrueshëm
- Mjedis
- Mbrojtje e konsumatorëve
- Siguri ushqimore

Orientime të Përgjithshme të Politikës Ekonomike (OPPE) / Broad economic policy guidelines (BEPG)

Orientimet e Përgjithshme të Politikës Ekonomike (OPPE), të cilat marrin formën e një rekomandimi të Këshillit, janë hallka qendrore në bashkërendimin e politikave ekonomike të Shteteve Anëtare. Ato sigurojnë mbikëqyrjen shumëpalëshe të prirjeve ekonomike të Shteteve Anëtare. Qysh prej vitit 2003, OPPE-të janë publikuar për një periudhë trevjeçare.

Baza ligjore për to është neni 121 TFBE (ish neni 99 i Traktatit themelues të Komunitetit European). Këshilli European, duke vepruar përmes shumicës së cilësuar, me këshillim të Komisionit European, nxjerr një draft për OPPE-në dhe ia raporton gjetjet e tij Këshillit European, i cili miraton një përfundim. Mbi bazën e këtij përfundimi, Këshilli European, duke vepruar përmes shumicës kualifikuese, miraton një këshillë që përcakton këto drejtime të përgjithshme. Parlamenti European informohet në lidhje me këtë këshillim.

Sipas Traktatit të Lisbonës, kur politikat ekonomike të Vendeve Anëtare nuk janë në përputhje me udhëzimet e përgjithshme të politikës ekonomike dhe/ose rrezikojnë të pengojnë funksionimin normal të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, Komisioni mund të paralajmërojë shtetin në fjalë. Këshilli, në bazë të rekomandimit të Komisionit, i paraqet shtetit rekomandimet e nevojshme. Këshilli, me kërkesë të Komisionit, mund t'i bëjë publike këto rekomandime.

Shiko:

- Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM)
- Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit

P

Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit / Stability and Growth Pact

Pakti i Stabilitetit dhe Zhvillimit (PSZ) është pjesë e fazës së tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (BEM), i cili filloi më 1 janar 1999. Qëllimi i këtij Pakti është të sigurojë që shtetet anëtare ruajnë disiplinën e tyre buxhetore, pas hyrjes së monedhës së vetme.

Në terma praktikë, pakti përfshin një Rezolutë të Këshillit Europian (miratuar në Amsterdam, më 17 qershor 1997) dhe dy Rregullore të Këshillit të datës 7 korrik 1997, që përcaktojnë rregulla të hollësishme teknike (njëra mbi mbikëqyrjen e pozicioneve buxhetore dhe bashkërendimin e politikave ekonomike dhe tjetra mbi zbatimin e procedurës së deficitit të tepërt). Pas diskutimeve për vënien në shfrytëzim të PSZ-së, në këto dy Rregullore janë bërë shtesa dhe ndryshime në muajin qershor 2005.

Në periudhën afatmesme, Shtetet Anëtare marrin përsipër të synojnë të ndjekin qëllimin për një buxhet të balancuar ose afërsisht të balancuar, si edhe t'i paraqesin Këshillit dhe Komisionit një program stabiliteti brenda datës 1 mars 1999 (dhe ta përditësojnë këtë program çdo vit). Në mënyrë të ngjashme, shteteve që nuk marrin pjesë në fazën e tretë të Bashkimit Europian Monetar, me fjalë të tjera atyre Shteteve Anëtare që nuk kanë futur në përdorim euron, u kërkohet që të paraqesin një program konvergjence.

Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit i hap rrugën Këshillit që të ndëshkojë çdo Shtet Anëtar, i cili nuk arrin të marrë masat e duhura për mbylljen e një deficitit të tepërt (procedura e deficitit të tepërt). Fillimisht ky ndëshkim do të kishte formën e një depozite pa interes me Komunitetin, por që mund të kthehet në gjobë, në qoftë se deficitit i tepërt nuk korrigjohet brenda dy viteve. Megjithatë, nuk ka asnjë rregull të fiksuar në lidhje me këto gjoba: ato i nënshtrohen një vlerësimi të rrethanave nga Këshilli.

Me Traktatin e Lisbonës janë bërë disa ndryshime në rishpëndrajen e pushteteve që kanë të bëjnë me kontrollin dhe respektimin e rregullave të Paktit të Stabilitetit. Komisioni ruan rolin e mbrojtësit të traktatit për sa i përket deficitit publik si pjesë e Paktit të Stabilitetit. Komisioni ka të drejtë të përgatisë një opinion për shtetin anëtar që ka deficit përtej normës. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, procedurat për sanksionet tashmë do të përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Komisionit dhe jo në formën e rekomandimit të thjeshtë sic ishte para miratimit të Traktatit. Këshilli i Ministrave mund të kundërshtojë nismën e ndërmarrë nga Komisioni.

Shiko:

- Kritere të konvergjencës
- Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM)
- Procedurë e deficitit të tepërt

Parim, -i i mosdiskriminimit / Non-discrimination principle

Synimi i këtij parimi është të sigurojë barazi në trajtimin e individëve, pavarësisht kombësisë, gjinisë, origjinës racore apo etnike, fesë apo besimit, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual.

Neni 18 TFBE (ish neni 12 i Traktatit të KE-së) ndalon çdo diskriminim mbi bazat e kombësisë. Sipas Traktatit të Amsterdimit, në Traktatin e KE-së është futur një nen 13

(aktualisht neni 19 TFBE), për të përforcuar garancinë e mos-diskriminimit, të parashikuar në Traktatet dhe për ta zgjeruar fushën vepruese të këtij parimi, në mënyrë që të mbulojë edhe rastet e cituara më lart.

Traktati i Lisbonës ka parashikuar se mosdiskriminimi përbën një nga vlerat kryesore europiane. Bashkimi ka qëllim që të promovojë paqen, vlerat dhe mirëqënien për qytetarët e tij. Për më tepër, më anë të politikave të tij, Bashkimi lufton përjashtimin social dhe diskriminimin dhe mbështet drejtësinë dhe mbrotjen sociale, barazinë gjinore, solidaritetin midis brezave dhe mbrotjen e të drejtave të fëmijëve. Me anë të Traktatit të Lisbonës Bashkimi angazhohet më qartazi në luftën kundër përjashtimit social dhe diskriminimin si edhe ndaj nxitjes së drejtësisë dhe mbrotjes sociale.

Shiko:

- Mundësi të barabarta
- Trajtim i barabartë i burrave dhe grave
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

Parim, ~i i proporcionalitetit / Proportionality principle

Sikurse edhe parimi i subsidiarititetit, parimi i proporcionalitetit rregullon ushtrimin e kompetencave të Bashkimit Europian, duke kërkuar të vendosë brenda kufijve të përcaktuar veprimin e kryer nga institucionet e Bashkimit Europian. Në bazë të kësaj norme, përfshirja e institucioneve duhet të kufizohet vetëm me ato veprime që janë të nevojshme për arritjen e objektivave të traktateve. Me fjalë të tjera, shkalla e veprimit duhet të përputhet me synimin e kërkuar.

Kjo do të thotë se Bashkimi Europian ka në gatishmëri forma të ndryshme të ndërhyrjes. Ai, në rastet kur efekti është i njëjtë, duhet të ndjekë atë qasje që u jep lirinë më të madhe shteteve anëtare dhe individëve.

Parimi i përpjestueshmërisë është parashtruar qartë në nenin 5, TFBE. Një protokoll për zbatimin e parimeve të subsidiarititetit dhe përpjestueshmërisë, që i është bashkëlidhur TKE-së nga Traktati i Amsterdemit, vendos kriteret për zbatimin e të dy këtyre parimeve. Traktati i Lisbonës nuk e ndryshon në mënyrë domethënëse parimin e proporcionalitetit.

Shiko:

- Shpërndarje e kompetencave
- Subsidiarititet

Parim, ~i parandalues / Precautionay principle

Koncepti i parimit parandalues është parashtruar, për herë të parë, në një komunikatë të Komisionit, të miratuar në shkurt 2000, në lidhje me përdorimin e parimit parandalues, në të cilën përkufizohet ky koncept dhe parashikohet se si duhet të zbatohet.

Ky tekst plotëson Dokumentin e Bardhë "Për sigurinë ushqimore" (janar 2000) dhe marrëveshjen e arritur në shkurt 2000 në Montreal, në lidhje me Protokollin e Kartagenës "Për biosigurinë".

Në këtë dokument Komisioni përcakton rastet e veçanta në të cilat është i zbatueshëm ky parim:

- Kur të dhënat shkencore janë të pamjaftueshme, jo konkluzive apo jo të sigurta;
- Kur një vlerësim paraprak shkencor tregon se mund të ketë një frikë të arsyeshme për pasoja mundësisht të rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve apo bimëve.

Në të dy rastet, rreziqet nuk përputhen me nivelin e lartë të mbrojtjes që kërkon Bashkimi Europian.

Në Komunikatë përcaktohen edhe tre rregullat që duhet të ndiqen për respektimin e parimit parandalues:

- Një vlerësim i plotë shkencor i realizuar nga një autoritet i pavarur, për të përcaktuar shkallën e pasigurisë shkencore;
- Një vlerësim i rreziqeve të mundshme dhe i pasojave të mosveprimit;
- Pjesëmarrje, në kushtet e transparencës maksimale, e të gjitha palëve të interesuara në studimin e masave të mundshme.

Komisioni Europian do të donte, gjithashtu, të theksonte se masat që vijnë si rezultat i përdorimit të parimit parandalues, mund të marrin formën e një vendimi për të vepruar ose për të mos vepruar, në varësi të nivelit të rrezikut që konsiderohet “i pranueshëm”. Bashkimi Europian e ka zbatuar këtë parim parandalues në fushën e Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht (OMGJ), për shembull, me miratimin e një moratoriumi për komercializimin e tyre në periudhën 1999-2004.

Shiko:

- Mbrojtje e konsumatorit
- Mjedisi
- Siguri ushqimore
- Organizma të Modifikuar Gjenetikisht (OMGJ)
- Shëndet publik

Parlamente kombëtare / National parliaments

Konferenca e Komiteteve të Çështjeve të Komunitetit Europian (KKCKE), e përbërë nga përfaqësues nga komitetet përkatëse të parlamenteve kombëtare dhe anëtarët e Parlamentit Europian, është mbledhur çdo 6 muaj që nga viti 1989.

Protokolli i Lisbonës siguron në Traktat një bazë bashkëpunimi midis parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit Europian. Së bashku, ata do të përcaktojnë organizimin dhe promovimin e bashkëpunimit ndërparlamentar efektiv dhe të rregullt. KKCKE mbulon detyrat e mëposhtme:

- mund të komunikojë me Parlamentin Europian, Këshillin dhe Komisionin;
- nuk mund të lidhë parlamentet kombëtare, ose “paragjykojë pozicionet e tyre”;
- promovon shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira;
- mund të organizojë konferenca ndërparlamentare.

Dy atributet e para zbatoheshin edhe përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Dy të tjerat janë të reja, dhe zyrtarizojnë aktivitetet e zhvilluara nga KKCKE.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Mاستrihtit (1993), Bashkimi Europian ka fituar kompetenca në fushat që më përpara i takonin nivelit kombëtar, si drejtësia dhe punët e brendshme. Për këtë arsye, rëndësia e shkëmbimeve ndërmjet parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit Europian u theksua në një Deklaratë për Rolin e Parlamenteve Kombëtare në Bashkimin Europian.

Në këtë deklaratë që iu bashkëngjiti Traktatit të Mاستrihtit, u kërkua nga qeveritë anëtare që t'u dërgonin në kohën e duhur parlamenteve të tyre, propozimet ligjore të Komisionit Europian për t'u informuar dhe për një shqyrtim të mundshëm të tyre. Deklarata këshillon, gjithashtu, zgjerimin e kontakteve midis Parlamentit Europian dhe parlamenteve kombëtare, për të lehtësuar përfshirjen e parlamenteve kombëtare në procesin e Komunitetit dhe ushtrimit e (është e paplotë si fjali)

Me Traktatin e Amsterdamin, Traktatit të Bashkimit Europian i është bashkëlidhur në formën e një shtojce një Protokollit “Për rolin e parlamenteve kombëtare”. Sipas këtij protokollit, të gjithë dokumentet e Komisionit Europian për qëllime konsultimi (dokumentet e gjelbra dhe të bardha dhe komunikatat) duhet t’u përcillen menjëherë parlamenteve kombëtare.

Parlamentet kombëtare kanë një periudhë 6-javore për të diskutuar një propozim ligjvënës, që pas datës që Komisioni e vë në dispozicion të Parlamentit dhe Këshillit Europian, deri në ditën kur propozimi vihet në axhendën e Këshillit.

Konferenca e Komiteteve të Çështjeve të Komunitetit Europian ka dhe kompetencën t’u japë institucioneve të Bashkimit Europian çdo ndihmë që e konsideron të përshtatshme dhe të shqyrtojë çdo propozim për një akt legjislativ që lidhet me krijimin e një zone lirie, sigurie dhe drejtësie, që mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Traktati i Lisbonës parashikon një rol më të qartë dhe më konkret për parlamentet kombëtare në veprimtarinë e Bashkimit. Protokollit i parë i Traktatit të Lisbonës i kushtohet rolit të parlamenteve kombëtare. Përfshirja më e madhe e parlamenteve kombëtare parashikohet edhe në parathënien e Traktatit, sipas të cilës shtetet anëtare dëshirojnë “të nxisin përfshirjen më të madhe të parlamenteve kombëtare”

Sipas Traktatit të Lisbonës, përfshirja e parlamenteve kombëtare konsiston në të drejtën e tyre për të:

- marrë informacion dhe projektligje drejtpërdrejtë nga institucionet e BE-së;
- siguruar zbatimin e parimit të subsidiaritetit;
- marrë pjesë në vlerësimin e politikave të BE-së në fushën e drejtësisë, sigurisë dhe lirisë;
- monitoruar dhe kontrolluar Europolin;
- qenë të përfshirë në vlerësimin e punës së Erojust;
- qenë të njoftuar për aplikimet e vendeve që duan të aderojnë në BE;
- bashkëpunuar me parlamentet e tjera dhe me Parlamentin evropian;
- marrë pjesë në rishikimin e traktateve.

Shiko:

- Parlamenti Europian
- Subsidiaritet
- Transparencë e procedurave të Këshillit Europian

Parlamenti Europian / European Parliament

Parlamenti Europian është asamble e përfaqësuesve të 492 milion qytetarëve të Bashkimit Europian. Që nga viti 1979, ata janë zgjedhur nëpërmjet votimit të përgjithshëm dhe të drejtpërdrejtë dhe me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, nga 185, numri i tyre u ul në 750 përfaqësues të shpërndarë mes shteteve anëtare, në përputhje me popullsinë e tyre.. Funkcionet kryesore të Parlamentit Europian janë si vijon:

- kompetenca legjislativ: në shumicën e rasteve, Parlamenti Europian ka, të përbashkëta, tagra legjislativ me Këshillin Europian, sidomos për procedurën si bashkëvendimmarrje;
- kompetenca buxhetore: Parlamenti Europian ka, të përbashkëta, tagra buxhetore me Këshillin, gjatë votimit të buxhetit vjetor, duke i dhënë këtij buxheti fuqi vepruese, përmes nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Parlamentit dhe gjatë kontrollit mbikëqyrës të zbatimit të tij;
- kompetenca të kontrollit mbi Institucionet e Bashkimit Europian, sidomos mbi

Komisionin Europian. Parlamenti mund të japë ose jo miratimin për emërimin e komisionarëve dhe ka tagrin për largimin e Komisionit Europian, si organ, përmes miratimit të një mocioni censure. Ushtron edhe tagrin e kontrollit mbi veprimtaritë e Bashkimit Europian, përmes pyetjeve me shkrim ose me gojë që mund t'ia drejtojë Komisionit dhe Këshillit Europian. Ai mund të ngrejë komisione të përkohshme dhe komisione hetimore, objekti i të cilëve nuk kufizohet, medoemos, me veprimtaritë e institucioneve të Komunitetit, por mund të përfshijë edhe masat e marra nga Shtetet Anëtare, me qëllim vënien në zbatim të politikave të Komunitetit Europian.

Traktati i Amsterdimit (në fuqi qysh prej vitit 1999), i ka rritur kompetencat e Parlamentit Europian, duke e zgjeruar ndjeshëm procedurën e bashkëvendosjes. Edhe Traktati i Nisës, i cili hyri në fuqi në vitin 2003, e ka rritur rolin e Parlamentit Europian si bashkëligjvënës, duke e zgjeruar procedurën e bashkëvendosjes dhe i ka dhënë Parlamentit të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës së Komuniteteve Europiane.

Me ndryshimet e Traktatit të Lisbonës, Parlamenti Europian do të ketë një marrëdhënie më të fortë me liderët e BE-së sepse ai do të përzgjedhë Presidentin e Komisionit, mbi bazën e propozimeve që duhet të marrin parasysh rezultatit e zgjedhjeve për Parlamentin Europian, dhe kolegjin e komisionerëve, në gjirin e të cilit ulet dhe Përfaqësuesi i Lartë i Politikës së Jashtme dhe të Sigursisë. Gjithashtu, ata do të përgjigjen përpara Parlamentit Europian.

Traktati i Lisbonës rrit në mënyrë të konsiderueshme rolin e Parlamentit Europian nëpërmjet procedurës së vendimmarrjes së përbashkët, e cila njihet si procedura e zakonshme ligjvënese në të cilën si Parlamenti, ashtu edhe Këshilli kanë të njejtin rol në miratimin e ligjeve. Numri i fushave për të cilat ligjet do të miratohen me bashkëvendimmarrje është rritur shumë dhe aty përfshihen fusha të tilla si bujqësia, transporti, fondet strukturore, drejtësia dhe punët e brendshme. Parlamenti tashmë do të luajë një rol të madh dhe në rishikimin e ardhshëm të Traktateve.

Shiko:

- Procedurë e pëlqimit
- Procedurë e vendimmarrjes së përbashkët
- Procedurë e konsultimit
- Procedurë e bashkëpunimit
- Institucione Europiane
- Parti politike Europiane
- Komisione parlamentare
- Parlamente kombëtare
- Avokati i Popullit
- Statuti për deputetët e Parlamentit Europian
- Procedurë zgjedhore standarde për Parlamentin Europian

Parti politike europiane / European political parties

Rregullorja “Për rregulloret për partitë politike në nivel Europian dhe normat që rregullojnë financimin e tyre” ka hyrë në fuqi në vitin 2004. Në të përcaktohen kushtet për njohjen e një partie Europiane, prej nga lind e drejta për të përfitur financim nga Komuniteti:

- Duhet të ketë personalitet juridik në Shtetin Anëtar ku ka selinë;
- Duhet të ketë përfaqësim, në të paktën një të katërtën e Shteteve Anëtare, me deputetë të Parlamentit Europian apo parlamenteve kombëtare ose rajonale, ose të ketë marrë, në të paktën një të katërtën e Shteteve Anëtare, të paktën tre për qind të votave të hedhura në secilin prej këtyre Shteteve Anëtare në zgjedhjet më të fundit të Parlamentit Europian;

- Duhet të respektojë parimet e Bashkimit Europian;
- Duhet të ketë marrë pjesë në zgjedhjet për Parlamentin Europian, ose të ketë shprehur synimin për të marrë pjesë në to.

Janë vendosur edhe kushtet që duhen përmbushur për të fituar të drejtën për të marrë fonde nga Komuniteti Europian (8,4 milion në vit): duhet të deklarojë burimet e financimit dhe disa burime të caktuara janë të ndaluara. Fondet nga Komuniteti duhet të përdoren vetëm për të mbuluar shpenzimet e lidhura me programin e vet politik dhe, në asnjë rrethanë, nuk mund të përdoren për të financuar partitë politike kombëtare.

Partia Popullore Europiane (PPE), Partia e Socialistëve Europianë (PSE), Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropën (ALDE), Partia e Blertë Europiane (PBE) dhe E Majta e Bashkuar Europiane (EMBE) janë vetëm disa prej partive të ngritura me bazë Europiane.

Shiko:

- Parlamenti Europian
- Procedurë zgjedhore standarde për Parlamentin Europian
- Statuti për deputetët e Parlamentit Europian

Partnerë socialë / Social partners

Komisioni duhet të këshillohet me partnerë të ndryshëm socialë, në rastet kur dëshiron të paraqesë propozime në këtë fushë (neni 154 TFBE, ish neni 138 i Traktatit të Komunitetit Europian). Dialogu social ndodh nëpërmjet tri organizatave kryesore ndërsektoriale që përfaqësojnë partnerët socialë në nivel Europian:

- Konfederata e Sindikatave Europiane (KSE);
- Bashkimi i Industrive të Komunitetit Europian (BUSINESSEUROPE);
- Qendra Europiane për Ndërmarrjet me Pjesëmarrje Publike (QENPP)

Krahas këtyre tri organizatave ndërsektoriale Europiane, ka edhe shumë grupe të tjera shoqërore-profesionale, të cilat përfaqësojnë interesa specifike ose sektoriale.

Puna e Komisionit Europian synon që të nxitë konsultimin e partnerëve socialë dhe të marrë çdo masë të nevojshme, për të lehtësuar dialogun e tyre, duke siguruar mbështetje të ekuilibruar për palët e interesuara.

Përpara paraqitjes së propozimeve në fushën e politikës sociale, Komisioni Europian këshillohet me partnerët socialë në lidhje me drejtimin e mundshëm të masave të BE-së.

Partnerët socialë luajnë, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në Komision Ekonomik dhe Social Europian, ku marrin pjesë së bashku me përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile. Neni 152 TFBE parashikon në mënyrë të qartë partnerët socialë, dialogun social dhe samitin social trepalësh.

Shiko:

- Komisioni Ekonomik dhe Social Europian (KESE)
- Dialog social
- Politikë sociale
- Marrëveshje për Politikën Sociale

Partneritete për anëtarësim (aderim) / Accession partnership

Partneritetete për anëtarësim janë instrumente strategjike të paraanëtarësimin, që përcaktojnë nevojat e veçanta të vendeve candidate për të cilat duhet të jepet asistencë e paraanëtarësimin dhe që ofrojnë një kuadër për:

- Prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme dhe kushtet e përcaktuara për secilin vend kandidat, mbi bazën e kriterëve të anëtarësimit (kriteret e Kopenhagenit), në përputhje me mendimin e Komisionit në lidhje me kërkesën për anëtarësim që ka paraqitur vendi kandidat;
- Asistenca e paraanëtarësimit.

Për secilin vend kandidat, krijohet një partneritet për anëtarësim, për të ofruar drejtim dhe nxitje gjatë përgatitjeve për anëtarësimin. Për këtë qëllim, secili vend kandidat harton një Program Kombëtar për Miratimin e Acquis-së (PKMA), i cili përcakton afatet kohore për hyrjen në fuqi të partneritetit. Secili vend kandidat përgatit edhe një plan veprimi për fuqizimin e kapaciteteve të veta administrative dhe gjyqësore.

Partneriteti i anëtarësimit mund të revizionohet në dritën e zhvillimeve të reja, sidomos nëse njëjtëson prioritete të reja gjatë procesit të paraanëtarësimit.

Shiko:

- Kriteret e anëtarësimit
- Vende candidate
- Acquis e BE-së
- Asistencë e paraanëtarësimit
- Strategji e paraanëtarësimit

Patentë, ~a e Bashkimit European / EU Patent

Në korrik 2000 Komisioni European propozoi krijimin e një Patente Komuniteti, për t'u dhënë mundësi shpikësve të marrin një patentë të vetme, që të jetë ligjërish e vlefshme në të gjithë Bashkimin European. Një Patentë e Vetme Komuniteti do ta zvogëlonte ndjeshëm barrën mbi bizneset dhe koston e marrjes së një patente, duke e bërë kështu Evropën më konkurruese dhe duke nxitur risitë.

Përfitimet e një sistemi të patentave të Komunitetit do të ishin:

- Mbrojtje e thjeshtuar e shpikjeve në të gjithë territorin e Bashkimit European, falë një procedure të vetme dhe lëshimit të patentave nga një drejtori e Zyrës Europiane të Patentave në Mynih;
- Një zvogëlim i konsiderueshëm i kostove të nxjerrjes së patentave, sidomos të atyre kostove që shoqërojnë përkthimin dhe depozitimin;
- Një siguri më të madhe juridike, falë një sistemi të vetëm e të centralizuar për trajtimin e mosmarrëveshjeve përpara një gjykate Europiane për patentat.

Sistemi i propozuar do të shmangte edhe pengesat që shoqërojnë sistemin e patentave Europiane, i cili ka ekzistuar qysh prej vitit 1973. Patenta Europiane është një subjekt i vetëm deri në çastin e lëshimit të saj, kur shndërrohet në aq patenta kombëtare, sa ka qenë edhe numri i vendeve të cituara në kërkesë. Pas nxjerrjes së saj, Patenta Europiane u nënshtrohet ligjeve kombëtare dhe nuk ka asnjë autoritet të përbashkët për të harmonizuar jurisprudencën në nivel European.

Megjithatë, synimi i patentës së Bashkimit nuk është të zëvendësojë sistemet kombëtare ekzistuese dhe sistemin European, por të bashkëekzistojë me to. Shpikësit do të jenë të lirë të zgjedhin atë mbrojtje të patentave që do të ishte më e duhura.

Krijimi i një sistemi të patentave të Bashkimit është një çështje delikate, sepse deri tani, ky projekt është bllokuar gjithmonë në Këshillin e Ministrave. Pengesa më e madhe bllokuese është çështja e përkthimit të pretendimeve të patentave. Rrjedhimisht, është e pamundur të dihet se kur do të fillojë të vihet në dispozicion Patenta e Bashkimit.

Shiko:

- Agjenci të Bashkimit European
- Pronë intelektuale

Personalitet juridik i Bashkimit / Legal personality of the Union

Të dy Komunitetet (Komuniteti European dhe Euratomi) që përbëjnë Bashkimin European kanë, secili, personalitet juridik. Megjithatë, Traktati i Bashkimit European nuk përmban asnjë dispozitë për personalitetin juridik të Bashkimit European, edhe pse BE-ja përbëhet nga dy komunitete dhe dy fusha të bashkëpunimit ndërqeveritar, që janë Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS) dhe Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor për Çështjet Penale.

Komuniteti European ka tagrin për të lidhur dhe negociuar marrëveshje në përputhje me kompetencat e jashtme të tij, për t'u anëtarësuar në një organizatë ndërkombëtare dhe për të pasur delegacione në vendet jo anëtare.

Çështja e personalitetit juridik të Bashkimit European është ngritur në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare, sidomos në lidhje me tagrin për të lidhur traktate apo për t'u bërë palë në marrëveshje apo konventa. Bashkimi European nuk ka kompetenca të institucionalizuara për bërjen e traktateve, domethënë nuk e ka cilësinë institucionale për të lidhur marrëveshje me vendet jo anëtare. Megjithatë, ai ndjek objektivat e vet në nivel ndërkombëtar, qoftë kjo përmes lidhjes së marrëveshjeve të Këshillit të Bashkimit European, apo përmes deklarimit të qëndrimit të vet në arenën ndërkombëtare, sidomos në lidhje me PPJS-në.

Traktati i Lisbonës i njeht personalitetin juridik Bashkimit European, duke i njohur kështu të drejtën për të hyrë në marrëdhënie juridike më të tretët. Nëpërmjet dhënies së personalitetit juridik, Traktati i jep të drejtën Bashkimit për tu bërë palë në organizata ndërkombëtare, dhe për të qenë subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe i gjykatave ndërkombëtare. Dhënia e personaliteti juridik bëhet në përputhje me kompetencat e BE-së duke përfshirë kompetencat e tij dhe/ose të shteteve anëtare për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare.

Shiko:

- Komuniteti European
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
- Shtylla të Bashkimit European
- Korniza Institucionale e Përbashkët

Perspektivë, ~a financiare / Financial perspective

Perspektiva financiare është programi buxhetor i Bashkimit për një periudhë shtatëvjeçare. Është produkt i një marrëveshjeje ndërinstitucionale midis Parlamentit European, Këshillit dhe Komisionit dhe në të vendoset vëllimi më i madh dhe përbërja e shpenzimeve publike të parashikueshme të Bashkimit. Rregullohet çdo vit nga Komisioni European për të marrë në konsideratë çmimet dhe zhvillimet e PKB-së së Bashkimit. Megjithatë, duhet theksuar se perspektiva financiare nuk është buxhet shumëvjeçar, duke qenë se është procedura e buxhetit vjetor ajo që ka rëndësi për përcaktimin e vlerave faktike të shpenzimeve dhe për zbrëthimin midis titujve të ndryshëm të buxhetit.

Deri tani, janë arritur katër marrëveshje ndërinstitucionale të këtij lloji, e para në vitin 1988, e dyta në 1992, e treta në 1999 dhe e katërta në vitin 2006:

- Perspektiva financiare 1988-1992 (paketa Delors I);
- Perspektiva financiare 1993-1999 (paketa Delors II);
- Perspektiva financiare 2000-2006;
- Perspektiva financiare 2007-2013.

Kjo kornizë financiare shumëvjeçare ka për synim sigurimin që, shpenzimet të bëhen në mënyrë të rregullt, duke qëndruar gjithmonë brenda kufijve të burimeve të veta të Bashkimit Europian. Në të vendoset një tavan për shpenzimet vjetore në sferat kryesore të aktivitetit të Bashkimit për një periudhë që është të paktën pesëvjeçare.

Edhe me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës unanimiteti do të vazhdojë të përdoret për përcaktimin e kuadrit financiar. Kjo do të thotë që shtetet do të vazhdojnë të kenë të drejtën e vetos në:

- përcaktimin dhe vendosjen e kontributeve të tyre në buxhetin e Bashkimit
- miratimin e kuadrit financiar të BE-së

Megjithatë, futja e "klausolave urë" në këtë fushë do të bëjë që në disa raste të përdoret shumica e cilësuar në vend të unanimitetit duke e bërë kështu më fleksibël procesin e përcaktimit të kuadrit financiar të BE-së.

Shiko:

- Kohezion ekonomik, social dhe territorial
- Zgjerimi
- PHARE
- Strategji e paraanëtarësimit

Peshim, ~i i votave në Këshillin e Bashkimit Europian / Weighting of votes in the Council

Votimi me shumicë të cilësuar në Këshillin e Bashkimit Europian mbështetet në parimin e ponderimit të votave. Sipas sistemit të tanishëm të votës së ponderuar, Shtetet Anëtare me popullsi më të madhe kanë 27-29 vota, vendet me popullsi të mesme kanë 7-14 vota, ndërsa vendet e vogla kanë 3 ose 4 vota. Që të miratohet, një vendim kërkon të paktën 235 vota, nga 245 vota gjithsej.

Mekanizmi i ponderimit është rezultat i kompromisit midis Shteteve Anëtare që, edhe pse të barabarta në ligj, ndryshojnë në shumë aspekte të ndryshme. Numri i votave që i jepet një Shteti Anëtar përcaktohet nga madhësia e popullsisë, pas një rregullimi që çon një mbipërfaqësim relativ të vendeve me popullsi të vogël.

Në Evropën me 15 Shtete Anëtare, ky sistem u jepte legjitimitet vendimeve, me miratimin me shumicë të cilësuar, mbështetur në marrëveshjen më të gjerë të mundshme. Vendet e mëdha nuk mund të bëheshin bashkë për t'i mënjanuar në pakicë vendet e vogla dhe anasjelltas.

Nisur nga synimi për zgjerim, Konferenca Ndërqeveritare e vitit 2000 (KN) nisi një rishikim të sistemit të votës së ponderuar, për t'u kujdesur që pesha relative e vendeve të vogla dhe të mesme, të mos ishte në shpërpjesëtim me popullsitë e tyre. Si rezultat, votat e dhëna vendeve më të populluara janë rritur në krahasim me të tjerët, në mënyrë që të ruhet legjitimiteti i vendimeve të Këshillit Europian sa i takon përfaqësimit demografik. Ponderimi i tanishëm i votave, i mishëruar në Traktatin e Nisës, ka hyrë në fuqi, më 1 nëntor 2004.

Shtetet Anëtare kanë një numër të caktuar votash, sipas peshës së tyre demografike. Traktati i Lisbonës fut konceptin e shumicës së dyfishtë e cila do të llogaritet sipas dy kritereve:

- Shteti: 55% e shteteve të BE (në 27, 15 Shtetet Anëtare)
- Popullsia: 65% e popullsisë së BE-së.

Një pakicë bllokimi duhet të përfshijë së paku 4 Shtete Anëtare.

Sistemi me shumicë të dyfishtë është më demokratik dhe më efektiv në krahasim me sistemin e parashikuar nga Traktati i Nicës (2001), pasi lehtëson krijimin e shumicës dhe rrjedhimisht edhe vendimmarrjen.

Shiko:

- Shumicë e dyfishtë
- Kompromisi i Janinës
- Shumicë e cilësuar
- Shumicë e cilësuar e përforcuar
- Unanimitet

Peticione / Petitions

E drejta për peticion është një e drejtë që e gëzon çdo shtetas i Bashkimit European, si dhe e çdo personi fizik apo juridik që është rezident apo e ka selinë të regjistruar në një Shtet Anëtar, për të paraqitur një kërkesë ose ankesë përpara Parlamentit European, subjekt në një çështje që është brenda sferës së veprimtarisë së Bashkimit dhe e prek atë në mënyrë të drejtpërdrejtë (nenet 24 TFBE dhe 227 TFBE, ish nenet 21 dhe 194 të Traktatit themelues të Komunitetit European).

Komisioni Parlamentar European për peticionet merr në konsideratë nëse kërkesa të tilla janë të pranueshme. Kur e sheh të përshtatshme, ai mund t'ia parashtrijë çështjen Avokatit të Popullit. Gjatë hartimit të një mendimi mbi një peticion të vlerësuar si të pranueshëm, ai mund t'i kërkojë Komisionit European t'i japë dokumente ose informacion.

Peticioni mund t'u dërgohet edhe komisioneve të tjera parlamentare për informim, në mënyrë që ato të veprojnë lidhur me çështjen. Në disa raste të jashtëzakonshme, Komisioni për Peticionet mund t'i paraqesë për miratim një raport Parlamentit European, në seancë plenare, apo për të kryer një mision fakt-mbledhës.

Shiko:

- Qytetari e Bashkimit European
- Parlamenti European
- Avokati i Popullit

Përbërje, ~a e Komisionit European / Composition of the European Commission

Qysh në fillim të tij, Komisioni European gjithmonë përbëhej nga dy shtetas të secilit Shtet Anëtar me popullsi më të madhe dhe një shtetas të secilit prej Shteteve të tjera Anëtare. Në BE-në e zgjeruar, përbërja e Komisionit është vendosur në qendër të një debati të konsiderueshëm.

Përbërja e Komisionit European është çështje thelbësore, sepse vendoset për numrin më të favorshëm të komisionerëve të nevojshëm për të garantuar legjitimitetin, përgjegjësinë kolektive dhe efikasitetin e një institucioni, qëllimi i të cilit është të prezantojë interesin e përgjithshëm me pavarësi të plotë. Koncepti i përgjegjësisë kolektive ka rëndësi thelbësore. Ai është një tipar karakteristik i strukturës së Komisionit European dhe do të thotë që pozicionet e miratuara nga Komisioni European, pasqyrojnë pikëpamjet e Komisionit European si një i tërë dhe jo të anëtarëve të veçantë. Me perspektivën e zgjerimit të ardhshëm, ekziston frika që një rritje në numrin e komisionerëve, do të çojë në nacionalizimin e funksionit të tyre në dëm të përgjegjësisë kolektive. Në të kundërt, nëse numri do të kushtëzohet, ekziston frika që disa shtete nuk do të përfaqësohen brenda Komisionit European si të tilla.

Traktati i Nisës, që ishte rezultat i Konferencës Ndërqeveritare 2000, ofronte një zgjidhje kalimtare, duke e kufizuar numrin me një komisioner për çdo Shtet Anëtar, duke filluar me Komisionin 2004-2009. Ekzekutivi i tanishëm European, i kryesuar nga ish-Kryeministri portugez, José Manuel Barroso, përbëhet, rrjedhimisht, nga 27 komisionerë. Në 2009, Komisionit mori mandatin e ri pesë-vjeçar dhe José Manuel Barroso u rikonfirmua President

i tij. Protokollin për Zgjerimin, që i është bashkëlidhur Traktatit të Nisës, thotë se, duke filluar nga data kur merr detyrën Komisioni i parë pas datës së anëtarësimit të Shtetit Anëtar të njëzeteshtatë (domethënë, në parim, duke filluar në nëntor 2009), numri i anëtarëve të Komisionit European do të jetë më pak se numri i Shteteve Anëtare. Atëherë, numri faktik do të vendoset me unanimitet nga Këshilli European.

Aktualisht, Traktati i Lisbonës nuk do ta ndryshojë numrin e komisionerëve (27, po aq sa dhe numri i shteteve anëtare të BE-së). Megjithatë, Traktati parashikon që nga 1 nëntori i vitit 2014 numri i komisionerëve do të reduktohet në dy të tretën të numrit të vendeve anëtare. Çka do të thotë që jo gjithnjë shtetet anëtare do të kenë komisioner, ato do të përfaqësohen me sistem rotacioni.

Një ndryshim tjetër përse i përket përbërjes së Komisionit është se Përfaqësuesja e Lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë është njëkohësisht dhe Komisionerja për marrëdhëniet me jashtë dhe një nga zëvendës presidentët e Komisionit.

Shiko:

- Zgjerim
- Komisioni European
- Presidenti i Komisionit European
- Peshim votave në Këshill

Përfaqësuesi i lartë i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë / High Representative for the CFSP

Me Traktatin e Amsterdamin (miratuar në 1997) u krijua një post i ri i quajtur Përfaqësuesi i lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS). Ky post mbahet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit, detyra e të cilit është të ndihmojë Presidencën e Bashkimit në çështjet që lidhen me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Ai/ Ajo që mban këtë post, njihet edhe si “Z/Znj PPJS” (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë). Përfaqësuesi i lartë i lejon Bashkimit European të shprehet me koherencë dhe transparencë në skenën ndërkombëtare, duke i dhënë atij një fytyrë dhe zë të dallueshëm.

Përfaqësuesi i lartë ndihmon edhe në formulimin, përgatitjen dhe zbatimin e vendimeve të politikës nga Këshilli European. Ai ose ajo mund të krijojë dialog politik me palë të treta në emër të Këshillit European, me kërkesën e Presidencës.

Përgjegjësia për drejtimin e Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit bie mbi Zëvendëssekretarin e Përgjithshëm.

Pozicioni i Përfaqësuesit të lartë është forcuar në mënyrë të ndjeshme me Traktatin e Lisbonës. Përfaqësuesi i Lartë është përfaqësuesi i Bashkimit për marrëdhëniet me jashtë dhe sigurinë dhe ky pozicion është tashmë i veçantë nga ai i sekretarit të përgjithshëm të Këshillit. Ky pozicion është konsideruar si me tre koka duke qenë se përfshin:

- Përgjegjësitë që më parë i takonin Sekretarit të përgjithshëm/Përfaqësuesit të lartë të Këshillit;
- Përgjegjësitë për presidencën 6 mujore për sa i përket PJPS përfshirë dhe drejtimin e Këshillit të çështjeve të jashtme dhe përfaqësimin e BE-së në marrëdhëniet me jashtë.;
- Përgjegjësitë e komisionerit dhe Zëvendëspresidentit për të siguruar përputhje në politikën e jashtë të BE.

Në ushtrimin e këtyre detyrave që kanë për qëllim unifikimin dhe vazhdimsinë e politikës së jashtme të BE-së, Përfaqësuesi i lartë së bashku me Këshillin, do të ndihmohet nga Shërbimi European për Marrëdhëniet me Jashtë.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Këshilli i Bashkimit European
- Komisioni European
- Shërbimi European për Marrëdhëniet me Jashtë

Përgatitje, ~a profesionale / Vocational training

Politika e formimit profesional mbështetet në nenin 166 TFBE (ish neni 150 i Traktatit themelues të Komunitetit European), që parashikon se: “Komuniteti zbaton një politikë të formimit profesional, e cila mbështet dhe plotëson punën e Shteteve Anëtare, duke respektuar tërësisht përgjegjësinë e Shteteve Anëtare për përmbajtjen dhe organizimin e formimit profesional”.

Formimi profesional përbën një element thelbësor të Strategjisë së Lisbonës, që jep ndihmesë në punësim. Pas nismës së Bryzhit, të marrë nga nëpunësit civilë të nivelit të lartë përgjegjës për formimin profesional (tetor 2001), nisi një proces i rritur bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe të formimit profesional. Deklarata e Kopenhagenit (2002) dhe Komunikata e Mastrihtit (2004) kanë rikonfirmuar prioritetet e transparencës, njohjes dhe cilësisë së trajnimit dhe kanë parashtruar prioritetet në nivel kombëtar.

Janë përpiluar dy skema të rëndësishme: “Europass-Training” (1998), e cila përshkruan aftësitë e përfuara nga trajnimi jashtë vendit, dhe “Europass” (2004), e cila ndërthur pesë dokumente që synojnë ofrimin e një pamjeje të qartë dhe të thjeshtë të kualifikimeve dhe të aftësive të qytetarëve në mbarë Evropën.

Programi sektorial “Leonardo da Vinci”, si pjesë e programit të veprimit për arsimim dhe mësim gjatë gjithë jetës, është një mjet financimi për veprimtaritë e formimit. Ai kërkon të mbështesë dhe plotësojë punën e bërë nga Shtetet Anëtare, përmes nxitjes së partneritetit dhe lëvizshmërisë midis vendeve, novacionit dhe cilësisë së formimit, si edhe përmes dimensionit European të sistemeve dhe praktikës së formimit.

Agjencitë dhe organet Europiane, aktive në fushën e formimit, janë:

- Qendra Europiane për Zhvillimin e Formimit Profesional (CEDEFOP), me qendër në Selanik, e krijuar në vitin 1975;
- Fondacioni European për Trajnimin, Torino, i krijuar në vitin 1994;
- Komiteti Këshillimor për Formimin Profesional, i ngritur në vitin 2004 për ta ndihmuar nga Komisioni European në realizimin e politikës së tij.

Shiko:

- Arsimimi
- Agjenci të Bashkimit European
- Rini

Përgjegjësi, ~a mjedisore / Environmental liability

Përgjegjësia mjedisore është një zbatim i parimit “ndotësi paguan”, i parashtruar në Traktatin themelues të Komunitetit European. Kuadri organizativ për zbatimin e këtij parimi jepet në Direktivën 2004/35/KE.

Ky parim zbatohet për dëmin mjedisor dhe rrezikun e dëmit që lind nga veprimtaritë tregtare, pasi është e mundur të konstatohet një lidhje shkak-pasojë midis dëmit dhe veprimtarisë në fjalë. Dëmi mjedisor përkufizohet si dëm i drejtpërdrejtë ose i tërthortë që i shkaktohet mjedisit, florës dhe faunës ujore dhe habitateve natyrore të mbrojtura nga rrjeti “Natyra

2000”, si edhe kontaminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i dherave që mund të sjellë një rrezik të rëndë për shëndetin e njeriut.

Janë krijuar dy sisteme përgjegjësie: një sistem në kuadër të të cilit nuk ka nevojë të provohet fajti dhe një sistem, në të cilin duhen paraqitur prova të fajtit ose të neglizhencës. Sistemi i parë zbatohet për veprimtaritë tregtare të rrezikshme, ose me mundësinë për të qenë të rrezikshme të renditura në legjislacionin e Bashkimit. Në këtë rast, subjekti mund të mbajë përgjegjësi edhe nëse nuk ka bërë asnjë faj. Sistemi i dytë zbatohet për të gjitha veprimtaritë e tjera tregtare në kuadër të të cilave janë dëmtuar, ose janë në rrezik të madh dëmtimi, speciet dhe habitatet natyrore të mbrojtura nga ligjet e Kashkimit Europian. Në këtë rast, subjekti nuk mban përgjegjësi nëse nuk ka bërë faj ose nëse nuk ka qenë neglizhent.

Shiko:

- Politikë për ndërmarrjet
- Mjedis
- Natyra 2000

Politikë, ~a e fqinjësisë / Neighbourhood Policy

Politika Europiane e Fqinjësisë (PEF) kërkon të vendosë marrëdhënie të veçanta me vendet fqinje në Evropën Lindore, Mesdheun e Jugut dhe Kaukazin e Jugut, për të cilët anëtarësimi nuk është ende në perspektivë. Kjo politikë është futur në zbatim qysh në vitin 2003, për të ndarë përfitimet e zgjerimit me vendet fqinje dhe për të evituar lindjen e përçarjeve të reja. Kjo politikë bën pjesë në Strategjinë Europiane për Siguri.

PEF-ja përqendrohet në nxitjen e demokracisë, lirisë, prosperitetit, sigurisë dhe stabilitetit, si edhe mbështetjen në marrëdhënien ekzistuese me vende të ndryshme fqinje. Megjithatë, vendosja e marrëdhënieve të tilla të veçanta, varet nga një interes i përbashkët për ruajtjen e vlerave të përbashkëta: demokracia, shteti ligjor, të drejtat e njeriut, qeverisja e mirë, parimet e ekonomisë së tregut dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Politika vihet në jetë përmes planeve dypalëshe të veprimit, të cilët pasqyrojnë nevojat e fqinjëve në fjalë dhe interesat e ndërsjella të atij vendi dhe BE-së. Këto plane përcaktojnë programin e punës për një periudhë tre deri pesëvjeçare, duke mbuluar reforma politike dhe ekonomike, një harmonizim më të ngushtë të legjislacionit me atë të Komunitetit, përgatitjen në disa programe të caktuara të Bashkimit dhe zhvillimin ose fuqizimin e bashkëpunimit dhe dialogut.

Marrëveshjet dypalëshe që janë lidhur përpara se të ekzistonte PEF-ja shërbejnë si një kuadër për realizimin e politikës. Vendet fqinje përfitojnë ndihmë financiare dhe teknike, kryesisht përmes Instrumentit të Fqinjësisë dhe Partneritetit Europian (IFPE) për periudhën 2007-2013 (që zëvendëson programet TACIS dhe MEDA nga viti 2000 deri në vitin 2006).

Shiko:

- TAIEX (Zyrë për Shkëmbimin e Informacionit të Asistencës Teknike)

Politikë, ~a ekonomike / Economic policy

Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM) nënkupton bashkërendim të ngushtë të politikave ekonomike kombëtare, të cilat, në këtë mënyrë, janë kthyer në një çështje me interes të përbashkët. Praktikisht, Këshilli me këshillim të Komisionit vendos me shumicë të cilësuar dhe harton udhëzime që i dërgohen Këshillit Europian. Duke ndjekur konkluzionet e këtij të fundit, Këshilli, përsëri me shumicë të cilësuar, miraton një këshillim që përcakton Udhëzimet e Përgjithshme të Politikës Ekonomike (UPPE) të Shteteve Anëtare dhe të Komunitetit dhe informon Parlamentin Europian (neni 121 TFBE, ex ish neni 99 i Traktatit të Komunitetit Europian). Këto udhëzime të përvitshme janë elementi qendror i bashkërendimit të politikave ekonomike të Bashkimit.

Përveç këtyre udhëzimeve të përgjithshme, Traktati i Bashkimit Europian parashtron dispozita të politikës ekonomike në kreun VII duke përfshirë:

- mbikëqyrjen shumëpalëshe: Shtetet Anëtare të mbledhura në Këshillin Europian, vëzhgojnë zhvillimet ekonomike dhe zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të politikës ekonomike; ato mund të nxjerrin këshillime për qeverinë e një Shteti Anëtar që nuk përputhet me këto udhëzime;
- procedurën e deficitit të tepërt: Shtetet Anëtare duhet të shmangin deficitet shtetërore të tepërta dhe i takon Komisionit të sigurohet që Shtetet Anëtare të veprojnë në përputhje me këtë parim;
- ndihmën financiare: nëse një Shtet Anëtar është në vështirësi të mëdha, Këshilli sipas disa kushteve mund të japë ndihmë financiare;
- ndalimin e marrjes së angazhimeve të Shteteve të tjera Anëtare: Komuniteti Europian ose Shtete të tjera Anëtare nuk mund të marrin angazhimet e Shteteve të tjera Anëtare;
- ndalimin e mundësisë së privilegjuar: është e ndaluar t'u jepen organizmave, autoriteteve apo ndërmarrjeve publike mundësi të privilegjuara për financime.

Traktati i Komunitetit Europian parashikon gjithashtu dispozitat institucionale të zbatueshme për Bankën Qendrore Europiane dhe dispozitat kalimtare të nevojshme për zbatimin e fazave të ndryshme të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

Protokolli i Eurogrupit bashkangjitur Traktatit të Lisbonës bëri njohjen zyrtare të takimeve të Ministrave të financës dhe ekonomisë së shteteve të eurozonës të shvilluara përpara mbledhjeve të ECOFIN.

Shiko:

- Krite të konvergjencës
- Këshill i Bashkimit Europian
- Bashkim Ekonomik dhe Monetar (BEM)
- Punësimi
- Bankë Qendrore Europiane (BQE)
- Komisioni i Europian
- Këshil-i Europian
- Parlament-i Europian
- Politikë-a monetare
- Shumicë-a e cilësuar
- Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit

Politikë, ~a e Përbashkët Bujqësore / Common Agricultural Policy (CAP)

Politika e Përbashkët Bujqësore është një fushë ku kompetenca ushtrohet në mënyrë të përbashkët midis Bashkimit Europian (BE) dhe Shteteve Anëtare. Sipas nenit 39 TFBE (ish neni 33 i Traktatit të Komunitetit Europian), qëllimet e Politikës së Përbashkët Bujqësore janë sigurimi i çmimeve të arsyeshme për konsumatorët Europianë dhe të ardhura të ndershme për fermerët, sidomos përmes organizimit të përbashkët të tregjeve bujqësore dhe përmes sigurimit të zbatimit të parimeve të miratuara në Konferencën e Stresës në vitin 1958, që janë, çmime të njëjta, solidaritet financiar dhe preferencë për Komunitetin.

Politika e Përbashkët Bujqësore është një nga politikat më të rëndësishme të Bashkimit (shpenzimet bujqësore llogaritin 45% të buxhetit të komunitetit). Politika vendoset me shumicë të cilësuar në Këshillin Europian pasi është këshilluar me Parlamentin Europian.

PPB-ja e ka përmbushur objektivin e vet kryesor, që ka qenë arritje e plotësisht të nevojave

për ushqime me forcat e veta brenda Komunitetit. Megjithatë, shumë shpejt u duk qartë nevoja për ndryshime madhore të politikës, për të rregulluar çekuilibrat dhe mbiprodhimin që erdhi si rezultat i PPB-së. Si rrjedhim, me kalimin e kohës objektivat e kësaj politike kanë ndryshuar si rezultat i reformave të njëpasnjëshme (kryesisht, reforma McSharry e vitit 1992 dhe Agjenda 2000).

Reforma më e fundit, në qershor 2003, përbënte një zhvillim madhor në PPB-në. Kjo reformë solli risitë e mëposhtme:

- Një pagesë të vetme për zotërim për fermerët e BE-së, pavarësisht prodhimit (veçimi i mbështetjes);
- Lidhja e këtyre pagesave me zbatimin e standardeve që lidhen me mjedisin, sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe bimëve dhe mirëqenien e kafshëve (zbatimi integral i parimeve);
- Një politikë e përforcuar e zhvillimit rural, me zvogëlim të pagesave të drejtpërdrejta për fermat e mëdha, në mënyrë që të financohet politika e re (modulimi);
- Një mekanizëm të disiplinës financiare (vendosja e një tavani mbi shpenzimet për mbështetjen e tregut dhe ndihmën e drejtpërdrejtë nga viti 2007 deri në vitin 2013).

Reforma përfshin edhe një përmirësim të politikës së organizimit të përbashkët të tregjeve në kuadër të PPB-së. Janë reformuar, tashmë, disa sektorë: duhani, pambuku, vaji i ullirit dhe sheqeri.

Traktati i Lisbonës solli këto ndryshime të rëndësishme për politikat bujqësore dhe të peshkimit:

- Përdorimin e procesit të zakoshëm legjislativ për këto fusha.
- Rishikimin e procedurave të buxhetimit duke rritur rolin e Parlamentit në vendimarrjen për shpenzimet bujqësore.

Shiko:

- Mirëqenie e kafshëve
- Politika e Përbashkët e Peshkimit
- Organizimi i Përbashkët i Tregjeve Bujqësore (COM)
- Mjedisi
- Siguri ushqimore
- Zhvillim rural

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë / Common Foreign and Security Policy (CFSP)

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë rregullohet në Titullin V të TBE i cili mbulon gjithashtu marrëdhëniet me jashtë (ish Titulli V të Traktatit të Bashkimit Europian). Kjo politikë zëvendësoi Bashkëpunimin Politik Europian dhe parashikoi kuadrin aktual të një politike të përbashkët mbrojtjeje, e cila në kohën e duhur do të çonte në një mbrojtje të përbashkët.

Qëllimet e PPJS të Bashkimit Europian janë përcaktuar në nenin 24 TBE (ish neni 11 i Traktatit të Bashkimit Europian) dhe do të arrihen përmes instrumenteve specifike ligjore (veprime të përbashkëta, qëndrime të përbashkëta), të cilat duhet të miratohen nga Këshilli me unanimitet. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (1999), Bashkimi Europian ka dhe një instrument të ri në dispozicion, strategjinë e përbashkët. Traktati i Amsterdimit parashikon votim me shumicë të cilësuar sipas disa kushteve dhe, që kur u nënshkrua PPJS-ja, ka pësuar ndryshime në çdo Këshill Europian.

Traktati i Nisës (2001) prezantoi mundësinë që, sipas kushteve të caktuara të vendosej

bashkëpunim më i ngushtë në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë për zbatimin e veprimeve dhe qëndrimeve të përbashkëta. Ky bashkëpunim më i ngushtë nuk mund të përdoret për implikime ushtarake apo mbrojtjeje.

Traktati i Lisbonës nuk ndryshon objektivat e PPJS dhe nuk i jep kompetenca të reja Bashkimit në këtë fushë. Dispozitat e reja thjesht parashikojnë që Bashkimi të ketë një rol më aktiv në këtë fushë, por kjo do të varet shumë nga vullneti i shteteve anëtare për të dhënë aprovimin e tyre që Bashkimi të veprojë. Traktati ndryshon fare pak procedurën e vendimmarrjes në këtë fushë. PPJS do të jetë subjekt i rregullave dhe procedurave të vecanta, neni 24 TBE). Përfaqësuesi Lartë, së bashku me Këshillin Europian dhe Këshillin e Ministrave do të jetë përgjegjës për PPJS. Traktati i ri parashikon se Këshilli mund të vendosë me shumicë të cilësuar për një veprim apo qëndrim të Bashkimit të propozuar nga Përfaqësuesi i Lartë.

Shiko:

- Abstenim konstruktiv (abstenim pozitiv)
- Qëndrim i përbashkët
- Strategji e përbashkët (CFSP)
- Coreu (CORrespondance EUropéenne)
- Deklarata
- Veprim i përbashkët
- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
- Shtylla të Bashkimit Europian
- Komisioni Politik dhe i Sigurisë (KPS)
- Kornizë Institucionale e Përbashkët
- Bashkimi Europian Perëndimor (BEP)
- Përfaqësuesi i Lartë

Politika e Përbashkët e Peshkimit / Common fisheries policy

Edhe pse në Traktatin e Romës të vitit 1957 parashikohej një Politikë e Përbashkët për Peshkimin (PPP), “Blue Europe” u bë politikë e përbashkët, në kuptimin e plotë të fjalës, vetëm në vitin 1983.

PPP-ka ka të njëjtën bazë ligjore (nenet 38-44 TFBE ish nenet 32-38 të Traktatit të KE-së) me Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB) dhe ka të njëjtët objektiva: rritja e produktivitetit, stabilizimi i tregjeve dhe siguri i ofertës dhe çmimeve të arsyeshme për konsumatorët. Si PPB-ja, PPP-ja është në fushën e kompetencës që, është e përbashkët midis Bashkimit Europian dhe Shteteve Anëtare.

Reformat e mëpasshme u kanë shtuar synimet e mëposhtme objektive fillestarë të PPP-së: shfrytëzim i qëndrueshëm i burimeve, mbrojtje e mjedisit, masa mbrojtëse për një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe kontributit për kohezionin ekonomik dhe social.

Në veçanti, mbrojtja e rezervave të peshkimit dhe i mjedisit detar përbën një çështje kyçe, duke pasur parasysh rrezikun që kanoset nga pakësimi i burimeve.

PPP-ja funksionon në katër nivele:

- Ruajtje dhe administrim i qëndrueshëm i rezervave të peshkimit, për të mbrojtur burimet e peshkimit;
- Organizim i tregut për të bashkuar ofertën me kërkesën, në interes të prodhuesve dhe konsumatorëve;

- Politikë strukturorë për të ndihmuar industrinë e peshkimit dhe të kultivimit të peshqve që t'i përshtatin impiantet dhe organizimin e tyre në përputhje me kufizimet e vendosura nga tregu dhe pakësimi i burimeve; mbështetja e Komunitetit në këtë fushë jepet, kryesisht, përmes "Instrumentit Financiar për Orientimin e Peshkimit " (FIG);
- Marrëdhëniet me vendet që nuk janë anëtare të Komunitetit dhe organizatat ndërkombëtare, domethënë bisedimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të peshkimit dhe masat e përbashkëta të ruajtjes për peshkimin në thellësi.

Sot, Bashkimi Europian po kërkon të ketë një politikë të plotë detare, që të përfshijë politikat e peshkimit, mjedisit dhe industrive detare.

Traktati i jep rëndësi politikave të peshkimit dhe ato gjenden në një titull të rishikuar të tij, së bashku me bujqësinë "Bujqësia dhe peshkimi", Titulli III i TFBE (nenet 38–44).

Shiko:

- Politika e Përbashkët Bujqësore

Politika e Përbashkët e Transportit / Common transport policy

Objektivi kryesor i Politikës së Përbashkët të Transportit është heqja e pengesave në kufijtë midis Shteteve Anëtare, për të lehtësuar lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.

Për këtë qëllim, objektivat parësore janë plotësimi i tregut të brendshëm për transportin, sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm, administrimi i programeve të financimit dhe rregullimit të territorit, përmirësimi i sigurisë dhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërkombëtar. Kjo politikë ka të bëjë edhe me caktimin e kushteve, në bazë të të cilave mund të ushtrojnë shërbime transporti në Shtetet Anëtare shoqëritë jo rezidente të transportit.

Qysh prej hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, vendimet janë marrë në bazë të procedurës së bashkëvendosjes, pas konsultimeve me Komisionin Europian Ekonomik dhe Social dhe Komisionin e Rajoneve.

Shiko:

- Rrjete TransEuropiane (RRTE)

Politika e Përbashkët Tregtare / Common Commercial Policy

Politika Tregtare e Përbashkët është një prej shtyllave kryesore të marrëdhënieve të Bashkimit Europian me pjesën tjetër të botës. Ajo është një fushë ku kompetencën e vetme e ka Bashkimi (neni 207 TFBE, ish neni 133 i Traktatit Themelues të Komunitetit Europian) dhe lidhet me krijimin e një bashkimi doganor të Shteteve Anëtare.

Politika Tregtare e Përbashkët kërkon një sjellje të njëtrajtshme të marrëdhënieve tregtare me vendet e treta, sidomos përmes një tarife të përbashkët doganore dhe regjimeve të përbashkëta të import-eksportit.

Komuniteti Europian e mbështet heqjen e kufizimeve tregtare dhe të barrierave doganore. Për të mbrojtur tregun e Komunitetit, ai ka në dispozicion të vet instrumente të tilla, si masat antidumping dhe antisubvencion, Rregulloren për Barrierat Tregtare dhe Masat Mbrojtëse.

Komisioni bisedon dhe lidh marrëveshje ndërkombëtare në emër të Komunitetit Europian në nivel dypalësh dhe nivel shumëpalësh. Ai luan një rol aktiv në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Bashkimi Europian mbështet tregtinë e harmonizuar dhe të liberalizuar që u shërben interesave të gjithë aktorëve ndërkombëtarë dhe sidomos, vendeve që ndodhen në pozitat më të pafavorshme. Në këtë frymë, preferencat e përgjithshme dhe të veçanta për vende të tilla, përbëjnë një aspekt madhor të politikës së përbashkët tregtare.

Politikat tregtare janë zgjeruar sipas nenit 207 TFBE dhe në përputhje me praktikat aktuale, negociatat ndërkombëtare për tregtinë në shërbime, pronësinë intelektuale, investimet direkte përfshihen në kompetencat e BE-së. Megjithatë, Traktati parashikon se Këshilli vendos me unanimitet për negociimet apo marrëveshjet në këtë fushë. Gjithashtu, parashikohet një kërkesë e re që Komisioni t'i raportojë Parlamentit European mbi progresin në negociata.

Shiko:

- Bashkimi Doganor
- Përgjegjësi të jashtme të Komunitetit European .

Politika Europiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes / European security and defence policy (ESDP)

Politika Europiane e Mbrojtjes dhe e Sigurisë (ESDP) përfshin krijimin gradual të Politikës së Përbashkët të Mbrojtjes, e cila, me kalimin e kohës, mund të çojë në një mbrojtje të përbashkët. Politika Europiane e Sigurisë dhe Mbrojtjes (PESM) synon të lejojë, që Bashkimi European të zhvillojë kapacitetet e veta civile dhe ushtarake për menaxhimin e krizës dhe parandalimin e konflikteve në nivel ndërkombëtar, duke ndihmuar, në këtë mënyrë, për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare në përputhje me Kartën e OKB-së. Politika Europiane e Mbrojtjes dhe e Sigurisë, e cila nuk përfshin krijimin e një ushtrie Europiane, po zhvillohet në pajtueshmëri dhe bashkërendim me NATO-n.

Traktati i Mاستrihtit (1992) ishte i pari që futi dispozita për përgjegjësitë e Bashkimit, në lidhje me sigurinë dhe mundësinë e një politike të ardhshme të përbashkët për mbrojtjen. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdami, në Traktatin e Bashkimit European (Titulli V), janë përfshirë detyra të reja. Kjo risi e rëndësishme lidhet me misionet humanitare dhe të shpëtimit, të ruajtjes së paqes dhe përdorimit të forcave të luftimit në menaxhimin e krizës, duke përfshirë operacionet për vendosjen e paqes (të njohura si “detyrat e Petersbergut”). Përveç këtyre operacioneve civile dhe ushtarake për menaxhimin e krizës, Politika Europiane e Mbrojtjes dhe e Sigurisë përfshin një komponent të parandalimit të konfliktit. Komisioni Politik dhe i Sigurisë (KPS), Komisioni Ushtarak i Bashkimit European (KUBE) dhe Shtabi Ushtarak i Bashkimit European (SHBBE) janë strukturat e përhershme ushtarake dhe politike, përgjegjëse për një politikë autonome dhe operacionale mbrojtëse të Bashkimit European. Këshilli European i Helsinkit vendosi “objektivin global”, me fjalë të tjera, Bashkimi European duhet të jetë në gjendje të dislokojë deri në 60 mijë trupa brenda 60 ditësh dhe për të paktën një vit.

Në Këshillin European të Gëtebergut, në qershor 2001, Këshilli European foli për gatishmërinë e tij për t'i përmirësuar kapacitetet e BE-së në fushat e parandalimit të konfliktit dhe menaxhimit të krizës, përmes përdorimit të mjeteve ushtarake dhe civile.

Traktati i Nisës (2001) ia dha kompetencën për operacionet e menaxhimit të krizës KPS-së, edhe pse përgjegjësia i mbetet Këshillit.

Me Traktatin e Lisbonës PESM është ndryshuar në Politikën e Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Kjo politikë përfshin inkuadrim progresiv të një politike të përbashkët të mbrojtjes së Bashkimit atëhere kur Këshilli European ta shohë të arsyeshme. Çdo vendim do të merret me unanimitet dhe në përputhje me dispozitat kushtetuese të çdo Vendi Anëtar. Gjithashtu, Traktati i Lisbonës paraqet një dispozitë të re e cila lejon një formë të institucionalizuar bashkëpunimi mes Shteteve Anëtare të BE, të quajtur Bashkëpunim i Përhershëm i Strukturuar.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
- NATO e rinovuar

- Detyra të Petersberg-ut
- Bashkimi Europian Perëndimor (BEP)

Politika monetare / Monetary policy

Politika monetare mbulohet nga nenet 127-133 TFBE (ish nenet 105 deri në nenin 111 e Traktatit të Komunitetit Europian). Kjo politikë ka një rëndësi themelore për Bashkimin Ekonomik dhe Monetar (BEM). Procedurat e vendimmarrjes së përbashkët variojnë sipas çështjeve në fjalë:

- për çështjen e monedhave nga Shtetet Anëtare (neni 128 TFBE, ish neni 106(2)) zbatohet procedura e bashkëpunimit pas këshillimit me Bankën Qendrore Europiane (BQE);
- për formulimin e udhëzuesve të politikës së kursit të këmbimit (neni 132 TFBE, ishneni 111(2)), Këshilli vendos me shumicë të cilësuar pas rekomandimit nga Banka Qendrore Europiane ose nga Komisioni Europian pas këshillimit me Bankën Qendrore Europiane;
- për masat zbatuese të përcaktuara në Statutin e Sistemit Europian të Bankave Qendrore (SEBQ) neni 129 TFBE ish neni 107(6)), kufijtë dhe kushtet sipas së cilave Banka Qendrore Europiane ka të drejtën të vërë gjoba (neni 130 TFBE, ish neni 109 (3)), Këshilli vendos me shumicë të cilësuar pas këshillimit nga Banka Qendrore Europiane dhe pas këshillimit me Parlamentin dhe Komisionin Europian;
- për rregullime teknike të statutit të Sistemit Europian të Bankave Qendrore (neni 129 TFBE, ish neni 107(5)), Këshilli vendos me shumicë të cilësuar pas këshillimit nga Banka Qendrore Europiane dhe pas këshillimit me Komisionin Europian dhe pas marrjes së pëlqimit të Parlamentit Europian;
- për kursin e këmbimit të euros ndaj valutave jo komunitare (neni 132 TFBE, ish neni 111(1)), Këshilli vendos me unanimitet pas këshillimit nga Banka Qendrore Europiane ose nga Komisioni, pas këshillimit me Parlamentin Europian.

Dispozitat institucionale (nenet 282-284 TFBE dhe dispozitat kalimtare të Titullit VIII TFBE (ish Titulli VII i Traktatit të Komunitetit Europian) kanë procedurat e tyre të veçanta të vendimmarrjes, të cilat janë të ndryshme nga procedurat e identifikuara këtu.

Shiko:

- Procedurë e konsultimit
- Krite të konvergjencës
- Procedurë e bashkëpunimit
- Këshilli i Bashkimit Europian
- Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM)
- Banka Qendrore Europiane (BQE)
- Komisioni Europian
- Parlamenti Europian
- Shumicë e cilësuar
- Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit
- Unanimitet

Politika për ndërmarrjet / Enterprise policy

Objektivi i Politikës për ndërmarrjet është krijimi i një mjedisi që e përkrah krijimin dhe zhvillimin e bizneseve, sidomos të Ndërmarrjeve të Vogla dhe Mesme (NVM), brenda Bashkimit Europian.

Fokusi kryesor i kësaj politike është:

- Nxitja e sipërmarrjes (nxitja e krijimit dhe mbështetja e shoqërive, sidomos e NVM-ve, gjatë fazës së çeljes dhe zhvillimit të tyre);
- Nxitja e performancës Europiane sa i takon aftësisë konkurruese (nxitja e bizneseve për t'iu përshtatur ndryshimeve strukturore dhe ruajtja e një niveli të lartë dhe të qëndrueshëm të rritjes së produktivitetit);
- Mbajtja parasysh e karakteristikave dhe nevojave specifike të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë;
- Nxitja e novacionit (ndjekja e zhvillimeve teknologjike, projektme të reja të produkteve, zhvillimi i mënyrave të reja të marketingut të produkteve);
- Rritje e mundësisë për të përfituar financim, mbështetje nga rrjetet dhe programet;
- Thjeshtim i mjedisit rregullator dhe administrativ.

Pra, politika për ndërmarrjet jep ndihmesë për rritjen e qëndrueshme dhe krijimin e vendeve të punës. Ajo është e lidhur me arritjen e objektivit të vendosur nga Këshilli European në Lisbonë, më 23 dhe 24 mars 2000, kur kryetarët e shteteve dhe qeverive deklaruan se Bashkimi European duhet të bëhej ekonomi më konkurruese dhe dinamike, e mbështetur në njohuri në botë, brenda vitit 2010.

Politika e BE-së për ndërmarrjet ndihmon në mbështetjen dhe bashkërendimin e veprimtarive të Shteteve Anëtare. Bashkimi nuk mund të zërë vendin e kompetencave kombëtare dhe as nuk mund të harmonizojë aktet ligjore dhe nënligjore kombëtare.

Shiko:

- Konkurrueshmëri (aftësia konkurruese)
- Zhvillim i qëndrueshëm
- Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (NVM)
- REACH: Kuadri Rregullator për Lëndët Kimike
- Kërkim shkencor dhe zhvillim
- Përgjegjësi mjedisore
- Strategjia e Lisbonës

Politika Sociale / Social policy

Traktati i Amsterdamit përfshin Marrëveshjen mbi politikën sociale të nënshkruar nga njëmbëdhjetë Shtetet Anëtare në Traktatin themelues të Komunitetit European, duke i dhënë fund një situatë të ndërlikuar. Nga viti 1993 deri në vitin 1999 kanë ekzistuar dy baza ligjore të veçanta për masat e politikës sociale: vetë Traktati i Komunitetit European dhe një marrëveshje e veçantë, e cila nuk u nënshkrua nga Britania Madhe. Tani të gjitha masat e politikës sociale janë bashkuar në Titullin XI të Traktatit të Komunitetit European.

Objektivat e politikës sociale të përcaktuara në Traktatin e Komunitetit European dhe të përfshira në tekstin e Kushtetutës Europiane, u frymëzuan nga Karta Sociale Europiane e vitit 1961 dhe Karta e Komunitetit e të Drejtave Sociale Themelore të Punëtorëve e vitit 1989: nxitja e punësimit, përmirësimi i kushteve të punës, mbrojtja e duhur profesionale, dialogu social, përgatitja profesionale e forcës punëtore për të arritur një nivel të lartë dhe të qëndrueshëm të punësimit, duke luftuar në të njëjtën kohë përjashtimin social.

Shiko:

- Karta e të Drejtave Themelore
- Komisioni European Ekonomik dhe Social (KEES)
- Dialog social

- Kartë Sociale (Karta e të Drejtave Themelore Sociale të Punëtorëve)
- Partnerë socialë
- Marrëveshja për Politikën Sociale

Presidencë, ~a e Këshillit të Bashkimit European / Presidency of the Council of the European Union

Presidenca e Këshillit të Bashkimit European organizohet në bazë të një sistemi rotacioni gjashtëmujor, ku secili Shtet Anëtar mban cilësinë e Presidencës për një periudhë gjashtëmujore. Rendi i rotacionit vendoset nga Këshilli i Bashkimit European, me unanimitet.

Mbajtja e Presidencës është detyra e secilit Shtet Anëtar, si edhe një kontribut në drejtim të funksionimit normal të institucioneve të Komunitetit. Përgjegjësitë e Presidencës janë:

- Kryesimi i mbledhjeve të Coreper dhe të grupeve të punës dhe komiteteve të tjera të Këshillit;
- Organizimi dhe administrimi i punës së Këshillit, në përputhje me rregulloren e brendshme të tij;
- Përfaqësimi i Bashkimit në lidhje me PPJS (mbi ndihmën e Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë).

Sipas Traktatit të Lisbonës, Këshilli i Punëve të Jashtme kryesohet nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Sigurisë. Bashkëpunimi me grupe nga tre i presidencave gjashtë-mujore të njëpasnjëshme është rikonfirmuar nga Traktati i Lisbonës, me qëllim inkurajimin, vazhdimin dhe planifikimin strategjik në të gjithë presidencat gjashtë-mujore.

Shiko:

- Këshilli i Bashkimit European
- Coreper
- Këshilli European
- Trojkë

President, ~i i Komisionit European / President of the European Commission

Neni 214, paragrafi 2, i Traktatit themelues të Komunitetit European parashikonte që Këshilli, i mbledhur dhe me përbërje kryetarët e shteteve ose qeverive dhe me shumicë të cilësuar, propozonte personin që synonte të emëronte si President të Komisionit dhe kjo kandidaturë miratohej nga Parlamenti European. Kjo procedurë është vendosur në Traktatin e Nisës, ndërsa Traktati i Amsterdimit parashikonte që qeveritë e Shteteve Anëtare ta propozonin personin, me marrëveshje të përbashkët, kandidaturë që duhej të aprovohej nga Parlamenti European. Pastaj qeveritë caktonin personat që synojnë t'i emërojnë si anëtarë të Komisionit European, në marrëveshje me Presidentin e ri European.

Presidenti i Komisionit European ka kompetenca të konsiderueshme, në bazë të nenit 217 të Traktatit të KE-së, për të siguruar te Kolegji i Komisionerëve European, pas zgjerimit të realizuar me anëtarësimin e Shteteve të reja Anëtare, të veprojë me konsekuencë dhe efijencë.

Pra, ai është personi që cakton linjat e përgjithshme të politikës, të cilat duhet t'i ndjekë Komisioni European në punën e tij. Ai vendos për caktimin e përgjegjësive mes komisionerëve dhe për rishpërndarjen e portofolave, gjatë mandatit të Komisionit European.

Me miratim të Kolegjit, ai emëron edhe nënpresidentët, numri i të cilëve nuk është i caktuar në Traktat. Më tej, pasi të marrë miratimin e Kolegjit të Komisionerëve European, ai mund t'i kërkojë një anëtar të Komisionit European të japë dorëheqjen.

Presidenti i Komisionit Evropian, për periudhën 2004-2009, ishte ish-Kryeministri portugez José Manuel Durão Barroso, i cili e mori detyrën nga Romano Prodi, si Kreu i Ekzekutivit Evropian.

Traktati i Lisbonës futi një formulë të re për zgjedhjen e Presidentit të Komisionit Evropian. Në fakt, sipas nenit 17 TBE: duke marrë parasysh zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe pasi mban konsultimet e duhura, Këshilli Evropian, me shumicë të kualifikuar, i propozon Parlamentit Evropian një kandidat për President të Komisionit. Ky kandidat do të zgjidhet nga Parlamenti Evropian me një shumicë e anëtarëve të tij përbërës. Nëse ai nuk ka marrë shumicën e kërkuar, Këshilli Evropian, me shumicë të kualifikuar, brenda një muaji do të propozojë një kandidat të ri që do të zgjidhet nga Parlamenti Evropian duke ndjekur të njëjtën procedurë.

Presidenti aktual i Komisionit Evropian për vitet 2009-2014 u rizgjedh José Manuel Barroso.

Shiko:

- Përbërje e Komisionit Evropian
- Konfirmim i Komisionit Evropian
- Komisioni Evropian

President, ~i i Këshillit Evropian / European Council President

Sipas Traktatit të Lisbonës, Këshilli Evropian do të kryesohet nga një President me kohë të plotë, duke shërbyer një mandat prej dy vitesh e gjysmë, i rinovueshëm edhe një herë. Presidenti zgjidhet nga Këshilli Evropian me votim me shumicë të cilësuar. Presidenti kryeson Këshillin Evropian, siguron përgatitjen dhe vazhdimësinë e punës, përpiqet të lehtësojë kohezion dhe mirëkuptimin brenda Këshillit Evropian dhe raporton në Parlamentin Evropian pas çdo takimi. Presidenti i Këshillit Evropian mbulon dy role të gjera: ai udhëheq Këshillin Evropian dhe përfaqëson Bashkimin në marrëdhëniet me jashtë, për çështje të lidhura me PPJS pa ndërhyrë në detyrat e Përfaqësuesit të Lartë.

Aktualisht, Presidenti i Këshillit Evropian është Herman Van Rompuy.

Shiko

- Traktati i Lisbonës
- Këshilli Evropian
- Presidenca e Bashkimit Evropian

Procedurë, ~a e bashkëpunimit / Cooperation procedure

Procedura e bashkëpunimit (neni 252 i Traktatit të Komunitetit Evropian, ish-neni 189 pika c) u prezantua me Aktin Unik Evropian. Ai i dha Parlamentit Evropian një ndikim më të madh në procesin legjislativ, duke i lejuar dy "lexime". Fillimisht, qëllimi i kësaj procedure u zgjerua me Traktatin e Mastroihtit. Traktati i Amsterdamiit e ndryshoi më pas këtë tendencë, duke inkurajuar procedurën e vendimmarrjes së përbashkët (neni 251 i Traktatit të Komunitetit Evropian). Procedura e bashkëpunimit zbatohet vetëm në fushën e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

Procedura e bashkëpunimit fillon gjithmonë me një propozim nga Komisioni Evropian i cili i dërgohet Këshillit dhe Parlamentit Evropian. Pas leximit të parë, Parlamenti Evropian jep një mendim për propozimin e Komisionit Evropian. Këshilli Evropian me shumicë të cilësuar harton një qëndrim të përbashkët, i cili i dërgohet Parlamentit Evropian së bashku me të gjithë informacionin e nevojshëm dhe arsyet që e çuan Këshillin Evropian në miratimin e këtij qëndrimi të përbashkët.

Parlamenti European analizon këtë qëndrim të përbashkët gjatë leximit të dytë dhe brenda tri muajsh mund ta miratojë, ta ndryshojë ose ta refuzojë atë. Në dy rastet e fundit, duhet të veprohet me shumicë absolute nga anëtarët. Nëse propozimi nuk pranohet, Këshilli duhet të vendosë me unanimitet për një lexim të dytë.

Më pas, brenda një muaji Komisioni European rishqyrton propozimin mbi të cilin Këshilli European u mbështet për qëndrimin e përbashkët dhe i dërgon propozimet e tij Këshillit European, i cili me dëshirën e tij mund të përfshijë ose të përjashtojë ndryshimet e propozuara nga Parlamenti European.

Brenda tre muajsh, Këshilli European me shumicë të cilësuar, mund të miratojë propozimin e ri të shqyrtuar, ta ndryshojë me unanimitet, ose të miratojë gjithashtu me unanimitet ndryshimet që nuk janë marrë parasysh nga Komisioni.

Në procedurën e bashkëpunimit, Këshilli European mund të ushtrojë të drejtën e vetos, duke refuzuar të shprehë mendimin e tij për ndryshimet e propozuara nga Parlamenti European, ose për propozimet e ndryshuara nga Komisioni European, duke e bllokuar kështu procedurën legjislativë.

Shiko:

- Procedurë e pëlqimit
- Procedurë e vendimmarrjes së përbashkët
- Procedurë e konsultimeve
- Këshilli i Bashkimit European
- Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM)
- Komisioni European
- Parlamenti European

Procedurë, ~a e deficitit të tepërt / Excessive deficit procedure

Procedura e deficitit të tepërt rregullohej nga neni 104 i Traktatit themelues të Komunitetit European, ku Shtetet Anëtare ishin të detyruara të evitojnë deficitet e tepërta në buxhetet e tyre kombëtare.

Komisioni European vlerëson situatën dhe Këshilli European vendos nëse ekziston apo jo një deficit i tepërt. Komisionit European, i cili përpilon një raport në lidhje me këtë, i kërkohet të marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës (kushtet ciklike, reformat, etj.) që mund të ndikojnë në deficitin e tepërt.

Kur Këshilli European vendos se ekziston një deficit i tepërt në një Shtet Anëtar, para së gjithash ai i jep rekomandime Shtetit Anëtar në fjalë, me idenë për të ndrequr situatën brenda një periudhe të caktuar. Nëse Shteti Anëtar nuk i përmbush këto rekomandime, Këshilli European mund ta udhëzojë të marrë masat e duhura për zvogëlimin e deficitit. Nëse është e nevojshme, Këshilli European ka edhe mundësinë të vendosë gjoba dhe t'i kërkojë Bankës Europiane të Investimeve (BEI) të rimendojë politikën e saj huadhënëse për Shtetin Anëtar në fjalë.

Vlera referencë për ekzistencën e një deficitit të tepërt është vlera 3% e prodhimit të brendshëm bruto (PBB). Një Rregullore e Këshillit, e miratuar në vitin 1997, ka për synim të shpejtojë dhe sqarojë vënien në zbatim të procedurës për deficitin e tepërt.

Shiko:

- Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM)
- Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit

Procedurë, ~a e Vendimmarrjes së Përbashkët / **Codecision procedure**

Procedura e Vendimmarrjes së Përbashkët u prezantua në Traktatin e Mاستrihtit (neni 251 i Traktatit të Komunitetit European). Kjo procedurë i jep Parlamentit European kompetenca për të miratuar akte së bashku me Këshillin European. Procedura përfshin një, dy ose tre lexime. Efekti i saj është rritja e kontakteve ndërmjet Parlamentit dhe Këshillit, ligjvënësve dhe Komisionit European. Praktikisht, ka forcuar kompetencat legislative të Parlamentit European në fushat e mëposhtme: lëvizjen e lirë të punëtorëve, të drejtën e vendosjes, shërbimeve, tregun e brendshëm, arsimin (masat stimuluese), shëndetësinë (masat stimuluese), politikën e konsumatorit, rrjetet ndërEuropiane (udhëzimet), mjedisin (program i përgjithshëm masash), kulturën (masat stimuluese) dhe kërkimet shkencore (program kuadër).

Traktati i Amsterdimit ka thjeshtuar procedurën e vendimmarrjes së përbashkët duke e bërë më të shpejtë, më efikase dhe duke forcuar rolin e Parlamentit European. Përveç kësaj, ky rol është rritur në fusha të reja si përjashtimi social, shëndeti publik dhe lufta kundër mashtrimit që ndikon në interesat financiare të Komunitetit European.

Forcimi i natyrës demokratike të Komunitetit European kërkon që Parlamenti European të marrë pjesë në ushtrimin e kompetencave ligjvënëse. Kështu që, çdo instrument ligjvënës i miratuar me shumicë të cilësuar ka të ngjarë të bjerë brenda objektit të procedurës së bashkëvendosjes. Prandaj, në shumicën e rasteve, vendimmarrja e përbashkët në Parlament shkon paralel me votimin me shumicë të cilësuar në Këshill. Megjithatë, për disa dispozita të Traktatit, vendimmarrja e përbashkët dhe unanimiteti ekzistojnë akoma.

Traktati i Nisës i vë pjesërisht kapak kësaj situate. KNQ-ja e shkurtit 2000, kërkon një zgjerim të fushës së zbatimit të vendimmarrjes së përbashkët, paralelisht edhe si shtojcë e përdorimit të votimit me shumicë të cilësuar në Këshill. Shtatë dispozita për të cilat KNQ-ja planifikoi të zbatonte votim me shumicë të cilësuar, i nënshtrohen procedurës së vendimmarrjes së përbashkët. Këto janë: iniciativa për të luftuar diskriminimin, bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile, masat e veçanta të përkrahjes industriale, masat e kohezionit ekonomik dhe social (jashtë fondeve strukturore), statuti për partitë politike Europiane dhe masat në lidhje me vizat, azilin dhe emigracionin.

Me Traktatin e Lisbonës është rritur roli i Parlamentit European. Tashmë Parlamenti do të ushtrojë funksione legislative së bashku me Këshillin dhe procedura e vendimmarrjes së përbashkët do të jetë procedura e zakonshme e miratimit të ligjeve europiane.

Shiko:

- Komisioni i Pajtitimit
- Këshilli i Bashkimit European
- Parlamenti European
- Procedurë e Pëlqimit
- Procedurë e Konsultimit
- Procedurë e Bashkëpunimit

Procedurë, ~a e Këshillimit / **Consultation procedure**

Procedura e Këshillimit (neni 225 TFBE, ish neni 192 i Traktatit të KE-së), i jep mundësi Parlamentit European të japë mendimin e vet për një propozim të ardhur nga Komisioni si dhe t'i kërkojë atij të bëjë një propozim. Nëse Komisioni nuk bën propozimin, atëherë ai duhet të specifikojë arsyet. Në rastet e parashikuara në Traktat, Këshilli European duhet të këshillohet me Parlamentin European përpara se të votohet për propozimin e Komisionit dhe merr parasysh pikëpamjet e tij. Megjithatë, ai nuk është i detyruar të ndjekë qëndrimin e Parlamentit European, por është i detyruar vetëm të konsultohet me të. Nëse Këshilli European i shmanget shumë propozimit fillestar, mendimi i Parlamentit European duhet të

merret sërish. Kompetencat e Parlamentit European janë të kufizuara sipas kësaj procedure, aq sa mund të shpresohet që Komisioni të marrë parasysh ndryshimet në një propozim të ndryshuar.

Përveç rasteve të parashikuara në traktate, Këshilli duhet të këshillohet me Parlamentin European edhe për çështjet më të rëndësishme. Këshillimi është me dëshirë. Përveç kësaj, kjo procedurë këshillimi përdoret për miratimin e instrumenteve jo të detyrueshme, veçanërisht, të rekomandimeve dhe mendimeve që nxirren nga Këshilli dhe Komisioni European.

Shiko:

- Procedurë e Pëlqimit
- Procedurë e Vendimmarrjes së Përbashkët
- Procedurë e Bashkëpunimit
- Këshilli i Bashkimit European
- Komisioni European
- Parlamenti European

Procedurë, ~a e Pëlqimit / Assent procedure

Procedura e Pëlqimit (neni 192 i Traktatit Themelues të Komunitetit European), është futur nga Akti i Vetëm European (1986). Kjo procedurë kërkon që Këshilli të marrë pëlqimin e Parlamentit European përpara se të merren vendime të rëndësishme. Parimi i pëlqimit mbështetet në një lexim të vetëm. Parlamenti European mund të pranojë ose të refuzojë një propozim, por nuk mund ta ndryshojë atë. Nëse Parlamenti European nuk e jep pëlqimin e tij, akti në fjalë nuk mund të miratohet.

Procedura e Pëlqimit zbatohet më shumë për Aderimin e Shteteve të reja Anëtare (neni 49 i Traktatit të Bashkimit European), për Marrëveshjet e Asociimit dhe për marrëveshje të tjera themelore me vendet e treta.

Procedura e Pëlqimit përdoret gjithashtu për çështjet e qytetarisë, për detyrat e veçanta të Bankës Qendrore Europiane (BQE), për ndryshimet e Statutit të Sistemit European të bankave qendrore dhe Bankës Qendrore Europiane, për Fondin e Kohezionit dhe Fondet strukturore, si edhe për procedurën standarde për zgjedhjet e Parlamentit European (neni 190 i Traktatit të Komunitetit European).

Në fund, Parlamenti European jep pëlqimin e tij, për zbatimin e sanksioneve të vendosura mbi një Shtet Anëtar për një shkelje të rëndë dhe të vazhdueshme të të drejtave themelore (neni 7 i Traktatit të BE-së) dhe, për një bashkëpunim më të ngushtë në fushat që i nënshtrohen procedurës së bashkëvendimmarrjes.

Parlamenti European e jep pëlqimin me shumicë votash. Megjithatë, edhe në dy raste të tjera kërkohet shumicë e deputetëve, domethënë për anëtarësimin e një Shteti të ri Anëtar dhe për procedurën zgjedhore.

Traktati i Lisbonës nuk i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë 'procedurës së pëlqimit'.

Shiko:

- Procedurë e Vendimmarrjes së Përbashkët
- Procedurë e Konsultimit
- Këshilli i Bashkimit European
- Komisioni European
- Parlamenti European

Procedurë, ~a Standarde Zgjedhore e Parlamentit European / Uniform Electoral Procedure for the European Parliament

Traktati themelues i Komunitetit European i kërkon Parlamentit European të përpilojë propozime për t'u dhënë mundësi deputetëve të tij të zgjidhen përmes ushtrimit të drejtpërdrejtë të së drejtës që kanë të gjithë për të votuar, ose përmes përdorimit të një procedure të njëtrajtshme në secilin Shtet Anëtar, ose në përputhje me parimet e përbashkëta. Megjithatë, tani për tani, nuk veprohet kështu, duke qenë se, krahas listave kombëtare, ka edhe lista rajonale.

Një procedurë si kjo është e rëndësishme, sepse do të kërkonte që, tendencat e ndryshme politike Europiane të përfaqësohen me më shumë vërtetësi në Parlamentin European.

Pas një sërë debatesh dhe mosmarrëveshesh, Këshilli dhe Parlamenti European, më në fund, kanë rënë dakord për katër pika, të cilat e harmonizojnë procesin zgjedhor në zgjedhjet Europiane, duke marrë, në të njëjtën kohë, në konsideratë situatën ekzistuese:

- Metoda e njëtrajtshme e votimit është përfaqësim i përpjestueshëm, duke përdorur një listë, ose një votë të vetme të transferueshme (vetëm në Irlandë);
- Vota mund të jetë preferenciale;
- Zonat e ndryshme zgjedhore (kombëtare apo rajonale) mund të qëndrojnë të pandryshuara, për sa kohë që nuk e pengojnë përfaqësimin proporcional. Zonat zgjedhore rajonale duhet të caktohen në një datë të mëvonshme në shtetet me popullsi mbi 20 milion banorë;
- Pragu minimal për marrjen e një vendi në Parlament është 5% e votave të hedhura.

Shumica e rregullave që kanë të bëjnë me votimin dhe zgjedhjet mbeten të dallueshme, sidomos, përsa u takon datave të zgjedhjeve, zonave zgjedhore, zbatimit të përfaqësimit proporcional, numrit të mandateve që mund të mbahen paralelisht, votimit dhe kushteve për të fituar të drejtën dhe rritjes së barazisë. Përsa u takon zonave zgjedhore, shumica e Shteteve Anëtare kanë miratuar sistemin me një zonë zgjedhore, ku i gjithë vendi përbën një zonë zgjedhore. Shtetet e tjera Anëtare kanë një numër zonash zgjedhore: Irlanda, Brytania e Madhe, Gjermania, Italia, Greqia, Belgjika, Polonia dhe Franca, e cila miratoi një ligj në prill 2003, për të zëvendësuar sistemin me një zonë zgjedhore të vetme, me tetë zona zgjedhore ndërrajonale.

Në periudhën afatgjatë, Parlamenti dëshiron të ecë në drejtim të pasjes së një zone të vetme zgjedhore në nivel të Bashkimit European.

Traktati i Lisbonës bën ndryshime simbolike duke hequr shprehjen e TKE e cila njih rëndësinë e partive politike si një 'faktor për integrimin e Bashkimit', duke e zëvendësuar me pohimin se 'ato do të kontribuojnë në rritjen e ndërgjygjësimit politik dhe ato do të jenë shprehje të vullnetit politik të qytetarëve të BE-së (neni 10 TBE).

Shiko:

- Parlamenti European
- Parti politike Europiane
- Statut për deputetët e Parlamentit European

Proces, ~i i Barcelonës / Barcelona Process

Procesi i Barcelonës, i njohur edhe si Partneriteti Euro-Mesdhetar, përbën politikën që ndjek Bashkimi European në drejtim të vendeve të Mesdheut. Qëllimi i tij është fuqizimi i lidhjeve midis Bashkimit European dhe vendeve partnere, duke nxitur, në të njëjtën kohë, lidhje më të ngushta mes vetë vendeve mesdhetare.

Objektivi i partneritetit, të promovuar në vitin 1995, pas Deklaratës së Barcelonës, është

nxitja e paqes dhe e stabilitetit në rajon, përmes vendosjes së një dialogu politik që respekton vlerat e përbashkëta të partnerëve, siç është demokracia dhe shteti ligjor. Synimet e tjera janë nxitja e parandalimit dhe zgjidhjes së konflikteve, si edhe e prosperitetit, sidomos përmes krijimit të një zone të tregtisë së lirë dhe zhvillimit të bashkëpunimit.

Në këtë kuadër, Partneriteti Euro-Mesdhetar i bashkon Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet mesdhetare, në një program të madh, me tre linja kryesore: linja politike dhe e sigurisë, linja ekonomike dhe financiare dhe linja sociale dhe kulturore. Edhe fuqizimi i bashkëpunimit në fushat e drejtësisë, migrimit dhe përfshirjes sociale është një element i rëndësishëm i Procesit të Barcelonës.

Partneriteti vihet në jetë si në nivel dypalësh, ashtu edhe në nivel rajonal. Masat dypalëshe i përshtaten vendit partner përkatës, kur një aspekt i rëndësishëm janë Marrëveshjet e Asociimit Euro-Mesdhetar. Ky Proces mbështetet edhe me fonde nga Komuniteti Europain, programi MEDA dhe Linja e Financimit për Investimet dhe Partneritetin Euro-Mesdhetar (FEMIP) të Bankës Europiane për Investime (BEI).

Shiko:

- Politikë e fqinjësisë

Proces, ~i i Stabilizim - Asociimit / Stabilisation and Association Process

Politika e Bashkimit Europian në drejtim të vendeve të Ballkanit Perëndimor merr formën e Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit, i nisur në Samitin e Zagrebit në nëntor 2000. Vendet e përfshira në këtë proces janë Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia, që përfshin edhe Kosovën, sipas përkufizimit që jep rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky proces, synon të sigurojë paqe dhe stabilitet në rajon, duke ofruar mbështetje për fuqizimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor dhe zhvillimin e një ekonomike tregu. Ai e vendos theksin te zhvillimi i bashkëpunimit rajonal, për shembull, përmes një zone të tregtisë së lirë dhe përmes dialogut politik.

Qëllimi i Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit është vendosja e marrëdhënieve të posaçme midis vendeve në fjalë dhe Bashkimit Europian, në këmbim të reformave, me idenë për t'u anëtarësuar në BE, çka kërkon harmonizimin e legjislacionit të këtyre vendeve me atë të Komunitetit. Këto vende njihen si kandidatë të mundshme për t'u anëtarësuar në BE.

Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit u fuqizua në Samitin e Selanikut në vitin 2003, duke përfshuar elementet e procesit të anëtarësimit. Ai mbështetet në:

- Marrëdhëniet kontraktore përmes Marrëveshjeve të Stabilizim-Asociimit (MSA), lidhja e të cilave varet nga progresi i arritur nga vendet e përfshira në proces. Në lidhje me këtë, vlerësimi i kërkesës për anëtarësim, i paraqitur prej tyre, do të mbështetet në rezultatet që lidhen me zbatimin e dispozitave nga ana e tyre, sidomos të atyre që kanë të bëjnë me tregtinë;
- Marrëdhëniet tregtare në nivel rajonal dhe me Bashkimin Europian; Bashkimi Europian u jep preferenca tregtare vendeve të Ballkanit Perëndimor;
- Një instrument financiar, Instrumenti i Asistencës të Paraanëtarësimit (IPA) për periudhën 2007-2013 (që ka zëvendësuar programin CARDS për periudhën 2000-2006).

Vendet e Ballkanit Perëndimor që fitojnë statusin e vendit kandidat, vazhdojnë të përfitojnë nga disa aspekte të caktuara të Procesit të Stabilizim dhe Asociimit, edhe pse kanë filluar të angazhohen në procesin e anëtarësimit.

Shiko:

- Asistencë paraanëtarësimit
- TAIEX (Asistencë Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit)

Programi i Ndhmës Komunitare për Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore (PHARE) / Programme of Community aid to the countries of Central and Eastern Europe (PHARE)

Përpara IPA-s, PHARE ishte mjete kryesor i asistencës së paraanëtarësimit për vendet kandidatë për në BE. Synimi kryesor i këtij programi ishte të mbështeste vendet kandidatë në procesin e miratimit dhe zbatimit të acquis dhe t'i përgatiste këto vende për administrimin e Fondeve Strukturore. Duke pasur parasysh këtë, ky program përqendrohej në dy prioritetet:

- Ngritjen e institucioneve;
- Financimin e investimeve.

I nisur në vitin 1989 për të mbështetur rindërtimin e ekonomive të Polonisë dhe Hungarisë, programi PHARE, shkallë-shkallë, u zgjerua për t'i përfshirë të gjithë vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Prej vitit 1994, detyrat e programit PHARE janë miratuar në përputhje me prioritetet dhe nevojat e çdo vendi kandidat.

Për periudhën 2000-2006, programi PHARE pati një buxhet prej më shumë se 10 miliard Euro (afro 1,56 miliard Euro në vit). Në vitin 2000, u futën edhe dy programe të tjera: ISPA për transportin dhe mjedisin dhe SAPARD për bujqësinë.

Për periudhën 2007-2013, Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA) është i vetmi instrument financiar për vendet kandidatë për BE, Instrument i cili i zëvendëson të gjitha format ekzistuese të asistencës së paraanëtarësimit, përfshirë edhe programin PHARE.

Shiko:

- Zgjerimi
- Asistencë e paraanëtarësimit
- Strategji e paraanëtarësimit

Prokurim, ~i publik / Public procurement

Kontratat e Prokurimit Publik mbulojnë materialet, shërbimet dhe veprat e blera nga sektori publik. Kontratat që e kalojnë një vlerë të caktuar, u nënshtrohen normave dhe procedurave të Bashkimit.

Ky legjislacion siguron trajtim të drejtë për bizneset dhe transparencë në trajtimin e ftesave për të marrë pjesë në tender. Ai duhet parë në kuadër të konkurrencës dhe lirisë për të ofruar shërbime brenda tregut të përbashkët European.

Disa kontrata të caktuara mbeten një çështje tërësisht në duart e Shteteve Anëtare, pavarësisht vlerës së tyre, kur ato prekin interesat specifike të shteteve. Kjo vlen sidomos për kontratat e lidhura me sektorin e mbrojtjes.

Në vitin 2004, Këshilli dhe Parlamenti European miratuan një paketë të re legjislacioni, i cili i thjeshton dhe i modernizon procedurat për lidhjen e kontratave të sektorit publik. Kjo paketë përbëhet nga dy direktiva, njëra prej të cilave mbulon kontratat e shërbimeve, materialeve dhe punëve publike, ndërsa tjetra mbulon kontratat publike në sektorët e ujësjellës-kanalizimeve, energjetikës, transportit dhe postave.

Dy direktiva të tjera rregullojnë procedurat e ankimit në lidhje me caktimin e kontratave të materialeve dhe punëve publike, si dhe procedurat për lidhjen e kontratave nga entet operatore në sektorët e ujësjellës-kanalizimeve, energjetikën, transportin dhe telekomunikacionin.

Legjislacioni i Bashkimit kërkon që kontratat, që kalojnë një vlerë prag të caktuar, të shpallen në Gazetën Zyrtare. Sistemi i Informacionit për Prokurimin Publik (SIMAP) i jep industrisë së prokurimeve publike informacione për mundësitë për aktivitet tregtar në nivel European dhe ndërkombëtar.

Shiko:

- Politika për ndërmarrjet

Pronësi, ~a intelektuale / Intellectual property

Ashtu si mallrat e prekshme, krijimet intelektuale mund të përbëjnë pronësi që përcaktohet si "Pronësi Intelektuale". Pronësia Intelektuale mbulon tradicionalisht dy fusha:

- pronësinë industriale, që përfshin kryesisht patentat, skicat dhe modelet, markat e prodhimit dhe shërbimit dhe përcaktimet e origjinës të mbrojtura;
- të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, që zbatohen për të gjitha veprat letrare dhe artistike.

Kjo fushë mbulon çështjet kulturore, sociale dhe teknologjike me rëndësi të veçantë që duhet të merren parasysh gjatë hartimit të një politike koherente në këtë fushë. Kështu, për çështjen e pronësisë industriale, rregulloret e Bashkimit janë përpjekur të harmonizojnë kushtet për regjistrimin e markave të prodhimit dhe markave tregtare dhe t'u japin përdoruesve mbrojtjen e siguruar nga një tërësi e vetme rregullash. Në dhjetor 2001, është miratuar edhe një Rregullore që fut një skemë të Komunitetit Europian. Bashkimi Europian për të inkurajuar shpikjet po punon edhe për krijimin e një patente komunitare.

Në lidhje me çështjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, legjislacioni i harmonizuar i Bashkimit u hartua në fusha, ku pasiguria ligjore mund të pengonte shfrytëzimin e të drejtave në disa territore (programe kompjuteri dhe baza të dhënash, transmetim radioteleviziv satelitor dhe ritransmetimi kabllor, e drejta për huadhënie dhe huamarrje dhe disa të drejta të caktuara). Legjislacioni Europian u përshtat për të marrë parasysh sfidat e reja që solli progresi teknologjik dhe shoqëria e informacionit. Masa që synojnë luftimin e falsifikimit dhe piraterisë janë marrë në nivel Europian.

Traktati i Lisbonës përmban disa dispozita të veçanta për pronësinë intelektuale. Si ndër më të rëndësishmet mund të përmendim nenin 118 i cili parashikon krijimin e të Drejtave Intelektuale të BE-së brenda procedurës së zakonshme ligjvënëse.

Shiko:

- Shoqëri e informacionit

Protokolli i Kiotos / Kyoto Protocol

I miratuar në dhjetor 1997, Protokolli i Konventës Kuadër të OKB-së për ndryshimin e klimës (UNFCCC) vë në dukje qëndrimin e ri të bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me fenomenin e ndryshimeve klimaterike. Sipas këtij protokollit, vendet e industrializuara kanë marrë përsipër të ulin prodhimin e gjashtë gazeve serë (dyoksid karboni, metan, oksid azoti, hidrofluorokarboneve, perfluorokarboneve dhe heksafluorit të squfurit) më së paku 5% gjatë periudhës 2008-2012, krahasuar me nivelet e vitit 1990.

Protokolli i Kiotos parashikon tre mekanizma të mbështetur në treg: tregtimin e çlirimeve të gazeve midis vendeve nënshkruese të protokollit, zbatimin e përbashkët të projekteve nga këto vende dhe mekanizmin e zhvillimit të pastër (me vendet që nuk e kanë nënshkruar Protokollin).

Shtetet Anëtare dhe Bashkimi Europian nga ana e tyre kanë marrë përsipër të ulin çlirimin e këtyre gazeve gjatë së njëjtën periudhë me 8%. Në vitin 2003, çlirimet globale të gjashtë gazeve serë në vendet e Bashkimit Europian qenë 1,7% poshtë niveleve të vitit 1990.

Më 31 maj 2002, Bashkimi Europian dhe Shtetet Anëtare e miratuan Protokollin e Kiotos. Miratimi i Protokollit nga Rusia në vitin 2004 i dha mundësi Protokollit të hyjë në fuqi, më 16 shkurt 2005 dhe të ketë fuqi detyruese mbi vendet nënshkruese.

Protokollit të Kiotos është një hap i parë drejt trajtimit të problemit të ndryshimit të klimës, për ta zgjidhur këtë problem. Në nëntor 2005, Konferenca e palëve të UNFCCC-it dhe të Protokollit të Kiotos i dhanë një shtysë të re Protokollit dhe hodhën themelet për diskutime të ardhshme për kuadrin ndërkombëtar për të trajtuar ndryshimin e klimës, për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi. Për më tepër, në mbledhjen e Këshillit Europian në mars 2007, BE-ja u angazhua, në mënyrë të njëanshme, për t'i pakësuar çlirimet e gazit CO₂ me 20% brenda vitit 2020 dhe u bëri thirrje vendeve të zhvilluara të lidhin një marrëveshje ndërkombëtare për të vendosur një objektiv konkret global për zvogëlimin e çlirimit të gazeve me 30% brenda vitit 2020.

Shiko:

- Energjetikë
- Mjedis
- Zhvillim i qëndrueshëm

Punësim, ~ i / Employment

Nxitja e një niveli të lartë punësimi është njëri prej objektivave të Komunitetit qysh prej hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, në maj 1999, kur edhe u fut Titulli VIII "Punësimi" në Traktatin themelues të Komunitetit Europian.

Edhe Titulli i ri IX TFBE (ish Titulli VIII TKE) "Punësimi" kërkon ngritjen e një Komisioni për Punësimin, me status këshillimor, për të lehtësuar detyrën e Bashkimit Europian për të nxitur bashkërendimin e politikave kombëtare për punësimin dhe tregun e punës.

Këshilli Europian i Lisbonës (mars 2000) mendonte se synimi i përgjithshëm i këtyre masave ishte ngritja e shkallës së përgjithshme të punësimin në Bashkimin Europian, në 70%, si edhe ngritja e shkallës së punësimin për femrat në më shumë se 60% brenda vitit 2010. Këshilli Europian i Stokholmit (mars 2001) shtoi edhe dy objektiva të ndërmjetëm dhe një objektiv tjetër shtesë:

- Shkalla e përgjithshme e punësimin dhe shkalla e punësimin për femrat të arrinte, përkatësisht, 67% dhe 57% në vitin 2005;
- Shkalla e punësimin për punëtorët në moshë më të madhe të arrinte 50% deri në vitin 2010.

Këshilli i Barcelonës (mars 2002) bëri thirrje për përforcimin e Strategjisë Europiane të Punësimin, si një instrument i Strategjisë së Lisbonës.

Mbështetja financiare për politikën e punësimin jepet përmes instrumenteve të ndryshme:

- Programi i ardhshëm PROGRES 2007-2013, synimi i të cilit është dhënia e asistencës financiare për punën në drejtim të arritjes së objektivave të BE-së për punësimin dhe çështjet sociale;
- Prioritetet e Fondit Social Europian, të cilët janë pjesë e objektivave të SEP-së;
- Programi i mësimin të ndërsjellët, i nisur në fillim të vitit 2005, si pjesë e masave shtytëse për nxitjen e punësimin. Objektivi kryesor i tij është rritja e transferueshmërisë së politikave më të efektshme brenda fushave kryesore të SEP-së.

Në nivel Europian, strukturat kryesore në fushën e punësimin janë:

- Observatori Europian i punësimin, një sistem informimi për politikën e punësimin, i ngritur në vitin 1982 nga Komisioni, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare;
- Rrjeti EURES, i cili ndihmon në krijimin e një tregu Europian pune, i arritshëm për të gjithë përmes shkëmbimit ndërajonal dhe ndërkombëtar të vendeve të lira të punës dhe kërkimit të punës, si dhe përmes shkëmbimit të informacionit për kushtet e jetesës dhe fitimin e kualifikimeve.

Shiko:

- Konkurrueshmëri
- Komision për punësimin
- Strategjia Europiane për Punësimin (SEP)
- Strategjia e Lisbonës
- Fonde strukturore dhe Fond i Kohezionit



Qartësi, ~a e traktateve (Thjeshtim i traktateve) / Clarity of the Treaties (simplification of the Treaties)

Bashkimi Europian është krijuar gradualisht dhe struktura e tij është rezultat i një sërë ndryshimesh në traktate të ndryshme. Këto shtesa dhe ndryshime kanë bërë, shkallë-shkallë, që tekstet themeluese të Bashkimit Europian të jenë gjithnjë e më të vështira për t'u lexuar dhe kuptuar.

Traktati themelues i Romës u pasua, mes shumë të tjerëve, nga Akti Unik Europian dhe Traktati i Bashkimit Europian (Traktati i Mastrohitit). Ky traktat krijoi një strukturë të re, Bashkimin Europian, përveç Komunitetit Europian, i cili përbëhej nga tri shtylla (Komunitetet Europiane, Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë dhe Bashkëpunimi në Fushën e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme). Traktati i Nisës dhe ai i Amsterdimit përmbajnë ndryshime të traktateve të mëparshëm dhe një sistem të ri të numërimit të neneve. Traktateve i janë shtuar një numër i madh shtojcash dhe protokolle.

Në dhjetor 2001, Deklarata e Lekenit nisi një proces thjeshtimi të traktateve.

Shiko:

- Deficit demokratik
- Deklarata e Lekenit
- Rishikim i traktateve
- Thjeshtim i legjislacionit
- Transparencë (liria e shikimit të dokumenteve)
- Traktate

Qeverisje, ~a / Governance

Debati për qeverisjen Europiane, i nisur nga Komisioni në Librin e Bardhë në korrik 2001, ka të bëjë me të gjitha rregullat, procedurat dhe praktikatat që ndikojnë në ushtrimin e kompetencave brenda Bashkimit Europian. Qëllimi është që të miratohen forma të reja qeverisjeje, të cilat e afrojnë Bashkimin Europian me qytetarët Europianë, e bëjnë më efektiv dhe përforcojnë demokracinë në Evropë, si edhe konsolidojnë ligjshmërinë e institucioneve. Bashkimi Europian lipset ta reformojë veten, në mënyrë që të mbushë deficitin demokratik në institucionet e veta. Kjo qeverisje duhet të përqendrohet në përcaktimin dhe zbatimin e politikave më të mira dhe më të qëndrueshme që lidhin organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet Europiane. Qeverisja përfshin gjithashtu përmirësimin e cilësisë së legjislacionit Europian, duke e bërë atë më të qartë dhe më efektiv. Për më tej, Bashkimi Europian duhet të kontribuojë në debatin për qeverisjen botërore dhe të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e funksionimit të institucioneve ndërkombëtare.

Shiko:

- Deficit demokratik
- Përpjestueshmëri
- Thjeshtim i legjislacionit
- Subsidiaritet

- Transparencë (liri e shikimit të dokumenteve)
- Transparencë e punimeve të Këshillit

Qëndrim, ~i i përbashkët (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European) / Joint position (Title VI of the EU Treaty)

Qëndrimi i përbashkët u prezantua me Traktatin e Mastrohit, si pjesë e bashkëpunimit në fushat e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Traktati i Amsterdimit e përmban këtë instrument në Titullin VI të Traktatit të Bashkimit European (Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale).

Qëndrimi i përbashkët është një instrument ligjor, i cili bën të mundur që Këshilli të përcaktojë orientimin e Bashkimit European për çdo çështje të veçantë. Shteteve Anëtare u kërkohet t'i vënë tërërisht në jetë, si në punët e brendshme, ashtu edhe në punët e jashtme, vendimet e miratuara me unanimitet në mbledhjet e Këshillit.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, qëndrimet e përbashkëta u shfuqizuan. Tashmë përdoret vetëm termi qëndrime.

Shiko:

- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale

Qëndrim, ~i i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)

Qëndrimi i përbashkët në kontekstin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, bën më sistematik bashkëpunimin dhe përmirëson bashkërendimin e tij. Shtetet Anëtare duhet të bien dakord dhe të mbajnë ato qëndrime, të cilat janë miratuar me unanimitet në takimet e këshillit.

Sipas nenit 25 TBE (ish neni 12 TBE), Bashkimi i realizon veprimet në kuadër të PPJS duke miratuar vendime që përmbajnë qëndrimin që do të mbajë BE në këtë fushë.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)

Qytetari, ~a e Bashkimit European / Citizenship of the Union

Nënshtetësia Europiane është krijuar me Traktatin e Bashkimit European (Traktati i BE-së), i nënshkruar në Mastrohit në vitin 1992. Qytetaria e bashkimit është në varësi të shtetësisë së njërit nga Shtetet Anëtare. Me fjalë të tjera, kushdo që ka shtetësinë e një Shteti Anëtar, është qytetar i Bashkimit European. Përveç të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në Traktatin themelues të Komunitetit European, qytetaria e bashkimit parashikon katër të drejta të veçanta:

- Liri për të qarkulluar dhe për të banuar në Bashkimin European;
- E drejtë për të votuar dhe për t'u zgjedhur në zgjedhjet vendore dhe në Parlamentin European, në Shtetin Anëtar ku banon;
- Mbrojtje diplomatike dhe konsullore në një vend të tretë nga autoritetet e çdo Shteti Anëtar, kur Shteti Anëtar, shtetësinë e të cilit ai ka, nuk është i përfaqësuar neni 23 TBE (ish neni 20 i Traktatit të KE-së);
- E drejtë e peticionit dhe ankimit tek Ombudsmeni (Avokati i popullit) European.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (1999), statusi i nënshtetësit European jep edhe të drejtat e mëposhtme:

- E drejtë për t'iu drejtuar institucioneve Europiane në njërën prej gjuhëve zyrtare dhe për ta marrë përgjigjen me shkrim në të njëjtën gjuhë;

- E drejtë për të shikuar dokumentet e Parlamentit European, Këshillit European dhe Komisionit European, në varësi të disa kushteve të caktuara (neni 15 TFBE ish neni 255 i Traktatit të KE-së);
- E drejtë për të mos u diskriminuar kundrejt shtetasve të tjerë të BE-së, në bazë të kombësisë (neni 18 TFBE ish neni 12 i Traktatit të KE-së) dhe për të mos u diskriminuar në bazë të gjinisë, racës, fesë, aftësive të kufizuara ose orientimit seksual;
- Mundësi e barabartë për të përfituar nga shërbimi civil i komunitetit.

Sigurisht që nocioni i Qytetarisë së Bashkimit European nuk e zëvendëson shtetësinë e Shteteve Anëtare, por i shtohet asaj. Kjo i jep qytetarit të thjeshtë një ndjenjë më të thellë dhe më konkrete përkatësie në Bashkimin European.

Traktati i Lisbonës sjell dy ndryshime themelore për qytetarinë europiane: Iniciativa qytetare për të propozuar ligje dhe kompetenca e re e Bashkimit mbi masat për mbrojtjen sociale, të lidhura këto me të drejtën e lëvizjes dhe lejeqëndrimin. Ndryshimet e tjera janë simbolike dhe një nga këto është pikërisht përfshirja e termit qytetar në dispozitat e parimeve demokratike (Titulli II i TBE).

Shiko:

- Karta e të Drejtave Themelore
- Lëvizje e lirë e personave (viza, azil, imigrim dhe politika të tjera)
- Avokati i Popullit
- Parim i mosdiskriminimit
- Peticione
- Transparencë (liri e shikimit të dokumenteve)

R

Rajone, ~t më të largëta / Outermost regions

Ekzistojnë shtatë “rajone më të largëta”: Guadalupe, Guajana franceze, Martinika, ReBashkim (katër departamente të huaja franceze), ishujt Kanarie (Spanjë) dhe ishujt Azore dhe Madeira (Portugali). Ato i nënshtrohen një deklaratë që i është shtuar Traktatit.

Këto rajone dallohen për dendësinë e vogël të popullsisë dhe për largësinë e konsiderueshme nga Kontinenti Europian. Vendndodhja e tyre i kthen këto vende në ura të nxitjes së marrëdhënieve tregtare me fqinjët e tyre që nuk janë anëtare të BE-së, shumica e të cilëve janë vende më pak të zhvilluara. Mbi të gjitha, falë këtyre rajoneve, territori detar i Bashkimit Europian është më i madhi në botë, me një zonë ekonomike që mbulon 25 milion km².

Rajonet më të largëta i nënshtrohen një deklaratë që i është bashkëlidhur Traktatit të KE-së, me Traktatin e Lisbonës, TFEU. Këto rajone mund të përfitojnë nga disa masa të veçanta, në bazë të (nenit 349 TFBE ish neni 299 të këtij Traktati). Kjo deklaratë jep mundësinë për miratimin e masave të veçanta për t'i ndihmuar këto rajone, nëse ka një nevojë objektive për t'i promovuar ekonomitë e tyre. Krahas kësaj, neni 349 TBE (ish neni 299 i Traktatit KE-së) i jep leje Bashkimit Europian të miratojë masa të veçanta, duke përcaktuar kushte për zbatimin e Traktatit KE-së dhe të politikave të përbashkëta në rastin e rajoneve më të largëta.

Shiko:

- Kohezion ekonomik, social dhe territorial

REACH (Kuari Rregullator për Kimikatet) / REACH (regulatory framework for chemicals)

Sistemi “REACH” vendos një Kuadër Rregullator Unik për regjistrimin, vlerësimin dhe autorizimin për Kimikatet. Qëllimi është të garantohet siguri më e madhe në prodhimin dhe përdorimin e substancave kimike.

REACH-i u kërkon operatorëve të grumbullojnë informacionin e plotë mbi vetitë e substancave, me të cilat ata prodhojnë ose importojnë të paktën një ton në vit dhe të demonstrojnë siguri në përdorim. Legjislacioni i mëparshëm kërkonte që, autoritetet e Shteteve Anëtare të vërtetonin ekzistencën e një rreziku para se të ndalonin një substancë. Kjo përmbysje e barrës së provës e bën procedurën më efikase.

Ky informacion pastaj duhet t'i dorëzohet Agjencisë Europiane për Kimikatet e krijuar për këtë qëllim. Agjencia, me seli në Helsinki, administron regjistrimin e substancave duke ngritur një bazë të dhënash. Substancat e paregjistruara nuk duhet të prodhohen në Bashkimin Europian dhe as të importohen në tregun e BE-së.

Autoritetet e Shteteve Anëtare vlerësojnë dosjet e regjistrimit dhe substancat që lënë vend për dyshim. Ato janë gjithashtu përgjegjëse për dhënien apo refuzimin e autorizimeve për substancat që paraqesin rrezik për shëndetin apo mjedisin. Kufizimet janë të mundshme për disa substanca të rrezikshme, por procedura gjithsesi është më e thjeshtë.

Sistemi “REACH” i miratuar në fund të 2006, zëvendëson 40 akte ligjore të mëparshme. Sipas legjislacionit të vjetër, kimikatet e hedhura në treg para vitit 1981 (rreth 99% e atyre tashmë në qarkullim) nuk u nënshtroheshin analizave. Për më tepër, meqë ishte

tejet e ngadaltë, procedura e mëparshme penalizonte novacionin dhe zëvendësimin e substancave që gjendeshin në treg.

Shiko:

- Politika për ndërmarrjet
- Mjedis
- Zhvillim i qëndrueshëm

Riformulim, ~i i legjislacionit / **Recasting of legislation**

Riformulim i legjislacionit do të thotë miratim i një akti të ri ligjor, që përfshin ndryshimin që i bëhet aktit bazë, por që anulon dhe zëvendëson këtë të fundit. Ndryshe nga kodifikimi zyrtar, përfshihen edhe ndryshime thelbësore. Riformulimi i legjislacionit bën gjithashtu një përmbledhje të përgjithshme të një fushe të legjislacionit. Akti i ri ligjor botohet në Gazetën Zyrtare (seritë L).

Shiko:

- Konsolidim i legjislacionit – formal/zyrtar
- Konsolidim i legjislacionit – joformal/shpallës
- Thjeshtim i legjislacionit

Rini, ~a / **Youth**

Neni 165 TFBE (ish neni 149 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian (TKE)) thotë se, veprimi i Bashkimit synon “nxitjen e zhvillimit të shkëmbimit të të rinjve dhe të shkëmbimit të instruktorëve social-edukativ”.

Përgjegjësia për çështjet rinore u përket Shteteve Anëtare, ndërsa veprimi i Bashkimit Europian, në thelb, vjen me nismën e Këshillit, kryesisht përmes këshillimeve dhe programeve të përpiluar për të zhvilluar bashkëpunimin dhe lëvizshmërinë në nivel të BE-së. Ky veprim orientohet me metodën e hapur të bashkërendimit.

Dokumenti i Bardhë i vitit 2001 “Për një shtysë të re për rininë Europiane”, shënoi një fazë të re të veprimit të Bashkimit Europian. Në thelb, ky dokument propozonte që bashkëpunimi midis Shteteve Anëtare duhet të rritet dhe duhet marrë më shumë në konsideratë dimensionin rinor në politikën sektoriale. Pas këtij Dokumenti të Bardhë, në mars 2005 u miratua Pakti për Rininë Europiane, i cili identifikon fushat ku ka nevojë për bashkërendim, me idenë për arritjen e objektivave të strategjisë së Lisbonës dhe fuqizimit të arsimit dhe trajnimit. Ky Pakt e vendos theksin te përmirësimi i arsimit, trajnimit, lëvizshmërisë, integritetit profesional dhe përfshirjes sociale të të rinjve Europianë, duke ndihmuar, në të njëjtën kohë, në harmonizimin e jetës në punë me jetën në familje.

Duke shkuar përtej këtij kuadri të përgjithshëm për veprim, Bashkimi Europian është në gjendje të përdorë instrumente të ndryshme për nxitjen e bashkëpunimit, falë programit “Rinia në veprim” për periudhën 2007-2013. Ky program është përpiluar për të nxitur të rinjtë, sidomos ata që ndodhen në pozita më të pafavorshme dhe ata me aftësi të kufizuara, si edhe për të nxitur sensin e nismës, shpirtin e sipërmarrjes dhe kreativitetin. Në këtë mënyrë, ai nxit lëvizjen e të rinjve në pozita të pafavorshme në të gjithë kuadrin joformal të arsimit, si edhe, përmes një Shërbimi Vullnetar Europian (SHVE), nxit përfshirjen në projekte brenda shoqatave dhe komuniteteve lokale, si në Evropë ashtu edhe në vendet në zhvillim, duke nxitur, kështu, mirëkuptimin reciprok.

Traktati i Lisbonës i shton ish-nenin 149 pohimin se veprimet Bashkimit do të synojnë nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën demokratike të Bashkimit. Për më tepër, Këshilli do të jetë në gjendje të miratojë rekomandimet për trajnimet profesionale.

Shiko:

- Arsimim
- Metodë e hapur e vëzhgimit
- Përgatitje profesionale

Rishikim, -i i traktateve / Revision of the Treaties

Neni 48 (ish neni N i Traktatit të Komunitetit European) përbën bazën ligjore që mundëson mbledhjen e një konference me përfaqësues të qeverive të Shteteve Anëtare (konferencë ndërqeveritare), me qëllim ndryshimin e traktateve. Sipas këtij neni, për ndryshime të tilla çdo Shtet Anëtar, apo Komisioni, mund t'i paraqesë Këshillit propozime. Në rast se Këshilli, pasi është këshilluar me Parlamentin dhe me Komisionin, është në favor të mbledhjes së një konference, kjo e fundit mbledhet nga Presidenti i Këshillit. Çdo ndryshim vijues hyn në fuqi dy muaj pasi është miratuar nga të gjitha Shtetet Anëtare në përputhje me kërkesat e tyre përkatëse kushtetuese.

Traktati i Lisbonës në nenin 48 të tij, parashikon procedurat e reja për rishikimin e Traktateve sipas të cilave Traktatet mund të rishikohen me procedurë të zakonshme rishikimi ose me procedura të thjeshtuara rishikimi.

Sipas procedurës së zakonshme, qeveria dhe Shtetet Anëtare, Komisioni ose Parlamenti European mund t'i paraqisin Këshillit propozimin për ndryshimin e traktateve. Këto propozime më pas i paraqiten Këshillit European dhe njëkohësisht njoftohen parlamentet kombëtare. Në qoftë se Këshilli European miraton propozimin me shumicë të thjeshtë, pasi është konsultuar më Parlamentin European dhe Komisionin, Presidenti i Këshillit mund të thërrasë mbajtjen e një Konvente të përbërë nga përfaqësues të parlamenteve kombëtare, qeverive të shteteve anëtare, Parlamentit European dhe Komisionit. Konventa mund të çojë në mbajtjen e Konferencës së Shteteve Anëtare. Ndryshimet diskutohen dhe miratohen në konferencën e përfaqësuesve të qeverive të shteteve anëtare. Këto ndryshime të traktatit hyjnë në fuqi në bazë të procedurave kushtetuese të shteteve anëtare.

Procedura e thjeshtuar parashikon se Shtetet Anëtare, Parlamenti European, ose Komisioni mund të paraqesin propozime për të ndryshuar të gjithë ose pjesë të Pjesës së III të TFBE, e cila lidhet me politikën dhe veprimtarinë e Bashkimit. Këshilli European miraton vendimin për ndryshimet me unanimitet, konsulton Parlamentin European dhe Bankën Qëndrore Europiane për çështjet monetare. Vendimi hyn në fuqi pasi është miratuar nga shtetet anëtare sipas procedurave të tyre kushtetuese.

Shiko:

- Konventa Europiane
- Konferencë Ndërqeveritare (KNQ)
- Traktate
- Traktati i Amsterdami
- Traktati i Nisës
- Traktati i Lisbonës

RR

Rrathë bashkëqendrorë / Concentric circles

Ky koncept përfshin një Evropë të strukturuar nga nënndarjet e shteteve që kanë fituar nivele të ndryshme integrimi. Ai nuk kufizohet vetëm me strukturën e integritit të Bashkimit Europian dhe kjo ide është përforcuar nga një numër figurash të shquara. Disa prej tyre flasin për “rrethin e të drejtës së ndarë” (Shtete Anëtare të Bashkimit Europian), “rrethin fqinj” (vende jashtë Bashkimit Europian në pritje për t’u anëtarësuar) dhe “rrathët më të zgjedhur” për qëllim të bashkëpunimit më të madh (rreth i monedhës, i mbrojtjes e kështu me radhë).

Shiko:

- Bashkëpunim i zgjeruar
- Evropa “me ritëm të shpejtë”
- Evropa me “gjeometri të ndryshme”

Rrjete NdërEuropiane / Trans-european networks (TEN)

Funksioni i Rrjeteve NdërEuropiane është krijimi i një infrastrukture bashkëkohore dhe të efektshme për t’i lidhur rajonet dhe rrjetet kombëtare të Evropës. Ato janë shumë të rëndësishme për funksionimin e duhur të tregut të përbashkët, duke qenë se sigurojnë lëvizjen e lirë të mallrave, njerëzve dhe shërbimeve.

Titulli XVI i TFBE (ish Titulli XVI Traktatit Themelues të Komunitetit Europian) ofron bazën ligjore për Rrjetet NdërEuropiane, të cilët ekzistojnë në tre sektorë të aktivitetit:

- Rrjete NdërEuropiane të Transportit (RNET), mbulojnë transportin rrugor dhe atë të kombinuar, rrugët detare e portet detare, si dhe rrjetin hekurudhor të shpejtë. Sistemet inteligjente të menaxhimit të transportit janë gjithashtu në këtë kategori, si për shembull projekti “Galileo”, sistem Europian i navigimit satelitor.
- Rrjete NdërEuropiane të Energjisë (RNE-E), mbulojnë sektorët e elektricitetit dhe gazit natyror. Ata ndihmojnë në krijimin e një tregu të vetëm të energjisë dhe kontribuojnë në sigurinë e furnizimit me energji.
- Rrjete NdërEuropiane të Telekomunikacionit (RNET), kanë si qëllim vënien në veprim të shërbimeve të bazuara në rrjetet e telekomunikacionit. Ata përqendrohen kryesisht në shërbimet publike, janë në qendër të iniciativës “eEvropë- shoqëri informacioni për të gjithë”.

Zëri buxhetor i RNET-eve plotësohet me kontribute nga Fondi Europian për Zhvillim Rajonal (FEZR), Fondi i Kohezionit, Banka Europiane e Investimeve (BEI) dhe Fondi Europian për Investime (FEI).

Qysh në vitin 1986, Akti Unik Europian theksonte lidhjen midis funksionimit pa probleme të tregut të vetëm dhe synimit për kohezion ekonomik, social dhe territorial. Ndërlidhja dhe ndërfunksionimi i rrjeteve infrastrukturorë kombëtarë, kanë dalë si faktorë kyç për një planifikim koherent të zhvillimit në komunitet.

Zgjerimi me përfshirjen e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, sot, po e rrit edhe më shumë rëndësinë e RNET-eve, duke e zgjeruar fushëveprimin e tyre në të gjithë kontinentin.

Lidhjet efiçente me rrjetet e vendeve të treta në lindje (Rusia dhe vendet e Bashkësisë së shteteve të pavarura) dhe në jug (vendet e ujëmbledhësit të Mesdheut), do të ndihmojnë në zhvillimin dhe drejtpeshimin ekonomik.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Transportit
- Kohezioni ekonomik, social dhe territorial
- eEvrope
- Energjetikë
- Banka Europiane e Investimeve (BEI)
- Galileo
- Fonde strukturore dhe Fond-i i Kohezionit
- Telekomunikacione

Rrjet, ~i Gjyqësor European për Çështje Penale / European Judicial Network in criminal matters (EJN)

Qëllimi i Rrjetit Gjyqësor European për Çështjet Penale (RRGJE) lehtëson ndihmën e ndërsjellë ligjore në luftën kundër krimit ndërkombëtar. Ky rrjet fillon me një Veprim të përbashkët të miratuar nga Këshilli më 29 qershor 1998.

Rrjeti Gjyqësor përbëhet nga pika kontakti të krijuara për të bërë të mundur që autoritet gjyqësore lokale dhe autoritet gjyqësore në Shtete të tjera Anëtare, të vendosin kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet tyre. Këto pika kontakti sigurojnë informacionin e duhur ligjor ose praktik për të ndihmuar autoritetet që të përgatitin një kërkesë për bashkëpunim gjyqësor.

Ekziston gjithashtu një Rrjet Gjyqësor European për Çështjet Civile dhe Tregtare i krijuar me Vendimin e Këshillit, më 28 maj 2001 dhe i bazuar në Rrjetin për Çështjet Penale.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë, dhe Drejtësisë
- Aksion i përbashkët (çështje të drejtësisë dhe të punëve të brendshme)
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale



Siguri, ~a ushqimore / Food safety

Bashkimi European e ka bërë sigurinë ushqimore një nga prioritetet kryesore të agjendës politike Europiane. Siguria ushqimore është një objektivi horizontal që merret parasysh në disa fusha të kompetencës së komunitetit: në politikën e përbashkët bujqësore dhe shtyllën e zhvillimit rural, mjedisin, shëndetin publik, mbrojtjen e konsumatorëve dhe tregun e brendshëm.

Në përgjigje të frikës publike në lidhje me ushqimet në vitet '90 (BSE, afta epizodike), në janar 2000, Komisioni European publikoi një Dokument të Bardhë "Për sigurinë ushqimore", i cili shënon një hap të rëndësishëm në reformimin e legjislacionit European në këtë fushë. Ai bën thirrje për zhvillimin e një kuadri ligjor, që e mbulon të gjithë zinxhirin ushqimor "nga ferma te luga", duke përdorur një qasje globale e të integruar. Kjo qasje e sheh sigurinë ushqimore si një anë që mbulon ushqimet dhe shëndetin e kafshëve, mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve, vizitat veterinarë, masat për shëndetin e kafshëve dhe përgatitjen dhe higjienën e produkteve ushqimore. Libri i Bardhë thekson edhe nevojën për të nisur një dialog të vazhdueshëm me konsumatorët, për t'i informuar dhe edukuar.

Miratuar në shkurt 2002, Rregullorja përbën bazën e legjislacionit të ri për sigurinë ushqimore dhe përcakton gjashtë parimet e përgjithshëm themelore:

- Konfirmim i natyrës së integruar të zinxhirit ushqimor;
- Analizë e rrezikut, si gur themeltar i politikës për sigurinë ushqimore;
- Kufi ndarjeje i qartë midis analizës dhe menaxhimit të rreziqeve;
- Përgjegjësi e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këtë sektor;
- Gjurmueshmëri e produkteve në çdo fazë të zinxhirit ushqimor;
- E drejtë e qytetarëve për të pasur informacion të qartë dhe të saktë.

Është ngritur Autoriteti European për Sigurinë Ushqimore (AESU). Detyrat kryesore të tij janë: dhënia e mendimeve të pavarura shkencore për çështjet e sigurisë ushqimore, mbledhja dhe analiza e të dhënave për secilin prej rreziqeve të mundshëm apo të lindur dhe mbajtja e një dialogu të vazhdueshëm me publikun. Në veçanti, ai nxjerr opinione shkencorë për disa produkte apo përbërës të caktuar ushqimorë (përbërës shtesë, OMGJ-të). Këshilli European i Brukselit, i mbajtur në dhjetor 2003, vendosi që selia e AESU-s të jetë në Parma të Italisë.

Shiko:

- Mirëqenie e kafshëve
- Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB)
- Mbrojtje e konsumatorëve
- Mjedis
- Agjenci të Bashkimit European
- Organizma të Modifikuar Gjenetikusht (OMGJ)
- Parim parandalues
- Shëndet-i publik
- Zhvillim rural

Statut, ~i për Deputetë të Parlamentit Europian / Statute for Members of the European Parliament

Neni 223 TFBE (ish neni 190 i Traktatit themelues të Komunitetit Europian) parashikon që Parlamenti Europian të miratojë rregulloret dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë kryerjen e detyrave nga ana e deputetëve, pasi t'i ketë kërkuar mendimin Komisionit Europian dhe me miratim të Këshillit Europian, duke vepruar me shumicë të cilësuar (me përjashtim të tatim-taksave, për të cilin kërkohet unanimiteti i Këshillit).

Pas, thajse, njëzet vjet bisedime, midis Parlamentit dhe Këshillit Europian, rregullat e reja u miratuan, më në fund, në shtator 2005.

Ky statut i ri ka eliminuar dallimet, sa i takon shpërblimit monetar të deputetëve të Parlamentit Europian, në varësi të vendit nga vijnë, duke vendosur një rrogë mesatare mujore prej shtatë mijë euro, e cila i nënshtrohet tatimit të komunitetit. Tani për tani, deputetët e Parlamentit Europian paguhet nga parlamentet e vendeve nga vijnë dhe, në përgjithësi, marrin të njëjtën rrogë si kolegët e tyre në parlamentet kombëtare.

Ndryshimet e tjera, të futura nga regjimi i ri, janë si më poshtë:

- Shpenzime të udhëtimit të lindura gjatë realizimit të detyrave të deputetëve rimburohen në bazë të kostos faktike dhe jo me pagesë aforfe;
- Rroga e deputetëve të Parlamentit Europian paguhet nga buxheti i komunitetit dhe jo më nga buxhetet kombëtare;
- Moshë e dalje në pension është 63, ndërsa e gjithë kostoja e pensioneve duhet të mbulohet nga Parlamenti Europian;
- Shtetet Anëtare kanë të drejtën ta tatonjë shpërblimin e punës së deputetëve të Parlamentit Europian, me shkallën tatimore që përputhet me regjimin tatimor kombëtar, krahas tatimit të vjelur nga komuniteti.

Rregullat e reja do të hyjnë në fuqi ditën e parë të seancës parlamentare, që fillon në vitin 2009.

Shiko:

- Parlamenti Europian
- Parti politike Europiane
- Procedurë zgjedhore standarde për Parlamentin Europian

Statut, ~i i Shërbimit Publik / Public service charter

Ideja mbi të cilën mbështetet karta e shërbimeve publike është se duhet të ketë një instrument në të cilin të përcaktohen të drejtat elementare dhe parimet që rregullojnë ofrimin e shërbimeve për përdoruesit e tyre. Parime të tilla do të përfshinin:

- vazhdimësitë e shërbimeve;
- cilësinë;
- siguritë e ofrimit të shërbimeve;
- të drejtë të barabartë përdorimi;
- çmime të përballueshme;
- pranueshmëri sociale, kulturore dhe mjedisore.

Neni 14 TFBE (ish neni 16 i Traktatit të KE-së, i futur nga Traktati i Amsterdimit), e konfirmon rolin e shërbimeve publike në Bashkimin Europian. Politika e BE-së për subjektet e shërbimeve publike ende e merr formën nga dëshira për t'i liberalizuar shërbimet publike dhe për ta zgjeruar objektin e konkurrencës në tregjet kombëtare, si në fushën e transportit hekurudhor, ashtu edhe në ato të shërbimeve postare, energjetikës apo telekomunikacionit.

Shiko:

- Shërbim publik
- Shërbim universal

Strategji, -a e Lisbonës / Lisbon Strategy

Gjatë mbledhjes së Këshillit European në Lisbonë (mars 2000), shefat e kryetarët ose të qeverive promovuan "Strategjinë e Lisbonës", që synonte ta bënte Bashkimin European (BE) ekonominë më konkurruese në botë dhe të arrinte punësim për të gjithë brenda vitit 2010. Kjo strategji, e hartuar në mbledhjet e mëpasshme të Këshillit European, mbështetet në tri shtylla:

- Shtyllë ekonomike, e cila përgatit terrenin për kalimin drejt një ekonomie konkurruese, dinamike, të mbështetur në njohuri. Theksi vendoset te nevoja për t'iu përshtatur vazhdimisht ndryshimeve në shoqërinë e informacionit dhe për të rritur punën kërkimore-zhvillimore.
- Shtyllë e dytë, e menduar për ta modernizuar modelin social European, përmes investimit në burimet njerëzore dhe përmes luftës kundër përjashtimit social. Pritet prej Shteteve Anëtarë të investojnë për arsimin dhe trajnimin dhe të realizojnë një politikë aktive për punësimin, duke e bërë më të lehtë kalimin drejt një ekonomie të dijes.
- Shtyllë mjedisore, e cila është shtuar në Këshillin European të Gëteborgut në qershor 2001, e cila e drejton vëmendjen drejt faktit, që rritja ekonomike duhet të shkëputet nga përdorimi i burimeve natyrore.

Është hartuar një listë me objektiva, me idenë për të arritur qëllimet e vendosura në vitin 2000. Duke pasur parasysh faktin që politikat në fjalë vijnë thuajse tërësisht në sferën e kompetencës së Shteteve Anëtare, është futur në përdorim një Metodë e Hapur e Bashkërendimit (MHB), që përfshin përgatitjen e planeve kombëtare të veprimit. Krahas Orientimeve të Përgjithshme të Politikës Ekonomike (OPPE), Strategjia e Lisbonës parashikon përshtatjen dhe fuqizimin e mekanizmave ekzistues të bashkërendimit: procesin e Luksemburgut për punësimin, Procesin e Kardifit për funksionimin e tregjeve (mallrave, shërbimeve dhe kapitalit) dhe Procesin e Këlnit për dialogun makroekonomik.

Shqyrtimi i periudhës së ndërmjetme, i kryer në vitin 2005, për të cilin është përgatitur një raport, nën drejtimin e zotit Ēim Kok, ish-Kryeministër i Vendeve të Ulëta, tregoi se treguesit e përdorur në MHB kishin bërë që objektivat të bëheshin lëmsh dhe se rezultatet e arritura nuk qenë bindëse.

Për këtë arsye, Këshilli European ka miratuar një partneritet të ri, i cili synon ta përqendrojë punën te arritja e një rritjeje më të fortë dhe afatgjatë dhe te krijimi i një numri më të madh vendesh pune. Sa i takon zbatimin, është thjeshtuar procesi i bashkërendimit. Do të paraqiten udhëzuesit e integruar për rritjen e punësimin, së bashku me udhëzuesit për politikat makroekonomike dhe mikroekonomike, gjatë një periudhe trevjeçare. Ata shërbejnë si bazë, si për Programin e Lisbonës të komunitetit, ashtu edhe për programet kombëtare të reformave. Thjeshtimi i programimit mundëson ndjekjen e zbatimit më nga afër, duke përdorur një raport të vetëm progresi.

Shiko:

- Orientime të Përgjithshme të Politikës Ekonomike (OPPE)
- Punësim
- Mjedis
- Strategjia Europiane për Punësim (SEP)
- Globalizim

- Shoqëri e informacionit
- Metodë e hapur e vëzhgimit
- Kërkim dhe zhvillim

Strategji, ~a e paraanëtarësimit / Pre-accession strategy

Strategjia e paraanëtarësimit ofron një "dialog të strukturuar" midis vendeve kandidate dhe institucioneve të BE-së, gjatë gjithë procesit të anëtarësimit, duke u ofruar të gjitha palëve një kuadër dhe instrumentet e nevojshme. Kjo strategji përcaktohet për secilin vend, veçmas.

Strategjia e paraanëtarësimit ekziston qysh prej Këshillit Europian të Luksemburgut (dhjetor 1997), gjatë të cilit u prezantua një strategji e përforcuar paraanëtarësimi për dhjetë vendet kandidate nga Europa Qendrore dhe Lindore. Në thelb, ajo mbështet në:

- Marrëveshje dypalëshe;
- Partneritete të anëtarësimit dhe Programe Kombëtare për Miratimin e *acquis* në legjislacionin kombëtar;
- Pjesëmarrje në programet, agjencitë dhe komitetet e Komunitetit Europian;
- Dialog politik;
- Vlerësim i Komisionit ("vëzhgimi") Europian;
- Asistencë e paraanëtarësimit;
- Bashkëfinancim-i nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (IFN).

Krahas këtyre institucioneve kryesore, strategjia e paraanëtarësimit mund të përfshijë të tjera për vende të veçanta, në varësi të rrethanave të veçanta të tyre.

Shiko:

- Bisedime të anëtarësimit
- Partneritet për anëtarësim
- Vende kërkuese
- *Acquis* i Komunitetit
- Zgjerim
- Perspektivë financiare
- PHARE (Program i Ndhmës së Komunitetit për vende të Evropës Qendrore dhe Lindore)
- Asistencë e paraanëtarësimit
- Kontroll rutinë
- TAIEX (Zyrë e Shkëmbimit të Informacionit të Asistencës Teknike)

Strategji, ~a e Përbashkët (Politikë e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë) / Common strategy (CFSP)

Strategjia e Përbashkët është një instrument i ri, i prezantuar me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë në Traktatin e Amsterdimit.

Sipas nenit të 26 TFBE (ish neni 13 i Traktatit të Bashkimit Europian), Këshilli Europian përcakton parimet dhe udhëzimet e përgjithshme për Politikën e Përbashkët të Jashtme e të Sigurisë dhe vendos për strategjitë e përbashkëta që duhen zbatuar nga Bashkimi Europian në fusha ku Shtetet Anëtare kanë interesa të përbashkëta të rëndësishme.

Me një fjalë, një strategji e përbashkët përcakton qëllimet dhe periudhën kohore që mbulohet, si edhe mjetet që duhet të vihen në dispozicion nga Bashkimi Europian dhe

Shtetet Anëtare. Strategjitë e përbashkëta zbatohen nga Këshilli duke miratuar në veçanti qëndrime dhe veprime të përbashkëta. Këshilli mund t'i këshillojë strategji të përbashkëta Këshillit European.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Qëndrim i Përbashkët (Titulli VI i Traktatit të BE-së)
- Veprim i Përbashkët (CFSP)

Strategji, ~a Europiane për Punësim / European Employment Strategy (EES)

Qysh prej kohës kur Traktati i Amsterdimit shtoi një titull të ri, Titullin IX për punësimin, në Traktatin Themelues të Komunitetit European, bashkërendimi i politikave të Shteteve Anëtare është një prioritet i Komunitetit.

Ka qenë në bazën e këtyre dispozitave të reja që Këshilli European i Luksemburgut, i mbledhur në nëntor 1997, promovoi Strategjinë Europiane të Punësimit (SEP), të njohur ndryshe edhe si "procesi i Luksemburgut".

SEP-i është një program vjetor planifikimi, vëzhgimi, ekzaminimi dhe rregullimi të politikave, i hartuar nga Shtetet Anëtare, për të bashkërenduar instrumentet që përdorin për t'i dhënë zgjidhje problemit të papunësisë. Kjo strategji mbështetet në katër komponentë:

- Udhëzuesi për punësimin: prioritete të përbashkëta për politikën e punësimit të Shteteve Anëtare, të hartuar nga Komisioni;
- Plane Kombëtare të Veprimit (PKV) për punësimin: zbatim i udhëzuesve të përbashkët në nivel kombëtar;
- Raporti i përbashkët i punësimit: përmbledhje e planeve kombëtare të veprimit, për t'u përdorur si bazë për përpilimin e udhëzuesve për vitin në vijim;
- Këshillime: Këshilli miraton këshillime të veçanta për vendet e ndryshme, me shumicë të cilësuar.

Në vitin 2005 Strategjia e Lisbonës u rishikua për t'u përqendruar më nga afër në zhvillimin e një rritjeje të fuqishme dhe të qëndrueshme dhe në krijimin e një numri më të madh vendesh pune, që të ishin edhe më të mira.

Ky riprezantim i Strategjisë së Lisbonës çoi në një shqyrtim të imët të SEP-së, duke e vënë në zbatim procesin e ri në korrik 2005, me miratimin, nga ana e Këshillit European, të udhëzuesve të integruar për rritjen ekonomike dhe punësimin.

Strategjia Europiane për Punësimin mbështetet në katër komponentë:

- Udhëzues të integruar për rritjen ekonomike dhe punësimin (udhëzuesit do të paraqiten, tani, së bashku me udhëzuesit për politikën makroekonomike dhe mikroekonomike të BE-së për një periudhë trevjeçare);
- Programe kombëtare të reformave për secilin vend;
- Raport vjetor i Komisionit, për rritjen ekonomike dhe punësimin, i cili analizon 25 programe të reja kombëtare të reformave, të paraqitur nga Shtetet Anëtare;
- Çdo këshillim i miratuar nga Këshilli.

Udhëzuesit e integruar për rritjen ekonomike dhe punësimin, do të shërbejnë si bazë për Programin e Lisbonës për komunitetin dhe për programet kombëtare të veprimit.

Shiko:

- Konkurrueshmëri
- Punësim
- Orientime të Përgjithshme të Politikës Ekonomike (OPPE)
- Strategjia e Lisbonës

Subsidiaritet, ~i / Subsidiarity

Parimi i subsidiaritetit përkufizohet në nenin 5 të Traktatit themelues të Komunitetit Europian. Ky parim ka për qëllim të sigurojë që vendimet të merren sa më afër të jetë e mundur me qytetarët dhe që të kryhen kontrole të vazhdueshme mbi faktin nëse veprimet në nivelin e Komunitetit janë të arsyeshme, duke i krahasuar me mundësitë në nivel kombëtar, rajonal apo vendor.

E shpjeguar më qartë, ky është një parim sipas të cilit, Bashkimi Europian nuk ndërmerr asnjë veprim (me përjashtim të fushave që janë nën kompetencat e tij ekskluzive), në qoftë se ai nuk është më efikas se sa veprimi që mund të merret në nivel kombëtar, rajonal apo vendor. Ky parim është i lidhur mjaft ngushtë me parimet e përpjestueshmërisë dhe domosdoshmërisë, të cilët kërkojnë që çdo veprim i Bashkimit Europian të mos shkojë përtej asaj, që është e nevojshme për arritjen e objektivave të Traktatit.

Këshilli Europian i Edinburgut i mbajtur në dhjetor 1992, lëshoi një deklaratë mbi parimin e subsidiaritetit, e cila përcaktoi rregullat për zbatimin e tij. Traktati i Amsterdimit e përsëriti përjashtjen që rrjedh nga kjo deklaratë në një Protokoll mbi zbatimin e Parimeve të Subsidiaritetit dhe Përpjesëtueshmërisë, që iu shtua Traktatit të Komunitetit Europian. Ky protokoll paraqiti dy elemente të rinj, që janë analiza sistematike e ndikimit të propozimeve legjislative mbi parimin e subsidiaritetit dhe përdorimi, kur është e mundur, i masave më pak detyruese të Komunitetit.

Traktati i Lisbonës në nenin 5 të tij parashikon për herë të parë se Bashkimi mund të veprojë vetëm në rastet kur objektivat e një veprimi nuk mund të arrihen në mënyrë të mjaftueshme nga shtetet anëtare si në nivel qendror dhe në nivel lokal e rajonal. Traktati i referohet për herë të parë nivelit lokal të pushtetit. Traktati i Lisbonës i jep kompetencë parlamenteve kombëtare të ruajnë zbatimin e parimit të subsidiaritetit. Traktati i Lisbonës parashikon dy procedura të reja, të njohura si karta e verdhë dhe karta portokalli të cilat u mundësojnë parlamenteve kombëtare të shprehin shqetësimet e tyre lidhur me parimin e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit.

Në bazë të mekanizmit të kartës së verdhë, parlamentet kombëtare ose komitetet kanë të drejtë të japin një mendim të arsyetuar kur një projektligj nuk plotëson zbatimin e parimit të subsidiaritetit. Më pas, parashikohet një sistem votimi me dy vota për çdo parlament kombëtar. Kur propozimi kundërshtohet nga 1/3 e votave, institucioni që ka propozuar nismën duhet ta rishikojë atë. Institucioni që rishikon legjislacionin mund ta mbajë, ndryshojë ose të tërheqë propozimin dhe duhet të japë arsye për vendimin.

Mekanizmi i parashikuar nga karta portokalli zbatohet vetëm për procesin e zakonshëm legjislativ. Ai parashikon një prag më të lartë dhe pasoja më të forta. Nëse shumica e votave e kundërshtojnë atëherë, Komisioni duhet ta rishikojë projektin. Komisioni mund ta mbajë, tërheqë apo ndryshojë propozimin ligjor. Përpara përfundimit të leximit të parë Parlamenti Europian, dhe Këshilli duhet ta rivlerësojë propozimin në dritën e parimit të subsidiaritetit të argumentave të dhëna nga Komisioni dhe parlamentet kombëtare. Në rast se këshilli voton me 55% të votave ose parlamenti me shumicën e votave kundër propozimit, atëherë ai quhet i pamiratur.

Shiko:

- Shpërndarje e kompetencave
- Parlamente kombëtare
- Parim i përpjestueshmërisë
- Thjeshtim i legjislacionit

SH

Shengen (Marrëveshje dhe Konventë) / Shengen (Marrëveshja dhe Konventa)

Nëpërmjet Marrëveshjes së nënshkruar në Shengen, më 14 qershor 1985, Belgjika, Franca, Gjermania, Luksenburgu dhe Holanda, ranë dakord të hiqnin në mënyrë graduale kontrollet në kufijtë e tyre të përbashkët dhe të lejonin lëvizjen e lirë të të gjithë personave, që ishin shtetas të Shteteve Anëtare që kishin nënshkruar Marrëveshjen, të Shteteve të tjera Anëtare ose të Vendeve të Treta.

Konventa Shengen e plotëson marrëveshjen dhe përcakton kuadrin organizativ dhe masat mbrojtëse për vënien në zbatim të lirisë së lëvizjes. Konventa e Shengenit u nënshkrua nga po këto pesë shtete më 19 qershor 1990, por hyri në fuqi vetëm në vitin 1995.

Marrëveshja dhe Konventa, rregullat e miratuara mbi atë bazë dhe marrëveshjet e lidhura me to, formojnë së bashku të ashtuquajturën "Acquis për Shengenin". Qysh prej vitit 1999, kjo është pjesë e kuadrit institucional dhe ligjor të Bashkimit Europian, me anë të një Protokollit të Traktatit të Amsterdimit.

Marrëveshjet Shengen, me kalimin e kohës, janë zgjeruar për t'i përfshirë të gjithë 15 Shtetet Anëtare të vjetra: Italia i nënshkroi ato në vitin 1990, Spanja dhe Portugalia në vitin 1991, Greqia në vitin 1992, Austria në 1995 dhe Finlanda, Suedia dhe Danimarka (me marrëveshje të veçantë) në vitin 1996. Irlanda dhe Britania e Madhe janë të vetmit pjesëmarrës të pjesshëm në legjislacionin Shengen, duke qenë se kontrolli kufitar në këto shtete nuk është hequr.

Legjislacionin Shengen e kanë miratuar edhe 10 Shtetet e reja Anëtare, mirëpo do të duhet një vendim i Këshillit të Bashkimit Europian përpara se të hiqet kontrolli kufitar në këto shtete.

Qysh në vitin 1996, në zonën Shengen marrin pjesë edhe dy vende, që nuk bëjnë pjesë në Komunitet (Islanda dhe Norvegjia), edhe pse këto shtete kanë një rol të kufizuar në vendimmarrje. Edhe Zvicra ka filluar të punojë në drejtim të hyrjes në legjislacionin Shengen.

Sipas nenit 7 të Protokollit (Nr 19), acquis e Shengen-it është integruar në kuadrin e Bashkimit Europian. Vendet që janë candidate për t'u anëtarësuar në BE duhet ta kenë pranuar medoemos të gjithë legjislacionin Shengen, në momentin e anëtarësimit.

Shiko:

- Zonë-a e Lirisë, Sigurisë, dhe Drejtësisë
- Acquis e BE-së
- Lëvizje e lirë e individëve (viza, azil, imigrim dhe politika të tjera)
- Shtylla të Bashkimit Europian

Shëndet, ~i publik / Public health

Sipas nenit 168 TFBE (ish neni 152 i Traktatit themelues të Bashkimit Europian), veprimtaria në fushën e shëndetit publik synon në parandalimin e sëmundjeve, përfshirë edhe përdorimin e drogës, duke nxitur kërkimet për zbulimin e shkaqeve dhe transmetimin e tyre, duke i kombinuar këto pikësnyime me informimin shëndetësor dhe arsimimin.

Edhe pse veprimi i Bashkimit duhet të plotësojë masat e marra nga Shtetet Anëtare, objektivat e vendosur në nenin 152 arrihen kryesisht, përmes nxitjes së bashkëpunimit midis Shteteve Anëtare, në përputhje me parimin e subsidiaritetit.

Synimet që ka Bashkimi European në fushën e shëndetit publik ndiqen përmes programit të veprimit që mbulon periudhën 2003-2008, duke u përqendruar te informacioni, aftësia për t'iu kundërpërgjigjur rreziqeve që i kanosen shëndetit, promovimi i shëndetit dhe parandalimi i sëmundjeve.

I futur me Traktatin e Mastrihtit, veprimi i Bashkimit (para Traktatit të Lisbonës, i Komunitetit) në fushën e shëndetit publik është përforcuar me Traktatin e Amsterdami.

Shiko:

- Procedurë e vendimmarrjes së përbashkët
- Lëndë narkotike
- Siguri ushqimore
- Parim parandalues
- Subsidiaritet

Shërbime, ~t audiovizive / Audiovisual Services

Politika e Bashkimit European për shërbimet audiovizive duhet të respektojë interesa dhe prioritete të ndryshme dhe disa herë kontradiktore, si: rregullat e konkurrencës (sidomos në lidhje me ndihmën shtetërore), rregullat mbi pronësinë intelektuale dhe parimet e shërbimit publik. Tregu European audioviziv po përballlet edhe me një sërë problemesh që përfshijnë:

- Pengesa gjuhësore që parandalojnë qarkullimin e lirë të programeve;
- Proces i vështirë i vendimmarrjes, i cili në përgjithësi kërkon unanimitet;
- Nevojë për investime të konsiderueshme që kërkojnë aleanca ndërkombëtare dhe/ose shkrirje, për të paraprirë zhvillimet teknologjike

Veprimtaria e Komunitetit European në fushën audiovizive është zhvilluar në dy drejtime:

- Në frontin ligjor, Direktivë për Televizionin pa Kufi, u miratua në vitin 1989 dhe u ndryshua në vitin 1997, duke siguruar një kuadër të harmonizuar për nxitjen e lëvizjes së lirë, prodhimin dhe shpërndarjen e programeve televizive Europiane. U prezantuan rregulla të përbashkëta për reklamimin, sponsorizimin, mbrojtjen e të miturve dhe e drejta e përgjigjes. Direktiva prezantoi dhe kuota të shpërndarjes, duke u kërkuar operatorëve televizivë të caktojnë, kur është e mundur, më shumë se gjysmën e kohës së tyre të transmetimit për çështjet Europiane.

Kjo direktivë është duke u ndryshuar, me idenë për t'i përditësuar rregullat ekzistuese dhe për t'i bërë ato më elastike.

- Skemë mbështetëse përmes programit MEDIA (Masa për nxitjen e zhvillimit të industrisë audiovizive) të Komunitetit. Krijuar në vitin 1991, ky program synon të mbështesë industrinë audiovizive përmes nxitjes së përgatitjes dhe shpërndarjes së veprave Europiane. Ai financon edhe skemat për përmirësimin e trajnimit të profesionistëve në këtë sektor.

Programi që është duke u zbatuar tani është MEDIA 2007, të cilit i është caktuar një buxhet prej thujse 755 milion euro dhe që mbulon periudhën 2007–2013.

Një tjetër prioritet është mbrojtja e të miturve dhe dinjitetit njerëzor në shërbimet audiovizive dhe informative. Në dhjetor 2006, Këshilli dhe Parlamenti European miratuan një rekomandim, me synim nxitjen e autoriteteve shtetërore dhe të palëve të interesuara për ta intensifikuar punën e tyre në këtë fushë.

Shiko:

- Konkurrencë
- Shërbim publik
- Televizion pa kufi

Shërbim, ~i European i Marrëdhënieve me Jashtë / European External Action Service

Shërbimi European i Marrëdhënieve me Jashtë (SHEMJ) u themelua nga Traktati i Lisbonës si një strukturë që do të asistojë Përfaqësuesin e lartë të PPJS. Kjo strukturë do të ndihmojë Bashkimin European në nivel global për t'i dhënë atij një profil më të lartë dhe të mundësojë atë që të projektojë më mirë dhe në mënyrë më eficiente vlerat dhe interesat e tij. SHEMJ do të funksionojë si një institucion i pavarur nga Komisioni dhe sekretari i përgjithshëm i Këshillit. Ai do të asistojë Presidentin e Komisionit, Komisionin, Presidentin e Këshillit European si edhe institucionet e tjera të Bashkimit duke përfshirë dhe Parlamentin European. Traktati prashikon se Shërbimi do të bashkëpunojë me shërbimet diplomatike të shteteve anëtare dhe ai do të përfshijë zyrtarë nga departamentet e vecanta të Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit, të Komisionit si dhe stafit të komanduar nga shërbimet diplomatike të Shteteve Anëtare. Shërbimi do të ngrihet me vendim unanim të Këshillit.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë
- Përfaqësues i Lartë

Shërbime, ~t me interes ekonomik të përgjithshëm / Services of general economic interest

Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm quhen shërbimet tregtare të interesit të përgjithshëm ekonomik, mbi të cilën autoritetet publike vënë detyrime të veçanta të shërbimit publik (neni 86 i Traktatit të Komunitetit European). Shembuj të shkëlqyer janë shërbimet e transportit, energjisë dhe komunikacionit.

Neni 14 TFBE, ish neni i 16, iu shtua Traktatit të Komunitetit European nga Traktati i Amsterdimit, duke pranuar vendin e zënë nga shërbimet me interes ekonomik të përgjithshëm në vlerat e përbashkëta të Bashkimit European dhe rolin e tyre në nxitjen e kohezionit social dhe territorial. Gjithashtu neni 14 përcakton se shërbime të tilla duhet të veprojnë mbi bazën e parimeve dhe kushteve që mundësojnë përmbushjen e funksioneve të tyre.

Neni 36 i Kartës së të Drejtave themelore të Bashkimit European i kërkon BE-së të njohë dhe respektojë lirinë e marrjes së shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm për të nxitur kohezionin social dhe territorial të Bashkimit European.

Shiko:

- Karta e të Drejtave Themelore
- Shërbime me interes të përgjithshëm
- Shërbimi publik
- Karta e Shërbimit Publik
- Shërbim universal

Shërbime, ~t me interes të përgjithshëm / General interest services

“Shërbime me Interes të Përgjithshëm” janë shërbime që konsiderohen të tilla nga autoritetet publike dhe i nënshtrohen detyrimeve specifike të shërbimeve publike. Ato

përfshijnë shërbime jotregtare (p.sh. arsim i detyrueshëm, mbrojtje sociale), detyrime të shtetit (p.sh. siguria dhe drejtësia) dhe shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm (p.sh. energjia dhe komunikimet). Neni 106 TFBE (ish neni 86 i Traktatit) nuk zbatohet për dy kategoritë e para (shërbime jo tregtare dhe detyrime shtetërore).

Në maj 2003, Komisioni Europian miratoi një Dokument të Gjellbër “Për shërbime me interes të përgjithshëm në Evropë”. Ky dokument çeli debatin për rolin e Bashkimit Europian në nxitjen e ofertës me shërbime me interes të përgjithshëm, në përcaktimin e objektivave të tyre me interes të përgjithshëm dhe mënyrën se si organizohen, financohen dhe vlerësohen.

Në maj 2004, Komisioni nxori edhe një Dokument të Bardhë për shërbimet me interes të përgjithshëm, në të cilin shpjegonte qasjen që ndjek Bashkimi Europian për të nxitur zhvillimin e shërbimeve cilësore me interes të përgjithshëm. Në të paraqiten elementet e një strategjie për të siguruar që të gjithë qytetarët dhe firmat në BE, të kenë liri marrjeje të shërbimeve cilësore me interes të përgjithshëm, me çmime të përballueshme. Komisioni ka vendosur ta zhvillojë qasjen e vet sektoriale, pa nxjerrë një direktivë të përgjithshme, hë për hë.

Shiko:

- Shërbim-i publik
- Kartë-a e Shërbimit Publik
- Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm
- Shërbim-i universal

Shërbim-i publik / Public service

Koncepti i Shërbimit Publik ka një kuptim të dyfishtë: ai përfshin si organet që sigurojnë shërbime, ashtu edhe shërbimet me interes të përgjithshëm që ato ofrojnë. Detyrimet e shërbimit publik mund të imponohen nga autoritetet publike mbi organin që siguron shërbimin (shoqëritë e linjave ajrore, transporti rrugor apo hekurudhor, prodhues energjie e kështu me radhë) në nivel kombëtar ose rajonal. Koncepti i shërbimeve publike dhe koncepti i sektorit publik (përfshirë edhe shërbimin civil) shpesh ngatërrohen gabimisht; ato ndryshojnë përsa i përket funksionit, statusit, pronësisë dhe “klientelës”.

Shiko:

- Shërbime me interes të përgjithshëm
- Kartë-a e Shërbimeve Publike
- Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm
- Subsidiariteti
- Shërbim-i universal

Shërbim, ~i universal / Universal service

Shërbimi Universal është një koncept i zhvilluar nga institucionet e Komunitetit. Ai i referohet grupit të kërkesave me interes të përgjithshëm, të cilat duhet të respektohen nga shërbime të tilla si telekomunikacioni dhe posta në të gjithë Komunitetin. Qëllimi është që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të përfitojnë shërbime cilësore me një çmim të arsyeshëm.

Shiko:

- Kohezion ekonomik, social dhe territorial
- Shërbime me interes të përgjithshëm
- Shërbim publik
- Karta e Shërbimit Publik
- Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm

Shoqëri, ~a Europiane / Societas Europaea (SE)

Shoqëria Europiane (e njohur me emrin latin “Societas Europaea” apo SE) është një shoqëri tregtare, e themeluar sipas ligjeve të Komunitetit Europian. Ajo ka kuadrin e vet juridik dhe mund të ushtrojë aktivitetet si një subjekt i vetëm në të gjithë BE-në.

Në vitin 2001, Bashkimi Europian miratoi zyrtarisht Rregulloren për Statutin e një Shoqërie Europiane, si edhe direktivën e lidhur me të, për pjesëmarrjen e punëmarrësve në shoqëritë eruopiane.

Ky legjislacion hyri në fuqi në vitin 2004, pas 30 vjetëve diskutim. Ai u jep mundësi shoqërive tregtare t’i ulin kostot administrative dhe u ofron atyre një strukturë juridike të përshtatshme për tregun e përbashkët, duke mënjeluar kufizimet juridike dhe praktike që lindin nga 25 sisteme të ndryshme juridike.

Në bazë të Statutit të Shoqërisë Europiane, një SE mund të krijohet me:

- bashkim;
- krijim të një shoqërie tip “holding”;
- krijim të një shoqërie të përbashkët të kontrolluar;
- shndërrim të një shoqërie ekzistuese të themeluar në bazë të ligjeve kombëtare.

SE duhet të ketë kapital minimal të nënshkruar prej 120.000 euro dhe selia e regjistruar, e përcaktuar në statut, duhet të përputhet me selinë reale të saj.

Marrëveshja për SE-të është njëra prej përparësive të identifikuar nga Plani i Veprimit për Shërbimet Financiare (FSAP) dhe konsiderohet si jetike për krijimin e një tregu tërësisht të integruar për shërbimet financiare.

Shiko:

- Konkurrueshmëri
- Politikë për Ndërmarrjet
- Tatime

Shoqëri, ~a e Informacionit / Information society

Shoqëri e Informacionit është term sinonim me “Teknologji të reja Informacioni dhe Komunikimi” (TIK). Që në fillim të viteve ‘90, janë zhvilluar me vull TIK-e të reja. Përdorimi universal i shkëmbimit elektronik të informacionit, përqendrimi drejt teknologjive digjitale, rritja eksponenciale e përdorimit të internetit dhe hapja e tregjeve të telekomunikacionit, janë shenja të këtij ndryshimi.

Shoqëria e Informacionit po revolucionarizon shumë fusha të jetës së përditshme, veçanërisht mundësinë për përgatitje profesionale dhe marrje njohurish (mësimi në distancë, shërbimet e lidhura më e-learning), në organizimin e punës dhe mobilizimin e aftësive (puna nëpërmjet televizionit, kompanitë virtuale), në jetën praktike (shërbimet e-health) dhe argëtimin. Gjithashtu sigurohen mundësi të reja në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve për ta bërë më të lehtë shprehjen e mendimit dhe pikëpamjeve. Megjithatë, këto ecuri pozitive shkojnë paralel me problemet e reja. Përdorimi në masë i internetit do të thotë, që janë bërë hapa kundër krimit, piraterisë, dhe çështjes së mbrojtjes të të dhënave personale dhe pronësisë intelektuale. Gjithashtu Shoqëria e Informacionit mund të kontribuojë në kufizimin e disa sektorëve të shoqërisë duke theksuar pabarazi sociale.

Në dritë të këtyre përfitimeve dhe kërcënimeve të mundshme, Bashkimi Europian e ka vënë Shoqërinë e Informacionit në zemër të strategjisë së tij për shekullin XXI. Mes të tjerave, janë hedhur hapa për përkrahjen dhe promovimin (plani i veprimit e-Evropë), si dhe janë miratuar masa, të cilat synojnë kontrollin dhe kufizimin e rrezikut që lidhet me

zhvillimin e Shoqërisë së Informacionit, si një plan veprimi që synon të nxisë përdorimin e sigurt të internetit dhe luftën kundër mesazheve të paligjshme dhe të dëmshme.

Shiko:

- eEuropa
- Pronësi intelektuale
- Telekomunikacion

Shpërndarje, ~a e kompetencave / Distribution of competences

Shpërndarja e kompetencave midis Bashkimit European dhe Shteteve Anëtare bën dallimin midis tre llojeve të ndryshme të kompetencave:

- Tagra paralele ose të përbashkëta (rasti më i zakonshëm);
- Tagra ekskluzive të Bashkimit (Shtetet Anëtare kanë hequr dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo mundësi për të vepruar);
- Tagra mbështetëse në fushat e veprimit mbështetës (detyra e vetme e Bashkimit është bashkërendimi dhe nxitja e veprimit që bëjnë Shtetet Anëtare).

Parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit veprojnë si rregullues të kompetencave, në mënyrë që të sigurojnë respektimin e kësaj shpërndarjeje.

Për herë të parë, nenet 3-6 të TFBE parashikojnë një listë e cila bën ndarjen e fushave të politikave të BE dhe tre llojet e kompetencave. Megjithatë, këto lista janë të shkurtra dhe nuk mbulojnë cdo aspekt të aktivitetit të Bashkimit.

Shiko:

- Kompetenca të Komunitetit
- Kompetenca të Jashtme të Komunitetit European
- Përpjestueshmëri
- Subsidiaritet
- Kompetenca dytësore
- Traktati i Nisës
- Traktati i Lisbonës

Shtylla të Bashkimit European / Pillars of the European Union

Koncepti i “shtyllave”, në përgjithësi, përdoret në lidhje me Traktatin për Bashkimin European deri në hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Struktura bazë e Bashkimit European përbëhet nga tri shtylla, të cilat janë:

- Shtyllë e Komunitetit, që kishte tre Komunitete: Komunitet European, Komunitet European për Energjinë Atomike (Euratom) dhe ish-Komunitet European i Qymyrgurit dhe Çelikut (KEQC) (Shtylla e parë);
- Shtyllë që i kushtohet Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë, e cila vendoste nën Titullin V të Traktatit të BE-së (Shtylla e dytë);
- Shtyllë që i kushtohet Bashkëpunimit Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale, e cila vendoset nën Titullin VI të Traktatit të BE-së (Shtylla e tretë).

Traktati i Amsterdimit i kaloi disa prej fushave që mbulonte Shtylla e tretë në Shtyllën e parë (lëvizja e lirë e personave).

Të tri Shtyllat funksiononin mbi bazën e procedurave të ndryshme të vendimmarrjes: Procedura e Komunitetit European për Shtyllën e parë dhe Procedura Ndërqeveritare për dy shtyllat e tjera. Në rastin e Shtyllës së parë, vetëm Komisioni mund t'i paraqiste propozime

Këshillit dhe Parlamentit European dhe një shumicë e cilësuar mjaftonte për miratimin e një akti të Këshillit. Në rastin e Shtyllës së dytë dhe të tretë, kjo e drejtë e marrjes së nismës ndahej midis Komisionit dhe Shteteve Anëtare dhe, në përgjithësi, ishte i nevojshëm unanimiteti i Këshillit.

Traktati i Lisbonës sjell një ndryshim shumë të rëndësishëm pasi ai eliminon konceptin e shtyllave duke shkruar kryesisht shtyllën e parë dhe të tretën. Komuniteti nuk ekziston më dhe ai do të zëvendësohet me Bashkimin. Megjithatë çështjet e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë janë subjekt i procedurave specifike dhe kjo e fundit është pjesë e TBE.

Shiko:

- Komunitarizëm
- Metodë Ndërqeveritare dhe të Komunitetit
- Komuniteti European
- Bashkimi European
- Kornizë Institucionale e Përbashkët

Shumicë, ~a e cilësuar / Qualified majority

Shumicë e cilësuar, nënkupton numrin e votave të nevojshme në Këshill për miratimin e një vendimi, kur diskutohen çështje mbi bazën e nenit 205 (2) të Traktatit të Komunitetit European.

Pas Konferencës Ndërqeveritare në 2000 dhe Traktatit të Nisës, është rivlerësuar numri i votave që i shpërndahen secilit Shtet Anëtar, në veçanti për ato shtete që kanë popullsi më të madhe, në mënyrë që të ruhet legjitimiteti i vendimeve të Këshillit, sa i takon përfaqësimit gjeografik. Pas datës 1 janar 2007, me zgjerimin e BE-së, shumica e cilësuar u ngrit në 255 vota nga 345 vota gjithsej, duke përfaqësuar një shumicë të Shteteve Anëtare. Për më tepër, një Shtet Anëtar mund të kërkojë të verifikohet nëse shumica e cilësuar përbën apo jo të paktën 62% të popullsisë gjithsej të BE-së. Nëse nuk është arritur ky prag, atëherë vendimi nuk miratohet.

Duke qenë se janë zhvilluar reforma të ndryshme institucionale, votimi me shumicë të cilësuar ka zëvendësuar votimin unanim, i cili është më pak i efektshëm për zhvillimin e një politike operative të Komunitetit (rreziku i vetos).

Shiko:

- Këshilli i Bashkimit European
- Shumicë e dyfishtë
- Kompromisi i Janinës
- Shumicë e cilësuar e përforcuar
- Unanimitet
- Peshim i votave në Këshill

Shumicë, ~a e cilësuar e përforcuar / Reinforced qualified majority

Kur Këshilli European vepron pa pasur nevojë për të marrë propozim nga Komisioni European (në fushat e politikës së jashtme dhe sigurisë së përbashkët, apo të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale), shumica e cilësuar duhet të përfshijë, të paktën, dy të tretat e Shteteve Anëtare.

Në Konferencën Ndërqeveritare të vitit 1996, e cila çoi në miratimin e Traktatit të Amsterdami, u ngrit ideja e një shumice të cilësuar të përforcuar, nga një sërë delegacionesh kombëtare dhe nga Komisioni European.

Ky propozim vjen nga bindja se, nëse ruhet kërkesa për unanimitet, kjo, shumë shpesh, do të shkaktojë zvarritje dhe ngecje të procesit në një BE të zgjeruar. Rrjedhimisht, unanimiteti mund të zëvendësohet, në disa raste të caktuara, me një shumicë të cilësuar të përforcuar, që është më e madhe se përqindja e zakonshme e votave që kërkohen përgjithësisht për votimin me shumicë.

Kushtetuta Europiane, parashikonte që pragu për shumicën e cilësuar të rritej në 72% për të gjithë aktet, me përjashtim të atyre që vijnë me propozim të Komisionit Europian apo të Ministrisë të BE-së për Punë të Jashtme.

Shiko:

- Shumicë e dyfishtë
- Shumicë e cilësuar
- Unanimitet
- Peshim i votave në Këshill

Shumicë, ~a e dyfishtë / Double majority

Në dritën e zgjerimit, janë paraqitur zgjidhje për të ruajtur ekuilibrin ndërmjet vendeve “të vogla” dhe të “mëdha” në vendimmarrje në Këshillin e Ministrave. Pas zgjerimit, ruajtja e sistemit të tanishëm të peshimit të votave në Këshill, mund të rezultojë në shumicë të cilësuar, që përfaqëson vetëm një pakicë të popullsisë së Bashkimit Europian. Për këtë arsye, Shtetet Anëtare me popullsi më të madhe kërkuan një sistem ripeshimi ose shumice të dyfishtë, e cila do të siguronte që shumica në Këshill të përfaqësonte jo vetëm Shtetet Anëtare, por edhe popullsinë e Bashkimit Europian.

Traktati i Nisës i vitit 2001, i cili nisi reformimin e funksionimit të institucioneve të Komunitetit në prag të zgjerimit, e ripërkufizon shumicën e cilësuar, në formën e shumicës së dyfishtë, madje, ndonjëherë, edhe shumicë e trefishtë. Ndërkohë që riponderimi i votave ecën në favor të Shteteve Anëtare të mëdha, shumica e cilësuar duhet të jetë edhe një shumicë e Shteteve Anëtare. Kjo gërshetohet me një sistem të njohur si “mbrojtja demografike”, që do të thotë se çdo Shtet Anëtar mund të kërkojë verifikim nëse shumica e cilësuar përfaqëson apo jo të paktën 62% të popullsisë. Nëse nuk përmbushet ky kusht, atëherë vendimi nuk mund të miratohet. Këto rregulla të reja kanë hyrë në fuqi më 1 nëntor 2004.

Sipas Traktatit të Lisbonës, shumica e cilësuar e dyfishtë që do të aplikohet pas vitit 2014 përfshin:

- 55% të shteteve (çka do të thotë 15, nga 27 shtete)
- që duhet të përkojë me 65% të popullsisë së BE

Pakica bllokuese duhet të përfshijë të paktën 4 Shtete Anëtare.

Shiko:

- Shumicë e cilësuar
- Shumicë e cilësuar e përforcuar
- Unanimitet
- Peshim i votave në Këshillin Europian

T

Taksim, ~i / Taxation

Pavarësisht prej krijimit të një tregu të vetëm të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, nuk ekziston ende një politikë e përbashkët e Bashkimit mbi taksimin. Në nënet 90-93 të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian, janë përcaktuar disa rregulla të veçanta, por procedura e vendimmarrjes në fushën e taksimit kërkon votimin me unanimitet në Këshill. Deri më tani, ky rregull e ka frenuar miratimin e rregullave të përbashkëta për taksat direkte dhe indirekte. Me qëllim shmangien e këtyre pengesave, Komisioni inkurajon tani përdorimin e procedurës së “bashkëpunimit më të ngushtë”, të parashikuar nga Traktati i Amsterdambit dhe të zhvilluar më tej nga Traktati i Nisës. Kjo procedurë i jep mundësi Komisionit për të propozuar që, një grup prej të paktën tetë Shtetesh Anëtarë, të mund të bashkëpunojnë mbi një çështje të caktuar pas marrjes së miratimit me shumicë të cilësuar nga Këshilli. Qëllimi po ashtu, është që të inkurajohen Shtetet Anëtarë që të miratojnë rekomandimet që synojnë eliminimin e pengesave të dëmshme të krijuara nga taksat, në vend të propozimeve ligjore të detyrueshme.

Kontrollet kufitare për TVSH-në u shfuqizuan me krijimin e tregut të vetëm në vitin 1993. Sot produktet taksohen në vendin e blerjes, por pasi Këshilli të vendosë sistemin përfundimtar të TVSH-së, produktet do të taksohen në vendin e origjinës. Për më tepër, TVSH-ja dhe normat e akcizës janë përafëruar shumë në Shtete të ndryshme Anëtarë.

Miratimi i një monedhe të vetme e bën akoma më urgjente vendosjen e normave të përbashkëta të vërteta të TVSH-së dhe rregullave të përbashkëta, për taksimin e ndërmarrjeve në Bashkimin Europian. Këshilli, si pjesë të “paketës mbi taksimin”, që ka për qëllim të luftojë konkurrencën e dëmshme për taksimin, ka miratuar:

- Kod i Sjelljes mbi Taksimin e Ndërmarrjeve (dhjetor 1997);
- Akt normativ për të ndrequr shtrembërimet ekzistuese në taksimin efektiv të të ardhurave nga kursimet, në formën e pagesës së interesit bankar (Direktivë mbi taksimin e të ardhurave ndërkufitare, të rrjedhura nga kursimet - qershor 2003);
- Sistem i përbashkët taksimi të zbatueshëm mbi pagesat e interesit dhe pagesat për përdorimin e pronës, të bëra mes kompanive të bashkuara (Direktivë mbi pagesën e interesit dhe pagesën për përdorimin e pronës - qershor 2003).

Nga ana tjetër, Këshilli është duke shqyrtuar shumë propozime nga Komisioni, ndërmjet të tjerash, propozime mbi reformën e sistemit të përbashkët të TVSH-së, rishikimin e sistemit të përbashkët të taksimit të zbatueshëm në bashkimet dhe ndarjet e ndërmarrjeve, transferimin e aktiveve dhe shkëmbimet e aksioneve që kanë të bëjnë me ndërmarrje të Shteteve të ndryshme Anëtare, si dhe rishikimin e kuadrit komunitar mbi tarifatat për përdorimin e infrastrukturës së transportit (Direktiva “Eurovignette”).

Shiko:

- Bashkim doganor
- Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM)
- Bashkëpunim i zgjeruar
- Harmonizim i sistemeve fiskale

Telekomunikacion, ~i ose komunikimet elektronike / Telecommunications or Electronic communications

Me qëllim plotësimin e tregut të brendshëm, liberalizimi i telekomunikacionit u bë përparësi e Komunitetit Europian në fund të viteve 1980. Procesi filloi në vitin 1988 me hapjen e tregjeve të terminaleve të telekomunikacionit ndaj konkurrencës dhe vazhdoi në vitet 1990 me liberalizimin e shërbimeve të telekomunikacionit, me përjashtim të telefonisë me zë.

Në 1993, Këshilli i Ministrave vendosi t'i liberalizojë tërësisht shërbimet e telefonisë me zë brenda datës 1 janar 1998.

Gjatë kësaj kohe, procesi i liberalizimit është zgjeruar në vitin 1994, për të përfshirë shërbimet e komunikimit dhe transmetimit satelitor dhe, pastaj, në vitin 1996, për të përfshirë rrjetet televizive kablore dhe komunikimin celular. Në të njëjtën kohë, duke filluar nga viti 1990, është vendosur një rrjet i hapur i infrastrukturës dhe shërbimeve të telekomunikacionit (ONP). Miratimi i rregullave të përbashkëta mundësoi harmonizimin e kushteve për hyrjen e subjekteve të reja në treg.

Nga viti 1994 e këtej, në kuadër të zhvillimit të "shoqërisë së informacionit", liberalizimi i strukturave të telekomunikacionit është paraqitur si mënyra për t'i zhvilluar multimediat. Janë miratuar nisma të ndryshme për harmonizimin e standardeve të komunikimit celular (standardi i vetëm GSM Europian) dhe satelitor dhe të rrjetit dixhital të shërbimeve të integruara (ISDN).

Më 1 janar 1998, u bë realitet liberalizimi i tregut të telekomunikacioneve në Evropë. Për të shoqëruar hapjen e sektorit për konkurrencën, Komisioni Europian i hyri një detyre të madhe, në vitin 1999, që është Reformimi i Kuadrit Rregullator të Evropës për Telekomunikacionin. Synimi i përgjithshëm ishte përmirësimi i lidhjes me shoqërinë e informacionit, duke vendosur një drejtpeshim midis rregullimit të këtij sektori dhe normave të konkurrencës të Evropës. Ky Kuadër Rregullator për Komunikimin elektronik përbëhet nga pesë direktiva harmonizuese, duke u përqendruar, në veçanti, në direktivat kuadër, lidhje me interkoneksion, autorizim, shërbim universal dhe të drejta të përdoruesve dhe, mbrojtje e informacionit personal. Këtyre iu shtua Vendimi i vitit 2002 për politikën, për spektrin e valëve radiofonike dhe Rregullorja e vitit 2002, për lidhjen me rrjetin lokal.

Tani, Komisioni Europian është duke e rishqyrtuar këtë kuadër, me idenë për të marrë në konsideratë ndryshimet teknologjike në treg dhe për të plotësuar nevojat e sektorit gjatë dhjetë vjetëve në vijim.

Shiko:

- eEvropa
- Shoqëri e Informacionit
- Rrjete NdërEuropiane (RRTE)
- Shërbim universal

Televizion, ~i pa kufij / Television without frontiers

Koncepti i televizionit pa kufij mbështetet në lëvizjen e lirë të programeve televizive Europiane brenda tregut të brendshëm dhe në futjen e kuotave të transmetimit (kërkesa që kanalet televizive të rezervojnë mbi një të dytën e kohës televizive të tyre për veprat Europiane).

Direktiva e Televizionit pa Kufij është guri themeltar i politikës audiovizive në Komunitetin Europian. Ajo synon mbrojtjen e disa objektivave të caktuara e të rëndësishme me interes publik, siç janë diversiteti kulturor, mbrojtja e të miturve (masat kundër programeve me natyrë të dhunshme ose pornografike) dhe e drejta e përgjigjes. Janë futur edhe disa rregulla të hollësishme për përmbajtjen dhe shpeshhtësinë e reklamave në televizion.

Pas konsultimeve me palët e prekura, në dhjetor 2005, Komisioni European publikoi një propozim për rishikimin e direktivës së televizionit pa kufij, me idenë për t'i modernizuar rregullat ekzistuese. Objektivi kryesor i këtij rishikimi është të marrë në konsideratë zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet në strukturën e tregut audioviziv, që kanë ndodhur pas miratimit të direktivës në 1989. Propozimi i ri synon edhe në zvogëlimin e barrës ekzistuese rregullatore mbi ofruesit e shërbimeve audiovizive. Kjo do të vlejë, sidomos, për dispozitat mbi reklamat, për të cilat Komisioni European propozon që rregullat të jenë më elastike.

Shiko:

- Shërbim audioviziv
- Kulturë
- Shërbim publik

Të drejta të njeriut / Human rights

Edhe pse Traktati i Romës i 1957 nuk përmban një dispozitë të veçantë për mbrojtjen e të drejtave themelore, Gjykata Europiane e Drejtësisë e ka konfirmuar nevojën për respektimin e të drejtave themelore në kontekstin e veprimit në nivel të BE. Mbrojtja e të drejtave themelore nga GJD është frymëzuar gjerësisht nga dispozitat e Konventës për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Europës, e miratuar më 4 nëntor 1950.

Praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë e Bashkimit European pranon parimin e parashikuar në Konventën e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës (KEDNJ), i nënshkruar në Romë, më datë 4 nëntor 1950.

Kushtetuta, që është në proces miratimi, tani parashikon që Bashkimi European të ketë personalitet juridik, çka do t'i japë mundësi të bëhet palë e KEDNJ-së.

Respektimi i të drejtave të njeriut u konfirmua nga Shtetet Anëtare në parathënien e Aktit Unik 1986 dhe më vonë u përfshi në nenin 6 të Traktatit të Bashkimit European, i cili bazohet në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe traditat e përbashkëta kushtetuese të Shteteve Anëtare.

Neni 6 i futur nga Traktati i Mastrohrit dhe ndryshuar nga Traktati i Amsterdimit pohonte se Bashkimi bazohet në parimet e lirisë, demokracisë respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe sundimin e parimeve të ligjit. Bashkimi respekton të drejtat themelore si të garantuara me Konventën e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Europës dhe si pjesë e traditës kushtetuese të Shteteve Anëtare.

Traktati i Lisbonës siguron bazat ligjore për aderimin e Bashkimit në Konventën e të Drejtave të Njeriut. Në bazë të deklaratës së nenit 6 bashkangjitur Traktatit të Lisbonës, pranimi i Bashkimit në Konventë do të bëhet në mënyrë të tillë që të merren parasysh legjislacioni dhe karakteristikat e Bashkimit.

Garancia e respektimit të të drejtave themelore është përforcuar më tej nga Traktati i Amsterdimit, i cili ka shtrirë juridiksionin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European, për të përfshirë respektin për të drejtat, që rrjedhin nga neni 6 në lidhje me veprimin e institucioneve të Bashkimit European. Në të njëjtën kohë, një klauzolë e re pezullimi parashtron se cilat veprime duhet të ndërmerren në rastet kur një Shtet Anëtar shkel seriozisht dhe vazhdimisht parimet mbi të cilat është ngritur Bashkimi European.

Karta e të Drejtave Themelore e shpallur në Këshillin European të Nisës në dhjetor 2000, përmban të drejta të tjera shtesë, të cilat nuk i siguron KEDNJ-ja, sidomos të drejtat sociale për punëtorët, mbrojtja e të dhënave, bioetika dhe e drejta për administrimin më të mirë.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit European, e cila me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës fitoi fuqi ligjore, konfirmon të drejtat themelore të garantuara nga Konventa

Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ashtu siç rezultojnë nga traditat e përbashkëta kushtetuese të Shteteve Anëtare. Karta nuk e zgjeron fushën e veprimit të legjislacionit europian dhe nuk i jep Bashkimit kompetenca të ndryshme nga ato të përcaktuara në Traktate. .

Shiko:

- Karta e të Drejtave Themelore
- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
- Klauzolë e pezullimit

Trajtim, ~i i barabartë i burrave dhe grave / **Equal treatment for men and women**

Që në vitin 1957, Traktati themelues i Komunitetit Ekonomik Europian parashtroi parimin e barazisë mes burrave dhe grave dhe neni 141 (me Traktatin e Lisbonës, neni 157 TFBE) kërkonte që ata të merrnin pagë të barabartë për punë të njëjtë. Që nga viti 1975, një sërë direktivash e kanë zgjeruar parimin për të mbuluar të drejtën e punësimit, kualifikimit dhe karrierës, duke synuar eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit në punë dhe më vonë në sigurimet shoqërore, skemat statutoare dhe skemat e punësimit.

Përveç nxitjes së mundësive të barabarta përmes programeve shumëvjeçare të filluara në vitet '80, Komisioni filloi zbatimin e strategjisë komunitare (2001-2005) për të krijuar një kuadër veprimesh brenda të cilit, të gjitha aktivitetet e Komunitetit Europian mund të kontribuojnë në objektivin e eliminimit të mosbarazisë dhe nxitjen e barazisë ndërmjet burrave dhe grave.

Traktati i Amsterdimit i shtohet nenit 141 (me Traktatin e Lisbonës, neni 157 TFBE), (që është i kufizuar në qëllim duke mbuluar vetëm shpërblimin e barabartë) duke përfshirë nxitjen e barazisë ndërmjet burrave dhe grave, si një nga detyrat e Komunitetit Europian, përcaktuar në nenin e 2-të të Traktatit të Komunitetit Europian. Karta e të Drejtave Themelore, e miratuar në dhjetor 2000, përcakton se "Barazia ndërmjet burrit dhe gruas duhet të sigurohet në të gjitha fushat, duke përfshirë punësimin, punën dhe shpërblimin".

Shiko:

- Karta e të Drejtave Themelore
- Arsimim

Traktate, ~t / **Treaties**

Krijimi i "Komunitetit" të parë, Komuniteti Europian i Qymyrgurit dhe Çelikut (KEQÇ), ishte pikënisja e procesit mbi pesëdhjetëvjeçar të bërjes së traktateve Europiane. Nga viti 1951 (Traktati i KEQÇ) deri në vitin 2001 (Traktati i Nisës), janë nënshkruar jo pak, po 16 traktate. Kjo seri traktatesh ka bërë, më shumë se thjesht, të ndryshojë tekstin origjinal: kanë lindur traktate të reja, të cilat e kanë zgjeruar pak nga pak familjen.

Më poshtë jepen traktatet kryesore:

- Traktat-i themelues i Komunitetit Europian të Qymyrgurit dhe Çelikut (KEQÇ), nënshkruar në Paris në 1951. Ky traktat ka pushuar që qeni në fuqi më 23 korrik 2002.
- Traktat-i themelues i Komunitetit Ekonomik Europian (KEE), nënshkruar në Romë në 1957.
- Traktat-i themelues i Komunitetit Europian të Energjisë Atomike (Euratom), nënshkruar në Romë në 1957.
- Akt-i i vetëm Europian (AE), nënshkruar në Luksemburg në 1986.
- Traktat-i për Bashkimin Europian (TBE), nënshkruar në Mاستriht në 1992.

- Traktat-i i Amsterdimit, nënshkruar, më 2 tetor 1997.
- Traktat-i i Nisës, nënshkruar, më 26 shkurt 2001.
- Traktati i Lisbonës, nënshkruar më 13 dhjetor 2007.

Të gjithë këto traktate janë ndryshuar disa herë, sidomos me anëtarësimin e shteteve të reja në 1973 (Danimarka, Irlanda dhe Mbretëria e Madhe), në 1981 (Greqia), në 1986 (Spanja dhe Portugalia), në 1995 (Austria, Finlanda dhe Suedia), në 2004 (Republika Çeke, Qiproja, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia) dhe në 2007 (Bullgaria dhe Rumania).

Në tetor 2004 u nënshkrua një Projekt-traktat Kushtetues European, i cili synon shfuqizimin dhe zëvendësimin e të gjithë traktateve ekzistuese, me përjashtim të Traktatit të Euratomit, me një traktat të vetëm. Ky projekt-traktat konsolidon traktatet Europiane të 50 vjetëve. Për të hyrë në fuqi, Traktati Kushtetues duhet të miratohet nga të gjithë Shtetet Anëtare në përputhje me rregullat kushtetuese të tyre, domethënë ose miratim nga Parlamenti ose me referendum. Pas vështirësive në miratimin e Traktatit në disa Shtete Anëtare Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive vendosën në mbledhjen e Këshillit European, më 16 dhe 17 qershor 2005, të hapin “një periudhë reflektimi” për të ardhmen e Evropës.

Në mbledhjen e Këshillit European, më 21 dhe 22 qershor 2007, udhëheqësit Europeanë arritën një kompromis dhe ranë dakord të thërrasin një Konferencë ndërqeveritare për të finalizuar dhe miratuar jo një kushtetutë por një “traktat të reformës” për Bashkimin European. Traktati i Lisbonës (Traktati i Reformës) u nënshkrua nga Shtetet Anëtare të Bashkimit të më 13 dhjetor 2007 dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009. Ai ndryshon Traktatin e Bashkimit European (TBE) dhe Traktatin Themelues të Komunitetit European (TTHKE). Traktati Themelues i Komunitetit European tashmë quhet Traktati mbi Funkcionimin e Bashkimit European (TFBE). Qëllimi i Traktatit të Lisbonës është të kompletojë procesin e reformës së nisur me Traktatin e Amsterdimit dhe atë të Nisës, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe legjitimitetit demokratik të Bashkimit, si dhe rritjen e koherencës së veprimeve të Bashkimit.

Shiko:

- Qartësi e traktateve (thjeshtim i traktateve)
- Konferencë Ndërqeveritare (KNQ)
- Rishikim i traktateve
- Traktati i Amsterdimit
- Traktati i Nisës
- Traktati i Lisbonës
- Traktate dhe ligje

Traktati i Amsterdimit / Treaty of Amsterdam

Traktati i Amsterdimit është rezultat i Konferencës Ndërqeveritare të paraqitur në Këshillin European të Torinos, më 29 mars 1996. Ai u miratua në Këshillin European të Amsterdimit, më 16 dhe 17 qershor 1997 dhe u nënshkrua më 2 tetor 1997 nga Ministrat e Jashtëm të pesëmbëdhjetë Shteteve Anëtare. Traktati hyri në fuqi, më 1 maj 1999 (dita e parë e muajit të dytë mbas ratifikimit nga Shteti Anëtar i fundit), pas miratimit nga të gjitha Shtetet Anëtare në përputhje me kërkesat përkatëse kushtetuese.

Nga pikëpamja ligjore, Traktati ndryshon dispozita të caktuara të Traktatit të Bashkimit European, traktatet themeluese të Komuniteteve Europiane dhe akte të tjera të lidhura me to, duke krijuar një politikë të punësimit të Bashkimit, duke transferuar tek Komuniteti (me Traktatin e Lisbonës, Bashkimi) disa nga çështjet në fushën e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme (DPB), duke reformuar Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS), duke zgjeruar votimin me shumicë të cilësuar dhe duke krijuar mundësinë për një

bashkëpunim më të zgjeruar mes Shteteve Anëtare. Ai nuk zëvendëson traktatet e tjera, por i bashkëngjitet akteve të lidhura me të.

Shiko:

- Traktati i Amsterdamit
- Traktate
- Traktati i Nisës

Traktati i Lisbonës / Treaty of Lisbon

Traktati i Lisbonës i njohur fillimisht si Traktati i Reformës u nënshkrua nga Shtetet Anëtare të Bashkimit më 13 dhjetor 2007 dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009. Ai ndryshoi Traktatin e Bashkimit Europian (TBE) dhe Traktatin Themelues të Komunitetit Europian. Traktati Themelues i Komunitetit Europian tashmë quhet Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE). Qëllimi i Traktatit ishte të plotësonte procesin e reformës së nisur me Traktatin e Amsterdamit dhe Traktatin e Nisës, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe legjitimitetit demokratik të Bashkimit, si dhe rritjen e koherencës së veprimeve të Bashkimit.

Bisedimet për reformimin e Bashkimit Europian kishin filluar që në vitin 2001 dhe rezultati i parë ishte projekti i Kushtetutës Europiane, i cili u rrëzua nga referendumet e zhvilluara në Francë dhe Holandë.

Më pas, u propozua Traktati i Reformës, në të cilin ndryshimet kryesore përfshijnë heqjen e strukturës me shtylla dhe heqjen e konceptit të Komunitetit, i cili tashmë është zëvendësuar me Bashkimin. Gjithashtu, Traktati i atribuon personalitet juridik Bashkimit, rrit votimin me shumicë të kualifikuar në Këshillin e Ministrave, rrit përfshirjen e Parlamentit Europian dhe parlamenteve kombëtare, si dhe rrit rastet e procedurës së vendimmarrjes së përbashkët (tashmë procedura e zakonshme) për miratimin e legjislacionit.

Traktati i Lisbonës themelon dy poste të reja, i dyti nga të cilët nuk është krejtësisht i ri. Bëhet fjalë për postet e Presidentit të Këshillit Europian (me kohë të plotë) dhe Përfaqësuesit të lartë për PPJS që është në të njëjtën kohë zëvendëspresident i Komisionit si dhe merr përsipër detyrat e Komisionerit për marrëdhëniet e jashtme. Ai kryeson gjithashtu Këshillin e Ministrave të Jashtëm. Traktati i dha efekt ligjor Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian.

Traktati i Nisës / Treaty of Nice

I miratuar në dhjetor 2000, në mbjllje të Këshillit Europian të Nisës dhe i nënshkruar më 26 shkurt 2001. Traktati i Nisës hyri në fuqi, më datë 1 shkurt 2003.

Traktati ishte rezultat i Konferencës Ndërqeveritare (KNQ), e cila filloi në shkurt 2000, objektivi i së cilës ishte përshtatja e mënyrës së funksionimit të institucioneve Europiane përpara hyrjes së Shteteve të reja Anëtare.

Ky traktat i hapi rrugën reformës institucionale të nevojshme për zgjerimin e ardhshëm të Bashkimit Europian me anëtarësimin e vendeve candidate nga Europa Lindore dhe Qendrore. Disa prej dispozitave të tij janë ndryshuar nga traktati i anëtarësimit të dhjetë Shteteve të reja Anëtare, i cili u nënshkrua në Athinë në prill 2003 dhe Traktati i Luksemburgut për anëtarësimin e Rumanisë dhe Bullgarisë, nënshkruar në prill 2005. Qysh prej 1 janarit 2007, datë kur ndodhi zgjerimi i fundit, Bashkimi Europian është mbështetur në Traktatet e BE-së dhe KE-së, me shtesat dhe ndryshimet më të fundit të bëra me Traktatet e Nisës, Athinës dhe Luksemburgut.

Ndryshimet kryesore të bëra nga Traktati i Nisës, lidhen me kufizimin e madhësisë dhe përbërjes së Komisionit, zgjerimin e votimit me shumicë të cilësuar, një ponderim të ri të

votave brenda Këshillit dhe bërjen më elastike të masave të fuqizuara të bashkëpunimit. Deklarata për të ardhmen e Bashkimit Europian, që i bashkëlidhet traktatit, përcakton hapat e radhës që duhen marrë për t'i thelluar reformat institucionale dhe për t'u kujdesur që Traktati i Nisës të jetë vetëm një fazë në këtë proces.

Projektkushtetuta, e nënshkruar në shtator 2004, u konceptua si një zgjatje e proceseve të reformave institucionale që nisën me Traktatin e Nisës.

Për të hyrë në fuqi, Traktati Kushtetues duhej të miratohej nga të gjithë Shtetet Anëtare në përputhje me rregullat kushtetuese të tyre, domethënë ose me miratim nga Parlamenti Europian ose me referendum. Pas vështirësive në miratimin e Traktatit nga disa Shtete Anëtare, Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive, vendosën në mbledhjen e Këshillit Europian, më 16 dhe 17 qershor 2005, të çelin një "periudhë reflektimi" për të ardhmen e Europës.

Në mbledhjen e Këshillit Europian, më 21 dhe 22 qershor 2007, udhëheqësit Europianë arritën një kompromis dhe ranë dakord të thërrasin një Konferencë Ndërqeveritare për të finalizuar dhe miratuar, jo një kushtetutë, por një "Traktat të reformës" për Bashkimin Europian. Traktati i Reformës (Traktati i Lisbonës) u nënshkrua më 13 dhjetor 2007 dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009.

Shiko:

- Debat mbi të ardhmen e Bashkimit Europian
- Konventa Europiane
- Konferencë Ndërqeveritare (KNQ)
- Deklarata e Lekenit
- Traktate
- Traktati i Amsterdami
- Traktati i Nisës: manual i plotë
- Traktati i Lisbonës

Transparencë, ~a (e drejtë për përdorim të dokumenteve) / Transparency (access to documents)

Neni 15 TFBE (ish neni 255 i Traktatit të KE-së) u jep të gjithë qytetarëve të Bashkimit Europian dhe çdo personi fizik ose juridik që ka rezidencën ose selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar, të drejtën e shikimit të dokumenteve të Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit.

Rregullorja e 30 majit 2001 e vë në zbatim këtë të drejtë të shikimit të dokumenteve nga tre institucionet. Megjithatë parashikon dy lloj përjashtimesh: raste në të cilat liria e shikimit refuzohet automatikisht (për arsye të sigurisë publike, mbrojtjes, marrëdhënieve ndërkombëtare) dhe raste në të cilat liria e shikimit refuzohet (mbrojtje e interesave tregtare të një personi, për shembull) me përjashtim të rasteve kur ka një interes publik më të madh për dhënien e këtij informacioni.

Krahas kësaj, liria e shikimit të dokumenteve duhet të mundësohet përmes vënies në zbatim të një regjistri publik elektronik.

Koncepti i transparencës lidhet me cilësinë e të qenit të hapur të institucioneve të Komunitetit dhe me funksionimin e qartë të tyre. Transparenca lidhet me kërkesat e qytetarëve për një liri më të madhe shikimi të informacionit dhe dokumenteve të BE-së dhe për një përfshirje më të madhe në procesin e vendimmarrjes, çka do të ndihmonte forcimin e ndjesisë së afërsisë me Bashkimin Europian.

Neni 255 është futur në Traktat në vitin 1997, por Këshilli dhe Komisioni Europian kishin miratuar më parë një kod etik në dhjetor 1993. Ky kod i sjelljes vendosi parime të përbashkëta

për të dy institucionet, në përputhje me deklaratën numër 17 “Për të drejtën e shikimit të informacionit” që i bashkëlidhet Aktit përfundimtar të Traktatit për Bashkimin Europian. Mbi bazën e këtij kodi etik, të dy institucionet përfshinë, në rregulloret e brendshme të tyre, dispozita konkrete për lirinë e shikimit të dokumenteve të tyre.

Shiko:

- Qartësi e traktateve (thjeshtim i traktateve)
- Kodifikim i legjisllacionit (formal/zyrtar)
- Konsolidim i legjisllacionit – joformal/deklarues
- Deficit demokratik
- Qeverisje
- Reformim i legjisllacionit
- Thjeshtim i legjisllacionit
- Transparencë e punimeve të Këshillit

Transparencë, -a e seancave të Këshillit / Transparency of Council proceedings

Në Rregulloren e brendshme të vetën, Këshilli i Bashkimit Europian vendos kushtet, në bazë të të cilave publiku mund të ketë liri shikimi të dokumenteve të tij (neni 240 TFBE ish neni 207 i Traktatit themelues të Komunitetit Europian). Më shumë liri shikimi duhet të jepet për dokumentet që lidhen me funksionin legjisllativ (neni 7 i Rregullores së brendshme të Këshillit). Në veçanti, “rezultatet e votimeve dhe shpjegimet e votave, si edhe deklaratat në procesverbal, duhet të bëhen publike”.

Sa u takon diskutimeve dhe debateve gjatë procedurës së bashkëvendosjes, debatet që vijnë pas prezantimit të projektlegjisllacionit nga Komisioni dhe votat (përfshirë edhe diskutimet përfundimtare dhe shpjegimet e votave), bëhen publike. Edhe debatet publike për politikën e përgjithshme dhe propozimet për legjisllacione me rëndësi madhore, zhvillohen një herë në vit. Zakonisht, liria e shikimit për publikun sigurohet përmes mjeteve audiovizive.

Në parim, votat, shpjegimet e votave dhe procesverbalet e Këshillit bëhen publike kur Këshilli është duke realizuar rolin legjisllativ. Edhe rezultatet e votave për vendime të caktuara, sidomos ato që lidhen me Shtyllën e dytë dhe Shtyllën e tretë, mund të publikohen, në varësi të disa kushteve. Nga ana tjetër, votat dëshmuese dhe miratimi i akteve përgatitore, nuk bëhen publike. Përndryshe, diskutimet në Këshill i nënshtrohen ruajtjes së informacionit profesional.

Kështu, transparenca e punimeve të Këshillit mbulohet nga neni 18 TFBE (ish neni 255 i Traktatit të KE-së), i shtuar me Traktatin e Amsterdimit, i cili thotë, se çdo qytetar i Bashkimit Europian dhe çdo person fizik dhe juridik që ka rezidencën ose selinë e regjistruar në një Shtet Anëtar, ka të drejtën e shikimit të dokumenteve të Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit. Sikurse edhe institucionet e tjera Europiane, edhe Këshilli duhet të bëjë publik një regjistër të dokumenteve.

Traktati i Lisbonës sanksionon se Këshilli do të mblidhet në publik kur debatohet dhe votohet legjisllacioni i Bashkimit, por jo-domosdoshmërisht gjatë gjithë negociatave. Transparenca dhe bërja publike e punës së Këshillit lehtëson pjesëmarrjen e shoqërisë civile. Gjithashtu, në këtë mënyrë, gazetarët mund të informojnë qytetarët mbi debatet që zhvillohen në Këshill.

Shiko:

- Coreper
- Këshilli i Bashkimit Europian
- Qeverisje
- Transparencë (liri e shikimit të dokumenteve)

Trojkë, ~a / Troika

“Trojka” përfaqëson Bashkimin Europian në marrëdhëniet e jashtme që bien në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP).

Qysh prej Traktatit të Amsterdimit, Trojka përbëhej nga bashkimi i:

- Ministrit të Jashtëm të Shtetit Anëtar që ka Presidencën e Këshillit të Bashkimit Europian;
- Sekretarit të Përgjithshëm/Përfaqësuesit të lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë;
- Komisionerit Europian të ngarkuar me Marrëdhëniet e Jashtme dhe Politikën Europiane të Fqinjësisë.
- Presidenca mund të ndihmohet, nëse është nevoja, edhe nga përfaqësues të Presidencës së ardhshme (neni 18 i Traktatit për Bashkimin Europian).

Sipas Traktatit të Lisbonës, posti i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë dhe Komisioneri Europian për Marrëdhëniet me Jashtë janë të shkrirë në një pozicion të vetëm: Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë. Ai / ajo zëvendëson përfaqësuesit e dy ish-pozicioneve të mëparshme në “Trojkë”. Kryetari i Këshillit Europian merr pjesë në Trojkë gjithashtu.

Shiko:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Përfaqësuesi i Lartë për CFSP (zoti/zonja CFSP)
- Presidencë e Këshillit të Bashkimit Europian (sistemi me rrotacion)

TH

Thellim, ~i / Deepening

Thellimi ka të bëjë me dinamikën e integritit që ka ekzistuar që në fillim të sipërmarrjes Europiane. Komunitetet Europiane janë zhvilluar nga një bashkim doganor, treg i përbashkët dhe pastaj zonë e euros, deri në një “bashkim gjithnjë e më të ngushtë” midis popujve të Evropës (neni 1 i Traktatit të Bashkimit Europian). Thellimi është një proces që shkon dorë për dorë me zgjerimin dhe shpesh, shikohet si një hap i nevojshëm përpara zgjerimit.

Në këtë frymë është vendosur reforma për politikën kryesore të Komunitetit (PPB dhe Politika Strukturore) dhe për punën e institucioneve për të krijuar një kontekst të favorshëm që Shtetet e reja Anëtare të bashkohen me Bashkimin Europian.

Pas zgjerimit të fundit të Bashkimit Europian në 2004 dhe 2007, respektivisht me 10 dhe 2 Vende të reja Anëtare, një debat mbi ndikimin e zgjerimit mbi thellimin e integritit europian (shpesh ai shihet si ngadalësuar) po zhvillohet në sferën politike, akademike dhe publike.

Shiko:

- Zgjerimi

Thjeshtim, ~i i legjislacionit / Simplification of legislation

Thjeshtim i legjislacionit nënkupton përjashtimin e materialit të tepërt, duke zbatuar në mënyrë rigorozë parimet e domosdoshmërisë dhe përpjestueshmërisë. Ky veprim përfshin kryesisht riformulimin dhe fuqizimin formal dhe joformal të legjislacionit .

Ky koncept mori një rëndësi më të madhe, në lidhje me tregun e brendshëm, që nga hartimi i Librit të Bardhë mbi plotësimin e tregut të brendshëm. Ai është theksuar nga Këshilli Europian i Edinburgut, në vitin 1992. Përgjatë dekadës së fundit është bërë një përpjekje e madhe për të krijuar një treg që garanton të katër liritë, por kjo ka çuar në pasurimin e legjislacionit Europian, thjeshtimi i të cilit është kthyer tashmë në një përparësi, me qëllim që të sigurohet se veprimi i Komunitetit është transparent dhe i frytshëm. Programi pilot (Thjeshtimi i Legjislacionit për Tregun e Brendshëm - THLTB) që mbulon katër fusha të veçanta, ka nisur në maj 1996 dhe është përforcuar me një program shumëvjeçar për thjeshtimin dhe përditësimin e legjislacionit të Komunitetit Europian, të miratuar nga Komisioni Europian në shkurt 2003.

Në përgjigje të deklaratës për cilësinë e hartimit të legjislacionit të Komunitetit, e cila i bashkëlidhet Aktit përfundimtar të Konferencës Ndërqeveritare (1997), në dhjetor 1998 u miratua një Marrëveshje Ndërinstitucionale që përcakton orientimet për përmirësimin e cilësisë së hartimit të legjislacionit.

Në dhjetor 2003, u miratua Marrëveshje e re Ndërinstitucionale, e cila shkon përtej, thjesht, cilësisë së hartimit të legjislacionit, e cila titullohet “Një ligjëbërje më e mirë”.

Shiko:

- Qartësi e traktateve (thjeshtim i traktateve)
- Instrumente ligjore të komunitetit

- Kodifikim i legjislacionit – formal/zyrtar
- Konsolidim i legjislacionit – joformal/deklarues
- Përputhshmëri
- Reformim i legjislacionit
- Subsidiaritet
- Transparencë (liri e shikimit të dokumenteve)

U

Unanimitet, ~i / Unanimity

Termi “unanimitet” i referohet kërkesës që të gjitha Shtetet Anëtare që mbledhen në Këshill, të bien dakord përpara se një propozim të miratohet.

Që nga Akti Unik Europian, unanimiteti është zbatuar në më pak fusha. Në kontekstin e Shtyllës së Parë, rregulli është që votimi kryhet me shumicë të cilësuar. Megjithatë, Shtylla e dytë dhe e tretë, vendosin ende përmes metodës ndërqeveritare dhe kërkesës për unanimitet, megjithëse Traktati i Nisës paraqiti votimin me shumicë të cilësuar në disa çështje të caktuara.

Ndër ndryshimet e futura nga Traktati i Lisbonës, unanimiteti është zëvendësuar me shumicë të kualifikuar për më shumë fusha, të tilla si menaxhimi i kufirit të jashtëm, azilit, emigracionit dhe masat përkatëse për azilkërkuesit dhe trajtimin të rasteve.

Shiko:

- “Urë” komunitare
- Shumicë e dyfishtë
- Kompromisi i Luksemburgut
- Shtylla të Bashkimit Europian
- Shumicë e cilësuar
- Traktati i Nisës
- Peshim i votave në Këshill

“Urë” komunitare (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian) / Community “bridge” (Title VI of the EU Treaty)

Procesi i vendimarrjes në bazë të Traktatit themelues të Komunitetit Europian (Shtylla e Parë) mund të futet për disa dispozita të caktuara të Titullit VI të Traktatit për Bashkimin Europian (Shtylla e tretë), për t’ia përshtatur ato natyrës së Komunitetit. Kjo mundësi ekziston qysh prej themelimit të Bashkimit Europian. Kjo procedurë e njohur si “ura”, kërkon unanimitet në Këshill dhe miratimin nga çdo Shtet Anëtar në përputhje me kërkesat e veta kushtetuese kombëtare.

“Passerelles” janë dispozita të cilat bëjnë të mundur që kërkesat procedurale të thjeshtohen, apo të bëhen modifikime të tjera, pa u nevojitur procedura formale të rishikimit të Traktatit. Ato kërkojnë unanimitet, duke i dhënë kështu çdo qeverie kombëtare të drejtën e vetos. Paragrafi 7 i nenit 48 Titulli VI të TBE është një nga passerelles (urat) e reja të paraqitura në Traktati i Lisbonës. Edhe në ato raste kur parashikohet unanimiteti, me vendim të Këshillit Europian, Këshilli i Ministrave, mund të marrë vendime me shumicë të cilësuar. Përgjatë përbëjnë vetëm vendimet me implikime ushtarake apo ato në fushën e mbrojtjes.

Lidhur me çdo iniciativë të marrë nga Këshilli Europian për përdorimin e dispozitave “passerelles” do të njoftohen për to parlamentet kombëtare. Nëse një prej parlamententeve kombëtare e kundërshton brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit, vendimi i sipërmendur, nuk do të miratohet. Në mungesë kundërshtimesh, Këshilli Europian mund të miratojë vendimin. Për miratimin e vendimeve të sipërmendura, Këshilli Europian vepron

me unanimitet pasi të marrë pëlqimin e Parlamentit European, i cili jepet nga shumica e anëtarëve të tij përbërës.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë
- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)
- Komunitarizim
- Metodë e Komunitetit dhe Ndërqeveritare
- Shtylla të Bashkimit European

Urdhër, ~i European i Arrestit / European arrest warrant

Urdhri European i Arrestit është një vendim gjyqësor i Shteteve Anëtare për arrestimin dhe dorëzimin e një personi të kërkuar për ndjekje penale ose për dënim me burg nga një Shtet tjetër Anëtar.

Urdhri European i Arrestit është një mjet që shërben për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve gjyqësore të Shteteve Anëtare, duke përjashtuar ekstradimin. Ky urdhër bazohet në parimin e njohjes së ndërsjellë të vendimeve në lidhje me çështjet penale.

Urdhri European i Arrestit bazohet në një Vendim Kuadër të miratuar në 13 qershor nga Këshilli. Ky vendim duhet të zbatohet nga 1 janari 2004.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë
- Vendim dhe Vendim për Kuadrin (Titulli VI i Traktatit të BE-së)
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale

V

Vende, ~t kandidat / Candidate countries

Statusi i Vendit Kandidat jepet nga Këshilli European, mbi bazën e një mendimi nga Komisioni European, i cili hartohet pas marrjes së një kërkesë për anëtarësim të paraqitur nga vendi në fjalë.

Megjithatë, Statusi i Vendit Kandidat nuk jep automatikisht të drejtën për t'u anëtarësuar në BE. Komisioni e shqyrton me kujdes kërkesën, në dritën e kriterëve të anëtarësimit (kriteret e Kopenhagenit), ndërsa procesi i anëtarësimit nis me vendimin e Këshillit European për të çelur bisedimet e anëtarësimit.

Në varësi të rrethanave, vendeve kandidat mund t'u kërkohej të vendosin një proces reformash, në mënyrë që ta harmonizojnë legjislacionin e tyre me Acquis Communautaire të Komunitetit dhe të fuqizojnë infrastrukturën dhe administratën e tyre, nëse është nevoja. Procesi i anëtarësimit mbështetet në Strategjinë e Paraanëtarësimit, e cila parashikon instrumente të tilla si ndihma financiare.

Anëtarësimi varet nga përparimi i arritur nga vendi kandidat, i cili matet rregullisht dhe ndiqet nga Komisioni.

Shiko:

- Kriteret e anëtarësimit (kriteret e Kopenhagenit)
- Bisedime të anëtarësimit
- Partneritet për anëtarësim
- Acquis i Komunitetit
- Zgjerim
- PHARE (Program i Ndihmës së Komunitetit për vende të Evropës Qendrore dhe Lindore)
- Ndihmë e paraanëtarësimit
- Strategji e Paraanëtarësimit
- Kontroll rutinë
- TAIEK (Zyrë për Asistencën Teknike dhe Shkëmbimin e Informacionit)

Vendim, ~i dhe Vendim Kuadër (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European) / Decision and framework decision (Title VI of the EU Treaty)

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdambit, këto instrumente të reja sipas Titullit VI të Traktatit të Bashkimit European (Bashkëpunimi gjyqësor dhe policor në çështje penale) kanë zëvendësuar veprime të përbashkëta. Duke qenë më të detyrueshme dhe autoritare, ato duhet ta bëjnë më të efektshëm veprimin nën Shtyllën e tretë të riorganizuar.

Vendimet Kuadër përdoren për të përafuar ligjet dhe rregulloret e Shteteve Anëtare. Propozimet bëhen me nismën e Komisionit ose të një Shteti Anëtar dhe duhet të miratohen me unanimitet. Këto vendime janë të detyrueshme për rezultatin që duhet arritur nga Shtetet Anëtare, por zgjedhja e formës dhe mjeteve u lihet në dorë autoriteteve kombëtare.

Vendimet përdoren për çdo qëllim, përveç përafrimit të ligjeve dhe rregulloreve të Shteteve

Anëtare. Ato janë të detyrueshme dhe masat për zbatimin e tyre në nivel të Bashkimit European miratohen nga Këshilli me shumicë të cilësuar.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, vendimet dhe vendimet kuadër u shfuqizuan.

Shiko:

- Zonë e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë
- Aksion i përbashkët (çështjet e drejtësisë dhe të punëve të brendshme)
- Urdhër European i Arrestit
- Bashkëpunim policor dhe gjyqësor në çështjet penale

Veprim, ~i i përbashkët (Politikë-a e Përbashkët e Jashtme dhe Sigurisë) / Joint action (CFSP)

Ky term, i cili është një instrument ligjor, pjesë e Titullit V të Traktatit të Bashkimit European (Politikë e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë PPJS), do të thotë veprim i bashkërenduar nga Shtetet Anëtare me anë të të cilit mobilizohen të gjitha burimet, (burimet njerëzore, njohuritë, burimet financiare, pajisjet etj) për të arritur objektiva specifike të përcaktuara nga Këshilli në bazë të udhëzimeve të përgjithshme të Këshillit European.

Shiko:

- Politikë e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë (PPJS)

Veprim, ~i i përbashkët (Drejtësia dhe Punët e Brendshme) / Joint action (Justice and Home Affairs)

Veprim i përbashkët, një instrument ligjor në ish Titullin VI të Traktatit të Bashkimit European që u përdor në 1993-1999, do të thotë veprim i bashkërenduar nga Shtetet Anëtare në emër të Bashkimit European ose brenda kuadrit të Bashkimit European, në ato raste, ku për hir të shkallës ose efekteve të veprimit të parashikuar, objektivat e Bashkimit European mund të arrihen më me rezultat nëpërmjet veprimit të përbashkët, sesa nga Shtetet Anëtare në mënyrë individuale. Traktati i Amsterdimit është shfuqizuar dhe është zëvendësuar nga “vendime” dhe “vendime kuadër”.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, veprimet të përbashkëta në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme u shfuqizuan.

Vëzhgim, ~i i zbatimit Të së Drejtës së BE-së / Monitoring the application of EU law

Detyra për vëzhgimin e zbatimit të së Drejtës së BE-së kryhet nga Komisioni European si mbrojtësi i Traktateve. Meqenëse Bashkimi European bazohet në respektimin e ligjit, ky vëzhgim ka rëndësi thelbësore për të siguruar përmbushjen e kërkesave dhe zbatimin e duhur të legjislacionit të Komunitetit nga/dhe në shtetet anëtare. Në ushtrimin e funksionit vëzhgues, Komisioni European kujdeset të ruajë rolin që u është caktuar edhe autoriteteve kombëtare, në veçanti gjykatave në këtë fushë.

Komisioni European mbledh informacion dhe pastaj u jep paralajmërime dhe dënime Shteteve Anëtare, nëse ato nuk i zbatojnë Traktatet e Bashkimit. Zbatimi i dobët ose moszbatimi i Traktateve mund të jetë rezultat i kontrollit mbikëqyrës administrativ, vështirësive teknike në zbatimin e tekstit, vështirësive të vënies në zbatim apo nga shqetësimet lidhur me mënyrën se si mund të reagojnë disa sektorë të caktuar apo publiku.

Nëse një Shtet Anëtar nuk i ka përmbushur detyrimet e veta, Komisioni European mund të japë një pikëpamje të arsyetuar, pasi i ka dhënë mundësi shtetit në fjalë të parashtrijë vërejtjet e veta. Nëse kjo pikëpamje nuk sjell asnjë pasojë, Komisioni mund të hapë çështje

përpara Gjykatës Europiane (procesi kundër një shteti në bazë të nenit 258 TFBE (ish neni 226 të Traktatit themelues të Komunitetit European).

Në lidhje me këtë, Komisioni mund t'i kërkojë Gjykatës t'i vendosë një gjobë Shtetit Anëtar në fjalë, nëse ky i fundit nuk i ka përmbushur kërkesat e mendimit të arsyetuar. Kjo kompetecë ia rriti shumë mundësinë Komisionit për të ndjekur zbatimin e duhur të legjislacionit të Bashkimit.

Krahas kësaj, publikimi i raporteve vjetore të Komisionit për zbatimin e legjislacionit të Komunitetit është shprehje e dëshirës për të pasur transparencë në trajtimin, jo vetëm të ankuesve, por edhe të qytetarëve dhe deputetëve.

Shiko:

- Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane
- Komisioni European
- Legjislacion i Komunitetit



Zgjerim, ~i / **Enlargement**

Bashkimi Europian tani ka 27 Shtete Anëtare. Krahas gjashtë Shteteve të para Anëtare (Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Luksemburgu dhe Vendet e Ulëta) në BE kanë hyrë edhe 21 vende të tjera. Këto vende janë:

- 1973: Danimarkë, Irlandë dhe Mbretëri e Bashkuar e Britanisë së Madhe;
- 1981: Greqi;
- 1986: Spanjë dhe Portugali;
- 1995: Austri, Finlandë dhe Suedi;
- zgjerim i pestë në vitin 2004 dhe 2007: Qipro, Republikë Çeke, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovakia dhe Slloveni, pastaj Bullgari dhe Rumani.

Kroacia, ish-Republika jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia kanë statusin e vendit kandidat. Bisedimet për anëtarësim me Kroacinë dhe Turqinë u çelën më 3 korrik 2005.

Vendet e Ballkanit Perëndimor, që janë të përfshira në procesin e stabilizim-asociimit, kanë statusin e vendit kandidat të mundshëm. Me përjashtim të Kroacisë dhe ish-Republikës jugosllave të Maqedonisë, të cilët janë vende candidate, këto vende janë Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, përfshirë Kosovën, sipas përkufizimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së Nr 1244.

Kriteret e anëtarësimit nuk janë cituar në mënyrë të qartë në Traktatin e Lisbonës, por atyre Traktati u referohet në nenin 49 të TBE, sipas të cilit kriteret e pranimit miratuar nga Këshilli Europian do të merren parasysh. Shteti Kandidat duhet të marrë parasysh vlerat e Bashkimit dhe të plotësojë kërkesat e Këshillit, i cili vendos me unanimitet. Vendi që aplikon për statusin e kandidatit tani duhet të informojë Parlamentin Europian i cili megjithatë nuk luan rol në procedurën e pranimit. Është Këshilli i cili vendos gjithnjë me unanimitet. Më pas, procedohet me ratifikimin e Traktatit të Hyrjes nga Shtetet Anëtare dhe shteti aspirant për t'u bërë anëtar, sipas dispozitave kushtetuese kombëtare.

Shiko:

- Pranim i Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin Europian
- Thellim
- Kriteret e anëtarësimit (kriteret e Kopenhagenit)
- Bisedime të anëtarësimit
- Vende candidate

Zonë Europiane e Kërkimeve Shkencore / European Research Area (ERA)

Zona Europiane e Kërkimeve Shkencore bashkon të gjitha burimet e Komunitetit për të bashkërenduar më mirë aktivitetet e kërkimeve shkencore dhe shpikjeve, si në nivelin e Shteteve Anëtare, ashtu edhe në nivelin e Bashkimit Europian.

Ky koncept filloi nga Komisioni në vitin 2000, duke synuar që të zhvilloheshin mundësi me të vërtetë interesante për kërkuesit.

Më përpara, kërkimi shkencor në nivel Europian ballafaqohej me vështirësi të shumta

si: fragmentarizimi i veprimtarive, izolimi i sistemeve kombëtare të kërkimit shkencor, mospërputhje të skemave administrative dhe ligjore dhe nivele të ulëta të investimit në njohuri.

Me anë të burimeve të mundshme, Zona Europiane e Kërkimeve Shkencore duhet të mundësojë ndarjen e të dhënave, krahasimin e rezultateve, kryerjen e studimeve shumë disiplinore, transferimin dhe mbrojtjen e njohurive të reja shkencore dhe të ofrojë mundësi përfitimi nga qendrat e ekselencës dhe pajisjet e fjalës së fundit të shkencës.

Zona Europiane e Kërkimeve duhet të përmbushë në këtë mënyrë një ambicie të rëndësishme së veçantë për Bashkimin Europian, e cila qëndron në zhvillimin e një politike të përbashkët për kërkimin shkencor.

Shiko:

- Kërkim dhe zhvillim

Zonë, ~a e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë / Area of freedom, security and justice

Është vendosur për të krijuar një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, me synimin për të siguruar liri të vërtetë të lëvizjes së njerëzve në territorin e Bashkimit Europian dhe një veprim më të efektshëm kundër krimit të organizuar dhe krimit ekonomik.

Çështjet që lidhen me drejtësinë dhe punët e brendshme, më parë trajtoheshin vetëm në kuadër të rregullave ndërqeveritare, sidomos në kuadër të Titullit VI të Traktatit të BE-së (“Shtylla e tretë”).

Traktati i Amsterdimit “e komunitarizoi” azilin, imigrimin dhe bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile. Ai e ruajti Shtyllën e tretë, që tani i kushtohet vetëm bashkëpunimit policor dhe bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale. Por të gjitha çështjet DPB janë rigrupuar nën titullin e përgjithshëm të zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Traktati i Lisbonës përfundoi shkrirjen e mbetur të shtyllës së tretë, atë të gjyqësorit dhe Bashkëpunimin Policor në shtyllën e parë. Kjo do t'i mundësojë Bashkimit të zhvillojë veprimet e veta dhe politikat të cilat përmbushin pritshmëritë e qytetarëve në lidhje me lirinë dhe sigurinë. Kjo zonë do të rregullohet nga legjislacioni i BE-së, i miratuar me anë të vendimeve me shumicë të cilësuar nga Këshilli dhe procedurë vendimmarrjeje të përbashkët me Parlamentin Europian. Traktati përfshin krijimin e “sistemit të menaxhimit të integruar të kufirit të jashtëm”. Gjithashtu, ai i hap rrugën krijimit të Zyra Europiane të Prokurorisë.

Shiko:

- Komunitarizim
- “Urë” komunitare
- Bashkëpunim i zgjeruar
- Eurojust
- Europol (Zyrë Policore Europiane)
- Lëvizje e lirë e individëve (viza, azil, imigrim dhe politika të tjera)
- Shtylla të Bashkimit Europian
- Bashkëpunim Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale
- Bashkëpunim Gjyqësor në Çështjet Civile
- Shengen (Marrëveshje dhe Konventë)
- Kornizë institucionale e përbashkët

Zyrë, ~a Europiane Kundër Mashtrimit (ZEKM) / European Anti-Fraud Office (OLAF)

Që nga data 1 qershor 1999, Zyra Europiane Kundër Mashtrimit ka qënë përgjegjëse për luftën kundër mashtrimit në buxhetin e Bashkimit Europian.

Zyra, e cila u ngrit me vendim të Komisionit Europian, zëvendësoi Njësinë e Bashkëndimit të Parandalimit të Mashtrimit (NJBPM), e krijuar në vitin 1988 me një mandat të kufizuar për të kontrolluar vetëm aktivitetin e Komisionit Europian.

Zyra e re mbikëqyr menaxhimin dhe financimin e të gjitha institucioneve të Bashkimit me një pavarësi të plotë vepruese. Kjo pavarësi garantohet nga:

- Drejtor i OLAF-it: i emëruar me marrëveshje ndërmjet Parlamentit, Komisionit dhe Këshillit, ka të drejtë të apeloje përpara Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Europiane me qëllim që të mbrojë pavarësinë e tij. Për më tepër, ai mund të nisë një hetim jo vetëm me kërkesë të institucionit, të organit apo Shtetit Anëtar në fjalë, por edhe me nismën e tij;
- Komitet Mbikëqyrës i OLAF-it: përgjegjës për vëzhgimin e funksionit hetues, i përbërë nga pesë figura të jashtme të pavarura, të emëruar bashkërisht nga Parlamenti, Komisioni dhe Këshilli.

Rregullat për hetimet e brendshme të kryera nga OLAF-i, me qëllim luftimin e mashtrimit, korrupsionit dhe veprimtarive të tjera të paligjshme, të cilat dëmtojnë interesat e Komuniteteve Europiane, janë përcaktuar në një Marrëveshje Ndërinstitucionale të datës 25 maj 1999 ndërmjet Parlamentit, Këshillit dhe Komisionit. Kjo Marrëveshje i zgjeron kompetencat e zyrës, duke përfshirë raste serioze të sjelljes joprofesionale të zyrtarëve dhe anëtarëve të tjerë të stafit, me pasoja disiplinore ose penale. Disa rregullore trajtojnë njoftimin e parregullsisë dhe rikuperimin e shumave të paguara gabimisht. Disa rregullore të tjera, përcaktojnë procedurën për hetimin dhe veprimet, si edhe kontrollet në vend.

Shiko:

- Komisioni Europian
- Luftë kundër krimit ekonomik

Zyrë, ~a e Shkëmbimit të Informacionit për Ndhimën Teknike (TAIEX) / Technical Assistance Information Exchange Office (TAIEX)

Programi i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit (TAIEX) është një instrument për ngritjen e institucioneve për të ofruar asistencë afatshkurtër në fushën e miratimit, zbatimit dhe kontrollit të zbatimit të Acquis së BE-së. Ky instrument funksionon qysh prej vitit 1996 dhe përgjegjësitë dhe fusha e veprimtarisë së tij është rritur qysh atëherë.

Asistenca nga TAIEX-u u jepet vendeve kandidate, vendeve që anëtarësohen në kuadër të strategjisë së paraanëtarësimit dhe procesit të kontrollit rutinë, dhjetë Shteteve të reja Anëtare dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

TAIEX-i ka në objektin e tij edhe vendet e përfshira në politikën Europiane të fqinjësisë dhe Rusinë, të cilët i asiston në hartimin dhe vënien në zbatim të legjisllacionit të tyre, në përputhje me planet e tyre të veprimt.

TAIEX-i i centralizon kërkesat për ndihmë, nga autoritetet publike dhe nga sektori privat dhe vendos kontakte midis kërkuesve dhe Shteteve Anëtare. Ky program angazhon ekspertë dhe organizon openenca, studime apo vizita vlerësuese, seminare pune dhe trajnime. Ai ndihmon edhe me përkthimin e legjisllacionit dhe ofron bazë të dhënash të ekspertëve dhe informacion për harmonizimin e legjisllacionit.

Shiko:

- Acquis e BE-së

- Zgjerim
- Politikë e fqinjësisë
- PHARE (Program i ndihmës së komunitetit për vende të Evropës Qendrore dhe Lindore)



Zhvillim, ~i i qëndrueshëm / Sustainable development

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm i referohet një mënyre të rritjes ekonomike, që përmbush nevojat e sotme, pa vënë në rrezik mundësinë e brezave të ardhshëm që të plotësojnë kërkesat e tyre. Ai synon t'i përmirësojë kushtet e jetesës së njerëzve, duke ruajtur, në të njëjtën kohë, mjedisin e tyre në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe mbi të gjitha, afatgjatë. Objektivi i zhvillimit të qëndrueshëm është i trefishtë: zhvillim që të jetë ekonomikisht eficient, shoqërisht i drejtë dhe mjedisor i qëndrueshëm.

Parimi i integritimit të problemeve të mjedisit në formulimin dhe zbatimin e politikave të tjera, gjë që është thelbësore për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm, u konfirmua në Traktatin e Mastrohitit.

Në maj 2001 është miratuar një Strategji e BE-së në favor të zhvillimit të qëndrueshëm, ndërsa në vitin 2005 kjo strategji është rishikuar për t'i dhënë një shtytje të re. Partneriteti Global për Zhvillimin e Qëndrueshëm, i miratuar nga Komisioni në vitin 2002, i dha kësaj strategjie një shtrirje të jashtme.

Përfshirja e çështjeve mjedisore në vendosjen dhe zbatimin e politikave të tjera, është thelbësore për arritjen e objektivit të zhvillimit të qëndrueshëm. Ky parim është pajtuar nga Traktati i Mastrohitit dhe në Samitin e Kardifit në vitin 1998 dhe përbën gurin themelitar të punës në nivel komuniteti për integrimin e çështjeve mjedisore.

Për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, autoritetet publike duhet të marrin masat e duhura, për t'i kufizuar pasojat dëmtoese të transportit dhe rreziqet ndaj shëndetit, për të përmirësuar administrimin e burimeve natyrore, sidomos konsumin e tyre, dhe për të luftuar përjashtimin social dhe varfërinë në Evropë dhe në mbarë botën. Ato duhet të marrin edhe masa kundër ndryshimit të klimës dhe për t'i kufizuar pasojat e kësaj dukurie.

Bashkimi European dhe Shtetet Anëtare të tij po punojnë për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm, jo vetëm brenda BE-së, por edhe përtej kufijve të tij, kryesisht përmes organizmave ndërkombëtare dhe në mbledhje të tilla, siç është Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm, i cili u zhvillua në Johannesburg në gusht-shtator 2002.

Traktati i Lisbonës pohon se një nga objektivat e Bashkimit European është që të punojë për zhvillimin e qëndrueshëm të Europës duke u bazuar në mënyrë të veçantë, në një nivel të lartë të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit. Edhe pse ideja e zhvillimit të qëndrueshëm është përfshirë në traktatet ekzistuese, Traktati i Lisbonës e përforcon dhe e përcakton më mirë këtë objektiv. Zhvillimi i qëndrueshëm afirmohet gjithashtu si një nga objektivat themelore të Bashkimit në marrëdhëniet e saj me të tretë.

Mjedisi është një nga fushat e kompetencave të përbashkëta midis Bashkimit dhe Shteteve Anëtare. Kur Bashkimi ndërhyr në këtë fushë, ai duhet të kontribuojë për qëllime e objektiva të qarta: ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut, nxitjen e përdorimit të kujdesshëm dhe racional të burimeve natyrore, nxitjen e masave në nivel ndërkombëtar për t'u marrë me problemet rajonale e mjedisit ose të gjithë botën. Ndryshimi i klimës është mes sfidave më të mëdha mjedisore, sociale dhe ekonomike me të cilat tashmë përballlet njerëzimi. Me Traktatin e Lisbonës, parandalimi i ndryshimit të klimës në një nivel ndërkombëtar bëhet një objektiv specifik i politikës mjedisore të BE-së. Traktati i Lisbonës shton mbështetjen e veprimeve ndërkombëtare për

të luftuar ndryshimet klimatike në listën e objektivave të përcaktimit të politikave mjedisore në nivel të BE. Kështu, Traktati pohon në mënyrë të qartë se BE-ja ka një rol drejtues për të luajtur në skenën botërore në këtë fushë.

Shiko:

- Aftësi konkurruese
- Energjetikë
- Politikë për ndërmarrjet
- Mjedis
- Globalizim
- Protokoll i Kiotos
- Parim parandalues

Zhvillim, ~i rural / Rural development

Zhvillimi rural është Shtylla e dytë e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB). Ai përputhet me objektivin e Lisbonës për aftësinë konkurruese dhe me objektivin e Gotenburgut për qëndrueshmërinë dhe përqendrohet në katër fusha themelore:

- Aftësi konkurruese e bujqësisë, produkteve ushqimore dhe pyjeve;
- Administrim i tokës dhe mjedisi;
- Cilësi e jetës dhe shumëllojshmëri e zonave fshatare;
- Nismë e komunitetit udhëheqës.

Aftësia konkurruese duhet të përmirësohet përmes masave që kanë në objektiv të tyre kapitalin njerëzor dhe fizik dhe produktet ushqimore, përfshirë prodhimin cilësor. Po futen disa masa për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe përmirësimin e sistemeve bujqësore dhe pyjore me vlerë të lartë natyrore. Po përmirësohet cilësia e jetës në fshat, duke nxitur shumëllojshmërinë e veprimtarive ekonomike dhe zhvillimin e infrastrukturës lokale. Në fund, nisma e udhëheqësit nxit shumëllojshmërinë e veprimtarive ekonomike në fshat përmes skemave novatore të zhvillimit lokal të integruar, me theksin e vendosur te pjesëmarrja.

Politika e zhvillimi rural ka kuadrin e vet të integruar të financimit dhe programimit. Këshilli ka hartuar një qasje strategjike për periudhën 2007-2013, e cila do të shndërrohet në plane strategjike kombëtare. Duke filluar nga 1 janari 2007 të gjitha masat do të financohen nga një fond i vetëm: Fondi Europian Bujqësor për Zhvillim Rural (FEBZH).

Shiko:

- Politikë e Përbashkët Bujqësore (PPB)
- Kohezion ekonomik, social dhe territorial
- Mjedis
- Siguri ushqimore
- Strategjia e Lisbonës
- Natyrë 2000
- Fonde strukturore dhe Fond i Kohezionit

SHTOJCË

TERMAT E FJALORIT SIPAS RENDIT ALFABETIK NË ANGLISHT

Abstention, constructive (positive abstention)	Abstenim konstruktiv (abstenim pozitiv)
Accession criteria (Criteria of Copenhagen)	Kriteret e pranimit (Kriteret e Kopenhagenit)
Accession negotiations	Bisedimet për anëtarësim
Accession of new Member States to the European Union	Anëtarësimi i Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin Europian
Accession partnership	Partneritet për anëtarësim
Animal welfare	Mirëqenia e kafshëve
Antitrust control	Kontrolli antitrust
Area of freedom, security and justice	Zona e Lirisë, Sigurisë dhe Drejtësisë
Article 36 Committee of the EU Treaty	Komiteti i krijuar në përputhje me nenin 36 të Traktatit të Bashkimit Europian
Assent procedure	Procedura e pëlqimit
Audiovisual Services	Shërbime audiovizive
Barcelona Process	Proces i Barcelonës
Broad economic policy guidelines (BEPG)	Orientimet e Përgjithshme të Politikës Ekonomike (OPPE)
Budget	Buxheti
Candidate countries	Vendet kandidatë
Charter of Fundamental Rights	Karta e të Drejtave Themelore
Citizen's Initiative	Iniciativë Qytetare
Citizenship of the Union	Qytetaria e Bashkimit
Clarity of the Treaties (simplification of the Treaties)	Qartësia e Traktateve (thjeshtimi i Traktateve)

Classification of expenditure	Klasifikim i shpenzimeve
Codecision procedure	Procedura e vendimmarrjes së përbashkët
Collective defence	Mbrojtja kolektive
Comitology	Komitologji
Committee of the Regions (CoR)	Komiteti i Rajoneve (KR)
Committees and working parties	Komitete dhe grupe të punës
Common action (justice and home affairs)	Aksion i përbashkët (çështjet e drejtësisë dhe të punëve të brendshme)
Common Agricultural Policy (CAP)	Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB)
Common Commercial Policy	Politika e Përbashkët Tregtare
Common fisheries policy	Politika e Përbashkët e Peshkimit
Common Foreign and Security Policy (CFSP)	Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë
Common organisation of the agricultural markets (COM)	Organizimi i Përbashkët i Tregjeve Bujqësore
Common position (CFSP)	Qëndrim i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)
Common strategy (CFSP)	Strategji e përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)
Common transport policy	Politika e Përbashkët e Transportit
Communitisation	Komunitarizimi
Community "bridge" (Title VI of the EU Treaty)	"Ura" komunitare (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European)
Community and intergovernmental methods	Metoda Komunitare dhe Ndërqeveritare
Competition	Konkurrenca
Competitiveness	Konkurrueshmëria
Composition of the European Commission	Përbërja e Komisionit European
Concentric circles	Rrathë bashkëqendrorë

Conciliation Committee	Komiteti i Pajtimimit
Confirmation of the European Commission	Konfirmimi i Komisionit Europian
Consolidation of legislation- formal/ official	Kodifikim i legjislacionit (zyrtar)
Consolidation of legislation- informal/ declaratory	Konsolidim i legjislacionit (jozyrtar)
Consultation procedure	Procedura e këshillimit
Consumer protection	Mbrojtja e konsumatorit
Convention (Title V of TFEU)	Konventa (Titulli V i TFBE)
Convergence criteria	Kriteret e konvergjencës
Cooperation procedure	Procedura e bashkëpunimit
Coreper	Coreper (Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm)
COREU (CORespondance EUropéenne)	COREU
Council of the European Bashkim	Këshilli i Bashkimit Europian
Court of Justice of the European Union	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian
Culture	Kultura
Customs Union	Bashkimi Doganor
Debate on the future of the European Union	Debat mbi të ardhmen e Bashkimit Europian
Decision and framework decision (Title VI of the EU Treaty)	Vendimi dhe vendimi kuadër (Titulli VI i Traktatit të BE)
Declaration (CFSP)	Deklarata (PPJS)
Deepening	Thellimi
Democratic deficit	Deficit demokratik
Development aid	Ndihmë për zhvillim
Distribution of competences	Shpërndarja e kompetencave
Double majority	Shumicë e dyfishtë

Economic and Monetary Union (EMU)	Bashkimi Ekonomik dhe Monetar (BEM)
Economic policy	Politika Ekonomike
Economic, social and territorial cohesion	Kohezioni Ekonomik, Social dhe Territorial
Education, Training, Youth and Sports	Arsimi, Formimi, Rinisa dhe Sporti
eEurope	eEurope (Europa elektronike)
Employment	Punësimi
Employment Committee	Komiteti i Punësimit
Energy	Energjia
Enhanced cooperation	Bashkëpunim-i më i ngushtë
Enlargement	Zgjerimi
Enterprise policy	Politika për ndërmarrjet
Environment	Mjedisi
Environmental liability	Përgjegjësia mjedisore
Equal opportunities	Mundësi të barabarta
Equal treatment for men and women	Trajtim i barabartë i burrave dhe grave
EU Acquis	Acquis i BE-së
EU Law	E drejtë-a e BE-së
EU Legal Instruments	Instrumente Ligjore të BE-së
EU Patent	Patenta e BE-së
EU Powers	Kompetenca të BE-së
Eurojust	Eurojust
European Anti-Fraud Office (OLAF)	Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (ZEKM)
Europe “a la carte”	Europa “a la karte”
European arrest warrant	Urdhri European i arrestit
European Central Bank (ECB)	Banka Qendrore Europiane (BQE)

European Commission	Komisioni European
European Community	Komuniteti European
European Company	Ndërmarrje Europiane
European Convention	Konventa Europiane
European Convention on Human Rights (ECHR)	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNj)
European Council	Këshilli European
European Council President	President-i i Keshillit European
European Court of Auditors	Gjykata Europiane e Llogarive
European Court of Human Rights	Gjykatë a Evropiane e të Drejtave të Njeriut
European Development Fund	Fondi European i Zhvillimit
European Economic and Social Committee (EESC)	Komiteti European Ekonomik dhe Social (KEES)
European Employment Strategy (EES)	Strategjia Europiane për Punësimin (SEP)
European External Action Service	Shërbimi European i Marrëdhënieve me Jashtë
European institutions	Institucionet Europiane
European Investment Bank (EIB)	Banka Europiane e Investimeve (BEI)
European Judicial Network in criminal matters (EJN)	Rrjeti Gjyqësor European për çështjet penale
European Parliament	Parlamenti European
European political cooperation (EPC)	Bashkëpunim politik European (BEP)
European political parties	Partitë politike Europiane
European Research Area (ERA)	Zonë Europiane e Kërkimit Shkencor (ZEKSh)
European security and defence identity	Identiteti European i mbrojtjes dhe sigurisë
European security and defence policy (ESDP)	Politika Europiane e Mbrojtjes dhe Sigurisë (PEMS)

European Union	Bashkimi Europian
European Union agencies	Agjencitë e Bashkimit Europian
Europol (European Police Office)	Europol (Zyra Europiane e Policisë)
Excessive deficit procedure	Procedura e deficitit të tepërt
External responsibilities of the European Community	Kompetencat e jashtme të Bashkimit Europian
Fight against drugs	Lufta kundër lëndëve narkotike
Fight against fraud	Lufta kundër mashtrimit
Fight against organised crime	Lufta kundër krimit të organizuar
Fight against racism and xenophobia	Lufta kundër racizmit dhe ksenofobisë
Fight against terrorism	Lufta kundër terrorizmit
Financial perspective	Perspektiva financiare
Food safety	Siguria ushqimore
Free movement of persons (visas, asylum, immigration and other policies)	Lëvizja e lirë e personave (vizat, azili, imigracioni dhe politika të tjera)
Galileo	Galileo
General Court	Gjykatë-a e Përgjithshme
General interest services	Shërbime me interes të përgjithshëm
Genetically modified organisms (GMOs)	Organizma Gjenetikiht të Modifikuara (OMGJ)
Globalisation of the economy	Globalizim i ekonomisë
Governance	Qeverisje
Green Paper	Libri i Gjellbër
Hard core	Bërthama e fortë
Hierarchy of Community acts (hierarchy of norms)	Hierarkia e akteve Komunitare (hierarkia e normave)
High Representative for the CFSP (Mr/ MS CFSP)	Përfaqësues i Lartë i PPJS (z/znj PPJS)
Human rights	Të drejtat e njeriut

Humanitarian aid	Ndihma humanitare
i2010	i2010
Information society	Shoqëri informacioni
Institutional balance	Ekuilibrë institucional
Intellectual property	Pronësi intelektuale
Intergovernmental Conference (IGC)	Konferencë Ndërqeveritare (KNQ)
Ioannina compromise	Kompromisi i Janinës
Joint action (CFSP)	Veprim i përbashkët (PPJS)
Joint action (Justice and Home Affairs)	Veprim i përbashkët (Drejtësia dhe Punët e Brendshme)
Joint position (Title VI of the EU Treaty)	Qëndrim i përbashkët (Titulli VI i Traktatit të BE)
Judicial cooperation in civil matters	Bashkëpunimi Gjyqësor në Çështjet Civile
Kyoto Protocol	Protokolli i Kioto-s
Laeken Declaration	Deklarata e Laeken-it
Legal personality of the Union	Personaliteti juridik i Bashkimit
Lisbon Strategy	Strategjia e Lisbonës
Luxembourg compromise	Kompromisi i Luksemburgut
Measures to combat money laundering	Masa për të luftuar pastrimin e parave
Mergers	Bashkime të ndërmarrjeve
Monetary policy	Politika Monetare
Monitoring the application of EU law	Vëzhgimi i zbatimit të së drejtës së BE-së
“Multi speed” Europe	Europa “me ritëm të shpejtë”
National parliaments	Parlamente kombëtare
NATO (North Atlantic Treaty Organisation)	NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
Natura 2000	Natyra 2000

Neighbourhood Policy	Politika e fqinjësisë
“New-look” NATO	NATO “e rinovuar”
Non-discrimination principle	Parimi i mosdiferencimit
OLAF (European anti-fraud office)	OLAF (Zyra Europiane kundër mashtrimit)
Ombudsman	Avokati i Popullit
Open method of coordination	Metoda e hapur e koordinimit
Opting out	Klauzola e mospjesëmarrjes
Outermost regions	Rajonet më të largëta
Own resources	Burime të veta
Parliamentary committees	Komisione parlamentare
Petersberg tasks	Detyrat e Petersbergut
Petitions	Peticione
Pillars of the European Union	Shtyllat e Bashkimit Europian
Police and judicial cooperation in criminal matters	Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështjet Penale
Political and Security Committee (PSC)	Komiteti Politik dhe i Sigurisë
Pre-accession assistance	Ndihma para anëtarësimit
Pre-accession strategy	Strategji para anëtarësimit
Precautionary principle	Parimi parandalues
Presidency of the Council of the European Union	Presidenca e Këshillit të Bashkimit Europian
President of the European Commission	President i Komisionit Europian
Programme of Community aid to the countries of Central and Eastern Europe (PHARE)	Programi i Ndhmës Komunitare për Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore
Proportionality principle	Parimi i proporcionalitetit
Public health	Shëndeti publik
Public procurement	Prokurimi publik

Public service	Shërbimi publik
Public service charter	Statuti i shërbimit publik
Qualified majority	Shumica e cilësuar
REACH (regulatory framework for chemicals)	REACH (Kuatri rregullator për kimikatet)
Recasting of legislation	Riformulim i legjislacionit
Reinforced qualified majority	Shumica e cilësuar e përforcuar
Research and development	Kërkimi dhe zhvillimi
Revision of the Treaties	Rishikim i Traktateve
Right of legal initiative	E drejta e nismës legjislative
Rural development	Zhvillimi rural
Schengen (Agreement and Convention)	Shengen (Marrëveshja dhe Konventa)
Screening	Kontroll paraprak
Services of general economic interest	Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm
Simplification of legislation	Thjeshtim i legjislacionit
Single institutional framework	Kornizë institucionale e përbashkët
Small and medium-sized enterprises	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
Social Charter (Charter of the Fundamental Social Rights of Workers)	Karta Sociale (Karta e të Drejtave Themelore Sociale të Punëtorëve)
Social dialogue	Dialogu social
Social partners	Partnerë socialë
Social policy	Politikë sociale
Social Policy Agreement	Marrëveshja për Politikën Sociale
Societas Europaea (SE)	Shoqëria Europiane
Stabilisation and Association Process	Procesi i Stabilizimit Asociativ
Stability and Growth Pact	Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit
State aid	Ndihma shtetërore

Statute for Members of the European Parliament	Statuti për Deputetë të Parlamentit Europian
Structural Funds and Cohesion Fund	Fonde Strukturore dhe Fondi i Kohezionit
Subsidiarity	Subsidiaritet
Subsidiary powers	Kompetenca dytësore
Suspension clause	Klauzola e pezullimit
Sustainable development	Zhvillimi i qëndrueshëm
TAIEX (Technical Assistance Information Exchange Office)	TAIEX (Zyra e Shkëmbimit të Informacionit për Ndhmën Teknike)
Tax harmonisation	Harmonizimi i taksave
Taxation	Taksimi
Telecommunications or Electronic communications	Telekomunikacioni ose komunikimet elektronike
Television without frontiers	Televizioni pa kufij
Trans-european networks (TEN)	Rrjetet NdërEuropiane
Transparency (access to documents)	Transparenca (e drejta e përdorimit të dokumenteve)
Transparency of Council proceedings	Transparenca e seancave të Këshillit
Treaties	Traktatet
Treaty of Amsterdam	Traktati i Amsterdimit
Treaty of Lisbon	Traktat-i i Lisbonës
Treaty of Nice	Traktati i Nisës
Troika	Trojka
Unanimity	Unanimiteti
Uniform Electoral Procedure for the European Parliament	Procedura Standarde Zgjedhore e Parlamentit Europian
Universal service	Shërbimi universal
“Variable-geometry” Europe	Europa me “gjeometri të ndryshme”

Vocational training

Përgatitja profesionale

Weighting of votes in the Council

Peshimi i votave në Këshill

Western European Union (WEU)

Bashkimi European Perëndimor (BEP)

White Paper

Libri i Bardhë

Youth

Rinia

Fjalorth për Integrimin European, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit European

Botuar nga:
Ministria e Integrimit
Rruga Papa Gjon Pali II, Nr. 3, Tiranë, Shqipëri.

Ky botim u mundësua me mbështetjen financiare të Bashkimit European (IPA 2008) dhe Qeverisë Gjermane në kuadër të Projektit të GTZ-së Mbështetje për Ministrinë e Integrimit - SMEI II